

## **KORRUPSIONI DHE ANTIKORRUPSIONI NË SISTEMIN E DREJTËSISË**

Për autorin:

Cristi Danilet është 34 vjeç dhe ka qene gjyqtar që prej 1998. Që nga viti 2003, ka qenë anëtar i një numri organizatash te ndryshme ne mbrojtje te pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe promovimit të integritetit të gjyqtarëve si: Shoqata e Magjistratëve të Rumanisë (anëtar i Komitetit Drejtues i degës Cluj 2003 – 2004), Shoqëria për Drejtësi (anëtar themelues që prej vitit 2005, President që prej vitit 2009), Transparency International Rumani (anëtar që prej vitit 2004, zgjedhur në Komitetin Drejtues në vitin 2007) dhe Bashkimi Kombëtar i Gjyqtarëve të Rumanisë (anëtar që prej vitit 2008).

Autori ka qenë anëtar i grupit të punës të krijuar nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës në vitin 2006 dhe iu caktua detyra e përgatitjes së një “Profili të Gjyqtarit/Prokurorit në Sistemin Ligjor Rumun”. Është bashkautor i punimit “Faktorët e Presionit dhe Konfliktet e Interesit në Sistemin e Drejtësisë”. Manual për Gjyqtarët (Shoqëria për Drejtësi, Konrad Adenauer Stiftung, 2007).

Nga viti 2005 deri në 2007 Cristi Danilet ishte anëtar i Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për Efiçencën e Drejtësisë. Atje, përktheu Rekomandimet përkatëse të Komitetit të Ministrave, që u mblodhën në përmbledhjen “Efektiviteti dhe Paanësia e Drejtësisë - Standardet Evropiane” (Instituti Rumun për të Drejtat e Njeriut, 2008), gjendet edhe në faqen e internetit të Këshillit të Evropës: [www.coe.int/cepej](http://www.coe.int/cepej). Në mars 2007 Cristi Danilet përfaqësoi Rumaninë në mbledhjen e ekspertëve të shteteve anëtare të OKB-së që kontribuan në përgatitjen e punimit “Komentar për Parimet e Bangalorit për Sjelljen Gjyqësor”, i cili përfaqëson kodin etik më të rëndësishëm të hartuar ndonjëherë për gjyqtarët.

Aspekte të këtij studimi kanë qenë tema prezantimesh që Cristi Danilet ka bërë në ngjarje të ndryshme si: simpoziumi ndërkombëtar “Etika dhe Kultura Profesionale: një qasje shumë disiplinore”, mbajtur nga Fakulteti i Historisë dhe Filozofisë të Universitetit Babes-Bolyai në Cluj-Napoca, më 5-6 tetor 2007; një konference ekstra kurrikulare që synohet për një audiencë të përbërë nga studentë të vitit të parë organizuar në Institutin Kombëtar të Magjistraturës më 9 tetor 2007; fjala e mbajtur në Shkollën e Vjeshtës në kuadër të projektit Rrjeti i ‘Gazetarëve’ për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut’, organizuar nga Lidhja për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut – dega Cluj në partneritet me Shoqatën e Gazetarisë Profesionale Cluj, mbajtur në Baisoara, Qarku Cluj, më 19-20 tetor 2007; fjalë e mbajtur në kuadër të programit të trajnimit për gazetarët ‘Media dhe Drejtësia – Në Kërkim të Dialogut’, organizuar nga Freedom House Rumani në Sinaia, më 22 – 24 shkurt 2008. Një paraqitje përmbledhëse e këtijstudimi u botua fillimisht nga Lidhja për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut – dega Cluj në ‘Gazetën tetor-dhjetor 2007’, që më pas u detajua nga Copoeru, Ion dhe Nicoleta Szabo (koordinatore) në ‘Etica si cultura profesionala’ (Kultura dhe Etika Profesionale), Cluj-Napoca: Editura Casa Cartii de Stiinta, 2008, 218-255.

Në fushën e korrupsionit Gjyqësor dhe të antikorrupsionit, autori mori një çmim nga Instituti Kombëtar i Magjistraturës për esenë e tij ‘Korrupsioni i Parë nga Brenda’ në tetor 2008. Ka marrë pjesë edhe në një program trajnimi ‘Ndërtimi i Integritetit Gjyqësor organizuar nga Instituti CEELI në Pragë, në nëntor 2008.

Shumë analiza për korrupsionin, pavarësinë e gjyqësorit, dhe reformën në sistemin gjyqësor mund të gjenden në blogun e autorit në adresën:

<http://cristidanilet.wordpress.com>.

Cristi Danilet  
KORRUPSIONI DHE  
ANTIKORRUPSIONI  
NË SISTEMIN E DREJTËSISË  
EDITURA C.H. BECK  
Descrierea CIP a Bibliotecii Nationale a României  
DANILET, CRISTI  
Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë  
Cristi Danilet. - Bucharest : Editura C.H. Beck, 2009  
Bibliogr.  
ISBN 978-973-115-771-9  
343.352  
Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.  
Tiergartenstrasse 35  
D-10785 Berlin  
Gjermani  
Tel.: +49 30 269 96 453  
Faks: +49 30 269 96 555  
Website: [www.kas.de](http://www.kas.de)  
Programi për Sundimin e Ligjit Evropa Juglindore  
Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.  
50 Plantelor Street  
Sector 2  
RO-023975 Bukuresht  
Rumani  
Tel.: +40 21 323 31 26  
Faks: +40 21 326 04 07  
e-mail: [office.rspsoe@kas.ro](mailto:office.rspsoe@kas.ro)  
Website: [www.kas.de/rspsoe](http://www.kas.de/rspsoe)

Redaktuar prej: Dr. iur. Stefanie Ricarda Roos, Director,  
Programi për Sundimin e Ligjit Evropa Juglindore  
Corina Rebegea, Koordinatorë Projekti,  
Programi për Sundimin e Ligjit Evropa Juglindore

Përktheu: Veronica Vasilescu

Ky është një botim për tu shpërndarë falas.  
Programi për Sundimin e Ligjit Evropa Juglindore i Fondacionit Konrad Adenauer nuk  
mban asnjë përgjegjësi në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi.  
Për përmbajtjen e këtij libri përgjigjet vetëm autori.

MOTO: 'Çdo njeri i veshur me pushtet priret të abuzojë me të'  
(Monteskje)

Falenderojmë Prof. Dr. Ion Copoeru nga Fakulteti i Filozofisë të Universitetit Babes-  
Bolyai të Cluj-Napoca, në idenë fillestare të cilit u bazua ky libër.

Listë Shkurtimesh

ANI - Agjencia Kombëtare e Integritetit

ANP - Administrata Kombëtare e Burgjeve

CCJE - Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian

GJEDNJ - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

ECEJ - Komisioni Evropian për Eficiencën e Drejtësisë

CoE - Këshilli i Evropës

SCM - Këshilli i Lartë i Magjistraturës

DGA - Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion

DGPA - Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen Antikorrupsion

NAD - Drejtoria Kombëtare Antikorrupsion

GRECO – Grupet e Vendeve kundër Korrupsionit

HCCJ – Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe Drejtësisë

MAI – Ministria e Administratës dhe e Brendshme

MJ - Ministria e Drejtësisë

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

SIPA - Shërbimi i Mbrojtjes së Pavarur dhe Antikorrupsion

SRI – Shërbimi Informativ Rumun

TI - Transparency International

TI-RO - Transparency International Rumani

BE- Bashkimi Evropian

UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNODC – Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin

## **PËRMBAJTJA**

Parathënie

**Hyrje**

### **Pjesa I - NOCIONET E PËRGJITHSHME PËR KORRUPSIONIN**

1. Tri vlerat
2. Çfarë është korrupsioni
  - 2.1 Opinioni publik
  - 2.2 Përkufizimi i fjalorit
  - 2.3 Rregullimet Ndërkombëtare
  - 2.4 Rregulloret Kombëtare
  - 2.5 Çfarë nuk është korrupsion? <sup>1</sup>
3. Sistemi gjyqësor dhe korrupsioni.

### **Pjesa II - DOBËSITË NË SISTEMIN E DREJTËSISË**

1. Besimi publik në sistemin gjyqësor
2. Korrupsioni gjyqësor në anketimet e opinionit
3. Personat e ndjekur penalisht dhe dënimet për korrupsionin në gjyqësor
4. Dobësitë në sistemin e drejtësisë
  - 4.1 Llojet e vendimeve në sistemin e drejtësisë
  - 4.2 Dobësi në fushat gjyqësore dhe të administrimit gjyqësor
  - 4.3 Dobësitë në fushën administrative
5. Diagnostikimi i korrupsionit në sistemin e drejtësisë
  - 5.1 Shkaqet e korrupsionit
  - 5.2 Format e korrupsionit
  - 5.3 Mjetet e korrupsionit
  - 5.4 Mënyrat e korrupsionit
  - 5.5 Qëllimi i korrupsionit
  - 5.6 Efektet e korrupsionit gjyqësor
  - 5.7 Llojet e korrupsionit

### **Pjesa III STANDARDET E INTEGRITETIT GJYQËSOR**

1. Rregullimet dhe përpjekjet mbarë botërore
2. Instrumentet e Këshillit të Evropës
3. Instrumentet e Bashkimit Evropian
4. Programet e tjera antikorrupsion dhe të integritetit publik

### **Pjesa IV POLITIKAT ANTIKORRUPSION PËR SISTEMIN E DREJTËSISË**

1. Komponentët e politikave antikorrupsion.
2. Përkufizim i tipareve të politikave antikorrupsion
3. Kuadri aktual antikorrupsion

---

<sup>1</sup> Shkëputur nga materialet e fushatës kombëtare ‘*Mos paguaj ryshfet!*’ (2004). Shih [www.nudaspage.ro](http://www.nudaspage.ro).

4. Parandalimi i korrupsionit në sistemin gjyqësor
5. Lufta kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë

## **KONKLUSIONE**

### ***Shtojca***

Shtojca I - Raport i Korrupsionit Global 2007, çështjet kyçe të korrupsionit gjyqësor  
Aneksi II - Pikëpamja e komisionerit për të drejtat e njeriut mbi korrupsionin në gjyqësor.

Aneksi III -Gjykimet e formës së prerë të dënimeve në çështjet penale rumune për krimet e korrupsionit gjyqësor.

### **Bibliografi**

## Parathënie

Korrupsioni është një koncept i përdorur gjerësisht gjatë pak viteve të fundit në Rumani dhe gjetkë, me një luftë efektive kundër fenomenit të konsideruar si parakusht për vetë ekzistencën e sundimit të ligjit si dhe tregues i qeverisjes së mirë. Integriteti në sistemin publik, korrupsioni dhe lufta kundër korrupsionit janë të gjitha fraza që përfaqësojnë një gamë të tërë sjelljesh që kanë krijuar hapësirën e tyre në fjalorin e zakonshëm të politikanëve, OJQ-ve, medias ose publikut të gjerë, ndjeshmëria e të cilëve ndaj fenomenit është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Kjo vjen kryesisht për shkak të monitorimit të Bashkimit Evropian duke pasur parasysh integrimin e Rumanisë në fushat kyçe të sistemit të drejtësisë në një kuptim të gjerë. Mbisundimi i temës në monitorimin e kryer nga Komisioni Evropian theksohet shumë qartë nga fakti se dy nga katër standardet kishin të bënin me luftën kundër korrupsionit, si në nivelin qendror dhe atë vendor. Nga ana tjetër, korrupsioni është përkufizuar gjithnjë e më tepër si çështje që ndikon në të gjithë shoqërinë, duke kryer shkelje në sektorët që besohen se janë të cënueshëm e duke pasur një ndikim përtej kufijve të një vendi.

Nga pikëpamja e cënueshmërisë nga korrupsioni dhe ndikimit të tij shoqëror, sistemi i drejtësisë mbetet një nga fushat më të ndjeshme dhe të dukshme në këtë drejtim. Është bërë gjithnjë e më tepër imperative nevoja për të zhvilluar e implementuar disa politika të përshtatshme që luftojnë korrupsionin në sistemin e drejtësisë. Ajo fillon nga kërkuesit e drejtësisë, për të cilët një sistem gjyqësor i paanshëm është një e drejtë themelore, dhe për gjyqtarët e prokurorët dhe *kategoritë* e tjera në sistem, të cilët gjithnjë e më tepër po ekspozohen ndaj kritikës së publikut. Pavarësisht nga studimet e shumta dhe strategjitë e iniciuara nga organizatat publike dhe joqeveritare, lënda është ende e pashteruar, veçanërisht në lidhje me strategjitë apo politikat konkrete të hartuara për të siguruar integritetin dhe pavarësinë e sistemit. Nga kjo pikëpamje, 'Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë' shkruar nga Gjyqtari Cristi Danilet paraqet një pamje të fenomenit nga brenda, mjetet që ekzistojnë për të luftuar korrupsionin dhe opsionet për parandalimin dhe sanksionimin e sjelljes së papranueshme.

Programi i Sundimit të Ligjit të Evropës Juglindore (RLP SEE) i Fondacionit Konrad Adenauer ka bashkëpunuar me Gjyqtarin Cristi Danilet në disa programe për integritetin dhe pavarësinë e drejtësisë, që janë edhe këto gjithashtu dy tema themelore të punës së ndërmarrë nga RLP SEE si në Rumani edhe në vende të tjera në rajon. Prandaj, bashkëpunimi ynë për këtë botim nuk ishte rastësor. Nga ana tjetër, ai plotëson gamën e veprimeve të ndërmarra nga RLP SEE *për qëllimin e rritjes së ndërgjegjësimit të specialistëve që punojnë për të reformuar sistemin e drejtësisë duke njohur rëndësinë e luftës kundër korrupsionit, për shanset e shëndosha të reformës së drejtësisë dhe për funksionimin e shoqërisë në përgjithësi*. Nga ana tjetër, publikimi i këtij vëllimi është pjesë e rëndësishme e përpjekjeve që RLP SEE po bën së bashku me partnerët në rajon për të identifikuar individët që mund të bëheshin pjesë e reformës së sistemit të drejtësisë dhe për të implementuar strategjitë dhe programet më të mira për të konsoliduar integritetin e sistemit të drejtësisë dhe sundimin e ligjit në përgjithësi.

Për këto arsye, ky vëllim është një ftesë për dialog si për specialistët edhe për vendimmarrësit politikë, si dhe për publikun e gjerë, i cili ndikohet po njëjloj nga debati publik për luftën kundër korrupsionit dhe për reformimin e sistemit të drejtësisë. Libri i Gjyqtarit Danilet përshkruan praktikën më të zakonshme nëpërmjet të cilave shfaqet korrupsioni në sistemin e drejtësisë në një kuptim të gjerë, duke funksionuar në këtë mënyrë si një udhëzues për njerëzit që dëshirojnë të identifikojnë dhe të kuptojnë format

e ndryshme që mund të marrë korrupsioni. Në të njëjtën kohë, ai është një përpjekje për të sistematizuar mjetet ekzistuese ndërkombëtare, rajonale dhe vendore në mënyrë që të nxirren zgjidhjet më të mira për mangësitë në integritetin e gjyqësorit rumun.

Shpresojmë që ky botim do të bëhet mjet i dobishëm jo vetëm për gjyqtarët, prokurorët apo stafin e gjykatave, por edhe për pjesën tjetër të kategorive profesionale që veprojnë në sistemin publik.

Synimi i këtij botimi dhe i debatit që ai mund të gjenerojë së bashku me iniciativa të tjera të ngjashme është që të kontribuojë për krijimin e një mase kritike që të çojë në zhvillimin e politikave të duhura për luftën kundër korrupsionit në drejtësi dhe nëpërmjet kësaj në konsolidimin e një sistemi transparent, efektiv, të paanshëm gjyqësor, që është një nga synimet kryesore të Programit për Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore.

Dr. Stefanie Ricarda Roos, M.A.L.D.

Drejtore

Programi për Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore

Konrad Adenauer Foundation, Bukuresht

stefanie.roos@kas.ro

Tetor 2009



## Hyrje

Drejtësia është shtylla vertebrale e çdo shoqërie demokratike. Sundimi i ligjit dhe pranimi i vlerave dhe parimeve të tij nënkupton besimin tek drejtësia. Që të ekzistojë besimi i qytetarëve tek sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë duhet të jenë në gjendje që të ofrojnë besueshmëri. Ata duhet të kenë sjellje të paqortueshme dhe sjellje profesionale shembullore. Duke u nisur nga këto kërkesa të veçanta, në këtë studim kemi analizuar integritetin gjyqësor dhe se si mund të dëmtohet ai nga korrupsioni. Synimi i kësaj sipërmarrjeje është që të arrijë të masë në mënyrë të besueshme korrupsionin në sistemin e drejtësisë rumune me qëllim që të mbahet pozicioni i duhur ndaj pretendimeve gjithnjë e më relevante që jo gjithmonë kanë bazë të fortë.

Është e vërtetë se korrupsioni mund të gjendet në çdo vend, në çdo nivel të organizatave të tij publike dhe private. Megjithatë, kuptimi i tij shpesh njihet shumë pak si nga publiku i gjerë madje dhe nga disa profesionistë të ligjit. Në fakt kjo vlen edhe për nocionet e tjera të përdorura gjerësisht si 'profesionalizmi', 'integriteti', 'deontologjia', 'shërbimi publik' ose 'interesi publik'. Fjala 'korrupsion', për shembull, nuk përkufizohet në legjislacionin vendor për organizimin gjyqësor, në statusin e gjykatësit/prokurorit, në statutin e stafit ndihmës dhe të lidhur me ta, apo në kodet deontologjike të këtyre kategorive profesionale. Kërkimi për fjalën 'integritet' (vetëm integriteti moral, natyrisht, jo integriteti fizik apo mendor) vetëm sa i përsërit tre citime me një enumeracion të thjeshtë fjalësh në aktet normative të lartpërmendura. Rregullorja e Vlerësimit të Gjyqtarëve/Prokurorëve parashikon, pa e detajuar, se integriteti duhet të vlerësohet 'mbi bazën e respektimit të standardeve të sjelljes, sanksioneve disiplinore të zbatuara dhe paanshmërisë'.

Në përgjithësi, me pranimin në një profesion ligjor dhe gjatë karrierës profesionale, dy gjërat e vetme që vlerësohen janë aftësia për të mbajtur mend nocionet ligjore, shumica e të cilave madje nuk shfaqen fare në punën tonë, dhe, në rastin më të mirë, mendimi logjik. Nuk janë zhvilluar rrugë të mjaftueshme për të matur forcën e karakterit, vertikalishtin dhe qëndrueshmërinë ndaj presionit; nuk janë kultivuar rrugë dhe metoda të mjaftueshme për të njohur dhe penguar abuzimin. Veç këtyre, mungesa e aftësive elementare të menaxhimit dhe komunikimit çon në përjetësimin e një gjendjeje indiference ose mos përfshirjeje të anëtarëve të një ekipi në organizatën e tyre. Shpërndarja e pamjaftueshme e informacionit tek publiku për mënyrën se si organizohet dhe funksionon sistemi i drejtësisë shpesh çon në humbjen e besimit dhe në një përhapje artificiale të korrupsionit.

Në këtë kontekst, synojmë të trajtojmë një çështje të ndjeshme - korrupsionin në sistemin e drejtësisë. Është çështje e ndjeshme sepse nuk duhet të ketë korrupsion në sistemin e drejtësisë për sa kohë që sistemi është pjesë e mekanizmit ligjor dhe institucional që supozohet ta luftojë atë.

Nga ana tjetër, bindjet e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, nëpunësve të gjykatave ose punonjësve të policisë gjyqësore në vitet e fundit, tregojnë se nuk kemi metoda të mjaftueshme për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sistem. Lënda e trajtuar është e ndjeshme edhe për arsyen se stafi i sistemit të drejtësisë e ka të vështirë të flasë për korrupsionin, meqenëse sistemi ende nuk ka zhvilluar një qëndrim të fortë kundër korrupsionit. Megjithatë, ka mjaft studime, raporte, statistika dhe madje çështje të gjykuara që na mundësojnë të krijojmë një opinion të informuar për korrupsionin në sistemin e drejtësisë. Kemi zgjedhur të flasim për 'sistemin e drejtësisë' sepse kjo punë përfshin jo vetëm gjyqtarët/prokurorët, por edhe policinë gjyqësore, avokatët, nëpunësit

e gjykatave, përmbauesit, noterët publikë, likuidatorët, ekspertët, inspektorët e integritetit e kështu me radhë. Është e ndjeshme edhe sepse shoqëria rumune shpesh i sheshon lehtësisht pretendimet e korrupsionit kundër nëpunësve civilë dhe gjyqtarëve/prokurorëve edhe në rastet kur çështja është thjesht një keqfunksionim organizativ ose një mungesë kompetence e agjentit publik. Ky punim e trajton këtë temë në katër pjesë të veçanta, duke parë çështjet e përgjithshme të korrupsionit që lidhen me sistemin e drejtësisë, modalitetet dhe mjetet e korrupsionit të punonjësve të sistemit, instrumentet ndërkombëtare në dispozicion në këtë fushë dhe metodat ose politikat kryesore kundër korrupsionit që aplikohen në sistemin e drejtësisë.

Objektivi i këtij studimi - më tepër sociologjik se sa ligjor - është që të ketë një qasje sistematike duke vlerësuar integritetin e sistemit rumun të drejtësisë në nivelin institucional dhe individual. Natyrisht, studimi nuk është i vlefshëm vetëm për Rumaninë, megjithëse shumica e referencave konkrete do të jenë për këtë vend. Rezultati i këtij kërkimi nuk synon që të jetë përgjithësues, por që të marrë parasysh situatat e përzgjedhura të mbledhura nga të dhënat zyrtare dhe përvoja personale.

Autori

## PJESA I

### NOCIONET E PËRGJITHSHME PËR KORRUPSIONIN

Parandalimi dhe lufta e korrupsionit në sistemin e drejtësisë është një objektiv parësor për reformimin e sistemit, në kontekstin më të gjerë të luftës në nivel kombëtar kundër fenomenit. Korrupsioni i drejtësisë mund të dëmtojë vlerat më të rëndësishme shoqërore, duke konsideruar faktin se sistemi ligjor është hartuar pikërisht për të siguruar epërsinë e ligjit, i cili shoqërohet, mes të tjerash, me ndjekjen penale dhe sjelljen para drejtësisë të veprave penale të korrupsionit.

Ligjshmëria është thelbësore për funksionimin e drejtësisë. Kjo karakteristikë e veçantë vjen nga kuptimi që ka publiku për mënyrën se si organizohet sistemi i drejtësisë, nga besimi që njerëzit kanë në kompetencën e gjyqtarëve/prokurorëve<sup>2</sup> dhe punonjësve të tjerë të sistemit, si dhe nga njohuritë për rregullat me të cilat funksionon sistemi dhe nga pranimi i autoritetit të gjykimeve të gjykatës. Veç masave mbrojtëse ligjore të profesionalizmit, punonjësve të sistemit gjyqësor u kërkohet të kenë edhe një aftësi specifike morale dhe një sjellje të caktuar.

#### 1. Tri vlerat

Çdo njeri që përfshihet në një çështje gjyqësore, që sillet para një forumi të drejtësisë shtetërore pret një vendim të paanshëm. Që të ndodhë kjo, veç zbatimit të procedurave, gjykatësi, prokurori, oficeri i policisë dhe figurat e tjera duhet të jenë profesionalë, duhet të veprojnë në mënyrë objektive dhe duhet të jenë asnjans.

Të gjitha këto janë aspekte që i përkasin paanshmërisë si vlerë morale, e cila nga ana e saj, ndërtohet mbi pavarësinë dhe e ka burimin tek integriteti. Kjo është arsyeja se për ata që operojnë në sistemin tonë - magjistrat ose stafi i rregullt - sundimi i ligjit supozon praninë e të tri vlerave:

Paanshmëria, pavarësia dhe integriteti.

*Paanshmëria* është vlera supreme, që nënkupton edhe si kushte, edhe si masa mbrojtëse dy nocionet e tjera. Paanshmëria është vlerë morale; ajo i përket vetes së brendshme të njeriut dhe për agjentin publik të drejtësisë do të thotë analizimi i fakteve bazuar në ligjin e aplikueshëm në mënyrë të drejtpeshuar mirë, pa paragjykim dhe parapëlqim në lidhje me çështjen që trajton, dhe pa vepruar në ndonjë mënyrë që do të favorizonte interesat e njëjës palë<sup>3</sup>. Paanshmëria e punonjësve të drejtësisë garantohet nga regjimi i tyre i papërputhshmërive dhe kufizimeve, përkatësisht konfliktet e interesave. Për gjyqtarët/prokurorët, edhe paraqitja është vlerë në vetvete: nuk mjafton që ata të marrin vendime për të qenë të paanshëm, ai ose ajo duhet edhe të shihet si i/e paanshme nga kërkuesit e drejtësisë.

*Pavarësia* është një karakteristikë e jashtme dhe do të thotë se agjentët publikë janë në gjendje të përpunojnë çështjet pa u ndikuar në asnjë mënyrë as nga pushtetet e tjera shtetërore, as nga eprorët në hierarki, aktorët apo grupet ekonomike të interesit. Në rastin e gjyqtarëve/prokurorëve, pavarësia rrjedh nga statusi i tyre dhe marrëdhëniet me

<sup>2</sup> Magjistra, në sistemin ligjor rumun, janë edhe gjykatësit edhe prokurorët.

<sup>3</sup> Shih Cristi Danilet, 'Pavarësia dhe Paanshmëria e Drejtësisë - Standardet Ndërkombëtare' në Horatiu Dumbrava, Dana Cigan, Cristi Danilet, 'Faktorët e Presionit dhe Konfliktet e Interesit në Gjyqësor, Udhëzues për Gjyqtarët', botuar nga Societatea pentru Justitie dhe Fondacioni Konrad Adenauer, 2007, fq. 22, gjendet në anglisht në [www.kas.de/rspsoe](http://www.kas.de/rspsoe).

pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ. Pavarësia për gjyqtarët/prokurorët, avokatët dhe nëpunësit civil, pavarësisht nga organizata për të cilën punojnë, mbrohet me ligj.

*Integriteti* është një karakteristikë e brendshme që do të thotë se një person vepron në përputhje me parimet dhe vlerat specifike, se nuk bën kompromise, as në punë, as në jetën private. Do të thotë një kryerje e detyrave të punës në mënyrë të ndershme, me mirëbesim, korrektesë dhe me zell. Në fakt, integriteti manifestohet në kryerjen e akteve gjyqësore me objektivitet<sup>4</sup>, me barazi të plotë, duke plotësuar kushtet e ligjit, *të gjitha këto për ligjshmërinë e aktit*. Në drejtësi, integriteti është shumë më tepër se një virtut - ai është një domosdoshmëri.

Integriteti analizohet nga dy pikëpamje të ndryshme: 'sundimi i ligjit', në të cilin integriteti lidhet me profesionalizmin e agjentit publik (integriteti i brendshëm); dhe 'demokracia', në të cilën integriteti lidhet me përgjegjësinë, që sistemi i drejtësisë dhe institucionet e tij kanë ndaj publikut në mënyrë që të fitohet besimi publik (integriteti nga një pikëpamje e jashtme)<sup>5</sup>. Megjithatë, është e qartë se të dy pozicionet tregojnë përfundimisht të njëjtën gjë: integritetin individual të agjentit publik. Kur vlera degradon, gjërat përkeqësohen në drejtim të atij që e quajmë korrupsion.

Korrupsioni i gërryhen të tri vlerat që përfshijnë shtyllat e një sistemi gjyqësor të shëndoshë. Një gjyqtar që pranon pagesë për të marrë një vendim të favorshëm do të bëhet i varur ndaj një individit ose grupi interesash që paguajnë ryshfetin. Kur gjyqtari është i varur nga dikush tjetër, nuk mund të flasim më për pavarësi, gjë që ndikon vetë pavarësinë e drejtësisë si sistem. Duke e blerë një vendim gjykate, kërkuesi i drejtësisë e fiton atë në mënyrë jo korrekte dhe me anë të kësaj, kërkesa për trajtim të barabartë përpara ligjit nuk plotësohet më, duke e bërë gjyqtarin të anshëm. Duke u dorëzuar para këtyre ndikimeve, gjyqtari humbet lartësinë morale dhe ekuilibrin.

Rëndësia e integritetit si dhe mënyrat e ndërtimit dhe mbajtjes së tij në sistemin e drejtësisë përbën temën qendrore të këtij studimi.

Për sa i përket pavarësisë së drejtësisë dhe paanshmërisë, do të trajtohen vetëm për aq sa mund të ndikohen nga aktet korruptive.

## 2. Çfarë është korrupsioni

Prandaj termi 'korrupsion' lidhet drejtpërdrejt me atë të 'integritetit'. Konceptin e 'integritetit' të agjentit publik e përfshin dhe e mbron Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit e vitit 2003, ratifikuar edhe nga Rumania<sup>6</sup>. Nenet kyçe të Konventës parashikojnë:

Neni 5 (1) Në përputhje me parimet themelore të sistemit të saj ligjor, secili Shtet Palë, zhvillon dhe implementon ose bën efektive politika të koordinuara kundër korrupsionit që promovojnë pjesëmarrjen e shoqërisë dhe pasqyrojnë parimet e sundimit të ligjit,

<sup>4</sup> Disa autorë thonë se vetë paanshmëria, së bashku me deontologjinë, është një aspekt i integritetit. Në pajtim me këtë ide, nuk do ta trajtojmë çështjen e paanshmërisë këtu, meqenëse është temë e një studimi në vetvete (shih Horatiu Dumbrava etj., vepra e cituar, fq. 22-25).

<sup>5</sup> Jonathan Soeharno, 'A është integriteti gjyqësor normë? Shqyrtimi i konceptit të integritetit gjyqësor në Angli dhe Holandë', në Revistën Ligjore Utrecht, vëll 3, edicioni 1, qershor 2007, në: [www.utrechtlawreview.org](http://www.utrechtlawreview.org).

<sup>6</sup> "Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit" (e njohur edhe si Konventa e Meridas) u miratua me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme nr. 58/4 më 31 tetor 2003 dhe hyri në fuqi më 14 dhjetor 2005. Ajo u nënshkrua nga Rumania më 9 dhjetor 2003 dhe u ratifikua nga Parlamenti rumun me ligjin nr. 365, datë 15 shtator 2004, botuar në Gazetën Zyrtare të Rumanisë nr. 903, datë 05 tetor 2004.

menaxhimit siç duhet të çështjeve publike dhe pasurisë publike, integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Neni 8 (1) Në mënyrë që të luftohet korrupsioni, çdo Shtet Palë do të promovojë, mes të tjerash, integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të tij publikë, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor. (2) Në veçanti, secili Shtet Palë do të përpiqet të zbatojë në sistemet e tij institucionale dhe ligjore, kodet ose standardet e sjelljes për performancën korrekte, të ndershme dhe të duhur të funksioneve publike.

Neni 11 (1) Duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e tij thelbësor në luftën kundër korrupsionit, secili Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij gjyqësor dhe pa paragjykuar pavarësinë e tij ligjore, do të marrë masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion të anëtarëve të gjyqësorit. Këto masa mund të përfshijnë rregullat për sjelljet e anëtarëve të gjyqësorit. (2) Masat për të njëjtin efekt si ato që merren sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përfshihen dhe zbatohen brenda shërbimit të prokurorisë në ata Shtete Palë ku ai nuk është pjesë e gjyqësorit por gëzon pavarësi të ngjashme me atë të shërbimit gjyqësor.

Mes të tjerash sjellje me integritet përkthehet si sjellje e paanshme dhe e pa korruptuar. Në përgjithësi, përdorimi i fjalës 'korrupsion' lidhet me termat e tilla si 'mitë' ose 'ryshfet'. Në realitet, korrupsioni shkon përtej pagesës ose marrjes së një ryshfeti, i cili përbën vetëm një pjesë të fenomenit të korrupsionit. Në rreshtat e mëposhtëm do të tregojmë se çfarë kuptojnë njerëzit me korrupsion, cili është kuptimi i tij sipas fjalorëve dhe rregulloreve ndërkombëtare, pas së cilës do të trajtojmë përkufizimin që, sipas pikëpamjes sonë, i përket këtij studimi të fokusuar tek korrupsioni gjyqësor.

## 2.1 Opinioni publik

Korrupsioni është një lloj 'sizmografi' që mat dhe vlerëson gjendjen e ligjshmërisë dhe moralit në një shoqëri<sup>7</sup>. Megjithatë, një farë paqartësie në lidhje me kuptimin e korrupsionit e bën perceptimin e tij të duket i largët dhe jo gjithmonë real.

Një anketim i vitit 2004 i popullsisë rumune solli kuptime dhe përkufizime të shumta që të anketuarit i vishnin korrupsionit. 23% e identifikonin korrupsionin si veprime të paligjshme nga individë në konflikt me ligjin; 26.3% i jepnin nocionit një ngjyrim ligjor, duke përfshirë pagesën dhe marrjen e ryshfeteve, dhuratave të paligjshme dhe abuzimin me pushtetin; 10% e përkufizonin korrupsionin si vepër imorale; dhe 4.4% e shikonin korrupsionin si mënyrë pasurimi me mënyra të paligjshme. Të anketuarit identifikuan politikanët, njerëzit në pozitë e pushtetit dhe kontrollit, të drejtësisë dhe punonjësit e policisë, si kategoritë që lidhen më tepër me korrupsionin<sup>8</sup>. Një anketim i vitit 2008 sugjeron se shumica e popullsisë (deri në 92.3%) beson se si pagesa e ryshfeteve dhe marrja e ryshfeteve nga nëpunësit civil apo punonjësit e policisë cilësohen si korrupsion. Të kërkuar këshilla kompetente prej dikujt që e njeh, i cili është nëpunës civil ose t'i ofrosh një tufë me lule një doktori për ta falenderuar, këto nuk konsideroheshin si vepra korruptive nga shumica e të anketuarve (deri në 87.6%)<sup>9</sup>. Sidoqoftë, qytetarët priren që ta bëjnë komponentin financiar të korrupsionit absolut,

<sup>7</sup> Shih Danciu, 'Sociologie Juridica', shtëpia botuese Lumina Lex, Bukuresht, 2007, fq. 244.

<sup>8</sup> Anketim i kryer në korrik - gusht 2004 që përfshiu 1,189 të anketuar nga të gjitha qarqet. Detajet tek Danciu, vepra e cituar, fq. 246.

<sup>9</sup> Anketimi i opinionit kërkonte të maste perceptimin publik për fenomenin e korrupsionit, i kryer në dhjetor 2007 nga Drejtoria e Përgjithshme kundër Korrupsionit së bashku me Komunikimin Totem, i disponueshëm në [www.mai-dga.ro](http://www.mai-dga.ro).

duke neglizhuar shërbimet reciproke, të cilat, në fakt, janë një burim i tërthortë i të ardhurave. Nga ana tjetër, nuk mund të mos vëmë re se individët shpesh e përgjithësojnë dhe e ekzagjerojnë madhësinë e fenomenit që ata besojnë se është korrupsion. Kjo ndodh ndonjëherë edhe për të përligjur sjelljen e tyre, duke e marrë të mirëqenë faktin se, pa ju drejtuar korrupsionit, ata nuk do të ishin kurrë në gjendje të materializonin të drejtat dhe interesat e tyre legjitime. Për shembull, në shoqërinë rumune ekziston një perceptim i përgjithësuar se nuk mund të kesh kujdesin mjekësor pa ryshfet për doktorin, se nuk mund të marrësh një autorizim nga organet administrative pa paguar mitë, dhe se nuk mund ta fitosh një padi gjyqësore pa korruptuar gjyqtarin.

## 2.2 Përkufizimi i fjalorit

Fjala 'korrupsion' vjen nga fjala latine 'corrumpere', që do të thotë 'thyej' ose 'shkatërroj'. Me sa duket, akti korruptiv shkatërron ose thyen ligjin, detyrat dhe normat morale. Në përgjithësi, asnjë përkufizim në fjalorët e disponueshëm nuk këmbëngul tek aspekti ligjor i korrupsionit. Në fjalorin shpjegues të gjuhës rumune (DEX), përkufizimi i korrupsionit merr një dimension shoqëror dhe moral, meqenëse e shpjegon si 'devijim nga morali, ndershmeria, detyra; fëlligështi, poshtërsi'<sup>10</sup>. Në këtë drejtim, termi përdoret në përkufizimin e 'korruptimit seksual' si krimi nëpërmjet të cilit kryhet një veprim i turpshëm ndaj një të mituri. Nga ana tjetër, 'ryshfeti - mita në rumanisht (nga fjala sllave 'mito') do të thotë para ose mallra të marra prej dikujt ose të dhëna dikujt në shkëmbim të dashamirësisë së atij personi dhe që e bën atë të kryejë një detyrë të punës ose të kryejë një paligjshmëri në favor të atij që e paguan mitën ose që ofron mallrat'<sup>11</sup>.

*Fjalori Merriam - Webster* e përkufizon korrupsionin si 'dëmtim i integritetit, virtutit apo parimit moral; çuarja drejt së gabuarës me anë të mjeteve të papërshtatshme apo të paligjshme (si mita)<sup>12</sup>. *Le Petit Robert* e redukton përkufizimin e korrupsionit tek mita: 'korrupsioni është përdorimi i mjeteve të dënueshme (mitë, ryshfet, para, dhurata) me qëllim ndikimin në veprimin e një zyrtari kundër detyrave ose ndërgjegjes së tij ose të saj'<sup>13</sup>. *Fjalori Juridik Black* jep një përkufizim ligjor më të gjerë të korrupsionit, si dhe një përkufizim i cili është më afër kuptimit që ne do të adoptojmë në këtë punim: 'një veprim që bëhet me synimin për të dhënë disa avantazhe që nuk përputhen me detyrën zyrtare dhe të drejtat e të tjerëve. Akti i një zyrtari ose personi kujdestar që në mënyrë të paligjshme dhe të gabuar përdor pozicionin ose karakterin e tij për të nxjerrë përfitim për vete ose për një person tjetër, në kundërshtim me detyrën dhe të drejtat e të tjerëve'<sup>14</sup>.

## 2.3 Rregullimet Ndërkombëtare

---

<sup>10</sup> Akademia Rumune, 'Dictionarul Explicativ al Limbi Romane/ Fjalor Shpjegues i Gjuhës Rumune' botimi i dytë, Shtëpia Botuese Univers Enciclopedic, Bukuresht, 1996.

<sup>11</sup> Akademia Rumune, 'Micul Dictionarul Academic/ Fjalor i Vogël Akademik', volumi I, Shtëpia Botuese Univers Enciclopedic, Bukuresht, 2001.

<sup>12</sup> Gjendet në internet në adresën [www.m-w.com](http://www.m-w.com).

<sup>13</sup> 'Le Nouveau Petit Robert dictionnaire alphabétique et analogique de la langue française'/texte remanié et amplifié sous la direction de Josette Rey/Debove et Alain Rey. - Nouv. Ed. / de Paul Robert. - Paris: Dictionnaire Le Robert, 2003. Gjithashtu shih përkufizimin që është vënë në dispozicion nga qendra kombëtare e burimeve tekstuale dhe leksikore të Francës, në adresën [www.cnrti.fr/lexicographie/corruption](http://www.cnrti.fr/lexicographie/corruption).

<sup>14</sup> Black's Law Dictionary /ed. Bryan A. Garner. - 7th ed. - St. Paul: West Group, 1999.

a. Përkufizimi i njohur më shumë për korrupsionin është ai që jep Banka Botërore: 'korrupsioni është përdorimi i paligjshëm i burimeve publike për përfitim personal'<sup>15</sup>. Një përkufizim i ngjashëm për korrupsionin vjen nga Transparency International: 'korrupsioni është abuzimi me pushtetin e besuar për përfitim personal'<sup>16</sup>. Përkufizimi i mëvonshëm përfshin më shumë se pushteti publik meqenëse korrupsioni gjithmonë mund të shfaqet në sektorin privat. Kjo do të thotë jo vetëm përfitime financiare por edhe dhurata të të gjitha llojeve, duke përfshirë ato jo materiale si ambiciet politike ose profesionale, promovimet ose primet.

b. OKB, në "Kodin e saj të Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (1979)"<sup>17</sup>, tregon se 'ndërsa përkufizimi i korrupsionit duhet t'i nënshtrohet ligjit kombëtar, ai duhet të kuptohet se *përfshin kryerjen ose moskryerjen e një veprimi gjatë ushtrimit të detyrës ose në lidhje me të, si reagim ndaj dhuratave, premtimeve, iniciativave të kërkuara ose të pranuara, ose marrja e gabuar e tyre*' (neni 7, pika b).

Në 'Programi Global kundër Korrupsionit' (1999), OKB deklaroi se *'esenca e fenomenit të korrupsionit është abuzimi me pushtetin, i kryer me qëllimin e nxjerrjes së një përfitimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë personal për veten ose për një person tjetër në sektorin publik ose privat'*. Në fakt, ky është një përkufizim i marrë nga organizatat e lartpërmendura. Në strategjinë e saj 'Lufta kundër Korrupsionit për të Përmirësuar Qeverisjen' (1998), Programi i Zhvillimit të OKB-së e përkufizon korrupsionin si *'shpërdorim i detyrës së pushtetit publik ose autoritetit për përfitime private - nëpërmjet mitës, shpërdorimit të detyrës, tregtimit të influencës, nepotizmit, mashtrimit, parave për përshpejtim'<sup>18</sup> ose abuzimit me fondet'*.

Instrumenti universal më i rëndësishëm në fushën që po shqyrtojmë këtu, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit (2003), nuk jep një përkufizim për korrupsionin, bazuar në supozimin se koncepti ndryshon vazhdimisht dhe se, nga natyra e vet, ai përfshin qasje të shumëfishta. Konventa merr një qasje përshkruese duke mbuluar format e shumëllojshme të korrupsionit që ekzistojnë aktualisht, duke ofruar gjithashtu një kuadër për format e korrupsionit që ende mund të shfaqen në të ardhmen. Shtetet Palë në Konventë do të penalizojnë veprat e mëposhtme penale: mitëdhënien/mitëmarrjen, tregtimin e influencës, abuzimin me funksionet, pasurimin e paligjshëm (duke përfshirë sektorin privat), pastrimin e të ardhurave nga krimi, fshehjen dhe pengimin e drejtësisë. Konventa gjithashtu i detyron shtetet që të vendosin përgjegjësinë e personave ligjorë si dhe të kriminalizojnë pjesëmarrjen dhe tentimin.

---

<sup>15</sup> 'Të Ndihmojmë Vendet të Luftojnë Korrupsionin: Roli i Bankës Botërore', Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe Zhvillimit/ Banka Botërore, shtator 1997, fq. 19.

<sup>16</sup> Në 'Parimet e Biznesit për të Luftuar Mitën' (2002), t'i e përkufizon korrupsionin në çështjet e biznesit si: 'ofrimi, premtimi, dhënia, pranimi ose kërkimi i një avantazhi që çon në një veprim i cili është i paligjshëm ose shkelje e besimit'. Përkufizimi i referohet jo vetëm transaksioneve të sektorit privat, por edhe korrupsionit të agjentëve publikë për qëllimin e këtyre transaksioneve. Shih 'Parimet e Biznesit për të Luftuar Mitën' të Transparency International që gjendet në [http://www.transparency.org/global\\_priorities/private\\_sector/business\\_principles](http://www.transparency.org/global_priorities/private_sector/business_principles).

<sup>17</sup> 'Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit', miratuar me rezolutën 36/169 të datës 17 dhjetor 1979. Termi 'zyrtarët të zbatimit të ligjit' përfshin të gjithë zyrtarët e ligjit, qofshin të emëruar apo të zgjedhur, të cilët ushtrojnë pushtete policore, veçanërisht fuqinë e arrestimit ose ndalimit. Gjendet në [www2.ohcr.org/English/law/codeofconduct.htm](http://www2.ohcr.org/English/law/codeofconduct.htm).

<sup>18</sup> Para të paguara për të përshpejtuar procedurat e ndryshme burokratike.

c. Fondi Monetar Ndërkombëtar e përkufizon korrupsionin si '*abuzim me autoritetin ose besimin publik për përfitim privat*'<sup>19</sup>.

d. Grupi i Ekspertëve për Korrupsionin i INTERPOLIT e përkufizon atë si '*çdo veprim apo mosveprim nga individë ose organizata, publike ose private, duke shkelur ligjin ose besimin për përfitim ose fitim*'<sup>20</sup>.

Duke ju referuar rreptësisht forcave policore në '*Standardet globale për luftën ndaj korrupsionit në forcat/shërbimet policore*', INTERPOLI e përkufizon korrupsionin si: kërkim ose pranim, qoftë direkt apo indirekt, nga një oficer policie ose ndonjë punonjës tjetër i forcës/shërbimit policor i parave, artikujve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve ose avantazhit, qoftë për vete ose për ndonjë person, grup apo entitet, në shkëmbim të ndonjë akti apo mosveprimi tashmë të kryer ose të neglizhuar, ose që do të bëhet ose neglizhohet në të ardhmen, ose në lidhje me kryerjen e ndonjë funksioni të policimit ose të lidhur me të, ofrimit ose dhënies, qoftë direkt ose indirekt, një oficeri policie ose ndonjë punonjësi tjetër të forcës/shërbimit policor të parave, artikujve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimit ose avantazhit për oficerin e policisë ose për ndonjë person tjetër ose për ndonjë person, grup ose entitet në shkëmbim të ndonjë veprimi ose mosveprimi tashmë të kryer ose të neglizhuar ose që do të kryhet ose do të neglizhohet në të ardhmen në kryerjen e ndonjë funksioni ose që lidhet me të ose që lidhet me policimin, ndonjë akt ose neglizhim në kryerjen e detyrave nga një oficer policie ose punonjës tjetër i forcës/shërbimit policor që mund ta ekspozojë një person në mënyrë të padrejtë ndaj një akuze ose dënimi për një veprë penale ose mund të ndihmojë në mënyrë të padrejtë që një person të mos akuzohet ose të çlirohet nga një veprë penale, shpërndarja e paautorizuar e informacionit konfidencial ose të kufizuar policor për shpërblimin ose ndonjë gjë tjetër, ndonjë akt ose neglizhim në kryerjen e detyrës nga një oficer policie ose ndonjë punonjës tjetër i një force/shërbimi policor për qëllimin e përfitimit të parave, artikullit me vlerë, dhuratës, favorit, premtimit, shpërblimit ose avantazhit për vete ose ndonjë person tjetër, grup ose entitet, ndonjë akt ose neglizhim që përbën korrupsion sipas një ligji të Shtetit Anëtar, pjesëmarrja si kryesor, bashkëkryesor, iniciues, shtytës, bashkëpunëtor në krim, ndihmës përpara faktit, ndihmës pas faktit, konspirues ose në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen ose përpjekjen për të kryer ndonjë akt që përmendet më sipër.

e. Në memorandumun shpjegues të Raportit të Komitetit PACE për Çështjet Ekonomike dhe Zhvillimin para miratimit nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës të Rezolutës 1214 (2000) për '*Rolin e Parlamenteve në Luftën kundër Korrupsionit*', korrupsioni përkufizohet si '*përdorimi dhe abuzimi me pushtetin publik për fitim privat*'<sup>21</sup>.

Grupi Shumëdisiplinor për Korrupsionin i ngritur nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në vitin 1994 miratoi përkufizimin e mëposhtëm provizor për korrupsionin: '*korrupsioni siç trajtohet nga GMC i Këshillit të Evropës është njëherësh mitëmarrja dhe ndonjë sjellje tjetër në lidhje me personat që u janë besuar përgjegjësitë në sektorin publik ose privat, që shkel detyrat që rrjedhin nga statusi si zyrtar publik, punonjës privat, agjent i pavarur ose ndonjë marrëdhënie tjetër e atij lloji dhe që synon fitimin e*

<sup>19</sup> 'Qasja për Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Luftës ndaj Korrupsionit – Udhëzues' i FMN-së, 2005, në <http://www.imf.org/external/np/gov/guide/eng/index.htm>.

<sup>20</sup> Grupi i Ekspertëve për Korrupsionin i INTERPOLIT në <http://www.interpol.int/public/corruption/igec/default.asp>.

<sup>21</sup> Dokumenti nr. 8652 i 18 shkurtit 2000, përgatitur nga Komiteti për Çështjet Ekonomike dhe Zhvillimin i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, pika II. I. 4, në <http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=http://assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/doc00/EDOC8652.HTM>.



*avantazheve të padrejta të çfarëdo lloji për vete ose për të tjerët*. (pika 27 e 'Raportit Shpjegues të Konventës të Ligjit Civil mbi Korrupsionin'<sup>22</sup>).

Më vonë, Konventa e Ligjit Civil për Korrupsionin do të shtjellonte se 'korrupsion' do të thotë 'të kërkosh, të ofrosh, të marrësh ose të japësh, direkt ose indirekt, një ryshfet ose ndonjë avantazh tjetër të padrejtë ose ndonjë perspektivë të tyre, që shtrembëron kryerjen siç duhet të ndonjë detyre ose sjelljeje që kërkohet nga marrësi i mitës, avantazhit të padrejtë ose perspektivës së tyre' (neni 2). 'Konventa e Ligjit Penal për Korrupsionin' e detajon korrupsionin si 'mitëmarrje aktive e zyrtarëve publikë'<sup>23</sup>, mitëmarrje pasive e zyrtarëve publikë (duke përfshirë detyrimin e shtetit për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit të brendshëm ato sjellje që përfshijnë mbajtësit e detyrës gjyqësore ose zyrtarëve të gjykatës ndërkombëtare juridiksioni i të cilëve pranohet nga Pala), [dhe] tregtia e influencës'.

f. BE, në komunikatën përfundimtare (2003) 317 nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian Ekonomik dhe Social për një politikë gjithëpërfshirëse të BE-së kundër 'korrupsionit' miraton përkufizimin e korrupsionit të përdorur nga programi global i OKB-së kundër korrupsionit: '*abuzimi me pushtetin për fitim privat*'. Konventa për Luftën kundër Korrupsionit përfshin zyrtarët e komuniteteve evropiane ose zyrtarët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (1997)<sup>24</sup> e përkufizon korrupsionin pasiv dhe korrupsionin aktiv nga zyrtarët<sup>25</sup>.

## 2.4 Rregulloret Kombëtare

a. Strategjia kombëtare kundër korrupsionit për vitin 2005-2007<sup>26</sup> i përkufizon aktet e korrupsionit si ato *veprime që ndikojnë në shpërndarjen universale dhe të drejtpeshuar të mallrave për qëllimin e nxjerrjes së përfitimit për individë ose grupe individësh*. Strategjia kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët e cenueshëm dhe në administratën vendore publike për periudhën 2008 - 2010<sup>27</sup> kufizohet vetëm duke *kujtuar* përkufizimet e Transparency International dhe ato të mëparshme të Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit.

Në ligjet që rregullojnë profesionet ligjore kam konstatuar një parashikim relevant vetëm në ligjin nr. 360/2002 për Statusin e Punonjësve të Policisë i cili, në nenin 2, thotë: '*Autoriteti i funksionit nuk mund të ushtrohet për interesin personal të personit*'.

b. Duke mos dhënë një përkufizim për korrupsionin, Kodi Penal rumun penalizon veprime të caktuara që futen në këtë kategori, në kapitullin për krimet e punës ose që

<sup>22</sup> Raporti gjendet tek: <http://conventions.coe.int/treaty/EN/Reports/Html/174.htm>.

<sup>23</sup> 'Zyrtar publik' do të thotë duke ju referuar përkufizimit të 'zyrtarit', 'zyrtarit publik', 'kryetarit të bashkisë', 'ministrit', ose 'gjykatësi' në ligjin kombëtar të shtetit në të cilin personi në fjalë e kryen atë funksion dhe siç zbatohet në ligjin penal të tij; konventa ju referohet gjithashtu zyrtarëve publikë të huaj.

<sup>24</sup> 'Konventa për Luftën kundër Korrupsionit që përfshin zyrtarët e komuniteteve evropiane ose zyrtarët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian' miratuar nga Këshilli Evropian u botua në Gazetën Zyrtare C 195 të 25 qershorit 1997, gjendet në: <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/133027.htm>.

<sup>25</sup> Për qëllimet e konventës, 'zyrtarë publik' do të thotë duke ju referuar përkufizimit të 'zyrtarit', 'oficerit publik', 'kryetarit të bashkisë', 'ministri' ose 'gjykatësi' në ligjin kombëtar të shtetit në të cilin personi në fjalë e kryen atë funksion dhe siç zbatohet në ligjin e tij penal.

<sup>26</sup> I quajtur edhe SNA II, miratuar me vendimin e qeverisë nr. 231/2005, botuar në Gazetën Zyrtare të Rumanisë nr. 272, datë 01 prill 2005.

<sup>27</sup> Botuar në Gazetën Zyrtare të Rumanisë nr. 514, datë 08 qershor 2008.

lidhen me punën: konflikti i interesave, mitëmarrja dhe mitëdhënia, pranimi i dhuratave të paligjshme dhe tregtimi i influencës (neni 253<sup>1</sup>-257). Sipas mendimit tonë në mënyrë që të respektohen standardet ndërkombëtare, kapitulli duhet të përfshijë edhe krime të tilla si represioni i padrejtë, arrestimi i paligjshëm dhe hetimi abuziv, përpjekja për të nxjerrë dëshmi mashtruese ose për të favorizuar shkelësin.

c. Një përkufizim me zbatim të menjëhershëm është ai në ligjin nr. 78/2000 për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e akteve të korrupsionit<sup>28</sup>: *përdorimi i funksionit, kompetencave të detyrave të marra në mënyrë që të fitohen para, mallra ose përfitime të tjera të padrejta për vete ose për një person tjetër*. Ligji operon me katër kategori të krimeve që u përkasin punonjësve të sektorit ligjor: krimet e korrupsionit (përveç atyre të parashikuara në nenin 254-257 të Kodit Penal, të tilla si, blerja e influencës dhe mitëdhënia një zyrtari të huaj ose një organizate publike ndërkombëtare), krimet e asimiluara nga korrupsioni, krimet që lidhen direkt me korrupsionin dhe krimet kundër interesave financiare të komuniteteve evropiane.

Në lidhje me korrupsionin në gjyqësor, ligji thotë, mes të tjerash, se dispozitat e tij zbatohen për zyrtarët publikë që shërbejnë në autoritetet dhe institucionet publike, pavarësisht nga procedura e emërimit (neni 1, germa a); për njerëzit me funksione kontrolli (neni 1, germa c); për njerëzit me funksione për zbulimin ose ndëshkimin e shkeljeve ose veprave penale; veprat penale që mbulohen nga nenet 254-257 të Kodit Penal kanë ndëshkime më të ashpra (neni 7); dhe ata që kryejnë detyra gjyqësore ose zyrtarët e ndonjë gjykate ndërkombëtare juridiksioni i të cilës pranohet nga Rumania (neni 8<sup>1</sup>).

## 2.5 Çfarë nuk është korrupsion?<sup>29</sup>

a. *Bakshishi*. Është e zakonshme për klientët që tu japin bakshish atyre që kryejnë shërbime të caktuara liberale si taksistët, kamerierët, berberët, etj., duke treguar se e vlerësojnë cilësinë e shërbimit. Nëse këta që kryejnë këto shërbime do abuzonin me zakonet e favorshëm, ky nuk është korrupsion.

b. *Abuzimi administrativ*. Situata kur një nëpunës civil ose zyrtar abuzon me detyrën në dëm të interesave të dikujt, pa ndjekur përfitimet personale nuk është korrupsion, por abuzim kundër interesit individual. Vetëm abuzimet e kryera me qëllimin e plotësimit të interesave personale janë korrupsion. Ndëshkimi ligjor për korrupsionin është penal (burgosje) dhe mund të çojë në humbjen e të drejtave civile, ndërsa ndëshkimi ligjor për abuzimin administrativ është gjithashtu administrativ (paralajmërim, pagesa, pezullim nga detyra, etj.)

c. *Neglizhenca*. Situata kur një nëpunës civil ose zyrtar neglizhon detyrat e punës së tij, duke ndikuar në interesat e një personi tjetër, pa ndjekur përfitimin personal, nuk është korrupsion por neglizhencë ose paaftësi administrative. Vetëm ato akte neglizhence që kryhen me qëllimin e plotësimit të interesave personale janë korrupsion. Ndëshkimi ligjor për neglizhencën është gjithashtu administrativ.

---

<sup>28</sup> Ligji u botua në Gazetën Zyrtare nr. 219, datë 18 maj 2000 dhe më pas u amendua. Rregullorja e mëparshme u përfshi në ligjin nr. 83/1992 që përcaktonte procedurë ligjore të përsheptuara në rastin e shkeljeve kriminale specifike të korrupsionit.

<sup>29</sup> Shkëputur nga materialet e fushatës kombëtare 'Mos paguaj ryshfet!' (2004). Shih [www.nudaspaga.ro](http://www.nudaspaga.ro).

d. *Gabimi i drejtësisë*. Në qoftë se një akt juridiksional që kryhet nga një prokuror ose gjykatës është i gabuar ose i paligjshëm, mjetet ligjore mund ta ndreqin gabimin juridik. Këto gabime nuk mund të konsiderohen korrupsion për sa kohë që ato nuk janë kryer për qëllimin e nxjerrjes së një përfitimi personal. Ushtrimi i funksioneve në keqbesim, kur akti nuk penalizohet, është një shkelje disiplinore në rastin e gjyqtarëve/prokurorëve (neni 99, germa “” e Ligjit nr. 303/2004 Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve).

e. *Paaftësia*. Situata kur nëpunësit civil ose zyrtarët kanë pozicione për të cilat nuk janë të kualifikuar dhe në të cilat ata nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre - që do të thotë detyra në përputhje me kërkesat e kompetencës dhe e profesionalizmit - është rezultat i paaftësisë dhe jo i korrupsionit. Moskryerja e detyrave nga dikush për shkak të paaftësisë nuk është korrupsion (si rezultat i një interesi të fshehur) ose abuzim (si rezultat i keqbesimit). Ndëshkimi ligjor për korrupsionin është penal, ndërsa për paaftësinë është administrativ.

f. *Konflikti i interesave*. Jo çdo konflikt interesash është pasojë e korrupsionit. Ndërsa korrupsioni nënkupton një veprim, një konflikt interesash është një situatë në të cilën kryerja e paligjshmërisë është vetëm potenciale. Lidhja midis të dy nocioneve ligjore do të trajtohet tërësisht në Pjesën IV të këtij libri.

### 3. Sistemi gjyqësor dhe korrupsioni

Në kontekstin e këtij studimi korrupsionin e trajtojmë në një mënyrë ndërdisiplinore se sa thjesht nga pikëpamja penale. Siç shihet më sipër, **korrupsioni është abuzimi me pushtetin për qëllimin e përfitimit personal**. E parapëlqejmë këtë përkufizim të gjerë, i cili përshtatet lehtë me rastet e sjelljes jo korrekte nga punonjësit e drejtësisë apo nga stafi i përfshirë në vendime që ndihmon sistemin e drejtësisë. Ky përkufizim përfshin fitimin material apo përfitimet e ndonjë natyre tjetër që rrjedhin nga korrupsioni. Përkufizimi përfshin si zyrtarët publikë (si gjyqtarët/prokurorët) dhe zyrtarët privatë (si avokatët ose noterët publikë), sepse korrupsioni ndikon tek interesi publik nëpërmjet kryerjes së akteve profesionale, masave dhe vendimeve në fushën ligjore.

Duke e përshtatur këtë përkufizim për sistemin e drejtësisë, mund ta përkufizojnë **korrupsionin gjyqësor** si një akt nëpërmjet të cilit punonjësit në sistemin e drejtësisë ndikohen negativisht duke prekur paanshmërinë e procesit gjyqësor për qëllimin e nxjerrjes së një përfitimi të paligjshëm për vete ose për persona të tjerë.

Ka dy lloje të këtij ndikimi negativ tek drejtësia:

I pari lidhet me ndikimet e padrejta që prekin pavarësinë e drejtësisë si sistem dhe/ose pavarësinë e gjyqtarëve si individë - *faktorët e presionit* që veprojnë mbi drejtësinë. Këtu mund të përfshijmë, por pa i kufizuar, ndërhyrjen politike në punësimin dhe emërimin e gjyqtarëve, ndikimet negative mbi pagat e gjyqtarëve dhe ndikimi për caktimin e çështjeve ose të gjyqtarëve në çështje të ndryshme. Analiza e masave mbrojtëse që i luftojnë këta faktorë dhe që synojnë të mbrojnë pavarësinë funksionale të sistemit dhe pavarësinë individuale të gjyqtarit (d.m.th., qëndrimin në detyrë për gjithë jetën, ekzistencën e një këshilli gjyqësor, etj), nuk është qëllimi i këtij punimi.

Lloji i dytë i ndikimit të papërshtatshëm në drejtësinë e procesit ligjor lidhet me shkeljen e sjelljes etike nga zyrtarët e sistemit gjyqësor ose me 'blerjen' e dashamirësisë së tyre - *mungesën e integritetit*. Ky aspekt do të analizohet në seksionet e ardhshme

bashkë me sektorët ku korrupsioni gjyqësor ka më shumë gjasë që të ndodhë, shkaqet e tij, si dhe metodat për parandalimin dhe pengimin e tij.

## PJESA II DOBËSITË NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Disa punime zyrtare të publikuara nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës (SCM) dhe deklaratat nga Presidenti i vendit dhe nga Ministri i Drejtësisë e përshkruajnë korrupsionin gjyqësor si fenomen.

'SCM është i vendosur të forcojë në të ardhmen edhe rolin e tij si këshill disiplinor, dhe është plotësisht i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tij. SCM riafirmon vullnetin e tij për të dënuar sjelljen e paligjshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të marrë masat në përputhje me kompetencat e tij në mënyrë që të *eliminohet fenomeni i korrupsionit nga sistemi gjyqësor rumun.*'<sup>30</sup>

'Kam dëgjuar për *gjykatës të korruptuar*, kam dëgjuar për *prokurorë të korruptuar*, i kam parë ata personalisht. I kam parë në gjykata dhe në raste publike. Dhe këto fakte e forcojnë besimin tim se një gjykatës është aq i pavarur dhe i lirë sa dëshiron të jetë.'<sup>31</sup>

'Drejtësia në Rumani *do të fillojë të funksionojë normalisht* sapo aktiviteti i prokurorëve të pasqyrohet në vendimet e gjykatës (...) kjo vlen si për cilësinë e punës së prokurorisë, dhe për masën deri në të cilën një gjykatës është i lirë të marrë një vendim. Fatkeqësisht, *kemi ende korrupsion të nivelit të lartë në sistemin gjyqësor.*'<sup>32</sup>

'I qëndroj deklaratës sime të mëparshme se sistemi gjyqësor nuk funksionin dhe se *ka një nivel të lartë korrupsioni*. Nuk dua të fyej askënd. Jam i sigurt se ka mjaft gjykatës të ndershëm që zbatojnë ligjin; megjithatë, të pretendosh se *ka korrupsion në vend, por nuk ka korrupsion në sistemin e drejtësisë*, është gabim.'<sup>33</sup>

'Ne duhet t'i deklarojmë luftë të *gjitha rrjeteve profesionale që jetojnë si parazitë (jetojnë si shushunjat) mbi sistemin gjyqësor*. Dhe me këtë dua të them avokatët, noterët, gjyqtarët dhe prokurorët, madje dhe punonjësit e teknologjisë së informacionit në gjykata.'<sup>34</sup>

Këto deklarata bazohen vetëm në përvojat rastësore me korrupsionin në sistemin gjyqësor ose thjesht në perceptimin e autorëve të këtyre deklaratave. Por një analizë e saktë e gamës së korrupsionit dhe zonave të cenueshme në sistemin gjyqësor kërkon një

---

<sup>30</sup> Deklaratë për shtyp e SCM, 9 dhjetor 2008, në [www.scm1909.ro](http://www.scm1909.ro).

<sup>31</sup> Fjalim i Presidentit të Rumanisë, Traian Bassescu, në një mbledhje me gjykatësit dhe prokurorët e rinj që u diplomuan nga Instituti Kombëtar i Magjistraturës, Pallati Cotroceni, 29 janar 2009, në [www.presidency.ro](http://www.presidency.ro).

<sup>32</sup> Deklaratë nga Presidenti i Rumanisë më 20 shkurt 2006 me rastin e paraqitjes së raportit të aktivitetit të prokurorëve, cituar nga Agjencia e Lajmeve HOT News, në [www.hotnews.ro](http://www.hotnews.ro).

<sup>33</sup> Deklaratë shtypi lëshuar nga administrata presidenciale më 9 mars 2006 në lidhje me deklaratat e presidentit në mbledhjen plenare të SCM, në [www.presidency.ro](http://www.presidency.ro).

<sup>34</sup> Deklaratë e Ministrit të Drejtësisë Cătălin Predoiu, në mbledhjen plenare të SCM më 8 janar 2009, në [www.realitatea.net](http://www.realitatea.net).

vlerësim krahasues dhe përforcimin nga studimet dhe anketimet e opinioneve për korrupsionin bazuar në perceptimin dhe përvojën si të përdoruesve të gjykatës edhe të personelit të gjykatës. Kjo kërkon gjithashtu një analizë të të dhënave zyrtare për hetimet kriminale dhe disiplinore të personelit në sistem. Kjo është saktësisht çka do të bëjmë më poshtë në mënyrë që të ndërtojmë një vlerësim gjithëpërfshirës për korrupsionin gjyqësor.

## 1. Besimi publik në sistemin gjyqësor

Besimi i rumunëve në institucionet publike është i ulët dhe korrupsioni shikohet si një fenomen tipik për vendin. Në lidhje me sistemin gjyqësor, integriteti i tij mban besueshmërinë e tij, i cili nga ana e tij rrit besimin e njerëzve tek gjyqësori. Prandaj është miratimi i publikut që i jep legjitimitet sistemit gjyqësor.

Sipas statistikave, në dhjetëvjeçarin e kaluar, besimi publik në sistemin gjyqësor rumun është lëkundur me 20% dhe 28%. Tabela e mëposhtme përfshin konstatimet nga statistikat më të fundit për institucionet publike dhe personelin gjyqësor:

Studimet kategoritë	Barometri i opinionit publik 2007 <sup>35</sup>	Gallup 2008 <sup>36</sup>	Eurobarometri 2007 <sup>37</sup>	Eurobarometri 2008 <sup>38</sup>
Kisha	-	84	77	-
Ushtria	-	65	68	-
Masmedia	-	56	61 (TV - radio) 53 (e shkruar)	-
Policia	-	38	36	-
Gjyqësori	20	20	26	25
Partitë politike	22	-	11	14
Parlamenti	17	-	17	19
Noterët	-	42		-
Personeli policisë	-	29	-	-
Avokatët	-	28	-	-
Gjykatësit	-	28	-	-
Prokurorët	-	26	-	-
Personeli gjyqësor	-	25	-	-
Përmbaruesit	-	23	-	-

*Tabela 1: Besimi i rumunëve në institucionet publike (në përqindje)*

<sup>35</sup> Barometri i opinionit publik 1998 – 2007 u krye nga fondacioni Soros. Kërkimi sociologjik pa perceptimin e rumunëve për udhëheqësit politikë që i përfaqësojnë ata dhe në fusha të tilla si gjyqësori. Raporti u botua më 6 dhjetor 2007 në [www.soros.ro](http://www.soros.ro).

<sup>36</sup> Anketim i opinionit financiar nga projekti i Bankës Botërore për reformën në drejtësi, i porositur nga SCM dhe i kryer nga Gallup Rumania, postuar në internet më 25 janar 2008 në faqen e internetit të HotNews në <http://tinyurl.com/csmgallup>.

<sup>37</sup> Komisioni Evropian, eurobarometri - Opinioni Publik në Bashkimin Evropian, vjeshtë 2007, botuar në 30 janar 2008, gjendet në [http://ec.europa.eu/public\\_opinion/archives/eb/eb68/eb68\\_ro\\_exec.pdf](http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb68/eb68_ro_exec.pdf).

<sup>38</sup> Komisioni Evropian, Eurobarometri - Opinioni Publik në Bashkimin Evropian, vjeshtë 2008, botuar më 20 janar 2009, gjendet në [http://ec.europa.eu/romania/documents/information/eb70\\_ro\\_exec.pdf](http://ec.europa.eu/romania/documents/information/eb70_ro_exec.pdf).

Besimi në institucionet publike kryesisht ndërtohet mbi paanshmërinë e perceptuar të shërbimeve dhe integritetin e personelit. Në formimin e këtij perceptimi, njerëzit mbështeten tek përvojat e tyre që lidhen me korrupsionin ose në raporte të jashtme për korrupsionin. Më poshtë janë të dhënat nga anketimi i opinionit që theksojnë ku është e mundur, përvojën, perceptimin dhe reagimin e qytetarëve lidhur me korrupsionin në sistemin gjyqësor.

## 2. Korrupsioni gjyqësor në anketimet e opinionit

Padyshim, perceptimet shpesh bazohen në përvojën e korrupsionit të njerëzve të cilët kanë kontakt me institucionet publike. Megjithatë, besojmë se një imazh sa më i saktë mund të jepet vetëm nga instrumentet e specializuara të matjes, me kusht që konstatimet në terren të interpretohen në mënyrë profesionale.

Tabela më poshtë përfshin një përzgjedhje të konstatimeve nga sondazhet më relevante të kryera gjatë pak viteve të fundit, ku shumica e tyre përfshijnë të dhëna për perceptimin mbi korrupsionin gjyqësor:

Korrupsioni tek:	Banka Botërore 2001 <sup>39</sup>	TI (2007) <sup>40</sup>	TI 2008 <sup>41</sup>	Gallup 2008 <sup>42</sup>			AID 2008 <sup>43</sup>	GAD 2008 <sup>44</sup>
				Nëpunësit e intervistuar të gjykatës	Avokatët e intervistuar	Qytetarë të intervistuar		
Gjykatësit								
- perceptimi	50	-	-	7	47	63	-	-
- përvoja				-	-	-	40	-
- mitë e dhënë	22	-	8	-	-	-	13	11,4
- mitë e kërkuar	16	10	-	-	-	-	-	-
		11						
Prokurorët (perceptimi)	-	-	-	8	60	60	40	10
Personeli i policisë	40	-	-	20	78	60	-	-
- perceptimi	-	-	-	-	-	-	-	-
- përvoja	-	9	13	-	-	-	-	-
- mitë e dhënë	-	10	-	-	-	-	-	-
- mitë e kërkuar	-	-	-	-	-	-	-	-
Avokatët Noterët	-	-	-	19	30	60	-	-
Personeli gjyqësor	-	-	-	13	28	35	-	-
Përmbartuesi	-	-	-	3	51	46	-	-
				15	35	43	-	-
Korrupsioni gjyqësor i raportuar	30-40	80	77	-	-	-	89	-
Probleme kryesore të korrupsionit	-	-	-	12	34	39	-	44
Kohëzgjatja e gjykimeve	-	-	-	-	-	10	-	-
Inkompetenca mbingarkesa	-	-	-	-	19	5	-	-
					12	-	-	-

Tabela 2: Korrupsioni në sistemin gjyqësor (me pikë përqindje)

<sup>39</sup> Sondazhe diagnostikuese për korrupsionin në Rumani, kryer nga Banka Botërore me kërkesë të Qeverisë së Rumanisë, në vitin 2001, në [www1.worldbank.org/publicsector/anticorrupt/RomEnglish.pdf](http://www1.worldbank.org/publicsector/anticorrupt/RomEnglish.pdf).

<sup>40</sup> Anketimet e opinionit të ngarkuara nga TI- RO në vitin 2007 për përgatitjen e raportit kombëtar të korrupsionit dhe fushatës 'Asnjë rryshfet. Jo pasurim me paratë tuaja'. Shih [www.faras paga.ro](http://www.faras paga.ro).

<sup>41</sup> TI-RO, 2008 Barometri Global i Korrupsionit, në [www.transparency.org.ro](http://www.transparency.org.ro).

<sup>42</sup> Anketimi i Gallupit, i kryer në janar 2008 me kërkesën e SCM.

<sup>43</sup> Anketim i kryer nëpërmjet INSOMAR nga Asociatia pentru Implementarea Democratiei (AID) në nëntor 2008.

<sup>44</sup> Anketimi i opinionit për perceptimin e publikut për korrupsionin i kryer nga Drejtoria e Përgjithshme kundër Korrupsionit së bashku me Komunikimin Totem në dhjetor 2007 në [www.mai-dga.ro](http://www.mai-dga.ro).

Duke i përmbledhur konstatimet e këtyre sondazheve, mund të arrihen konkluzionet e mëposhtme: ka një mospërputhje madhore midis gamës së perceptuar të korrupsionit në sistemin gjyqësor dhe përvojës së njerëzve në këtë drejtim. Disa herë janë ofruar para nga avokatët për gjyqtarët dhe prokurorët por pa u provuar se janë pranuar faktikisht. Shpesh ryshfetet janë ofruar në shkëmbim të përshpejtimit të procedurave dhe për caktimin e çështjeve të caktuara prokurorëve ose gjyqtarëve të caktuar. Shumica e atyre që dinin për shkeljet ligjore të korrupsionit nga personeli gjyqësor nuk i raportuan ato për shkak të procedurave të komplikuar që do të pasonin ose për shkak të besimit se asgjë nuk do të ndodhte (njerëzit nuk besojnë tek organet e ndjekjes penale). Përveç korrupsionit, njerëzit ishin të pakënaqur me cilësinë dhe kohëzgjatjen e proceseve, të karakterizuara nga çështje me papajtueshmëri të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe raste të abuzimit me procedurat. Tipologjia e ankesave na shtyn të besojmë se publiku i gjerë shpesh i ngatërron gabimet procedurale dhe neglizhencën me aktet e paligjshme të korrupsionit.

Vetë gjyqtarët dhe prokurorët janë të ndërgjegjshëm se korrupsioni ekziston në sistem, megjithatë e pranojnë se nuk kanë qenë efektivë për ta larguar atë. Një në katër prokurorë dhe gjykatës besojnë se sistemi rastësor i caktimit të çështjeve nuk është zbatuar siç duhet, ndërsa gjysma e gjyqtarëve dhe prokurorëve të intervistuar mendojnë se mund të ketë ndikim ose ndërhyrje në sistemin rastësor të caktimit të çështjeve<sup>45</sup>. Vetë gjykatësit dhe prokurorët kanë pak besim në sistemin gjyqësor. Më pak se 40% e të intervistuarve e konsiderojnë përbindshëm vendimet gjyqësore të prishura ose shkallën e pushimit të çështjeve si tregues relevant ose shumë relevant në një vlerësim objektiv të sistemit gjyqësor rumun. Indeksi i vendimeve të prishura shikohet si jo relevant kryesisht për shkak të mosbesimit në vendimet e marra nga institucionet që kontrollojnë gjyqësorin. Nga ana e vet, ky mosbesim ka disa shkaqe duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në praktikën gjyqësore të paqëndrueshme. Por përtej shkaqeve dhe shpjegimeve të mundshme, mosbesimi brenda sistemit tregon në vetvete një tregues domethënës për cilësinë e administrimit të drejtësisë dhe për besimin që sistemi mund të presë nga përdoruesit e gjykatës<sup>46</sup>. Si gjykatësit, prokurorët dhe nëpunësit e gjykatave, ashtu dhe avokatët dhe publiku i gjerë besojnë se përparësitë për përmirësimin e gjendjes së gjyqësorit rumun përfshijnë reduktimin e korrupsionit në sistemin gjyqësor, duke thjeshtuar proceset gjyqësore dhe trajtimin e kohëzgjatjes së tepërt të gjykimeve.

### **3. Personat e ndjekur penalisht dhe dënimet për korrupsionin në gjyqësor**

Të dhënat publike ekzistuese na mundësojnë të identifikojmë llojet e personave që ndiqen penalisht për shkeljen ligjore të korrupsionit. Numri i krimeve dhe ndëshkimeve administrative të zbatuara për sjelljen e paligjshme publike e plotëson këtë imazh. Megjithatë, asnjë standard nuk tregon numrin e kënaqshëm të hetimeve apo dënimeve që nevojiten në mënyrë që të matet efektiviteti në luftën kundër korrupsionit.

---

<sup>45</sup> Në fakt, Ministri i Drejtësisë, Cătălin Predoiu theksoi në mbledhjen plenare të SCM më 8 janar 2009, 'ka raste ku sistemi ECRIS (sistemi i integruar i informacionit për prokuroritë dhe gjykatat, shënimi i botuesit) është manipuluar, me ndihmën e punonjësve të teknologjisë të informacionit, për të shmangur caktimin rastësor të çështjeve' ([www.realitatea.net](http://www.realitatea.net), 8 janar 2009).

<sup>46</sup> Dr. Florin Stretianu, cituar tek barometri i sistemit gjyqësor, kryer nga Instituti për Politikat Publike dhe Instituti Kombëtar i Magjistraturës në vitin 2008, gjendet në [www.ipp.ro](http://www.ipp.ro), fq. 60.



**3.1** Një pikë referimi në analizimin e gamës së korrupsionit gjyqësor është ai i hetimeve penale. Kështu, sipas deklaratave për shtyp të lëshuara nga Drejtoria Kombëtare kundër Korrupsionit në lidhje me ndjekjet penale dhe sipas raporteve të punës 2004 - 2008, në lidhje me vendimet e formës së prerë<sup>47</sup>, konstatohet se hetimet penale janë kryer në kategoritë e mëposhtme të personelit gjyqësor dhe të krimeve:

- *personeli policor* në policinë rrugore dhe departamentin e policisë gjyqësore, për krime të tilla si mitëmarrja, mashtrimi, tregtimi i influencës, ndihma dhe mbështetja dhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare. Mund të evidentohet me lehtësi se sa më serioze të jetë vepra penale për të cilën akuzohet mitëdhënësi, aq më e madhe është mita;

- *gjykatësit civilë*, ndihmës gjyqtarët dhe prokurorët për mitëmarrje, tregtim të influencës, falsifikim dhe mashtrim;

- *prokurorët* për mitëdhënie, mitëmarrje, tregtim në influencë, mashtrim, ndihmë dhe mbështetje;

- *avokatët* për tregtim influence, ndihmë dhe mbështetje;

- *noterët publikë* për tregtim influence;

- *likuidatorët* për mitëmarrje, tregtim në influencë;

- *mjekët ligjorë* për mitëmarrje;

- *ekspertët kriminalistikë* për marrjen e përfitimeve të padrejta.

Në mënyrë që të shihet se në cilin nivel fillon korrupsioni në sistemin gjyqësor dhe sa thellë shkon ai, mund të ishte interesante që të shënonim se janë filluar hetimet penale edhe në rastet e mitëmarrjes dhe tregtisë së influencës që përfshin *personelin akademik*. Kjo ka përfshirë përpjekjet për të lehtësuar lëshimin e diplomave Bachelor në shkollat juridike nga disa *oficerë policie të nivelit të lartë*, të cilët përdorën procedura të punësimit të padrejtë ose nga *oficerë të nivelit të lartë të shërbimeve sekrete* të cilët përdorën procedura të padrejta të promovimit.

**3.2** Gjatë pesë viteve të kaluara, 26 gjyqtarë dhe prokurorë kanë dalë para gjykatës për krime të korrupsionit: 3 gjyqtarë në vitin 2005, 4 gjyqtarë dhe 1 prokuror në vitin 2006, 8 prokurorë dhe 1 gjyqtar në vitin 2007, 7 prokurorë dhe 2 gjyqtar në vitin 2008 dhe asnjë në vitin 2009. Këta gjyqtarë dhe prokurorë punonin në gjykatat dhe prokuroritë e të gjitha niveleve dhe janë akuzuar për mitëmarrje, tregti influence, dhe marrje të përfitimeve të padrejta. Pretendohet se janë kryer veprat penale në lidhje me çështjet që u janë caktuar atyre ose kolegëve të tyre dhe përfshinin shuma që shkonin nga 20 - 10.000 euro. Në raste të caktuara, aktivitetet kriminale shtriheshin në dy deri në tre vite dhe lidheshin me disa çështje që u ishin caktuar gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatës.

Nga çështjet me vendim të formës së prerë në vitet e fundit, 10 u dënuan për shkelje ligjore të korrupsionit<sup>48</sup>. Me përjashtim të SCM, e cila i ka dhënë këto të dhëna vetëm për tre vitet e fundit, as Ministria e Drejtësisë, as Ministria Publike nuk kanë

<sup>47</sup> Si deklaratat për shtyp edhe deklaratat e punës së NAD gjenden në [www.pna.ro](http://www.pna.ro).

<sup>48</sup> Të dhënat janë marrë nga një kërkesë për informacion publik të depozituar tek SCM. Në të kundërt, në Japoni, për gjashtëdhjetë vitet e fundit vetëm tre gjyqtarë të gjykatës janë pushuar nga puna për korrupsion. Gjykatësit japonezë janë në të vërtetë organi gjyqësor më profesional, më i pavarur dhe më i ndershëm në botë. Kjo ndodh sepse ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nuk janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë e tyre. Megjithatë, ata nuk mbajnë lidhje me publikun dhe gëzojnë paga të larta dhe sigurinë e duhur.

statistika në lidhje me kategoritë e personelit gjyqësor të dënuar për korrupsion, gjë që tregon qartazi një mungesë të synimit për të hartuar një strategji kundër korrupsionit.

Në pesë vitet e fundit, për çështjet nën juridiksionin e NAD, 155 anëtarë të trupës policore janë dërguar para gjykatës për korrupsion, prej të cilëve 90 ishin oficerë dhe pjesa tjetër ishin agjentë.

**3.3** Me analizën tonë lidhen dhe masat e marra nga organet e brendshme disiplinore ose një sitë kundër korrupsionit.

**3.3.1.** Midis janarit 2005 dhe qershorit 2009, rreth 36 gjyqtarë, shtatëmbëdhjetë prokurorë dhe një ndihmës-gjyqtar ju nënshtruan dënimeve administrative nga Departamentet e SCM-së. Nga këta, pesëmbëdhjetë gjyqtarë, pesë prokurorë dhe një ndihmës-gjyqtar u ndëshkuan për shkelje disiplinore për veprime të rënda, siç parashikohet nga neni 99/h i Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve/Prokurorëve nr. 303/2004.

Po kështu, midis janarit 2005 dhe janarit 2009, SCM miratoi marrjen e masave ndaluese ndaj dy gjyqtarëve dhe shtatë prokurorëve. Gjatë së njëjtës periudhë, SCM urdhëroi pezullimin e nëntë gjyqtarëve dhe gjashtë prokurorëve pas ndjekjeve penale të suksesshme. Për një gjyqtar dhe katër prokurorë u hoq e drejta për të ushtruar profesionin pasi vendimet e formës së prerë të gjykatës i kishin dënuar ata për krime të ndryshme<sup>49</sup>.

**3.3.2.** Drejtoria e Përgjithshme kundër Korrupsionit (GAD) në Ministrinë e Administratës e të Brendshme u vu në veprim në fund të vitit 2005.

Në vitin 2006, GAD kreu hetimet e korrupsionit për 1281 punonjës të ministrisë, prej të cilëve 219 u akuzuan ose u ndoqën penalisht si rezultat i tyre.

Hetimet patën si objekt gjithashtu 678 vetë nga personeli që nuk i përkiste Ministrisë së Brendshme dhe të Administrimit, prej të cilëve 281 u akuzuan ose u ndoqën penalisht.

Në vitin 2007, 169 punonjës të ministrisë u akuzuan për veprën e paligjshme të korrupsionit (55% e tyre anëtarë të policisë rumune) - 76 për mitëmarrje dhe 20 për marrjen e përfitimeve të padrejta. Gjithashtu, 70 punonjës të Ministrisë (58% e tyre anëtarë të policisë rumune) u ndoqën penalisht për korrupsion. Ja vlen të shënojmë se 84 çështje ndodhën në rastet kur punonjësit e Ministrisë njoftuan GAD ku ishin ofruar para në shkëmbim të shërbimeve të caktuara. Personat përkatës u hetuan më pas për mitëdhënie. Veç këtyre, 82 çështje lidheshin me punonjësit e ministrisë të cilët raportuan për kolegët e përfshirë në veprat e paligjshme të korrupsionit, një kategori që nuk është përfshirë në kategoritë e tjera të personelit gjyqësor.

Në vitin 2008, 285 punonjës të Ministrisë (prej të cilëve 143 ishin anëtarë të policisë rumune) ju nënshtruan hetimeve për korrupsion dhe 96 (56 prej tyre anëtarë të policisë rumune) u akuzuan për veprën e paligjshme të korrupsionit. 62 çështje ndodhën në rastet kur punonjësit e Ministrisë njoftuan GAD kur u ishin ofruar para në shkëmbim të shërbimeve të ndryshme, të cilat u pasuan me hetime në lidhje me individët përkatës për mitëdhënie. Për më tepër, pati dhe 104 çështje të tjera të personelit të Ministrisë që raportuan kolegët për përfshirje në vepra të paligjshme të korrupsionit<sup>50</sup>.

<sup>49</sup> Të dhëna të paraqitura në memorandumun nr. 3114/1154/BIPRM të datës 11 shkurt 2009, lëshuar nga SCM.

<sup>50</sup> Nxjerrë nga raporti për operacionet dhe rezultatet e GAD në vitin 2008, në [www.mai-dga.ro](http://www.mai-dga.ro).

Dënimet për korrupsionin të dhëna për punonjësit e MAB arritën në 17 (të gjitha vendimet e formës së prerë) në vitin 2006, 88 (70 vendime të formës së prerë) në vitin 2007 dhe 75 (47 vendime të formës së prerë) në vitin 2008<sup>51</sup>

**3.4** Duke parë sistemin gjyqësor në kuptimin e gjerë, duke përfshirë gjykatat, prokuroritë, policinë gjyqësore dhe organet e tjera të përfshira në administratën e drejtësisë dhe ruajtjen e rendit publik dhe luftën kundër sjelljes antisociale, mund të thuhet se veprat penale të korrupsionit janë të pranishme në çdo institucion të zbatimit të ligjit<sup>52</sup>.

Duke pasur parasysh hendekun midis perceptimeve për korrupsionin (ku korrupsioni shpesh ngatërrohet me paaftësinë ose burokracinë e tepërt) dhe përvojave faktike të korrupsionit ashtu sikurse midis përvojave të korrupsionit dhe numrit të çështjeve të ndjekura penalisht, mund të deklarojmë me siguri se korrupsioni nuk mund të shihet si praktikë sistematike në sistemin gjyqësor rumun.

Megjithatë, korrupsioni është i papranueshëm, pavarësisht nga gama e tij në sektorin gjyqësor. Si pjesë e një sistemi të krijuar pikërisht për të luftuar kundër korrupsionit në shoqëri, gjyqtarët dhe prokurorët, personeli policor dhe të gjithë anëtarët e tjerë të këtij sektori duhet të demonstrojnë integritet të panjollësor. Prandaj edhe një rast korrupsioni në institucionin gjyqësor mund të konsiderohet si problem serioz. Për më tepër, duke konsideruar se numri i krimeve të raportuara ndryshon prej numrit të krimeve të kryera<sup>53</sup> dhe statistikave të atyre që pretendojnë se u është kërkuar ose u është ofruar mitë në lidhje me sektorin e drejtësisë (11% dhe 10% në 2007 përkatësisht) dhe në lidhje me policinë (9% dhe 11% në 2007-ën) ndryshojnë nga numri i çështjeve të hetuara gjatë pak viteve të fundit, kuptojmë se numri i krimeve faktikisht të kryera mund të ishte shumë më i madh.

Ky konkluzion padyshim, do të ngrinte shqetësime tek autoritetet dhe organizatat profesionale përkatëse. Përtej pranimit ose refuzimit të korrupsionit si një problem brenda sistemit gjyqësor, parandalimi i korrupsionit duhet të luajë një rol jetësor në funksionimin e çdo institucioni ose organizate. Me fjalë të tjera, duhet të identifikojmë se cilat struktura në sistem janë të cenueshme, ku mund të ndikohet funksionimi i ligjor i sistemit dhe çfarë lloji vendimesh mund të influencohen.

#### **4. Dobësitë në sistemin e drejtësisë**

Publiku i gjerë e percepton frazën 'korrupsioni në sistemin gjyqësor' se i referohet ekskluzivisht ryshfeteve që marrin gjykatësit dhe ndoshta prokurorët. Qëllimi i kërkimit tonë - përkatësisht identifikimi i fushave të cenueshme që ndikojnë tek organizimi dhe funksionimi i një sistemi të krijuar pikërisht për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe

---

<sup>51</sup> Të dhëna të paraqitura në memo nr.1212606/BIRP datë 04 shkurt 2009, lëshuar nga GAD në Ministrinë e Brendshme dhe të Administratës.

<sup>52</sup> Vasile Dobrinou, Mihai-Adrian Hotca, Norel Neagu, Marius Murea, Costel Casuneanu, ligji nr. 78/2000 për parandalimin, identifikimin dhe penalizimin e veprave penale të korrupsionit, botuesit Wolters Kluwer, Bukuresht, 2008, fq. 32.

<sup>53</sup> Ky është një vlerësim kriminologjik i cili merr parasysh tregues të tillë si: shkallën e krimit faktik – numrin total të veprave penale të kryera në një zonë të caktuar në një periudhë të caktuar; niveli zyrtar i krimit – numri total i veprave penale për të cilat njoftohen institucionet e zbatimit të ligjit; krimi i ndëshkuar – numri total i veprave penale të dënuara pas vendimit të formës së prerë dhe gjykatës; shifra e errët e krimit – krimet e kryera por për arsye të ndryshme të paraportuara, dhe që shpjegojnë dallimin midis shifrave faktike dhe të paraqitura të krimit.

për të formuluar sugjerime për një politikë të përshtatshme gjyqësore kundër korrupsionit - kërkon një analizë gjithëpërfshirëse të korrupsionit në këtë sistem. Kjo është arsyeja përse nga njëra anë nuk mund t'i anashkalojmë kategoritë e personelit që punon në sistem dhe nga ana tjetër duhet të shqyrtojmë edhe rastet e mitëmarrjes të iniciuara nga qytetarët (sepse vetë veprimi i ofrimit të parave është një akt korrupsioni në vetvete, pavarësisht nëse agjenti publik e pranon atë apo jo). Dhe përfundimisht, analiza jonë nuk duhet të reduktohet tek rastet kur influencohen vendimet, por duhet të shikojë gjithashtu se si korrupsioni ndikon tek vendimet që merren në sistem, të cilët nuk kanë impakt të drejtpërdrejtë në procedurë gjyqësore.

Prandaj analiza e korrupsionit në sistemin e drejtësisë faktikisht do të ketë si objekt sistemin gjyqësor dhe përdoruesit e tij. Dhe fraza "sistem gjyqësor" vlen jo vetëm për gjykatësit dhe prokurorët<sup>54</sup>, por për të gjithë institucionet dhe profesionistët e përfshirë në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ligjore ose një padie. Kjo përfshin institucionet që përcaktojnë një vepër penale/shkelje (nga policia rrugore deri tek Garda Financiare), policia gjyqësore, prokurorët dhe gjykatësit, personeli administrativ i gjykatës dhe prokurorisë (nëpunësit e gjykatës, punonjësit e arkivës, personeli i regjistrimit, etj.), avokatët, ndërmjetësit, ekspertët, profesionistët e paaftësisë pagueuse, përmbaruesit, zyrtarët e shërbimit të provës, noterët publikë, inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Integritetit.

Konteksti social  
Sistemi i drejtësisë  
Sistemi jo shtetëror i drejtësisë  
Legjislativi  
Ekzekutivi  
Donatorët  
Sistemi gjyqësor  
Gjykatësit  
Prokurorët  
Personeli ndihmës  
Policia  
Sektori privat  
Masmedia  
Avokatët  
Shoqatat profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve  
Avokatët  
OJQ-të.  
Mjedisi akademik  
Opinionimi publik  
Krimi i organizuar

*Figura 1: Struktura e sistemit të drejtësisë (sipas TI-RO)*

#### **4.1 Llojet e vendimeve në sistemin e drejtësisë**

---

<sup>54</sup> Gjykatësit dhe prokurorët janë pjesë e "gjyqësorit", dhe së bashku me nëpunësit e gjykatës ata përbëjnë "sistemin gjyqësor" ose gjerësisht, "sistemin e drejtësisë". Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve rregullohet me ligjin nr. 303/2004 dhe organizimi i gjyqësorit në ligjin nr. 304/2004.

Robert Klitgaard, një ekspert i mirënjohur i korrupsionit ka krijuar ekuacionin e mëposhtëm që thekson shkaqet e korrupsionit:  $K$  (Korrupsioni) =  $M$  (Monopoli) +  $D$  (Diskrecioni) -  $P$  (Përgjegjshmëria)<sup>55</sup>.

Kjo do të thotë se kushtet optimale për korrupsionin linden aty ku një agjent publik apo edhe privat ka autoritetin ekskluziv për të marrë disa vendime, kur këto vendime në fakt nuk janë të motivuara nga fakti ose nga ligji ose nuk ju nënshtrohen kushteve dhe rrethanave të caktuara dhe kur i gjithë procesi i vendimmarrjes nuk është transparent para autoriteteve të tjera ose para publikut.

Po kështu, *Libri Burimor për Përgjegjshmërinë, Transparencën dhe Integritetin* i PNUD-it merr parasysh elemente të tjera që janë të rëndësishme në kundërpeshën e Monopolit dhe Diskrecionit. Formula për këtë arsye është:

***Korrupsion = (Monopol + Diskrecion) - (Përgjegjësi + Integritet + Transparencë)***<sup>56</sup>.

Do ta përdorim këtë 'recetë' për korrupsionin në analizën tonë për korrupsionin në sistemin gjyqësor, më specifikisht në identifikimin e dobësive të këtij sistemi.

Për të parë se ku dhe si ndodh korrupsioni në sistemin gjyqësor, së pari duhet të identifikojmë mangësitë e sistemit dhe dobësitë morale të agjentit në lidhje me vendimet e marra në fusha të ndryshme gjyqësore, pavarësisht nëse ato janë të rrënjosura në legjislacion, menaxhimin institucional apo pikërisht në sjelljen individuale. Kështu, institucionet gjyqësore kryesisht marrin vendime gjyqësore, d.m.th vendime që japin zgjidhjen për çështjen gjyqësore nëpërmjet institucioneve publike. Për shembull, prokurorët mund të vendosin t'i ndërpresin hetimet penale kundër një individi; gjyqtarët mund të vendosin ta dënojnë një të pandehur, etj.

Institucionet publike të thirrura për të marrë këto vendime disa herë, në një masë të madhe, mbështeten tek raportet e ekspertëve ose në pohimet që bëjnë avokatët ose anëtarët e profesioneve të tjera të lira.

Pavarësisht nga natyra penale ose civile e çështjes, secila prej atyre që u renditën më sipër në një pikë të caktuar mund të kthehen në agjentë aktivë ose pasivë të veprave penale të korrupsionit. Këto mund të kryhen në çdo etapë, nga hapat e para të procesit gjyqësor deri në implementimin e vendimit.

Përtej qëllimit operues të sistemit, përkatësisht administrimin e drejtësisë, institucionet që diskutohen këtu kryejnë edhe disa shërbime të tjera për publikun: ata regjistrojnë kërkesat, lëshojnë kopje dokumentesh në dosjet e çështjes, lejojnë aksesin në arshiva, vërtetojnë kopje, noterizojnë dokumente e kështu me radhë. Këto shërbime do t'i quajmë 'akte administrimi gjyqësor', që janë krijuar ose për të bërë të mundur vendimet gjyqësore (p.sh., caktimi i çështjeve për gjyqtarët), ose për të ndodhur në një fazë të mëvonshme (p.sh., komunikimi i vendimeve të gjykatës). Plotësimi i akteve të administrimit gjyqësor, si rregull, është detyrë e personelit përkatës administrativ në departamentet e regjistrimit, arshivës dhe statistikave.

Veç këtyre, institucionet në fjalë marrin edhe vendime thjesht administrative. Kështu, nga ana e organizimit, rajoni policor, prokuroria, gjykata, vendi i vuajtjes së dënimit ose Këshilli Superior i Magjistraturës veprojnë si çdo institucion tjetër publik, në të cilin vendimet merren për çdo gjë, që nga menaxhimi i karrierës deri tek

---

<sup>55</sup> Robert Klitgaard, Ronald Maclean-Abaroa, H. Lindsey Paris, 'Qytetet e korruptuara - udhëzues praktik për të kuruar dhe parandaluar', Banka Botërore, 2000, përkthyer në rumanisht dhe botuar nga Shtëpia Botuese Humanitas, 2006, fq. 42.

<sup>56</sup> PNUD, Shënim për praktikën kundër korrupsionit, 2004, [www.undp.org/governance/docs/AC\\_PN\\_English.pdf](http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf), fq. 2.

prokurimet publike. Kjo kategori përfshin edhe vendimet për politikat publike që lidhen me drejtësinë të marra nga Ministri i Drejtësisë.

#### **4.2 Dobësitë në fushat gjyqësore dhe të administrimit gjyqësor**

Në mënyrë sintetike tani për tani do të përmendim se zgjidhja e padive *civile* është detyrë e gjyqtarëve dhe zbatimi i këtyre zgjidhjeve është detyrë e përmbaruesve gjyqësorë. Kur kryhet një krim, çështja *penale* i shkon gjyqtarit vetëm kur këtë e vendos prokurori, bazuar në hetimet e kryera nga policia gjyqësore. Më vonë, Agjencia Kombëtare Penitenciare ose shërbimi i provës ekzekuton vendimin e formës së prerë. Në ndihmë të këtyre agjentëve publikë mund të jenë agjentët privatë, të tillë si avokatët ose ekspertët teknikë. Që të identifikohen dobësitë e sistemit, siç kemi marrë përsipër ta bëjmë, do të analizojmë çdo kategori personeli të përmendur më sipër, sipas rendit kronologjik të përfshirjes së tyre në çështjet penale/jo penale. Kjo është mënyra se si mund ta lidhim relevancën dhe llojin e korrupsionit me nivelin institucional.

**a. Policët gjyqësorë** kryejnë hetime penale në lidhje me veprat e paligjshme dhe individët e dyshuar se kanë kryer vepra penale. Si rregull, ata i depozitojnë ankesat dhe raportet penale tek policia dhe në shumicën e rasteve ky institucion kryhen hetimet penale.

Individët nën hetim janë të interesuar që të mos fillohet procesi penal kundër tyre dhe për këtë arsye nuk duan që të jenë të detyruar të paraqiten para prokurorëve. Për pasojë, ata mund t'u drejtohen akteve të korrupsionit në mënyrë që të jenë në gjendje të vazhdojnë të kryejnë vepra penale (p.sh., kontrabandën e narkotikëve, prostitucionin, lojërat e fatit). Kjo i siguron ata se do të njoftohen kur të planifikohen veprime kundër tyre (p.sh., duke e ditur kontrollin e banesës, kjo do t'u jepte atyre kohë të mjaftueshme që të shkatërronin provat penale) ose në mënyrë që ta bindin punonjës të policisë që të mos e regjistrojnë ankesën e një viktime në formatin e raportit penal. Ose ndryshe, ata mund të përpiqen t'i bindin punonjës të policisë që të hetojnë vetëm një pjesë të vogël të veprave penale të ankesës, ose të hartojnë një memo për prokurorin duke sugjeruar që prokurori të miratojë një zgjidhje në favor të individit që i nënshtrohet hetimit.

Prandaj, përpjekjet për të thyer integritetin duke korrumpuar punonjës të policisë gjyqësore mund të çojnë në raportimin e pasaktë të krimeve dhe fshehjen e raporteve. Veç këtyre, ata mund të ndikojnë në mënyrën e hetimit, vlerësimin e krimit, zgjidhjen e ankesës ose dhënien e informacionit thelbësor. Rreziku për shtrembërimin e të vërtetës mund të minimizohet vetëm në qoftë se prokurori që e anashkalon punën e organit të hetimit penal kontrollon tërësisht dokumentet e përpiluara nga punonjës të policisë.

Monopoli që ka policia në lidhje me autoritetin për të nisur hetimet penale mund t'i çojë ata që të kryejnë krime që lidhen me shantazhin: në shkëmbim të përfitimeve të caktuara, ata mund të premtojnë sigurimin e mbrojtjes së sjelljes kriminale (p.sh., prokurimin ose vjedhjen e produkteve të naftës). Gjithashtu, roli i policisë në ekzekutimin e urdhrave të kontrollit, urdhrave të arrestimit ose dënimeve mund t'i bëjë punonjës të policisë të cenueshëm ndaj krimeve të korrupsionit të kryera me qëllim pengimin e hetimeve, arrestimit ose ndalimit të keqbërësve.

Afërsia e punonjësve të policisë me qarqet kriminale dhe kontakti i tyre me botën kriminale mund t'i çojë disa prej tyre që të bëhen pjesë e sistemit të krimit të organizuar.

Në lidhje me pozicionin e punonjësve të policisë në sistemin gjyqësor, doktrina dallon nëntë lloje korrupsioni në polici<sup>57</sup>:

- korrupsioni i autoritetit, që u mundëson punonjësve të policisë të përdorin statusin e tyre në mënyrë që të nxjerrin përfitime të padrejta (p.sh., pronarët e restoranteve në zonat me emër të keq mund t'u ofrojnë vakte falas oficerëve të policisë në shkëmbim të mbrojtjes);
- ndihma, që përfshin marrjen e përfitimeve të padrejta në shkëmbim të lehtësimit të rritjes së bizneseve të keqbërësve (p.sh., policia u jep mbrojtje gjatë vjedhjes së naftës nga naftësjellësi);
- vjedhja oportune, ku punonjësit e policisë përvetësojnë pasurinë e njerëzve të arrestuar, viktimave, të vendngjarjeve ose pronave të pambrojtura (p.sh., punonjësit e policisë marrin narkotikët e konfiskuar për shitje ose konsumim);
- shantazhi, nëpërmjet të cilit policia merr përfitime të padrejta nga të dyshuarit në shkëmbim të fshehjes të veprave penale (p.sh., policia pranon mitën në mënyrë që të mos nisë hetimet penale);
- mbrojtja e aktiviteteve të paligjshme, të cilat blejnë mungesën e reagimit policor në mënyrë që t'u sigurojë kryerjen e aktiviteteve të paligjshme (p.sh., punonjësit e policisë 'blihen' nga tutorët që i detyrojnë prostitutat t'u ofrojnë atyre favore seksuale);
- mita, nëpërmjet të cilës kriminelët përpiqen që të shmangin masat procedurale (p.sh., arrestimin, kontrollin, ndalimin ose konfiskimin e pronës), të heqin nga dosjet provat inkriminuese ose që t'u regjistrohet vepra penale si krim më i lehtë;
- sjellja e drejtpërdrejtë kriminale, e cila nuk përfshin ekzistencën e agentit korruptues, por është një aktivitet i kryer nga oficerët e policisë kundër individëve të tjerë (p.sh., ata që bëjnë vetëgjyqësi, të cilët përdorin pajisjet e policisë dhe marrin ligjin nën kontrollin e tyre);
- rregullimet e brendshme, që përfshijnë ofertën dhe pranimin e mitës brenda njësive policore, në shkëmbim të bonuseve, stimujve, promovimeve para kohe, pozitave administrative të rëndësishme, etj.;
- vendosja e artikujve të paligjshëm, (p.sh., narkotikëve, posedimi dhe shitja e të cilave janë të dënueshme sipas ligjit), të cilët mund të vendosen në sendet personale të një individi dhe mund të përbëjnë bazën e akuzave kriminale kundrejt atij individi.

**b. Prokurorët** janë ata që kryejnë ndjekjen penale. Ata kanë monopolin e vendimeve akuzuese, të cilat i nxjerrin individët e dyshuar para gjykatës, në mënyrë që të përgjigjen penalisht. Në qoftë se i dyshuari është i pafajshëm, prokurori është kategoria e vetme që ka të drejtën ta pushojë fillimin e ndjekjes penale ose të ndërpresë fare procesin. Kur të dyshuarit nxirren para gjykatës, është prokurori që paraqet çështjen kundër tyre.

Ka raste kur vetë prokurorët dhe jo policia gjyqësore kryejnë hetimet penale. Në këto raste, llojet e korrupsionit të policisë të përmendura më sipër vlejné edhe për prokurorët. Në praktikë, janë raportuar raste kur janë bërë përpjekje për të korruptuar prokurorët për të filluar ndjekjen penale të palëve të treta<sup>58</sup>.

Meqenëse individët do të kërkojnë mënyra për të shmangur daljen para gjykatës, ata mund t'i drejtohen korruptimit të prokurorëve që të marrin një vendim të favorshëm. Në qoftë se çështja e tyre është tashmë para gjykatës, ata mund të korruptojnë prokurorin që

<sup>57</sup> Shih Pavel Abraham, *Korrupsioni*, Shtëpia Botuese Detectiv, Bukuresht, 2005, fq. 276 -279.

<sup>58</sup> U depozitua një ankesë kundër një prokurori, i cili gjoja kishte marrë mitë në shkëmbim të fillimit të ndjekjes penale të një afaristi: [www.hotnews.ro/Arhiva\\_noiembrie\\_2007/articol\\_1152023/-htm](http://www.hotnews.ro/Arhiva_noiembrie_2007/articol_1152023/-htm).

të mos i paraqesë të gjitha provat kundër tyre ose që të mos i sfidojë vendimet e gjykatës të favorshme për mitëdhënësin.

Për të shmangur aktet e paligjshme ose të pabazuara nga prokurorët, veprimet e tyre duhet të kontrollohen nga një prokuror i nivelit më të lartë (në mënyrë rastësore ose me marrjen e një ankese) dhe gjykatësi (vetëm me marrjen e një ankese dhe pasi të jenë kontrolluar dokumentet nga një prokuror i një niveli më të lartë). Në këtë drejtim, audit i kryer nga Freedom House në vitin 2005 për impaktin e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit 2001-2004 paralajmëron dobësitë në pozicionin e prokurorëve të niveleve më të ulëta në lidhje me kolegët e tyre në nivele më të larta, dhe identifikon parakushtet për problemet organizative<sup>59</sup>. Plani i veprimit që lidhet me strategjinë 2005-2007 përfshin masa të forta në lidhje me zbatimin e parimit të vazhdimësisë në ndjekjen penale: përcaktimin e kriterëve objektive për caktimin fillestar të çështjeve, reduktimin e mundësisë për rishpërndarjen e çështjes, reduktimin e ndërhyrjes nga prokurorë të niveleve më të larta në ndjekjen penale në çështjet e parashikuara në mënyrë specifike nga ligji dhe futja e kontrollit të gjykatës mbi vendimet e shpalljes së pavlefshme nga prokurori i një niveli më të lartë me kërkesën e prokurorit që ndjek çështjen penalisht<sup>60</sup>.

Megjithatë, Kodi aktual i Procedurës Penale u mundëson prokurorëve të prokurorive të niveleve më të larta që të marrin në dorëzim ndjekjen penale të çështjeve që futen në juridiksionin e prokurorive të niveleve më të ulëta. Një dobësi mund të ishte vlerësimi i atyre situatave kur këto transferime janë të domosdoshme. Diskriminimi nga kreu i prokurorisë së nivelit më të lartë, pa ndonjë bazë detyruese për këtë vendim dhe pa ndonjë marrëveshje me prokurorin e çështjes, mund të çojë në ndërhyrje në aktivitetin e prokurorit fillestar dhe në shtrembërim të përparimit të duhur të ndjekjes penale.

**c. Gjyqtarët** janë magjistratët që zgjidhin mosmarrëveshjet duke marrë vendime dhe në rastin e dënimit, marrjen e vendimeve detyruese. Kur qytetarët vijnë para gjykatës, ata kërkojnë vendime të favorshme, pavarësisht nga pozicioni i tyre në gjykim (pretendues ose i paditur në paditë civile, viktimë apo i pandehur në gjykimet penale). Për të shtyrë më tej aktet e korrupsionit, gjyqtarët mund të pranojnë ose të mohojnë provat për të përligjur vendimet e tyre, të urdhërojnë regjistrim të pasaktë të deklaratave të bëra nga palët ose dëshmitarët, të përshpejtojnë ose vonojnë zgjidhjen e çështjes, ose të marrin një vendim që bie ndesh me provat e dosjes ose me ligjin.

Korruptimi i një gjyqtari mund të ndikojë në përparimin e një çështjeje në shumë mënyra të ndryshme, duke filluar nga emërimi i gjykatësit dhe caktimi i çështjes, mënyra se si gjyqtari e drejton çështjen, koha e caktuar për secilën çështje, mënyra me të cilën trajtohen debatet, zbatimi i rregullave që kërkon paanësia dhe procesi i vendimmarrjes.

Që prej marsit 2005, në Rumani, çështjet u janë caktuar gjyqtarëve me rastësi, zakonisht nëpërmjet një sistemi të teknologjisë së informacionit. Por është e mundur që kjo të anashkalohet dhe që një çështje t'i caktohet një gjykatësi të veçantë nëpërmjet ndihmës së nëpunësit të gjykatës ose gjykatësit të besuar për të përdorur sistemin.

---

<sup>59</sup> Freedom House Uashington, *Politikat Kundër Korrupsionit të Qeverisë* së Rumanisë - Raport vlerësimi, mars 2005, gjendet në [www.just.ro](http://www.just.ro).

<sup>60</sup> Megjithatë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 345/2006, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 415 e datës 15 maj 2006, e anuloi si antikushtetuese fjalinë e dytë në nenin 64, paragrafi 3 i ligjit nr. 304/2004 (i cili ishte futur në paketën e reformës së drejtësisë në vitin 2005), i cili thoshte se "masa e shpalljes së pavlefshme i nënshtrohet kontrollit të gjykatës që ka juridiksionin mbi dosjen e çështjes, me kërkesën e prokurorit që ka miratuar zgjidhjen përkatëse"



Ky individ, që ka përdorur programin kompjuterik për një periudhë të gjatë dhe që mund të vlerësojë se cilit panel do t'i caktohet çështja, mund të sigurojë që, ose operacioni të kryhet sipas rendit të depozitimit të padive, mund të futë variable kohore për të cilat ka vetëm një caktim të mundshëm (një panel)<sup>61</sup> ose mund të futë kritere komplekse të shtrembëruara në mënyrë që ta 'pilotojë' çështjen drejt një paneli të veçantë<sup>62</sup>.

Ja vlen të shënojmë se programi kompjuterik nuk do të gjenerojë caktimin e një çështjeje një gjykatësi të veçantë, por një paneli gjyqtarësh të cilët kanë një kod identifikimi të veçantë, që e dallon atë nga të tjerët. Sipas rregulloreve të brendshme, anëtarësia e këtyre paneleve do të vendoset *në fillim të çdo viti*, megjithëse kryetari i gjykatës rezervon të drejtën ta ndryshojë atë më pas, sipas rrethanave që nuk janë objektive. Ky devijim ndihmohet nga fakti se në shumicën e gjykatave anëtarët e trupit gjykues nuk janë publik. Gjithashtu, meqenëse anëtarët e panelit përcaktohen në fillim të vitit, edhe për çështjet e pagjykuara, një çështje që nuk është gjykuar në fund të vitit mund të merret nga gjyqtarë të tjerë të caktuar në fillimin e vitit që të jenë pjesë e atij paneli<sup>63</sup>. Një mjet tjetër për të kapërcyer caktimin rastësor mund të arrihet duke ndryshuar anëtarët e panelit të gjyqtarëve *gjatë vitit*.

Si rregull, gjyqtarët që janë emëruar për të zgjidhur një çështje mund të zëvendësohen vetëm për arsye objektive. Megjithatë, gjyqtari i caktuar mund të abuzojë me këto arsye me kërkesa të depozituara për leje për të munguar, leje sëmundjeje, dhe leje vjetore, të cilat çojnë në zëvendësimin e gjyqtarit me një tjetër që bëhet anëtar i panelit. Në qoftë se zëvendësi gjithashtu 'papritur' sëmuret, atëherë eventualisht çështja mund të përfundojë përpara gjyqtarit të dëshiruar. Në mënyrë të ngjashme, një metodë tjetër për të ndryshuar anëtarët e panelit gjatë vitit është duke ngritur ose duke çmontuar panelet dhe duke e transferuar çështjen nga paneli i vjetër tek panelet e reja.

Meqenëse në Rumani programi i kompjuterit përcakton edhe gjyqtarin edhe datën e seancës së parë, gjykatësi mund të korruptohet duke ndryshuar datën e seancës, duke përshpejtuar kështu në mënyrë të paligjshme procesin<sup>64</sup>.

---

<sup>61</sup> Për shembull, një padi e depozituar në gjykatë në një ditë të veçantë e ka seancën e saj të parë të planifikuar në një datë disa ditë më vonë; në qoftë se e njëjta padi depozitohet tre ditë më vonë dhe të gjitha variabellet e tjera janë identike, atëherë seanca e planifikuar nga sistemi i kompjuterit do të jetë tre ditë më vonë. Në qoftë se anëtarësia e panelit njihet paraprakisht, atëherë mund të 'zgjidhet' dita se kur të depozitohet padia. Shih artikullin 'dedikimi'. Kancelari i gjykatës ndihmon C. për të fituar 'Parkun B', në të përditshmen 'Gardianul', datë 01.02.2008, në <http://tinyurl.com/grefiera>.

<sup>62</sup> Kjo ishte e mundur veçanërisht sepse, midis marsit 2005 dhe majit 2008, nuk ishin përcaktuar kritere komplekse konsistente. Vetëm me Rezolutën Nr. 561 të datës 15 maj 2008, SCM përcaktoi nivele konsistente komplekse në gjithë vendin.

<sup>63</sup> Kjo dobësi mund të ndikojë edhe jurisprudencën e një gjykate: le të supozojmë se një Gjykatë Apeli ka tre panele me tre gjyqtarë secili, prej të cilëve dy panele kanë një praktikë të caktuar dhe paneli tjetër një praktikë të ndryshme për të njëjtën çështje. Një vendim mund të merret për të ricaktuar gjykatësit në mënyrë që një gjyqtar i panelit të tretë të bëhet anëtar i paneleve të tjera, në të cilët ata duhet të pranojnë praktikën e imponuar nga shumica, e cila mund të mos jetë gjithmonë e drejtë.

<sup>64</sup> Ja vlen të shënojmë papërputhshmëritë procedurale në legjislacion: sipas nenit 99, paragrafi 8 i rregullores së brendshme të gjykatave "kërkesat për vendosjen e një afati tjetër për seancën e parë do të marrin përgjigje nga paneli i gjyqtarëve të cilit i është caktuar dosja nëpërmjet procedurës së caktimit rastësor," sipas nenit 153, paragrafi 3 në kodin e procedurës civile, "fuqinë për t'ju përgjigjur një kërkesë për vendosjen e një afati tjetër të seancës së parë e ka kryetari i gjykatës, zëvendëskryetari i gjykatës, kryetari i departamentit të gjykatës ose gjyqtari që zëvendëson këtë të fundit. Gjatë procesit gjyqësor, kërkesa për rivendosjen e afatit zgjidhet nga paneli i gjyqtarëve". Kjo mospërputhje legjislative mund të lehtësojë ndërhyrjen e kryetarit të gjykatës në administrimin e çështjes nga gjyqtari përkatës.

Gjithashtu gjykatësit mund të korruptohen duke dhënë përjashtime ose reduktime të shpenzimeve të gjykimit për proceset civile, në rrethana të tjera nga ato që parashikon ligji. Është me vlerë të shënojme se në lidhje me dosjet që i caktohen panelit prej 9 gjyqtarësh të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, rregullat e caktimit rastësor nuk aplikohen. Kjo është serioze në mënyrë të veçantë, meqenëse ky panel ka juridiksionin mbi zgjidhjen e apeleve në çështjet që gjykohen në gjykatën e shkallës së parë nga Gjykata Penale e HCCJ, në lidhje me senatorët, deputetët, anëtarët e qeverisë, gjykatësit dhe prokurorët që punojnë në gjykatat e apelit dhe në HCCJ dhe anëtarët e SCM (neni 24 i ligjit nr. 304/2004 mbi organizimin e gjyqësorit, neni 29 i Kodit të Procedurës Penale). Neni 32 i ligjit nr. 304/2004 parashikon krijimin e një paneli prej nëntë gjyqtarësh, 'si rregull, nga gjyqtarë të specializuar, në varësi të natyrës së çështjes.' Megjithatë, në praktikë janë raportuar situata në të cilat ky panel ka përfshirë, disa herë në numër të madh, gjyqtarë nga gjykatat që nuk janë gjykata penale të HCCJ, gjë që është e papranueshme në lidhje me specializimin e gjyqtarit. Në çdo rast, rregullat për anëtarët e këtij paneli, që përbëhen nga gjyqtarë të emëruar nga kryetari i HCCJ nuk janë publike.

Abuzimet mund të ndikojnë qarkun e çështjeve në një gjykatë, në situata të tilla kur një çështje transferohet në një gjykatë tjetër ose refuzohet juridiksioni nga një gjykatë, gjë që çon në kthimin e çështjes në gjykatën fillestare. Po të mos tregohet kujdes për ta kthyer çështjen tek i njëjti panel fillestar, ajo mund t'i dërgohet një paneli tjetër 'gabimisht'. Ka pasur situata kur një çështje i është transferuar një paneli tjetër nga kryetari i gjykatës<sup>65</sup>.

Për sa ju përket palëve, duhet përmendur se ato jo gjithmonë e dinë identitetin e gjyqtarëve që gjykojnë çështjen e tyre, gjë që e bën të pamundur kërkesën për masa mbrojtëse të paanshmërisë. Për shembull, meqenëse emri i gjyqtarit nuk afishohet në derën e sallës së gjykatës apo në faqen e internetit të gjykatës, në qoftë se njëra palë vendos të mos marrë pjesë në seanca, ajo nuk do të jetë në gjendje ta sfidojë gjyqtarin që lidhet me palën kundërshtare apo avokatët e tyre sepse ajo nuk do ta dinte se kush ishte gjyqtari përkatës. Kjo nuk është e vërtetë për sa u përket prokurorëve. Prokurorët marrin njoftim rregullisht për gjyqtarët e planifikuar për të trajtuar kërkesat e arrestimit kështu që, teorikisht, prokurorët mund ta zgjedhin ditën në të cilën depozitojnë kërkesën për arrestimin e një individi të caktuar. Ky veprim mund të rritë gjasën që urdhri i veçantë të arrestit të kërkohet nga një gjyqtar i caktuar, veçanërisht nga që ata e dinë se praktika gjyqësore nuk është e qëndrueshme në këtë drejtim.

Vetë palët mund t'i shmangin çështjet e caktuara me rastësi: përdoruesit e gjykatës dhe avokatët kanë krijuar tashmë një praktikë nga depozitimi i disa padive, në lidhje me të njëjtën temë, në momente të ndryshme kohore në një gjykatë. Pasi ata caktohen në panele të ndryshme, pala në fjalë braktis paditë që u janë caktuar paneleve 'të padëshiruar'. Në këtë mënyrë, përfitohet nga mungesa e rregullave të brendshme që t'u kërkojnë gjykatave të kontrollojnë, para regjistrimit të padive, nëse ka procese të tjera me të njëjtën lëndë dhe nëse palët janë tashmë ende pjesë e këtyre gjykimeve të

---

<sup>65</sup> "Shtëpia e Monikës, historia e plotë," në gazetën Cotidianul e datës 12 dhjetor 2005, në [www.cotidianul.ro/casa\\_monica\\_i\\_povestea\\_completa-5998.html](http://www.cotidianul.ro/casa_monica_i_povestea_completa-5998.html): një shtëpi e pretenduar nga pronari nuk iu kthye pronarit dhe apelimi i depozituar nga paditësi u pushua nga HCCJ; më vonë, doli në dritë se banorët e shtëpisë në fjalë ishin prindërit e një doktori që trajtonte bashkëshortin e njëjtes prej gjyqtarëve në panel gjatë gjykimit dhe se çështja kishte përfunduar në tavolinën e asaj gjyqtareje për shkak të ndërhyrjes së kryetarit të gjykatës, megjithëse procedura e caktimit rastësor çështjen fillimisht ia kishte dërguar një paneli tjetër.

papërfunduara<sup>66</sup>. Nga ana tjetër, nuk ka rregulla që penalizojnë palët dhe/ose avokatët që abuzojnë me të drejtat e tyre procedurale në këtë mënyrë.

Një fushë tjetër e cenueshme është vendimi për kërkesat e transferimit, që pasqyron plotësisht diskrecionin dhe mungesën e transparencës të organeve gjyqësore. Kështu, një palë që dëshiron të transferojë një gjykim në një qytet tjetër duhet të depozitojë një kërkesë transferimi në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, e cila i përgjigjet kërkesës me dyer të mbyllura në proceset civile. Ky vendim nuk ka nevojë të materializohet sipas rregullave të procedimit civil dhe nuk i nënshtrohet apelit. E njëjta gjë është e vërtetë në proceset penale sepse faktikisht baza e kërkuar sipas Kodit të Procedurës reduktohet tek tregimi i teksteve të ligjit.

Pavarësisht nga arsyet e parashtruara për kërkesën e transferimit, të cilat rregullohen në terma të përgjithshme,<sup>67</sup> për sa kohë që këto arsye vlerësohen nga gjyqtari, një palë mund të përpiqet të ndikojë tek vendimi. Asgjë nuk e detyron panelin e gjyqtarëve që të tregojë se për se e kanë miratuar transferimin e dosjes. Veç këtyre, deri tani nuk ka pasur rregulla që të diktojnë kriteret për për zgjedhjen e gjykatës në të cilën do të transferohet çështja përkatëse. Kjo ngre dyshime madhore në lidhje me paanshmërinë e transferimit të një gjykimi nga një gjykatë tek një tjetër. Së fundi, në proceset civile, kryetari i një gjykate përkatëse është i lirë ta pezullojë një gjykim derisa të zgjidhet kërkesa e transferimit nga paneli i emëruar, pa pasur nevojë që të mbështesë vendimin e tij ose të saj (neni 40, paragrafi 2, Kodi i Procedurës Civile). Kjo çon në një përzierje të pamohueshme nga ana e organit administrativ në aktivitetin e gjykatës që ka juridiksionin mbi çështjen.

I pandehuri mund të ofrojë mitë në shkëmbim të një ndëshkimi më të ulët. Mosarritja nga ana e gjyqtarëve që të mbështetin me prova vendimet e tyre në këtë drejtim - nëse e bëjnë këtë - e kthen diskrecionin e tyre për caktimin e një vendimi ose për përkufizimin e mënyrës se si do të kryhet ai në një element që favorizon korrupsionin ose dyshimet për korrupsion.

Meqenëse gabimet e mundshme të gjykimit - qofshin me qëllim apo jo - trajtohen vetëm me anë të formave të zakonshme ose të veçanta të apelimit, gjyqtarët që kanë monopolin mbi gjykimet e shkallës së fundit përfaqësojnë një zonë të cenueshme. Për sa kohë që nuk ka një gjykatë tjetër që të vlerësojë vendimet e tyre, gjyqtarët e apelit do të jenë 'objekte' të përzgjedhjes për mitëdhënësit, ndryshe nga gjyqtarët në gjykatat e niveleve më të ulëta. Megjithatë, gjyqtarët në gjykatat e niveleve më të ulëta janë gjithashtu të cenueshëm, veçanërisht ata të qyteteve të vogla që janë larg qyteteve të mëdha ku ndodhen gjykatat. Qytetarët do të përpiqeshin më tepër të 'zgjidhnin punë' në nivel vendor më tepër se sa të udhëtonin në një qytet tjetër për të sfiduar vendimin e parë.

---

<sup>66</sup> Vetëm në çështjet e insolvencës, sipas nenit 31 të ligjit nr. 85/2006, një gjyqtar i çështjeve civile është i detyruar të kontrollojë nëse ka ende në zhvillim procese të tjera kundër debitorit apo të depozituara nga debitori në gjykatë.

<sup>67</sup> Më specifikisht, arsyet e përmendura në nenin 37, paragrafi 2, Kodi i Procedurës Civile: 'Një transferim çështjeje mund të kërkohet për *arsyet e dyshimit legjitim ose sigurisë publike*. Dyshimi shikohet si i ligjshëm kur paanshmëria e gjyqtarëve mund të supozohet se ndikohet nga rrethanat e çështjes, statusi i palëve ose vendi. Arsyet e sigurisë publike janë ato rrethana që krijojnë supozimin se gjykimi i kryer në gjykatën përkatëse mund të prishë rendin publik'. Dhe neni 55, paragrafi 1, kodi i procedurës penale: Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e Drejtësisë e transferon një gjykim nga gjykata përkatëse tek një gjykatë e të njëjtit rang, në situatat kur *paanshmëria e gjyqtarëve mund të ndikohet nga rrethanat e çështjes, nga armiqësitë vendore ose statusi i palëve, kur ekziston rreziku i prishjes së rendit publik (...)*'.

Kryerja e një gabimi të qëllimshëm gjyqësor si pasojë e korrupsionit mund të shoqërohet me ndëshkime penale ose administrative kundër atij gjykatësi. Në këto rrethana, vendimi i gabuar mund të korrigjohet nëpërmjet procedurës së rishikimit (neni 322/4 Kodi i Procedurës Civile, dhe neni 394, paragrafi 1 d, Kodi i Procedurës Penale).

Përpjekjet për korrupsionin e një gjykatësi mund të kenë objekt jo vetëm rezultatin e një vendimi të veçantë. Ka pasur raste kur është ofruar mitë në shkëmbim të përshpejtimit të lëshimit të një vendimi. Por mita mund të ofrohet edhe në shkëmbim të vonesës së një procesi. Shtyrja e papërligjor e seancave mund ta shtyjë çështjen përtej datës të parashkrimit, për shembull. Veç kësaj, përpjekje mund të bëhen edhe për të korrumpuar gjyqtarin që akuzohet për aplikimin e një vendimi në mënyrë që, pasi vendimi me burg të marrë formën e prerë, gjyqtari mund ta urdhërojë kancelarin e gjykatës të mos e lëshojë urdhrin për ekzekutimin e vendimit.

Duhet të përmendim gjithashtu se efektet e tërthorta të korrupsionit të një oficeri të policisë ose të një gjyqtari apo prokurori për sa i përket zgjidhjes së veçantë të një çështjeje; kjo mund të ndikojë në jetën e atij komuniteti sepse gjendjet e tjera të çështjeve varen nga ajo zgjidhje. Për shembull, mos kontrollimi i informacionit në lidhje me një ofertë të falsifikuar mund të lehtësojë përfundimin e punimeve të ndërtimit duke mos marrë parasysh rregullat e sigurisë të cilat mund të rrezikojnë jetën e njerëzve të tjerë.

Korrupsioni i pjesëtarëve të policisë ose edhe të oficerëve të shërbimit informativ, u mundëson grupeve të kriminit të organizuar që të operojnë më lirisht, gjë që ka një impakt negativ në ndalimin e këtyre çështjeve si trafikimi i qenieve njerëzore (numri i kufizuar i individëve), kontrabanda e armëve (numri i kufizuar i individëve), ose kontrabanda e drogës.

Nëse një gjykatës nuk e penalizon një zyrtar që ka shkelur ligjin, kjo mund të lejojë një privatizim mashtrues. Për shembull, korrupsioni i një gjyqtari të ngarkuar për të zgjidhur një apelim në një çështje të së drejtës së punës mund të çojë në konfirmimin e pushimit të paligjshëm nga puna dhe në këtë mënyrë mund të rrezikojë familjet e punonjësve të pushuar. Përrjashtimi i paligjshëm nga pagesa e taksave dhe tatimeve për një shoqëri me borxhe të mëdha në buxhetin publik mund të thellojë defiçitin buxhetor. Kriminelët e rrezikshëm mund të ngelen të lirë për shkak të rrjedhjes së informacionit nga policia ose prokurorët, ose mund të çlirohen nga akuza pas korrupsionit të gjyqtarëve, gjë që do të rrezikonte sigurinë e të gjithë qytetarëve.

**d. Nëpunësit që punojnë me gjykatat dhe prokuroritë** kryesisht përfshihen në regjistrimin e të dhënave dhe trajtimin e dosjeve të çështjes. Këtyre nëpunësve të gjykatave kryesisht iu besohen aktivitetet e administrimit gjyqësor.

Në shumicën e gjykatave në vend, caktimi i kompjuterizuar i çështjeve për gjyqtarët i besohet një nëpunësi gjykate të emëruar në mënyrë specifike. Por ndërsa në teori caktimi i çështjeve bëhet me rastësi, kur ekzistojnë lidhje joetike midis nëpunësit të gjykatës përkatës dhe avokatit që depoziton padinë, nëpunësi mund të bindet që ta shtyjë regjistrimin e të dhënave derisa të regjistrohen çështjet pasuese në mënyrë që të sigurohet që çështja t'i caktohet një gjyqtari të veçantë.

Nëpunësit mund të korrumpohen duke mos lëshuar fletëthirrjet për të vonuar procesin, ose duke hequr provat nga dosja për të shtrembëruar të vërtetën. Agjentët proceduralë ose punonjësit e postës mund të korrumpohen nga palët për të ndryshuar ose madje për të shkatërruar fletëthirrjet ose dokumentet e tjera që ju dërgohen palëve. Palët në këtë mënyrë mund të shmangin ose të shtyjnë paraqitjen e tyre para organeve

gjqësore ose mund të kenë një shans tjetër për të marrë pjesë në seanca në të cilat ata nuk kanë qenë.

Ryshfetet mund të ofrohen edhe për të fshehur një dosje çështjeje ose, në të kundërt, për t'u gjetur dhe për t'u vënë në dispozicion më me gatishmëri palëve në arshivë. Palët e një padie apo edhe palët e treta, si gazetarët, mund të ofrojnë mitë në mënyrë që të marrin kopje të dokumenteve nga dosja pa miratimin e gjyqtarit ose nëpunësit të gjykatës të gjykatës. Kjo mund të përfshinte kopjet e dokumenteve jopublike si transkriptimet e regjistrimeve audio.

Po kështu, punonjëset e arshivës mund të korruptohen me qëllim që të sigurojnë heqjen nga dosja të regjistrimeve të hapave proceduralë që u janë komunikuar palëve ose për të përshpejtuar lëshimin e dokumenteve zyrtare që vërtetojnë se është duke u vazhduar një gjykim. Në shkëmbim të një 'dhurate', një pale ose avokatit mund t'i ofrohet akses preferencial në dokumentet në arkiva, edhe jashtë orëve të punës, ose mund të lejohen që të marrin dosje nga arkiva ose ndërtesa e gjykatës, gjë që ndalohej nga rregullorja e brendshme.

*e. Ekspertët* janë persona që kanë njohuri profesionale në një fushë të veçantë, më të lartë se ajo e gjykatës dhe ndihmojnë gjykatën që të sqarojë një çështje. Siç e ilustron shembujt e mëposhtëm, njohuritë e ekspertit mund ta ndihmojnë një gjykatë që të marrë një vendim. Në çështjet që lidhen me kthimin e parave të tatimit mbi vlerën e shtuar, gjykatësit të Gjykatës Fiskale u drejtohen audituesve për të llogaritur shumat e sakta që duhen riparuar nga autoritetet tatimore (vlerësimi kontabilist<sup>68</sup>). Në një çështje për pasuri të paluajtshme, gjykata do të angazhojë një ekspert topografie për të identifikuar trojet për të cilat është mosmarrëveshja (vlerësimi teknik - gjyqësor<sup>69</sup>). Në një çështje që përfshin një aksident me makinë, gjykata do të thërrasë një ekspert teknik për të përcaktuar dinamikën e aksidentit ose një ekspert kriminalistik që është i specializuar në grafologji për të vendosur mbi një nënshkrim në një dokument të veçantë që po sfidohet (vlerësimi kriminalistik<sup>70</sup>). Kur përmbajtja e alkoolit në gjak e një individi që drejton mjetin në rrugët publike vihet në diskutim, mund të kërkohet një raport ekstrapolimi BAC retrograd (raportet kriminalistike<sup>71</sup>).

Raportet e ekspertit përbëjnë provë, që do të thotë se ky raport mund ta udhëzojë gjyqtarin për të formuar një opinion dhe për të marrë një vendim, gjë që e bën të panevojshme nevojën për prova të mëtejshme. Korruptimi i ekspertëve synon sigurimin e raporteve të favorshme të ekspertëve, që përfshijnë kryerjen e veprave penale nga ekspertët përkatës - falsifikim, ku përpilojnë një raport me shkrim ose një dëshmi false kur ofrojnë sqarime verbale para gjykatës. Kur konstatimet dhe konkluzionet e

---

<sup>68</sup> Udhëzim i Qeverisë nr. 65/24.08.1994 për certifikimin si auditues ose kontabilist i miratuar, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 243, 30 gusht 1994.

<sup>69</sup> Udhëzim i Qeverisë nr. 2/21.01.2000 për organizimin e aktiviteteve të vlerësimit gjyqësor dhe paragjyqësor teknik, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 26, 25 janar 2000.

<sup>70</sup> Vendim i Qeverisë nr.368/03. 07.1998 për organizimin dhe funksionimin e institutit kombëtar të kriminalistikës, botuar në Gazetën Zyrtare nr.248, datë 3 korrik 1998; neni 26/15 i ligjit nr.218/2002 për organizimin dhe funksionimin e policisë rumune, botuar në Gazetën Zyrtare nr.305 të datës 9 maj 2002; neni 1 (a) i H.G. nr.1411/02.09.2004, botuar në Gazetën Zyrtare nr.833, datë 9 shtator 2004 për përcaktimin e aktiviteteve të financuara plotësisht nga të ardhura të pavarura të Shërbimit Informativ Rumun; O. G. nr. 75/2000, për certifikimin e ekspertëve kriminalistikë, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 407 të datës 29 gusht 2000.

<sup>71</sup> Udhëzim i Qeverisë nr. 1/2000 për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kriminalistike, ribotuar në Gazetën Zyrtare nr. 996, të datës 10 nëntor 2005.

ekspertëve ndikohen në këtë mënyrë, paanshmëria e vendimit të marrë nga prokurori ose gjykatësi do të shtrembërohet dukshëm. Kur ka dyshime në lidhje me mënyrën se si është kryer vlerësimi ose për konkluzionet e nxjerra nga ekspertët, prokurorët ose gjyqtarët mund të urdhërojnë që të bëhet një vlerësim tjetër nga një ekspert tjetër ose në një komision ekspertësh. Megjithatë, gjykatësit ose prokurorët nuk janë të detyruar që t'i besojnë konkluzionet e secilit raport.

Një fakt alarmues që lidhet me vlerësimet është se për vite, organeve gjyqësore u ka munguar financimi që nevojitet për të rregulluar këto procedura. Kjo është arsyeja për se gjykatave u duhet të bindin një nga palët që të kërkojë një vlerësim si provë për çështjen dhe të paguajë për shërbimet e atij eksperti. Megjithatë, pasi paguhet eksperti nga njëra palë në çështjen gjyqësore para vendimit të gjykatësit, natyrshëm do të lindin dyshime në lidhje me objektivitetin e konkluzioneve në raportin vlerësues.

Duhet të përmendim gjithashtu një aspekt shqetësues që lidhet me raportin zyrtar të vlerësimit - megjithëse ligji lejon pjesëmarrjen e një eksperti të autorizuar të propozuar nga një palë në proces, ky ekspert sipas ligjit, nuk mund të ndërhyjë në ecurinë e vlerësimit. Eksperti vetëm mund të paraqesë para organit gjyqësor komentet e tij ose të saj në lidhje me çështjen që analizohet dhe raportin. Me fjalë të tjera, vlerësimi zyrtar domosdoshmërisht përfshin një monopol të shtetit - atë të institutit patologjik kriminalistik "Nina Minovici" dhe Institutit Kriminalistik Kombëtar.

Vlerësimet kriminalistike gjithashtu përfshijnë fusha për të cilat ka një numër të vogël ekspertësh<sup>72</sup> që do të thotë se në qoftë se raporti fillestar do të kundërshtohet, nuk do të ketë ekspertë për të kryer një vlerësim të ri. Prandaj meqenëse konstatimet nuk mund të kontrollohen, këto fusha bëhen të cenueshme ndaj korrupsionit. Edhe në fusha të tjera, ku edhe raporti fillestar edhe raporti i dytë mund të bëhen (nga një ekspert dhe një ekip ekspertësh përkatësisht) për sa kohë që ato nuk i nënshtrohen kontrolleve nga ekspertët jashtë sistemit zyrtar, nuk do të ketë ekspertë për të kontrolluar konkluzionet e tyre. Për shembull, në qoftë se një palë në një proces gjyqësor depoziton një ankesë kundër një eksperti kriminalistik për falsifikim në lidhje me konkluzionet në një raport të veçantë, organet gjyqësore duhet të hetojnë pretendimet duke kërkuar opinionin e një eksperti tjetër. Por kur eksperti i dytë punon me të parin, në të njëjtin institucion, përgjegjshmëria mund të humbasë. Për shkak të organizimit, ekspertët zyrtarë mund të ofrojnë çfarë do konkluzioneve që duan ose që u kërkohet që të japin, dhe asnjë autoritet nuk mund t'i verë ata përpara përgjegjësisë për konkluzionet e tyre<sup>73</sup>. Zgjidhja e dukshme është të dorëzohet monopoli i shtetit menjëherë dhe të promovohet liberalizimi i këtij profesioni<sup>74</sup>.

Një situatë veçanërisht speciale lidhet me *testet e toksikologjisë*. Kështu, kur një individ dyshohet për drejtim automjeti në gjendje të dehur, oficeri i policisë mat përmbajtjen e alkoolit në frymë duke përdorur testin e frymës. Në qoftë se testi tregon një përmbajtje alkooli në gjak më tepër se 0.40 mg/L, shoferi çohet në një njësi të kujdesit shëndetësor për t'i marrë mostra gjaku. Në qoftë se konstatohet një përqendrim mbi 0.80 mg/L e alkoolit të pastër në gjak, atëherë kjo bëhet vepër penale që mbart një

---

<sup>72</sup> Këto vlerësime kryhen nga instituti kriminalistik kombëtar (INEC), që është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë; INEC ka rreth 30 ekspertë zyrtarë në nivel kombëtar.

<sup>73</sup> Shih gazetën *Gardianul* të datës 10 shtator 2007, 'Monopoli i shtetit në vlerësimin a mafias' në [www.gardianul.ro/index.php?pag=nw&id=100767](http://www.gardianul.ro/index.php?pag=nw&id=100767).

<sup>74</sup> Societatea pentru Justitie bie dakord me këtë pozicion. Shih deklaratën për shtyp të datës 17.11.2008 në [www.sojust.ro](http://www.sojust.ro).

dënim potencial nga një deri në pesë vite burg<sup>75</sup>. Prandaj, kriminelët që synojnë të shmangin ndjekjen penale do të përpiqen të korruptojnë ose punonjësin e policisë (që ta bind atë të mos e çojë kriminelin në klinikë ose të vonojë marrjen e mostrave, në mënyrë që të ulët përqendrimi i alkoolit), ose personelin e kujdesit shëndetësor për t'i bindur ata që të ndryshojnë konstatimet. Në qoftë se është nisur një hetim penal, i dyshuari mund të kërkojë një test ekstrapolimi BAC retrogadë, që kryhet në mjediset e Institutit të Patologjisë Kriminologjike 'Mina Minovici'.

Në një skenar të tillë, i dyshuari mund të pranojë se ka pirë alkool, por mund të pretendojë se sasia e alkoolit ishte më e vogël se sa ajo faktike, dhe mund të pretendojë në mënyrë false se përpara ndalimit ai ose ajo kishte marrë një sasi të madhe ushqimi. Duke marrë këtë parasysh dhe duke përdorur faktorët e tillë si pesha dhe mosha e shoferit, eksperti kriminalistik mund të konkludojë në raport se BAC ishte më e ulët se shifra faktike<sup>76</sup>. Kjo shifër duhet të shërbejë vetëm si udhëzues për gjyqtarin; i akuzuari duhet të paraqesë prova për të mbështetur pretendimin e tij ose të saj në lidhje me afatin kohor dhe sasinë e ushqimit dhe pijet e konsumuara.

Në çështjet kriminale, duhet të përmendim edhe rëndësinë e raporteve të favorshme të vlerësimit që hartohen nga patologët kriminalistë në lidhje me një *sëmundje të rëndë*, nga e cila mund të vuajë kriminelin i dënuar si arsye për pezullimin ose ndërprerjen e dënimit, dhe vlerësimet e hartuara nga psikiatritë kriminalistë për të vlerësuar gjendjen mendore të të dyshuarit në kohën e kryerjes së krimit. Ekzistenca e mjeteve për të shmangur kryerjen e dënimeve me burg (në çështjen e mëparshme)<sup>77</sup> ose ndonjë formë e detyrimit kriminal (në çështjen e fundit)<sup>78</sup>, i bën këto fusha të kriminalistikës objekte të korrupsionit.

Së fundi, graviteti i plagosjeve matet me *numrin e ditëve të kujdesit shëndetësor*. Statusi gjyqësor i veprës së paligjshme dhe ashpërsia e vendimit do të varet nga ky numër. Prandaj, patologu kriminalist mund të 'korruptohet' nga kriminelin në shkëmbim të konkludimit se një plagosje kërkon një numër më të vogël ditësh të kujdesit shëndetësor se sa është faktikisht, gjë që është e mjaftueshme për të siguruar një dënim më të butë.

---

<sup>75</sup> Shih nenin 88 dhe 89 të O.U.G nr.195/12. 12.2002 për drejtimin e mjetit në rrugët publike, ribotuar në Gazetën Zyrtare nr.670 të datës 3 gusht 2006, me amendimet e mëvonshme.

<sup>76</sup> Pas kalimit, alkooli thithet nga trupi me një ritëm që varet nga përqendrimi i pijes, shpejtësia e inxhestionit, mungesa ose prania e ushqimit në stomak. Në një stomak bosh 90-95 për qind e alkoolit hyn në rrjedhën e gjakut në 30 minuta, ndërsa kur është marrë ushqim, procesi i absorbimit mund të zgjatet deri në 90 minuta. Maksimumi i nivelit BAC arrihet në 30-90 minuta pas marrjes, në varësi të sasisë së marrë; ritmi i shpërndarjes së alkoolit është 0.10-0.30 g për qind në orë, në varësi të masës në të cilën është mësuar trupi me pirjen e alkoolit. Prandaj, edhe pse për shembull oficeri i policisë mund të vendosë një përmbajtje alkooli në frymë prej 0.75 mg/L, d.m.th afërsisht 1.5 g alkool i pastër për litër në gjak (shumë më tepër se tavani 0.8), në qoftë se eksperti kriminalistik merr parasysh pretendimet e të dyshuarit se sapo ka pirë 50.gr konjak, një litër verë dhe ka ngrënë një ushqim të madh me mish, oriz dhe sallatë, eksperti mund të konkludojë se kur i dyshuari u kap duke drejtuar mjetin i dehur, kurba e rritur e BAC ishte në fazën fillestare dhe mund ta vërë BAC në 0.75 g % (që është më poshtë se tavani 0.8), duke e klasifikuar kundërvajtjen si një shkelje, më tepër se sa si një vepër penale.

<sup>77</sup> Sipas medias, klaustrofobia, septumi i devijuar dhe atrofia testikulare janë konsideruar sipas tyre, në rrethana të caktuara, si arsye mjekësore që kërkojnë pezullimin e një dënimi me burg. Shih '*Ndërprerje burgu me certifikatë mjekësore-nga atrofia testikulare tek glaukoma*' në gazetën Gandul të datës 02 shkurt 2009, në <http://tinyurl.com/scutiremed>.

<sup>78</sup> Diagnostikimi i pasaktë i doktorit për një të dyshuar terrorizmi i mundësoi atij që të lirohej, duke i dhënë mundësinë që më vonë të largohet nga vendi. Shih '*prokurori N. – I pushuar, Dr. T. nga Rahova – akuzuar për mashtrim,*' në gazetën Curentul e datës 25 korrik 2006 në <http://tinyurl.com/hayssam>.

**Përkthyesit** janë një lloj i veçantë ekspertësh të cilëve u ngarkohet përkthimi i dokumenteve të shkruara dhe interpretimi i debateve me gojë të mbajtura para organit gjyqësor. Përkthyesit mund të korruptohen nga individët që kërkojnë t'i japin gjykatës informacione që janë të ndryshme nga realiteti; barriera e gjuhës e pengon gjykatën që të dallojë mospërputhjen.

**f. Punonjësit e burgjeve** mund të korruptohen në shkëmbim të krijimit për të burgosurin të standardeve të burgosjes të ndryshme nga ato që parashikon ligji<sup>79</sup>. Një i burgosur, një i afërm i të burgosurit, ose avokati i të burgosurit, mund të ofrojë mitë me qëllimin për t'ia lehtësuar të burgosurit vuajtjen e dënimit, kontaktet preferenciale me vizitorët, ose vizita dhe pako ekstra. Rojet e burgut gjithashtu mund të korruptohen duke u lejuar të burgosurve të përdorin mallra të caktuara në mënyrë të paligjshme të tilla si telefonat, drogat ose alkooli.

Marrëveshjet midis të burgosurve që nxirren për të punuar dhe personeli që i mbikëqyr ata, ose midis të burgosurve që transferohen ose çohen në gjykatë dhe eskortës së tyre, mund të lehtësojnë një arratisje. Oficeri që përgjigjet për të dhënat e të burgosurit mund të marrë mitë në shkëmbim të modifikimit të të dhënave që mbahen për të siguruar një kohë më të shkurtër burgu. Menaxheri i kantierit të punës mund të marrë mitë në shkëmbim të punës së të burgosurve për përfitime private. Oficeri i disiplinës mund të korruptohet, në mënyrë që mos ta penalizojë një të burgosur që është fajtor për një shkelje disiplinore (gjë që në të kundërt do të pengonte të burgosurin që të merrte përfitime të caktuara) ose për t'i ofruar shpërblime të paligjshme të burgosurit.

Një roje burgu mund të marrë mitë në shkëmbim të nënshkrimit të dokumenteve të lirimimit dhe kreu i agjencisë penitenciare kombëtare mund të bindet që të miratojë transferimin e një të burgosuri në një qendër vuajtje dënimi me një nivel sigurie më të ulët. Doktorët e burgut mund të kërkojnë dhe të marrin mitë që t'u sigurojnë të dënuarve akses për substancat e paligjshme.

Korrupsioni mund të bëjë objekt edhe anëtarët e komisioneve që kanë monopolin për të shkurtuar vendimet në mënyrë që ta ndihmojnë të burgosurin të sigurojë një dënim të hapur ose gjysmë të hapur në vend të një dënimi me ndalim të mbyllur. Gjyqtari i deleguar për ekzekutimin e vendimeve mund të marrë mitë në shkëmbim të urdhërimit të një ndryshimi të regjimit. Gjithashtu këta anëtarë, që përbëjnë komisionin e dënimit me kusht, mund të jenë objekt i përpjekjeve për mitë në shkëmbim të propozimi për lirim të një të burgosuri para përfundimit të dënimit të tij, edhe kur nuk janë plotësuar kushtet.

**g.** Një tip tjetër i veçantë eksperti është **eksperti i insolvensës**. Këta janë specialistë që përfshihen nga gjykatësit për çështje civile në procedurat e falimentimit të shoqërive<sup>80</sup>. Pa kritere për emërimin e likuidatorëve, gjykatësit e çështjeve civile kanë diskrecion të plotë dhe mund të krijojnë lidhje me palët e përfshira. Duke qenë se pagesat e likuidatorëve janë substanciale, këta ekspertë mezi presin që të përfshihen në sa më shumë çështje që të jetë e mundur, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me shoqëri të mëdha. Si të tillë, ata mund të kenë dëshirë që ta ndajnë pagesën me gjyqtarët për të siguruar një emërim.

<sup>79</sup> Ligji nr. 275/04. 07.2006 për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të urdhëruara nga institucionet gjyqësore, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 627 të 20 korrikut 2006; G.H nr. 1897/21. 12.2006 miratimi i akteve nënligjore për ligjin nr. 275/2006, botuar në Gazetën Zyrtare nr.24, datë 16 janar 2007.

<sup>80</sup> Udhëzim Emergjent i Qeverisë nr. 86/08.11.2006, *Për organizimin e ekspertëve të insolvensës*, botuar në Gazetën Zyrtare nr.944 të 22 nëntorit 2006.



**h.** Ekuacioni i gjykimit nuk duhet të anashkalojë *dëshmitarët*. Ndërsa ka situata ku dëshmitarët raportojnë fakte të shtrembëruara para organeve gjyqësore për shkak të perceptimit të tyre të gabuar të realitetit ose për shkak të moshës së tyre, aftësive të ndryshme të kufizuara, kushteve të motit, etj., ka edhe situata kur dëshmitarët japin dëshmi të rreme pasi janë 'blerë' nga një palë e procesit gjyqësor<sup>81</sup>.

**i.** Mund të ketë edhe situata kur *avokatët* korruptohen nga pala kundërshtare në këmbim të mos përfaqësimit siç duhet të interesave të klientëve të tyre. Por më shpesh, përdoruesit e gjykatës shpresojnë të korruptojnë gjyqtarët nëpërmjet avokatëve të tyre të cilët në këtë mënyrë kanë gjasë të akuzohen për tregtim në influencë. Më të cenueshmit janë ata avokatë që më parë kanë punuar si gjyqtarë ose prokurorë, oficerë policie ose nëpunës gjyqësorë, sepse palët në proces shpresojnë që këta avokatë kanë ruajtur lidhjet me bashkëpunëtorët e tyre të mëparshëm. Vërtetë, në praktikë këto kategori kanë akses më të lehtë ndaj informacionit në sistem dhe ndaj zyrave të kolegëve të tyre të mëparshëm.

Situatat lindin kur avokatët kërkojnë shuma parash që ata pretendojnë se synohen për prokurorin ose gjykatësin, në mënyrë që të sigurohet një vendim i favorshëm, por të cilët ata i futin në xhep pa e kontaktuar gjyqtarin faktikisht. Duke pasur parasysh perceptimin e përhapur të korrupsionit dhe rrezikun e çështjes, palët do të tundohen t'i paguajnë këto shuma. Në fakt, në varësi të natyrës së çështjes, vendime të caktuara mund të parashikohen nga ata që kërkojnë para për të paguar mitë. Për shembull, kjo mund të ndodhë kur praktika gjyqësore në një lloj të caktuar çështjeje ka qenë e qëndrueshme (p.sh., një pezullim me kusht i dënimeve për kriminelët që e kanë për herë të parë dhe veprat penale të të miturve), ose kur lindin kundërshtime procedurale, të cilat është e sigurt që do të pranohen nga gjykata. Kur ndodh vendimi i parashikuar, palët e përfundojnë ngelen me përshtypjen se mita ka shkuar tek gjyqtari. Kjo është arsyeja, përse në anketimet e opinionit në lidhje me korrupsionin e gjyqtarëve, prokurorëve, përdoruesit e gjykatës do të përgjigjen në mënyrë të gabuar se ata kanë provuar personalisht korrupsionin e gjyqtarëve apo prokurorëve.

Ka edhe çështje kur, për të fshehur inkompetencën e tyre, disa avokatë i çojnë klientët e tyre në rrugë të gabuar që të besojnë se pala kundërshtare e ka korruptuar gjyqtarin. Edhe një herë, kjo gjeneron perceptime të pasakta mes përdoruesve të gjykatës në lidhje me korrupsionin e gjyqtarëve. Megjithatë, tregtimi në influencë dhe mashtrimi mund të kryhen edhe nga punonjësit e policisë, prokurorët dhe gjykatësit, të cilët mund të premtojnë që do të bisedojnë me kolegët e tyre për të marrë vendime të favorshme për mitëdhënësit. Edhe pse rezultati i një situatë të veçantë është një konkluzion i kaluar.

**j.** Mund të mendojmë edhe për vepra të tjera penale të korrupsionin që përfshijnë profesionistë të tjerë të cilët luajnë një rol në administrimin e drejtësisë. Për shembull, një debitor mund të korruptojë një *përmbartues* për ta vonuar konfiskimin e hipotekës ose për përjashtimin e aseteve të caktuara nga procedura e konfiskimit të hipotekës. Po kështu, *oficerët e shërbimit të provës* mund të korruptohen në shkëmbim të marrjes së

---

<sup>81</sup> Ka pasur çështje kur janë bashkëlidhur me dosjen e çështjes dëshmi nga dëshmitarë të krijuar (veçanërisht dëshmitarë ndihmës), ose janë hartuar deklarata nga punonjës policie ose vetë prokurorët për të siguruar besueshmërinë e dukshme ndaj akuzave që ata kanë bërë kundër individëve të caktuar. Shih *Shoqëria për Drejtësi, Sistemi Gjyqësor në Rumani – një raport i pavarur*, 2007, www.sojust.ro.

një raporti të favorshëm vlerësimi me anë të të cilit i kërkohet gjyqtarit të urdhërojë lirimin me kusht. **Punonjësit socialë** gjithashtu mund të jenë objekt i përpjekjeve për korrupsion nga prindërit për të siguruar një rekomandim që fëmija në fjalë t'i besohet atij prindi.

**k.** Korrupsioni mund të ndikojë edhe tek *inspektorët e integritetit* që punojnë në Agjencinë Kombëtare të Integritetit (NIA). Ata kanë autoritetin për të kontrolluar se si i plotësojnë detyrimet e tyre ligjore titullarët e detyrave publike, gjyqtarët ose prokurorët dhe nëpunësit civil në lidhje me deklarimin e aseteve të tyre, pa përputhshmëritë dhe konfliktet e mundshme të interesit. Në qoftë se i nënshtrohen presionit që vjen ose nga brenda institucionit (p.sh., nga organi i ngarkuar me vlerësimin profesional të punës së inspektorëve) ose nga jashtë (p.sh., nëpërmjet anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Integritetit<sup>82</sup>), mund të dëmtohet saktësia e hetimeve.

### 4.3 Dobësitë në fushën administrative

Siç u tregua më lart, nga ana organizative institucionet gjyqësore funksionojnë saktësisht si çdo institucion tjetër publik dhe fushat e cënueshme në këtë drejtim janë ato që marrin vendime tërësisht *administrative*. Këto në fund të fundit mbështetin funksionimin e institucioneve gjyqësore, duke i bërë fushat e mëposhtme të cënueshme ndaj korrupsionit:

#### a. Departamenti i Burimeve Njerëzore

Organet gjyqësore, organizatat jo qeveritare dhe media kanë raportuar shpesh raste të kandidatëve 'që i blejnë' pyetjet që kanë provimet për pozicione madhore në prokuroritë<sup>83</sup>, aplikantë në gjykata që testohen nga njerëz me të cilët aplikantët kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta administrative<sup>84</sup>, nepotizmi midis personelit të Administratës Penitenciare Kombëtare (NPA)<sup>85</sup>, 'lidhjet' e përdorura në punësimet në stafin e Policisë dhe Trupës së Xhandarmërisë<sup>86</sup>, aplikantë që kërkojnë të pranohen në Ministrinë e Drejtësisë<sup>87</sup> ose zyrat e noterëve publikë<sup>88</sup> dhe që merren në provim nga

<sup>82</sup> Në fakt, raporti i përkohshëm KE në Parlamentin dhe Këshillin Evropian në lidhje me progresin e Rumanisë në mekanizmin e bashkëpunimit dhe verifikimit, të datës 12 shkurt 2009, thotë: "Agjencia luftoi me sukses një përpjekje të bërë nga një anëtar i Këshillit Kombëtar të Integritetit, që mbikëqyr Agjencinë dhe synonte të ndikonte në vendimmarrjen e një çështje të caktuar"

<sup>83</sup> Deklaratë për shtyp e lëshuar nga NAD, 6 maj 2008, në [www.pna.ro](http://www.pna.ro): katër prokurorë, një gjykatës dhe një noter dolën para gjykatës me akuzat e mashtrimit, pasi kishin mundur të shtinin në dorë në mënyrë të paligjshme pyetjet e provimit në një garë për promovimin e prokurorëve në tetor 2007.

<sup>84</sup> Deklaratë për shtyp e lëshuar nga UNJR, 30 nëntor 2007, në [www.unjr.ro](http://www.unjr.ro): "Gjyqtarët, disa prej të cilëve mbajnë pozita madhore, janë testuar nga gjyqtarë të tjerë brenda juridiksionit të së njëjtës gjykatë apeli, në një garë promovimi në gjykata".

<sup>85</sup> Gandul, 29 maj 2007, kreu i shërbimit penitenciar akuzuar për punësimin e të afërmeve të tij në burgjet e qarkut Dolj, në <http://tinyurl.com/penitfamilie> Memorandumi nr. 252122 i datës 22 janar 2007, drejtuar Ministrisë të Drejtësisë: rreth gjysma e 12.000 punonjësve kanë lidhje familjare, me klane të vërteta të formuara brenda vendeve të vuajtjes së dënimit; Drejtori i Përgjithshëm i NPA u përpoq të bisedonte me komisionin e provimit që të punësonin dy nga të afërmit e tij dhe qiradhënësin e tyre në sistem.

<sup>86</sup> Cotidianul, 6 nëntor 2007, stafi MAI ankohet për lidhjet: sipas një anketimi të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme kundër korrupsionit, perceptimi i personelit është se njerëzit punësohen në Ministrinë e Administratës dhe atë të Brendshme duke përdorur 'lidhjet'.

<sup>87</sup> Cotidianul, October 22, 2007, Clan C. gets grip on justice, at [www.cotidianul.ro/clanul\\_chiuaru\\_acapareaza\\_justitia-34398.html](http://www.cotidianul.ro/clanul_chiuaru_acapareaza_justitia-34398.html): Në një konkurs të Ministrisë së Drejtësisë për të plotësuar pozicionet e ekspertit gjyqësor të një rangu të ngjashëm me postet e gjyqtarëve, mes aplikantëve u përfshin disa

bashkëpunëtorët e tyre, ekspertët që marrin të drejtën të bëjnë vlerësime ekspertësh në fusha në të cilat ata nuk janë të specializuar<sup>89</sup>. Përmendim gjithashtu përdorimin e mjeteve penitenciare për qëllimet personale dhe ndërtimin e ndërtesave private nga komandantët e vendeve të vuajtjes së dënimit të cilët përdorin punën e të dënuarve<sup>90</sup>. Në çdo garë pranimit për avokatë, gjithmonë ka zëra për shumat e parave që pretendohet se aplikantët u paguajnë avokatëve madhorë në shkëmbim të pranimit si avokatë praktikantë<sup>91</sup>. Disa avokatë e kanë pranuar këtë praktikë por asnjë nuk ka njoftuar zyrtarisht autoritetet përkatëse për të.

Në të gjitha garat, testi më i cënueshëm ka qenë *provimi me gojë*. Meqenëse kalimi është në diskrecionin e marrësve në provim dhe, si rregull, nuk ka ndonjë mjet për të kundërshtuar vendimin e tyre, këto teste u krijojnë aplikantëve dyshimin në lidhje me objektivitetin e komisionit të provimit. Nga ana tjetër, kjo metodë vlerësimi lë dyshime tek publiku i gjerë, bazuar në tregues të arsyeshëm, që konfliktet e dukshme të interesit ndihmojnë përjetësimin e interesave të grupit për të kryer akte kriminale. Edhe apelimi i rezultateve negative të provimeve bëhet i cënueshëm ndaj korrupsionit - aplikantët që humbasin apelin mund të kenë dëshirë që të ofrojnë mitë në shkëmbim të rishikimit të rezultatit të tyre fillestar, gjë e cila nënkupton rritjen e gjasës për promovimin e tyre.

Prandaj, për shkak të legjislacionit me gabime dhe praktikave abuzive, vendimet për karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të mos jenë objektive dhe mund të përfshijnë: emërimin e kryetarëve të gjykatave ose prokurorëve madhorë; ngritjen në detyrë si gjyqtar i HCCJ<sup>92</sup> dhe emërimi në pozicionet drejtuese në HCCJ, zyra e prokurorisë që është e lidhur me HCCJ dhe Drejtorinë Kombëtare Antikorrupsion; pranimit në trupën e gjyqtarëve dhe prokurorëve me anë të intervistave të SCM për avokatët me më tepër se dhjetë vite përvojë ose ish gjyqtarë/prokurorë<sup>93</sup>; emërimi ose

---

këshilltarë të ministrit, dhe komisioni I provimit dhe vlefshmëri përfshiu edhe këshilltarë të ministrit, që punonin në të njëjtën zyrë me aplikantët.

<sup>88</sup> Cotidianul, 23 tetor 2007, C. Ward bëhet noter, në [www.cotidianul.ro/clanul\\_chiuaru\\_acapareaza\\_justitia-34398.html](http://www.cotidianul.ro/clanul_chiuaru_acapareaza_justitia-34398.html): Një këshilltar i ministrit konkurron për postin e noterit publik dhe komisioni i provimit përfshin një tjetër këshilltar të ministrit, që punon në të njëjtën zyrë me aplikantin.

<sup>89</sup> Ziuja de Cluj, 9 maj 2005, driblimi i sistemit të drejtësisë, ribotuar nga Hotnews - lajme rajonale, në <http://tinyurl.com/driblare>. Pasi doli në pension si ekspert zyrtar nga Instituti Kombëtar i Kriministikës, një kimist thuhet se mori nëpërmjet Drejtorit të Drejtësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, një kartë identifikimi që vërteton të drejtën e tij për të punuar si ekspert i autorizuar kriminalistik për zërin dhe të folur; thuhet se ai e ka përdorur kartën e identifikimit në gjykatë dhe ka fituar të drejtën për të kryer vlerësime për të cilat ai nuk ka kualifikimet dhe asnjë verifikim nuk ishte bërë për të.

<sup>90</sup> Gazeta De Nord – Vest, 29 janar 2005, vjedhja dhe korrupsioni në burgje. Ziuja, 12 gusht 1998, shefi i vendit të vuajtjes së dënimit Gaesti detyron të dënuarit të punojnë tokën e tij, në [www.ziua.net/display.php?data=1998-08-12&id=11964](http://www.ziua.net/display.php?data=1998-08-12&id=11964).

<sup>91</sup> *Hidh pagesën*, Clujeanul, 9 gusht 2007 (*10,000 euro po të jesh me fat. 50,000 euro po qe se nuk ke rekomandim*) <http://old.clujeanul.ro/articol/ziar/cluj/taxa-de-casta/16670/14> dhe a nuk mund të bëhet pa mitë?, Clujeanul, 15.08.2007 <http://old.clujeanul.ro/articol/ziar/cluj/nu-se-poate-fara-spagac/16761/307/>; 10,000 euro është edhe pagesa që përmendet në *skandalin e pranimit në Dhomën e avokatëve*, Viata libera, Galati, 10 janar 2008, ribotuar në <http://bota.ro/wp-content/uploads/2008/01/spagagalati.doc>.

<sup>92</sup> Pa kritere për një vlerësim krahasues të aplikantëve për postet e gjyqtarit të HCCJ që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, SCM vendosi për shembull, në garën e gushtit 2005, të refuzojë 28 aplikantë pa treguar arsyt ekzakte nga përvoja e karrierës së tyre që nuk plotësonin kërkesat. Kjo u mundësoi disa aplikantëve që u refuzuan në tetor të pranoheshin në sesionin pasues, në nëntor 2005. E njëjta gjë ndodhi në vitet pasues. Shih [www.csm1909.ro](http://www.csm1909.ro).

<sup>93</sup> Midis shtator 2005 dhe gushtit 2008 procedura e intervistimit të SCM, siç përcaktohet nga neni 33, paragrafët (5) – (10) të Ligjit nr. 303/2004, i abroguar sot, çoi në emërimin e 111 aplikantëve si gjyqtarë dhe 145 aplikantëve si prokurorë.

revokimi i gjyqtarëve ose prokurorëve si inspektorë<sup>94</sup>; promovimi ose ndërprerja e promovimit për gjyqtarët dhe prokurorët; transferimi i gjyqtarëve në postet e prokurorit dhe e kundërta; ose edhe miratimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në seminare në vend apo jashtë shtetit. SCM ruan monopolin ekskluziv mbi të gjitha këto vendime dhe nuk ka nevojë që të shpjegojë bazën e tyre (treguesi i thjeshtë i teksteve të ligjit nuk cilësohet si justifikim), as se vendimet janë bazuar në kritere objektive dhe transparente. Këto emërime në dukje arbitrare krijojnë perceptimin e rrjeteve të vërteta besnike (të tilla si shokët e vjetër, që ndikojnë në vetë pavarësinë e agjentit), që çojnë në përjetësimin e abuzimit dhe korrupsionit.

Konkurimet për pozicionet e larta në gjykatat dhe prokuroritë përfshijnë testet me gojë, në të cilat aplikantët paraqesin një projekt të përshtatshëm për pozicionin për të cilin ata aplikojnë. Në këto provime, pyetjet janë të ndryshme për të gjithë aplikantët, rezultatet nuk maten me kritere të vendosura të përpiluara paraprakisht, dhe nuk ka nevojë që të shpjegohen vendimet. Veç kësaj, SCM emëron anëtarët e komisioneve të promovimit ose emërimit dhe kryetarët e gjykatave të apelit. Prokurorët e përgjithshëm emërojnë anëtarët e komisioneve të pranimit dhe promovimit për personelin ndihmës pa ndonjë lloj metodologjie - nuk ka ndonjë bazë të dhënash të kandidatit të mundshëm, anëtarët e komisionit nuk emërohen në mënyrë rastësore, dhe të ardhurat e tyre sigurohen nga anëtarësia në këto komisione. Kjo forcon dyshimet se preferencat personale të atyre që janë të ngarkuar me emërimet luajnë një rol kyç në procesin e emërimit.

Kjo është arsyeja, për shembull, për se të gjitha garat për pozicionet e niveleve të larta në gjykata dhe prokurori të organizuara nga SCM nëpërmjet Institutit Kombëtar të Magjistraturës midis vitit 2005 dhe 2007 u shtrembëruan nga emërimi i anëtarëve që ose nuk plotësonin parakushtet ligjore ose ishin të përfshirë në konflikte interesi me aplikantët<sup>95</sup>. Kjo provon jo vetëm mungesën e përgjegjësisë së disa gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me aktivitetet paragjyqësore, por edhe injorimin ose madje shkeljen e qëllimshme të ligjit administrativ kombëtar dhe të rregulloreve ndërkombëtare për integritetin dhe konfliktet e interesave<sup>96</sup>. Si në çdo institucion tjetër, korrupsioni mund të marrë formën e punësimit të personave të caktuar, bashkëshortëve, të afërmve, ose miqve.

Me vend në këtë kontekst janë konstatimet e një ankimi të Gallupit të janarit 2008: 27% e nëpunësve të gjykatës u përgjigjën se për punësimin e personelit në institucioni ku punojnë, janë të rëndësishme lidhjet informale me stafin ekzistues, 20% thonë se janë të rëndësishme marrëdhëniet fisnore dhe 3% përmendin dhuratat ose paratë të ofruara punonjësve e institucionit.

<sup>94</sup> Kështu, sipas një deklarate shtypi të lëshuar më 26 shkurt 2008, SCM urdhëroi ndërprerjen e promovimit të të gjithë inspektorëve në divizionin e inspektimit gjyqësor. Pa shpjegime të bazuara në kritere objektive dhe duke konsideruar se divizioni i inspektimit gjyqësor, aktualisht i përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë dhe prokurorë të promovuar, funksionon me koordinimin e SCM, lehtësisht mund të supozohet se këta inspektorë kishin 'dallime në opinione' me anëtarët e SCM, veçanërisht meqenëse inspektorët kanë kompetencën për të kontrolluar dhe hetuar gabimet disiplinore dhe etike të anëtarëve të SCM. Veç kësaj, për të provuar që nuk ka kritere për revokimin dhe punësimin e inspektorëve të SCM, deklarata për shtyp e SCM, e 9 prillit 2009, rendit emrat e inspektorëve të rinj dhe disa prej tyre janë përzgjedhur pikërisht nga ata që sapo ishin revokuar.

<sup>95</sup> Societatea pentru Justitie, Deklaratë për shtyp e lëshuar më 07 janar 2008, në [www.sojust.ro](http://www.sojust.ro).

<sup>96</sup> Mund të argumentohet se në atë kohë, legjislacioni kombëtar nuk e mohonte anëtarësinë në komision të një kolegu të gjykatës të njërit prej aplikantëve. Por aplikohen dispozitat për asnjësinë, paanshmërinë, objektivitetin dhe paraqitjen rregulluar në Kodin Model të Sjelljes për Zyrtarët Publik miratuar nëpërmjet Rekomandimit nr. (2000) 10 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Të njëjtat metoda mund të përdoren për të ndikuar në vlerësimin e personelit ose në vendimet e promovimit. Në të njëjtin anketim, 43% e nëpunësve të gjykatave thonë se promovimi duhet të bazohet në meritën individuale, gjë që zbulon pasiguri madhore në lidhje me paanshmërinë në sektor.

### ***b. Lista e pagave***

Sekretareve të gjykatës u jepen shpërblime dhe stimuj nga kreu i institucionit, sipas kritereve të paparashikueshme, jo transparente dhe subjektive. Prandaj, kreu i institucionit mund të tërheqë punonjës të bindur duke u ofruar atyre shuma të caktuara parash, paketa pushimesh me zbritje, pagesa në pjesëmarrjen në seminare, etj. Për shembull, kryetari i një gjykate mund të vendosë t'i japë shpërblim për performancë një punonjësi, i cili pastaj do të emërohet si anëtar i komisionit të ankandit të gjykatës dhe do t'i besohet 'misioni' i drejtimit të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve për gjykatën në drejtimin e zgjedhur nga kryetari.

Organizatave joqeveritare dhe media kanë zbuluar politika arbitrare për shpërblimet dhe stimujt në institucione të tilla si Ministria e Drejtësisë, Autoriteti Kombëtar Penitenciar dhe Këshilli i Lartë i Magjistraturës<sup>97</sup>. Në këto raste, shpërndarja arbitrare e parave mund të hedhë dyshim mbi integritetin dhe përshtatshmërinë e personelit.

### ***c. Prokurimi publik***

Si çdo institucion publik, gjykatat, prokuroritë, njësitë policore, vendet e vuajtjes së dënimit kanë nevojë që të blejnë mallra dhe shërbime të ndryshme për të siguruar funksionimin e tyre. Legjislacioni për prokurimin publik aplikohet dhe merr format e caktimit të drejtpërdrejtë të kontratave, ofertave publike, etj. Për të manipuluar një ofertë drejt një përfituesi të caktuar, shoqëritë e ftuara në ofertat për tender mund të kufizohen ose tenderat e marra nga një proces i hapur mund të vlerësohen në mënyrë arbitrare. Kur këto komisione përfshijnë gjyqtarët ose prokurorët, shanset për të ekspozuar parregullsitë ose për të penalizuar anëtarët e komisionit zvogëlohen duke pasur parasysh se ankesat e mundshme në lidhje me ofertën do të depozitohen në atë gjykatë specifike. Natyrisht, të gjithë individët e përfshirë në prokurimin publik mund të jenë objekt i korrupsionit. Kjo mund të përfshijë persona të tillë si zyrtari i ngarkuar me procedurën e prokurimit, eksperti financiar që motivon nevojën për prokurim, vendimmarrësi që miraton nevojën dhe procedurën, vlerësuesi që përzgjedh tenderin fitues, juristi që harton dhe nënshkruan kontratën, ose menaxheri i blerjeve i cili mbikëqyr kontraktuesin dhe pagesat.

Duhet përmendur në të njëjtin kontekst mundësia e shpërdorimit të fondeve institucionale. Kjo kategori mund të përfshijë, mes të tjerash, përdorimin abuziv të automjeteve, të telefonave, të pajisjeve të zyrës të institucionit ose edhe rimbursimin e shpenzimeve për qiranë ose transportin.

Megjithatë, këto janë raste të shkeljeve administrative ose tregtimit të influencës, dhe nuk duhet të ngatërrohen me veprimet korruptive; përkufizimi i këtij koncepti, siç u përmend më sipër, ka të bëjë me "pushtetin që i besohet" një individ.

## **5. Diagnostikimi i korrupsionit në sistemin e drejtësisë**

---

<sup>97</sup> Shih një deklaratë për shtyp me titullin pandershmeri, hipokrizi dhe përçmim i fuqisë ekzekutive, lëshuar më 26 shtator 2008 nga Bashkimi Kombëtar i gjyqtarëve në Rumani, gjendet në [www.unjr.ro](http://www.unjr.ro).

Si një element me impakt negativ në paanshmërinë e vendimmarrësve, korrupsioni ndikon në cilësinë e vendimeve të marra në këtë mënyrë. Kemi diskutuar më sipër se çfarë është korrupsioni dhe ku mund të haset ai në sistemin gjyqësor. Tani do të shkojmë tek shkaqet e korrupsionit gjyqësor dhe format e tij. Do të analizojmë edhe mjetet e përdorura për korruptimin e personelit gjyqësor dhe do të tregojmë se si ndodh kontakti midis individit që korruptohet dhe agjentit korruptues. Përfundimisht, do të identifikojmë llojet e korrupsionit dhe efektet që ai mund të ketë tek personeli, sistemi dhe tërthorazi tek shoqëria.

## 5.1 Shkaqet e korrupsionit

Korrupsioni është një fenomen kompleks shoqëror. Shkaqet e korrupsionit dhe rrethanat që e favorizojnë shfaqjen e tij janë të shumëfishta dhe mund të variojnë nga elementët gjyqësor<sup>98</sup> deri ato politike<sup>99</sup>, nga elementet administrative<sup>100</sup>, deri tek ato sociale dhe ekonomike<sup>101</sup>. Për sa i përket sistemit gjyqësor, shkaqet dhe faktorët që kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit ose të korrupsionit të perceptuar janë:

### a. Mungesa e informacionit

- *Sjellja e personelit.* Mosnjohja nga organi gjyqësor e dosjes së çështjes, mungesa e interesit për zgjidhjen e shpejtë të çështjes, shtyrjet e pajustificuara, mungesa e njohjes së qarkut të brendshëm të dokumenteve ose se ku të gjendet informacioni, qytetarët do t'i marrin këto sikur duan të thonë se interesi i personelit në çështjen përkatëse duhet 'të stimulohet', ose që këto elementë nënkuptojnë një kërkesë për mitë;
- *Mungesa e informacionit për mënyrën se si funksionon sistemi.* Shpesh, qytetarët nuk janë në dijeni të të drejtave të tyre dhe nuk kanë akses ndaj informacionit se si funksionon sistemi gjyqësor rumun për të mbrojtur të drejtat e tyre. Kjo krijon një popullsi të cenueshme nga mashtrimi prej individëve që kërkojnë mitë në shkëmbim të sigurimit ose përshpejtimit të një zgjidhjeje për çështjen;
- *Akresi i papërshtatshëm për qytetarët ndaj legjislacionit.* Legjislacioni rumun disponohet pa kosto vetëm në rrethana të caktuara<sup>102</sup>. Legjislacioni nuk arrihet nga të gjithë të huajt ose përdoruesit e gjykatës nga minoritetet etnike për shkak të mungesës së përkthimeve në gjuhët minoritare ose të minoriteteve etnike. Udhëzimet e postuara aktualisht në faqet e internetit të institucioneve të ndryshme, ose në disa gjykata, në shumicën e rasteve janë ekstrakte nga tekstet e ligjeve, më tepër se sa fletëpalosje që u shpjegojnë qytetarëve të zakonshëm se cilat janë të drejtat e tyre dhe mjetet procedurale me anë të të cilave të mbrojnë të drejtat e tyre;

<sup>98</sup> P.sh., mungesa e stabilitetit legjislativ, rregulloret e paplota, mospërputhjet midis ligjeve, vendimet e paparashikueshme të gjykatës, praktika jokonsistente gjyqësore.

<sup>99</sup> P.sh., parlamenti dekriminalizon krimet e korrupsionit, ose rregullon dënime më të buta ose madje planifikon të çmontojë institucionet kundër korrupsionit; Presidenti i vendit fal individë të dënuar për korrupsion; anëtarët e parlamentit bllokojnë ndjekjen penale në çështjet e lidhura me korrupsionin që përfshijnë ministrat.

<sup>100</sup> P.sh., sjellja e nëpunësve civilë, burokracia, mungesa e autoritetit.

<sup>101</sup> P.sh. pabarazitë sociale dhe aspirata për mirëqenie dhe komfort.

<sup>102</sup> Qeveria ofroi një faqe interneti, <http://legislatie.just.ro>, por për të pasur akses ndaj një akti normativ, pala e interesuar duhet të njohë tashmë dy çështje bazë të informacionit: numrin e ligjit dhe datën e tij.

- *Aksesi i dobët në jurisprudencë.* Programet kompjuterike pa pagesë që përmbajnë jurisprudencën ekzistojnë dhe përdoren vetëm brenda gjykatave dhe prokurorive të caktuara. Publiku nuk ka akses ndaj bazës së të dhënave, as edhe për çështjet në të cilat ata janë të përfshirë. Që prej 31 janarit 2006, të gjitha gjykatave u është kërkuar që ta bëjnë jurisprudencën e tyre publike nëpërmjet internetit<sup>103</sup>, por janë disa të cilat edhe sot, nuk kanë arritur të botojnë të dhënat e kërkuara. Në këtë pikë, zhvillimi i një aplikimi, Jurindex, është duke u bërë. Deri tani, aplikimi përfshin vendimet e dhëna nga gjykatat e apelit në vitin 2008;
- *Bashkëpunimi jo i duhur me masmedian.* Informacioni konfidencial shpesh rrjedh gjatë proceseve gjyqësore, në shumicën e rasteve për shkak të 'mirëkuptimit' midis gazetarëve dhe punonjësve të caktuar. Për shembull, në qoftë se shefi i një institucioni gjyqësor bashkëpunon me median rregullisht, ky zyrtar mund të përfitojë që media të mos e botojë kritikën publike që ka si objekt zyrtarin ose aktivitetet e institucionit, ose zyrtari mund të jetë në gjendje që ta përdorë median si një mjet për të shkarkuar hakmarrjen ose presionin personal.

#### **b. Mungesa e kontrollit dhe përgjegjshmërisë.**

- *Mungesa e demokracisë gjyqësore.* Fatkeqësisht rregullat e pashkruara akoma mbështesin sistemin gjyqësor dhe janë përjetësuar për shkak të mungesës së kulturës së etikës profesionale. Këto rregulla përfshijnë, por nuk kufizohen me atë që shefat nuk kritikohen, fshihet inkompetenca, të mos zbulohet korrupsioni, të fitohet mbi median, sindikata e institucionit të dobësohet ose diskreditohet ose që udhëheqësve të tyre tu mohohet pushteti i përfaqësimit;

- *Mospërfshirja e shoqërisë civile në monitorimin e sistemit.* Gjykatat dhe prokuroritë janë të mbyllura ndaj bashkëpunimit me organizatat joqeveritare që identifikojnë gabimet specifike organizative; aty ku ekzistojnë raporte të vlerësimit të jashtëm, ato anashkalohen dhe rekomandimet e tyre nuk implementohen;

- *Kompetenca profesionale e dobët.* Si pavarësia dhe integriteti janë të bazuar në trajnimin tërësor profesional. Aty ku mungojnë këto cilësi ose janë të pamjaftueshme dhe kur personelit u krijohen raste për përfitime shitesë, shanset për korrupsion rriten.

- *Burokracia e tepërt dhe mungesa e organizimit.* Qarku i koklavitur i dosjeve dhe të dhënat parësore, procedurat e stërzgjatura dhe jofleksible për marrëdhëniet me publikun, nëpunësit e pasjellshëm që i kalojnë qytetarët nga një zyrë në një tjetër, mund t'i bëjnë njerëzit të ndjejnë se ata nuk kanë opsion tjetër veçse t'iu drejtohen lidhjeve brenda sistemit dhe të kryejnë aktet e korrupsionit. Këto çështje lehtësohen nga monitorimi jo i duhur i procedurave administrative brenda institucionit, mosaplikimi i sanksioneve administrative në kohën e duhur dhe plotësisht ose fshehja e akteve joetike;

- *Frika nga hakmarrja.* Çdo punonjës që ka dijeni për veprimet e paligjshme ose joetike të kryera nga kolegët e tij ose të saj, eprorët ose vartësit është nën detyrimin ligjor dhe moral t'ua raportojë ato institucioneve përkatëse. Për shkak të riskut të ekspozimit, nuk raportohen faktikisht shkeljet, megjithëse mos njoftimi i organeve gjyqësore për zbulimin e një shkeljeje në vendin e punës, në vetvete është një krim<sup>104</sup>.

<sup>103</sup> Portali i gjykatave të ligjit, në <http://portal.just.ro>.

<sup>104</sup> Ligji detyron një individ që merr dijeni se është kryer një krim që lidhet me punën të njoftojë menjëherë prokurorin; I njëjti detyrim vlen edhe për personat e punësuar në pozicione drejtuese, në lidhje me ndonjë krim të kryer në atë institucion (neni 214 dhe 227 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 263 i Kodit Penal përkatësisht), ose për zyrtarët me kompetencë për inspektim dhe që kanë edhe të dhëna dhe

Kodet e etikës profesionale të policisë dhe personelit të vendeve të vuajtjes së dënimit janë të vetmet që specifikisht e ndalojnë tolerancën për shkeljet e korrupsionit dhe i detyrojnë punonjësit të informojnë eprorët dhe organet kompetente për shkeljet për të cilat ata vijnë në dijeni<sup>105</sup>. Shkelja e këtyre dispozitave mund të sjellë përgjegjësi administrative, civile ose penale. Në fakt, në një anketim të Gallupit në janar 2008, 29% e sekretareve të gjykatës u përgjigjën se ato nuk inkurajoheshin në institucionin e tyre të njoftonin rastet e shkeljeve pa pasur frikën e hakmarrjes, ndërsa 42% thanë se ato nuk inkurajoheshin për të kritikuar vendime të caktuara të eprorëve të tyre.

Për të siguruar mbrojtjen kundër hakmarrjes që bën objekt individët të cilët raportojnë veprat e paligjshme dhe jo etike, janë kaluar dy ligje: *ligji për mbrojtjen e dëshmitarit*<sup>106</sup> dhe *ligji për mbrojtjen e integritetit të denoncuesve*<sup>107</sup>. Në këtë kontekst, ja vlen të përmendim rolet e masmedias dhe shoqatave profesionale, të cilat janë kritikë për ekspozimin e rasteve të abuzimit duke pasur parasysh që presioni publik është efektiv në shumicën e rasteve;

- *Mekanizma të gabuar të përgjegjshmërisë*. Korrupsioni lulëzon aty ku risku i ekspozimit dhe ndëshkimeve është i ulët. Aktualisht, me heqjen e mjeteve për rishikimin e vendimeve (masë apelimi speciale e përdorur kundër gjykimeve të formës së prerë), gjyqtarët e Gjykatës së Apelit mund të vendosin si të duan, sepse nuk ka mjete për kundërshtim. (që gjykimet janë të formës së prerë)<sup>108</sup>.

Rreziku i vendimeve arbitrare për këtë arsye është i lartë. Megjithëse janë raportuar gabime të rënda të gjykimit gjatë viteve, nuk ka pasur penalitete të çfarë do lloji për ata që i kanë bërë ato. Pavarësisht nga dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë civile edhe penale, pandëshkueshmëria në lidhje me gabimet e kryera me qëllim ose nga neglizhenca e rëndë shkaktojnë kosto të rëndësishme për përdoruesit e gjykatës dhe shoqërinë dhe forcojnë ndjenjën se gjyqtarët dhe prokurorët janë mbi ligjin. Gjithashtu toleranca për këto çështje (vetëm pak deri tani), krijon një emër të keq për shumicën e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe nëpunësit civil edhe për ata që janë të ndershëm. Veç këtyre, është edhe risku i vogël që nëpunësit civil të pandershëm të penalizohen. Mungesa e integritetit thellohet më tej nga mosarritja shkurajuese e penalizimit të të korruptuarve. Siç do ta tregojmë më poshtë, në praktikë gjobat e urdhëruara nga gjykata për shkelësit e korrupsionit janë tepër të vogla. Po qe se këta shkelës nuk marrin dënime më të ashpra, nuk humbasin punën e tyre ose nuk i nënshtrohen gjykimeve të gjata, kultura e mosndëshkimit mundet të vazhdojë, e cila më tej gjeneron korrupsionin<sup>109</sup>;

---

informacion për krimet që futen nën juridiksionin e NAD (neni 14, paragrafi 1 një G. E. O nr.43/04.04.2002);

<sup>105</sup> Neni 19 në Kodin e Etikës Profesionale të Punonjësve të Policisë, neni 6 (k) në kodin e etikës profesionale të personelit penitenciar.

<sup>106</sup> Ligji nr. 62/19.12.2002 për mbrojtjen e dëshmitarëve, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 964 të 28 dhjetorit 2002.

<sup>107</sup> Denoncuesit janë ata punonjës të një organizate ose ish-punonjës ose anëtarë të organizatave të caktuara që raportojnë shkeljet e ligjit dhe rregulloreve, mashtrimet, veprat e korrupsionit për të cilat ata janë dëshmitarë dhe i kanë zbuluar, atyre palëve të cilat janë në gjendje ose dëshirojnë të ndërmarrin masat e kërkuara korrigjuese, ose brenda sistemit (eprorët, kolegët) ose nga jashtë sistemit (masmedia, organizatat gardiane, juristët). Këta kritikues zbuluan parregullsi të mëdha në shoqëritë private, p.sh., prodhuesit e duhanit ose edhe F.B.I ose Komisionin Evropian.

<sup>108</sup> Pranimi i Gabimeve të gjykimit është ende një tabu në Rumani. Media mbuloi gabime ndoshta të mëdha në çështjet e tilla si Tundrea dhe Visan. Në vende të tjera, ka debate të nxehta për çështjen – shih çështjet e tilla si Dreyfus, Villemin, Toulouse ose Outreau në Francë ose projekti i pafajësisë në SHBA.

<sup>109</sup> PNUD, shënim për praktikën kundër korrupsionit, 2004, cituar më sipër.



- *Rregullime që lejojnë vendimet me diskrecion.* Korrupsioni mund të ndikojë në vendimet që merr policia dhe prokurorët për të filluar një ndjekje penale, në transferimin e çështjeve nga një organ hetimor tek një prokuror, transferimin e çështjeve nga një prokuror çështjeje në një agjenci e një niveli më të lartë të ndjekjes penale, për të përcaktuar nëse kriteret e aplikuar në një ndëshkim do të jetë ndëshkim administrativ në vend të atij penal, apo për të vendosur se cila do të jetë shkalla e dënimeve që do të marrin gjykatësit.

Kjo mund të ndodhë sepse vendimet e lartpërmendura bazohen në kriteret e përgjithshme të parashikuara nga ligji, me diskrecionin e gjerë të organit gjyqësor që luan një rol kyç<sup>110</sup>. Ky diskrecion shpjegon për se gjyqtarët mund të marrin vendim ndryshe në çështje të ngjashme. Për shembull, kjo mund të shpjegojë për se vepra penale të ngjashme të kryera në rrethana të ngjashme, kanë diferenca të mëdha midis rezultateve në gjykata të ndryshme, disa të dyshuar arrestohen dhe të tjerë nuk arrestohen, ose për se disa të burgosur dënohen dhe për disa të tjerë nuk dënohen.

Vetë ligji përdor fjalën 'peshoj' në lidhje me kompetencën e gjyqtarëve për të vendosur për njoftimin e organeve të tjera që mund të aplikojnë dënime administrative për një individ që është nën hetim penal<sup>111</sup>; për të urdhëruar rishikimin ose amendimin e raporteve të vlerësimit<sup>112</sup>; për të vendosur për revokimin e arrestimeve parandaluese<sup>113</sup>; Për të miratuar caktimin e asistencës gjyqësore publike për ata që nuk kanë për të paguar avokatin<sup>114</sup>; për të urdhëruar shtyrjen dhe pezullimin e një dënimi<sup>115</sup>; për të afruar datat e seancave në raste urgjente<sup>116</sup>; në lidhje me kompetencën e prokurorëve për të kërkuar arrestimin parandalues<sup>117</sup>; zëvendësimin e tij ose revokimin e tij<sup>118</sup>; ose në lidhje me kompetencën e prokurorëve për të zgjidhur çështjet civile<sup>119</sup>. Gjithashtu fjala 'peshoj' shpesh haset në memorandumet shpjeguese të vendimeve gjyqësore, që sugjerojnë se vendimi bazohet në elementët subjektivë. Në vend të kësaj, ne besojmë fort se gjyqtarët nuk mund 'ta peshojnë' një gjendje de facto, por vetëm mund 'ta pranojnë' atë; ata nuk mundet 'ta peshojnë' de jure gjendjen, por 'vendosin' për të; ata nuk mundet 'ta peshojnë' nëse një i pandehur duhet dënuar, por 'vendosin' për të. I vetmi 'peshim' që lejohet sipas ligjit ka të bëjë me provat, por në këto raste fjala është përdorur në kuptimin e 'vlerësimit' të provave, d.m.th, një operacion logjik.

### c. Oportunitetet

- *Pagat e ulëta.* Të ardhurat mujore të gjyqtarëve janë të arsyeshme<sup>120</sup> por pagat e personelit ndihmës, veçanërisht ato të nëpunësve të arkivit dhe të agjentëve proceduralë

<sup>110</sup> E përmendim përsëri përkufizimin e korrupsionit të PNUD-it: korrupsioni = (monopoli + diskrecion) – (përgjegjshmëri + integritet + transparencë); dhe përkufizimin e Klitgaard për korrupsionin: korrupsioni = monopol + diskrecion – përgjegjshmëri. 'përgjegjshmëria' në radhë të parë do të thotë 'transparencë'.

<sup>111</sup> Neni 12 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>112</sup> Neni 115, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>113</sup> Neni 140<sup>3</sup>, paragrafi 7, Kodi i Procedurës Penale.

<sup>114</sup> Neni 171, paragrafi 2 dhe neni 172 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>115</sup> Neni 453, paragrafi 1 (a), Kodi i Procedurës Penale.

<sup>116</sup> Neni 89, paragrafi 1, Kodi i Procedurës Civile.

<sup>117</sup> Neni 138, paragrafi 3, Kodi i Procedurës Penale.

<sup>118</sup> Neni 139, paragrafi 31, Kodi i Procedurës Penale.

<sup>119</sup> Neni 45, Kodi i Procedurës Civile.

<sup>120</sup> Gjykatat e ligjit, tribunatet dhe gjykatat e apelit punësojnë afërsisht 4100 gjyqtarë. Pagat e tyre mujore neto aktualisht variojnë midis RON1, 900 dhe 6, 670, që nuk përfshijnë 50% bonus për shkallën e riskut dhe stresin, një e drejtë që aktualisht i nënshtrohet debatit. Shih deklaratën për shtyp të lëshuar më 13 janar 2009 nga bashkimi kombëtar i gjyqtarëve në Rumani, në .... (nëntor 2009).

janë shumë të ulëta, gjë që mund të inkurajojë korrupsionin administrativ. Një rritje në të ardhura nuk është e vetmja masë mbrojtëse kundër korrupsionit (në fakt, midis vitit 2005 dhe 2008, pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve u dyfishuan, megjithatë u rrit numri i çështjeve të korrupsionit që përfshinin gjyqtarët dhe prokurorët gjithashtu). Kjo duhet të shoqërohet me një ndryshim në qëndrime, me krijimin e një sistemi profesional të bazuar tek merita dhe me miratimin dhe zbatimin e rregullave antikorrupsion;

- *Kufizimet e imponuara nga natyra e pozicionit.* Ligji i ndalon personelit gjyqësor që të punësohen në pozicione të tjera, me përjashtim të disa posteve të mësimdhënies në shkollat e larta juridike. Ky ndalim, ndikon në mënyrë të paarsyeshme, mes të tjerash, tek personeli ndihmës në gjykata dhe prokurori, të cilët nuk mund të marrin ligjërisht të ardhura shtesë, megjithëse nuk janë të përfshirë në vendimmarrje gjyqësore;

- *Kontakti i drejtpërdrejtë me publikun.* Diskrecioni, i kombinuar me kontaktin e drejtpërdrejtë me publikun gjeneron dobësi. Aktiviteti për një kohë të gjatë në të njëjtin post gjithashtu krijon efekte të ngjashme: në qoftë se dikush punon për një kohë të gjatë në të njëjtin pozicion, krijohen marrëdhënie si brenda dhe jashtë institucionit që mund të inkurajojnë fshehjen e korrupsionit dhe trajtimin preferencial. Kjo mund të ndodhë në mënyrë të veçantë mes atyre punonjësve të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, por edhe midis atyre punonjësve në departamentet ndihmëse (p.sh., burimet njerëzore);

- *Çështjet e profilit të lartë.* Etja për para të shpejtë dhe të lehtë provokohet nga kontakti me çështje palët e të cilave janë të përfshira në asete tepër të vlefshme ose politikanë/afaristë që hetohen penalisht, gjithë ata që mund të jenë në gjendje të ofrojnë shuma të mëdha parash ose benefite të tjera në shkëmbim të vendimeve të favorshme.

#### **d. Rrethanat shoqërore**

- Ndjekja e të njëjtave shkolla, shoqata dhe qarqe, si dhe marrëdhëniet e ngushta fisnore. Këto marrëdhënie lehtësojnë kontaktet e drejtpërdrejta me individët që kanë detyra gjyqësore të cilat mund të inkurajojnë mitëdhënien dhe tregtimin në influencë. Kërcënimi i lartë që paraqesin këto marrëdhënie midis gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëpunësve të gjykatës, punonjësve të policisë me kolegët e tyre të mëparshëm të cilët janë bërë avokatë, dhe nga politikanët që gjithashtu janë avokatë, e bëri legjislaturën që të paraqesë një numër kufizimesh për praktikimin e ligjit.

Neni 821 i ligjit nr. 161/2003:

(1) *Ata deputetë ose senatorë që gjatë detyrës së tyre në parlament, dëshirojnë edhe të praktikojnë profesionin e avokatit, nuk mund të paraqesin argumente në çështjet që gjykohen në gjykatë ose tribunalë, ata nuk mund të japin asistencë gjyqësore për prokuroritë që janë nën juridiksionin e këtyre gjykatave.*

(2) *Ata deputetë ose senatorë të përmendur në paragrafin (1) nuk mund të japin asistencë gjyqësore për të pandehurit ose të paditurit, dhe as mund t'i ndihmojnë ata në gjykatë në çështjet penale që lidhen me:*

a) *Vepra penale të korrupsionit, vepra penale që barazohen me veprat penale të korrupsionit, vepra penale që janë të lidhura drejtpërdrejtë me veprat penale të korrupsionit dhe krime kundër interesave financiare kundër Komunitetit Evropian, siç parashikohet në ligjin nr. 78/2000 për parandalimin, zbulimin dhe penalizimin e shkeljeve të korrupsionit, me amendamentet e mëvonshme;*

b) *Veprat penale të përkufizuara nga ligji nr. 143/2000 për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me amendamentet pasuese;*

c) *Krimet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore siç parashikohet në ligjin nr. 678/2001 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me amendamentet pasuese;*

d) *Krimet e pastrimit të parave, siç parashikohet nga ligji nr. 656/2002 për parandalimin dhe ndëshkimin e pastrimit të parave, me amendimet pasuese;*

e) *Krimet kundër sigurisë së shtetit, siç parashikohet në nenin 155-173 të Kodit Penal;*

f) *Krimet që parandalojnë zbatimin e drejtësisë, siç parashikohet në nenin 259-272 të Kodit Penal;*

g) *Krimet kundër paqes dhe njerëzimit siç parashikohet në nenin 356-360 të Kodit Penal.*

(3) *Deputetët dhe senatorët e përmendur në paragrafin (1) nuk mund të paraqesin argumente në çështje të ligjit civil ose tregtar kundrejt shtetit rumun, kundrejt institucioneve dhe autoriteteve publike, kundrejt shoqërive dhe korporatave kombëtare në të cilat ata kanë aksione. Gjithashtu, ata nuk mund të paraqesin argumente në paditë kundër shtetit rumun, të gjykuara në gjykatat ndërkombëtare.*

(4) *Dispozitat sipas paragrafit (1) - (3) nuk aplikohen në çështjet në të cilat avokati është palë në çështjen gjyqësore ose jep asistencë juridike ose është përfaqësues i bashkëshortëve ose të afërmeve të tyre deri në shkallën e katërt, duke e përfshirë atë.*

Marrëdhëniet civile ose farefisnore midis atyre që përfshihen në gjykime kanë shkaktuar faktikisht rregullimin e disa mospërputhjeve në çështje apo kufizimeve.

Për shembull, sipas nenit 46, Kodi i Procedurës Penale: "*Gjyqtarët që janë bashkëshortë ose të afërm gjaku ose të lidhur nga martesë deri në shkallën e katërt, nuk mund të jenë pjesë e të njëjtit trup gjykues*". Neni 48, paragrafi 2 parashikon që "*Një gjyqtar është i papajtueshëm me pjesëmarrjen në një gjykim apeli kur bashkëshorti ose personi me të cilin është i afërm nga gjaku ose martesë, deri në shkallën e katërt ka marrë pjesë, si gjyqtar ose prokuror në gjykimin e të njëjtës çështje*".

Sipas nenit 20 të ligjit nr. 51/1995, (1) *Profesioni i avokatit nuk mund të praktikohet në gjykatë ose në prokurori ku bashkëshorti i avokatit, i afërm nga gjaku ose martesë deri në shkallën e tretë, ka pozicionin e një gjyqtari ose prokurori.*

(2) *Dispozitat në paragrafin (1) aplikohen edhe për avokatin bashkëshorti i të cilit ose personat e lidhur nga gjaku ose martesë deri në shkallën e tretë, punojnë si gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese ose si gjyqtarë financiare, këshilltarë llogarish ose prokurorë financiarë në Gjykatën e Llogarive.*

(3) *Dispozitat në paragrafin (1) aplikohen edhe për prokurorinë e atashuar tek HCCJ, dhe tek departamenti kombëtar kundër korrupsionit.*

(4) *Dispozitat në paragrafët (1) –(3) aplikohen edhe për avokatët e licensuar, ndihmës avokatët, avokatët e rinj ose të punësuar në profesion, të cilët përdorin formën e organizatës profesionale ose marrëdhëniet e bashkëpunimit profesional të përkufizuara sipas ligjit, në mënyrë që të shmangin këto dispozita, të cilat do të ndëshkohen si shkelje e rëndë.*

Megjithatë ka situata të tjera të cilat mbeten të parregulluara për sa u përket lidhjeve midis dy individëve që duhet t'i ndalojë ata që të mos punojnë së bashku në një çështje të veçantë të tillë si bashkëjetesa e dy gjyqtarëve në të njëjtin panel, bashkëjetesa e një gjyqtari dhe një avokati, ose martesë midis gjyqtarit të apelit dhe gjyqtarit që ka dhënë vendimin e mëparshëm.

- *Toleranca në shoqëri.* Në shumë fusha, njerëzit e konsiderojnë pagesën e shumëve shtesë të parave në shkëmbim të shërbimeve si 'normale'. Zakonisht, pacientët e quajnë normale që të paguajnë para shtesë për doktorët e tyre; në mënyrë të ngjashme, përdoruesit e gjykatës janë më të interesuar në atë se si të fitojnë favorin e trupit gjykues më tepër se sa në paraqitjen e paanshme të çështjes së tyre. Në këtë drejtim, barometri i opinionit publik i 2007-s të fondacionit SOROS, zbulon se njerëzit që kanë kontakte me elementë të sistemit të drejtësisë (tribunalin, zyrtarë noteriale, firmat e avokatisë) kishin njohuri se tek kush duhet të besonin në 11% rasteve në 2007<sup>121</sup> dhe kishin kontakte brenda policisë në 12.5% të rasteve<sup>122</sup>. Mosbesimi është thelluar nga ideja - së cilës i kanë hedhur benzinë raportet e masmedias - se gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen ndikimit politik;

- *Moskultivimi i nderit dhe integritetit.* Etika në sistemin gjyqësor reflekton etikën e shoqërisë rumune, e cila është disi e ulët. Kjo ndodh sepse nuk ka vlerësim etike kur punësohen aplikantët dhe gjatë gjithë karrierës së tyre, vlerësimet janë disi të përcipta dhe ndonjëherë janë një mjet presioni në duart e vendimmarrësve. Ka pak ose aspak seminare që fokusohen tek etika dhe paanshmëria dhe nuk ka fare nga ata që të trajtojnë antikorrupsionin. Kultura e shërbimit të interesave publike promovohet më mirë mes punonjësve të policisë më tepër se sa mes personelit të gjykatave apo prokurorëve;

- *Zakoni ose instikti.* Për sa kohë që një punonjës është përfshirë në shkeljet e korrupsionit dhe nuk është penalizuar, ose për sa kohë që bashkëpunëtorët kanë bërë të njëjtën gjë, ata do të inkurajohen të adoptojnë ose të vazhdojnë me të njëjtat forma të shkeljeve.

## 5.2 Format e korrupsionit

Siç ju treguam më sipër, kategoritë gjyqësore të korrupsionit penal rregullohen me Kodin Penal dhe ligjin nr. 78/2000. Për sa u përket atyre që janë më tepër me bazë etike se sa gjyqësore, një përkufizim që e kemi përdorur në këtë raport, ka disa forma të korrupsionit që mund të identifikohen në disa fusha duke përfshirë fushat gjyqësore, gjyqësore - administrative dhe vendimmarrjen administrative.

Duke krahasuar të dhënat e paraqitura nga hetimet zyrtare dhe penalitetet e aplikuar deri tani me situatat hipotetike të nxjerra nga dobësitë e sistemit të përshkruara më sipër, format e korrupsionit të pranishme në sistemin e administrimit të drejtësisë janë si më poshtë:

- *mitëdhënia dhe mitmarrja:* ajo përfshin dy individë, atë që premtos ose ofron një aset ose përfitim tjetër dhe atë që e kërkon ose e merr atë në shkëmbim të kryerjes së

<sup>121</sup> Krahasuar me 26% në 1998, 19% në 2002, 8% në 2005.

<sup>122</sup> Krahasuar me 29% në 1998, 18% në 2002, 9% në 2005.

ligjshme ose të paligjshme të një veprimi që është pjesë e përshkrimit të detyrës së dikujt; nuk ka rëndësi se kush e inicion aktin e korrupsionit<sup>123</sup>.

- **tregtimi i influencës**: lidhet me përfitimet e ofruara një individi që premtion të bindë një agjent publik që të kryejë (ose të mos kryejë) një veprim që është pjesë e përshkrimit të punës;

- **marrja e dhuratave**: përfshin marrjen e benefiteve duke ushtruar detyrën, që jo domosdoshmërisht ka synimin për të shtrembëruar trajtimin e atij procesi, por që mund të lehtësojë vendosjen e marrëdhënieve joetike;

- **"grasatimi"**: përfshin përfitimet e ofruara agjentëve zyrtarë në shkëmbim të përshpejtimit të ecurisë të procedurës ligjore ose për të parandaluar palën kundërshtare që të ndërhyjë e para;

- **mashtrimi**: lidhet me falsifikimin e të dhënave, në formën e mashtimit intelektual, falsifikimi, ndihma dhe mbështetja;

- **shantazhi**: përbën marrjen e përfitimeve me anë të presionit ose forcës (p.sh., një individ mund të kërcënohet me armë, ndëshkime administrative ose ndjekje penale në qoftë se ai ose ajo nuk adopton sjelljen e dëshiruar);

- **trajtimi preferencial**: konsiston në dhënien e ndihmës miqve, njerëzve që shoqërohet dikush, etj., të cilët fitojnë pozicione për shkak të lidhjeve të tyre më tepër se sa për shkak të kompetencës. Në këtë drejtim, vendimet më të cenueshme janë ato në të cilat vendet e punës zihen pa garë ose për të cilat vendosin testet me gojë. Kjo mund të ndodhë me transferimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera, emërimin e prokurorëve në NAD ose DIICOT, promovimin e gjyqtarëve të shkallës së lartë, emërimin e inspektorëve gjyqësorë në SCM, ose emërimin e sekretareve të gjykatës në gjykata;

- **nepotizmi**: është një formë e trajtimit preferencial që konsiston në lehtësimin e punësimit në sistem të bashkëshortit ose të afërmit të dikujt;

- **abuzimi me fondet**: ka të bëjë me keqpërvetësimin e fondeve publike;

- **shpërdorimi i informacionit të klasifikuar**: lidhet me përdorimin (për vete ose për miqtë e dikujt) të informacionit që përndryshe nuk do të ishte i disponueshëm që dikush merr për shkak të përshkrimit të detyrës për fitime personale (p.sh., një oficer i përmbartimit të gjykatës, blen nëpërmjet një ndërmjetësi një ndërtesë që del në ankand dhe shitet me një çmim poshtë vlerës së tregut);

- **përqindjet**: ndodhin kur një individ i bën një favor të paligjshëm një tjetri dhe ky i fundit bën të njëjtën gjë si shpërblim (p.sh., një individ promovohet nga kreu i institucionit në një pozicion të caktuar dhe, si i tillë, i pari lehtëson keqpërvetësimin e aseteve të caktuara në përfitim të këtij të fundit; menaxheri i një institucioni blen pajisje zyre pa nxjerrë një ftesë për tender nga një furnitor i cili pastaj e shpërblen menaxherin me një përqindje të shumës së paguar nga institucioni).

Në *Shtojcën III* renditim disa shembuj të rasteve që përfshijnë personelin gjyqësor, që u dënuan për korrupsion në 2004 - 2008. Këto shembuj zbulojnë se format më të shpeshta të korrupsionit në praktikë janë mitëdhënia dhe mitëmarrja, dhe tregtimi në influencë që kryhet për të ndryshuar vendimin e një prokurori ose gjyqtari.

### 5.3 Mjetet e korrupsionit

---

<sup>123</sup> Mita është pjesë e kategorive të *motivimit* të punonjësve. Në lidhje efektet e saj, një mitë është një formë *shpërblimi*. Shih Eugen Burdus, Gheorghita Caprarescu, *motivimi*, në 'bazat e menaxhimit organizativ', Peditura Economica, Bukuresh, 1999, fq. 486.

Çështjet e hetuara nga organet gjyqësore midis vitit 2004-2008 na mundësojnë të nxjerrim një numër konkluzionesh në lidhje me mallrat dhe shërbimet e përfshira në shkeljet e korrupsionit dhe rrethanat të cilat u ofruan ose u morën.

Kështu, *përfitimet* që kanë përbërë mjetet e korrupsionit përfshijnë:

- Para (RON, EURO ose USD në formën e parasë në dorë ose kartave bankare; pagesa e faturave; aksione në biznese 'të mbrojtura', hua);
- Objekte të ofruara si dhurata<sup>124</sup> të shitura me çmime mjaft të ulura (p.sh., bizhuteri, artikuj ushqimorë, artikuj elektronikë, pajisje shtëpiake, mobilieri, automobila, goma, karburant, veshje, kozmetikë, materiale ndërtimi, kafshë, pajisje gjuetie, ikona ose (automobilë të dërguar);
- Shërbimet, (p.sh., paketat e pushimeve, udhëtime jashtë shtetit, lehtësimi i blerjes së një shtëpie, lehtësimi i punësimit, kryerja e shërbimeve në shtëpi);
- Favore (mos depozitimi i ankesave administrative ose penale kundrejt marrësit të mitës, favore seksuale, transferim).

Çështjet e hetuara nga institucionet gjyqësore deri tani zbulojnë se *çmimi* i këtyre përfitimeve rritet sipas peshës së çështjes, me vlerën më të lartë në gjyqet tregtare që rrezikojnë shumë para, dhe në gjykimet penale ku rrezikohet liria e dikujt.

Çmimi varion edhe sipas pozicionit të zyrtarit të ngarkuar me hetimin penal (për shembull, një nivel më i lartë nënkupton një pozicion drejtues) dhe personi nën drejtim (d.m.th., qytetar i huaj, afaristi). Shuma e kërkuar në shumicën e rasteve është me lartë se shumta e marrë.

Përfitimet që përbëjnë mjetin e korrupsionit mund të vijnë nga sektori privat (paratë të paguara nga përdoruesit e gjykatës) ose nga fondet publike (abuzimi me fondet).

*Momenti* kur dikush tenton të manipulojë paanshmërinë e procesit ndodh ose në fillim, ose në fund të procesit ligjor përkatës. Si rregull, korrupsioni tenton të bëjë objekt ato institucione që kanë një monopol mbi fillimin e procesit (p.sh., Garda Financiare ose policia rrugore; organet gjyqësore si policia gjyqësore dhe prokurorët) dhe ata që marrin vendimet e formës së prerë (Gjykatat e Apelit). Përfitimet mund të merren pasi institucioni gjyqësor përfundon procesin ligjërish (marrja e përfitimeve të padrejta). Këto përfitime të ofruara në mënyrë të përsëritur mund të krijojnë një zakon dhe të kthehen në një premtim mite.

#### 5.4 Mënyrat e korrupsionit

Kur korrupsioni përfshin të paktën dy persona, kontakti midis tyre arrihet në dy mënyra:

- *drejtpërdrejt*: kjo kërkon besim të madh midis palëve, që zakonisht bazohet tek miqësia, kontaktet e mëparshme, ose rekomandimi nga një person tjetër që e beson agjenti publik. Kjo mund të përfshijë edhe mënyrat e presionit që rezultojnë nga marrëdhëniet e autoritetit (p.sh., me një epror), ose nëpërmjet shantazhit;

---

<sup>124</sup> Në Shqipëri, ofrimi i një dhurate një gjyqtari, duke përfshirë edhe nga personat e përfshirë në procesin gjyqësor, nuk shikohet si e paligjshme, edhe kur vjen nga përdoruesit e gjykatës që kanë përfituar nga një vendim i marrë nga gjyqtari në fjalë. Në disa lokalitete në Rumani, këto praktika përdoren nga firmat e mëdha të avokatisë ose firmat e insolvencës, në festa të caktuara; ekziston edhe praktika e ofrimit të luleve ose të paketave me kafe për gjyqtarët ose prokurorët. Deri në masën në të cilën dhurata ka vlerë simbolike dhe kjo sjellje tolerohet, mund të flasin nëse kjo lloj sjelljeje është etike apo jo, më tepër se sa është akt korrupsioni.

- *tërthorazi*: kjo kërkon përdorimin e ndërmjetësve. Këto mund të jenë bashkëpunëtorët aktualë ose të mëparshëm, pjesëtarët e familjes<sup>125</sup> ose personat me të cilët zyrtari hyn në kontakt shpesh, të tillë si personeli ndihmës i gjykatës, avokatët, ose madje fqinjët e gjyqtarëve ose prokurorëve. Kontakti mund të bëhet për një akt të vetëm të paligjshëm korrupsioni, ose ai mund të përsëritet (vepër penale e vazhduar).

## 5.5 Qëllimi i korrupsionit

**a.** Mita mund të kërkohej dhe të ofrohet për të shtrembëruar rezultatin e një procesi gjyqësor ose për të kryer një akt të paligjshëm.

Kategoria e parë përfshin mos vendosjen e penalteteve kur është shkelur ligji, lirimi e një individ të arrestuar megjithëse ndalimi i mëtejshëm do të ishte i domosdoshëm në të kundërt, ndryshimi i akuzave në mënyrë të pabazuar, keqraportimi i informacionit në procesverbalin e një çështjeje tjetër në raport, keqpërvetësimi ose shkatërrimi i provave në dosjen e çështjes, moslëshimi i fletëthirrjes, mosdorëzimi apo keqpërvetësimi i provës së dhënies së fletëthirrjes ose komunikimi i vendimit, shtyrja e një zgjidhjeje për një dosje çështjeje, rrjedhje informacioni, lejimi i qëndrimit të një të pandehuri të dënuar në mjediset e policisë në vend të transferimit të tij/të saj në vendin e vuajtjes së dënimit, bërja e një rekomandimi të favorshëm për një të ndaluar për të siguruar pezullimin e dënimit ose disponimi i paligjshëm i aseteve të një shoqërie tregtare gjatë procedurës së përgatitjes së mbylljes së saj.

Kategoria tjetër, ajo e vendimmarrjes administrative, përfshin: dhënien e një kontrate një ofertuesi i cili ka bërë një ofertë më të ulët se ofertat e tjera të marra, lëshimi i një certifikate regjistrimi kur një automobil i caktuar është prokuruar në mënyrë të paligjshme; sigurimi i mbrojtjes nga autoritetet për një grup kriminal, duke përdorur punën e të ndaluarit për ndërtimin e një ndërtese (për shembull, për personelin e agjencisë kombëtare penitenciare ose për gjyqtarët dhe prokurorët); regjistrimi i punonjësve si të pranishëm në punë pavarësisht mungesës së tyre.

**b.** Shumë shpesh, përfitimet ofrohen në shkëmbim të përfundimit të akteve ligjore. Kështu, në vitin 2007 Raporti për Korrupsionin Global nga Transparency International, 10% e të anketuarve nga 21 vende të mbuluara nga sondazhi u përgjigjën se ata kishin dhënë mitë në shkëmbim të një vendimi në favorin e tyre. Për shembull, mita mund të jepet nga i pandehuri, i akuzuar për një vepër penale të lehtë, për tu siguruar që gjyqtari të mos marrë vendimin e dënimit me burg, por ose të vendosë për një dënim të pezulluar ose nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës. Kjo mund të shërbejë edhe për të ndryshuar mendimin e gjyqtarit për të dhënë minimumin e dënimit ligjor në vend të maksimumit, institucionit gjyqësor për të shënuar ankesën dhe për të filluar hetimin për kriminelët e një vepre penale, ose për gjyqtarin për të planifikuar seancat më herët ose për të përshpejtuar dhënien e një vendimi. Mita mund të jepet edhe pa i kërkuar agjentit gjyqësor të bëjë ndonjë gjë të paligjshme, por si një masë mbrojtëse për të parandaluar palën kundërshtare që të korrutojë organin gjyqësor në emër të saj.

## 5.6 Efektet e korrupsionit gjyqësor

---

<sup>125</sup> Gjyqtari Aleksandr Karpov, zëvendëskryetar i Gjykatës së Lartë të Rusisë, dha dorëheqjen më 17 shkurt 2009, pasi i biri i tij u arrestua me akuzat për korrupsion. I biri i gjyqtarit dyshohej se kishte marrë 30.000 USD në shkëmbim të ndikimit mbi gjyqtarët e gjykatës në një dosje çështjeje (juridice. ro, 18.02.2009).

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Ai minon parimet e qeverisjes së mirë, barazisë sociale dhe drejtësisë. Ai shtrembëron konkurrencën, ndalon zhvillimin ekonomik dhe kërcënon stabilitetin e institucioneve demokratike dhe themelin moral të shoqërisë. Kostot sociale të korrupsionit manifestohen në shumat e parave të shpenzuara për të kryer veprat e paligjshme, shpenzimet e kryera nëpërmjet hetimeve, minimi i besimit publik dhe korrupsionit shtesë të gjeneruar për shkak të tij (formimi i zinxhirëve të korrupsionit).

Duke shkelur rregullat, detyrat dhe moralin, korrupsioni shkakton shpërbërjen e shoqërisë dhe të komunitetit sepse ai ndikon negativisht në përgjegjësinë dhe transparencën shoqërore dhe e gërryen besimin shoqëror. Ai çon në humbjen e integritetit të individëve, të cilët nga ana e tyre duhet të gënjëjnë dhe të zbatojnë standarde të dyfishta.

*Korrupsioni gjyqësor* ndikon jo vetëm në integritetin e profesionistëve gjyqësorë por gjithashtu tek sistemi si i tërë. Ai ndërhyt në paanësinë që duhet të përcaktojë detyrat e gjyqtarit ose prokurorit dhe në përgjithësi, në përgjegjësinë e të gjitha niveleve. Kostot e larta dhe efektet e rënda që sjell korrupsioni gjyqësor, si në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe tërthorazi, mund të grupohen si më poshtë:

**5.6.1 Për publikun dhe shoqërinë në përgjithësi**, ka një rënie të vlerave morale - konceptet e së mirës dhe së keqes bëhen relative kur u jepet një model negativ të rinjve. Mbrojtja e të drejtave kthehet në iluzion dhe demokracia gërryhet:

- *perceptimi i përgjithshëm negativ*: Edhe një numër i vogël i rasteve të korrupsionit në sistemin gjyqësor do të ketë ndikim negativisht tek publiku sepse është pikërisht ky sistem që ndëshkon korrupsionin në sektorë të tjerë. Kjo çon në një rënie të besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe forcon dyshimet për qëllimin të cilit i shërben drejtësia. Si rezultat, nuk ka parashikueshmëri dhe transparencë në rezultatin e një gjykimi kur sistemi nuk funksionon, kur prokurorët i blejnë pozicionet e tyre drejtuese dhe gjykatësit pranojnë mitë, kur zyrtarët e korruptuar të niveleve të larta ose kriminelët e rëndë marrin në qoftë se marrin, dënime të neglizhueshme.

Dyshimi i rritur i shkakton drejtësisë humbjen e pamjes së saj të ligjshmërisë, duke ulur efikasitetin e zbatimit të ligjit;

- *varfërimi i mëtejshëm i të varfërve*: me korrupsionin e përditshëm, kostot ndikohen në mënyrë të padrejtë mbi të varfrit, të cilët nuk arrijnë dot të paguajnë paratë shtesë për të fituar çështjen e tyre<sup>126</sup>. Ky është edhe opinioni i Komisionerit Evropian për të Drejtat e Njeriut, siç shprehet në Pikëpamjen mbi korrupsionin në sistemin e drejtësisë (24 qershor 2008), përfshirë në Shtojcën II të këtij raporti;

- *përzetësimi i praktikave të paanshme*: mosarritja e sistemit të drejtësisë që të penalizojë korrupsionin në mënyrë konsistente dhe në kohën e duhur ndihmon në rritjen e këtyre krimeve si midis individëve (miqve, të afërmeve, bashkëpunëtorëve), edhe në sektorë madhorë të tillë si politika, arsimit, kujdesi shëndetësor, mbrojtja e mjedisit.

Për pasojë, besimi i përgjithshëm në institucionet dhe autoritetet e tjera bie. Lidhjet e prezumuara me sistemin e drejtësisë do t'i bëjnë njerëzit që të humbasin besimin në cilësinë dhe autoritetin e institucioneve publike dhe do të gjenerojnë perceptimin se korrupsioni është e vetmja mënyrë për të përfituar shërbime të cilësisë së lartë, duke inkurajuar në këtë mënyrë publikun që t'i drejtohet atij më tej. Çdo pozicion, çdo

<sup>126</sup> Korrupsioni ndikon në mënyrë të veçantë të varfrit sepse është një përpjekje tepër e madhe për ta që të gjejnë burimet për të korruptuar agjentët publikë ndryshe nga njerëzit e pasur.



shërbim, çdo burim (politika, ekonomia, masmedia) do të shikohen si të dala në shitje, gjë që do të dobësojë konceptin e vetë demokracisë. Ndërkohë zhvillimi ekonomik mund të pengohet sepse investimet mund të bëhen më pak substanciale apo të përfshijnë fonde të paligjshme, ndihma e huaj mund të reduktohet dhe për sektorët e rëndësishëm do të ketë një shumë më të ulët të fondeve publike. Korrupsioni mund të bëhet sistemik dhe tipik;

- *mbrojtja e reduktuar e të drejtave*: kur individët e akuzuar për keqbërje pastrohen eventualisht për shkak të veprave penale të korrupsionit, viktimat nuk mund t'ua besojnë më gjykatave të ligjit për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre. Po kështu, shoqëritë që nuk paguajnë ryshfete nuk mund të jenë në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre dhe të mbrojnë interesat e tyre ekonomike. Ligji kundër korrupsionit zbatohet rrallë, gjë që u mundëson palëve të fitojnë një trajtim preferencial dhe diskriminues. Sundimi i ligjit që institucionet publike duhet të sigurojnë shkatërrohet. *Krimi inkurajohet*: korrupsioni i pandëshkuar jo vetëm që do t'i hedhë benzinë korrupsionit të mëtejshëm por do të lejojë gjithashtu dhe do të inkurajojë vepra penale të rënda të lidhura me të, të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda e drogës, pastrimi i parave, krimi i organizuar, shantazhi, evazioni i tatimeve, mes të tjerash.

#### **5.6.2 Për sistemin gjyqësor** korrupsioni ndikon vetë pavarësinë e sistemit:

- *ai ndikon në aftësinë funksionuese*: drejtësia bëhet private (preferenciale), ose inefikase (që është e barazvlefshme me padrejtësinë). Sistemi i përgjithshëm bëhet i paparashikueshëm dhe i pasigurt;

- *agjentët politikë gjejnë mekanizmat e vetëmbrojtjes*: në çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, do të ketë përpjekje për të korrumpuar gjyqtarët dhe prokurorët për t'ua përzierë me punën e tyre ose për të ndërhyrë në karrierën e tyre;

- *bie cilësia e shërbimeve*: kur personeli nxjerr fitime shtesë nga kryerja e shërbimeve preferenciale, ata nuk janë më të interesuar të përmirësojnë cilësinë e shërbimit të tyre;

- *rritet numri i çështjeve të korrupsionit të pagjykuara në gjykatë*: masa me të cilën organet profesionale e luftojnë korrupsionin do të bëjë që hetimet të jenë më të shpeshta.

#### **5.6.3 Për personelin gjyqësor** korrupsioni ndikon në integritetin, profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë e tyre dhe mund të shkaktojë:

- *rënie në profesionalizëm dhe cilësinë e punës*: personeli gjyqësor nuk do të jetë më i interesuar të përmirësojë aftësitë e tij profesionale për sa kohë që shërbimet që ata tashmë kanë kryer sigurojnë të ardhura shtesë;

- *korrupsion mes bashkëpunëtorëve*: sjellja e paligjshme, por fitimprurëse do të shumëfishohet po qe se nuk krijohen politika për ta parandaluar atë. Ajo shkakton mbytjen e drejtësisë;

- *përjetësimi i praktikave të padrejta me kalimin e kohës*: aktet e paligjshme të pandëshkuara të korrupsionit janë një nxitje për personelin gjyqësor që të vazhdojë të kryejë këtë lloj sjelljeje;

- *rënie të kurajës*: mos ndëshkimi i korrupsionit dhe përjetësimi i këtyre shkeljeve dobëson besimin e personelit gjyqësor tek reformimi i sistemit, dekurajon punonjësit për t'i raportuar ato dhe shkakton pesimizëm.

### **5.7 Llojet e korrupsionit**

Në lidhje me llojet e korrupsionit janë të mundshme disa tipologji, të cilat janë të paqarta pikërisht sepse për shkak të natyrës komplekse të korrupsionit:

### **5.7.1 Korrupsioni i vogël përkundrejt atij të nivelit të lartë**

Ka tre kritere për të dalluar midis korrupsionit të vogël dhe atij të nivelit të lartë:

#### **a. Pozicioni hierarkik i kriminelit**

Korrupsioni i nivelit të lartë është korrupsion i ashtuquajturit korrupsioni *politik* ose i *nivelit madhor*, i cili përfshin pozicionet e udhëheqjes publike<sup>127</sup> (d.m.th. ata që përcaktojnë strategjitë, politikat, ligjet). Korrupsioni politik mbulon një gamë të gjerë praktikash, nga financimet e paligjshme të partive politike dhe fushatave të zgjedhjeve, deri tek blerja e votave për të influencuar tregtinë mes politikanëve apo zyrtarëve të zgjedhur. Këta individë mund të përdorin pozitën e tyre zyrtare për të përmirësuar pasurinë e tyre personale. Kjo mund të ndodhë në disa situata të tilla si kalimi i legjislacionit për të dhënë një heqje për 24 orë të tatimeve për importe të caktuar nga shoqëri të caktuara, procedurat e privatizimit mund të manipulohen, aktet normative mund të falsifikohen (me anë të heqjes ose shtimit të paligjshëm të paragrafëve në një ligj) ose për të përmirësuar statusin ose fuqinë e tyre (nëpërmjet blerjes së një pozicioni kandidat një listë kandidatësh ose me blerjen e votave).

Në lidhje me sistemin e drejtësisë, korrupsioni politik mund të marrë formën e manipulimit të emërimeve, promovimit, transferimit ose revokimit të gjyqtarëve ose prokurorëve; ose të shtrembërimit të standardeve të listës së pagave dhe caktimit të çështjeve<sup>128</sup>. Mënyra se si garantohet mbrojtja nga influenza politike për të siguruar pavarësinë institucionale të sistemit të drejtësisë është nëpërmjet ndarjes së pushteteve dhe vetëqeverisjes të sistemit gjyqësor, i cili zakonisht mund të ndodhë nëpërmjet këshillave gjyqësore të ngarkuara me menaxhimin e karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>129</sup>. Autonomia e gjykatave mund të sigurojë menaxhimin e problemeve administrative të vetë gjykatës<sup>130</sup>. Korrupsioni i vogël është korrupsion burokratik ose administrativ që ndodh në institucionet e administratës publike, të cilat janë të ngarkuara me zbatimin e politikave publike dhe ligjeve të hartuar nga politikanët. Ai ndodh çdo ditë, kur qytetarët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me zyrtarët, duke përfshirë ata sistemit të drejtësisë. Ky lloj korrupsioni më tepër merr formën e mitëdhënies dhe mitëmarrjes. Shumat variojnë por zakonisht ato janë të vogla. Ky problem shfaqet si specifikë në vendet e tranzicionit.

Legjislatura rumune argumenton se një grup specifik individësh në sistemin gjyqësor (p.sh., gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) lejojnë juridiksionin mbi ndjekjen e tyre penale

---

<sup>127</sup> Ky përfshin presidentin e vendit, parlamentarët, ministrat, zyrtarët e lartë (duke përfshirë shërbimet e sigurisë dhe të ushtrisë), gjyqtarët. Disa argumentojnë se kjo kategori duhet të përfshijë edhe autoritetet vendore: prefektët, kryetarët e bashkive, anëtarët e këshillave të qarqeve dhe të këshillave vendorë.

<sup>128</sup> Në Algjeri, gjithashtu, gjyqtarët e pavarur ndëshkohen dhe transferohen në lokalitete të tjera. Në Peru dhe Sri Lanka, dosjet e çështjeve u transferohen gjyqtarëve më fleksibël. Deri në vitin 2006, shefi i sistemit gjyqësor britanik ishte gjithashtu edhe anëtar i qeverisë. Në SHBA, fushatat e zgjedhjes së gjyqtarëve financohen nga burime private. Shih raportin për korrupsionin global të t'i të vitit 2007.

<sup>129</sup> Shih opinion nr. 10 të vitit 2007 për këshillin për gjyqësorin në shërbim të shoqërisë, miratuar nga Këshilli Konsultativ i gjyqtarëve evropianë, në [www.coe.int/ceje](http://www.coe.int/ceje).

<sup>130</sup> Shih rezolutë për statusin financiar dhe administrative të gjykatave të ligjit dhe prokurorive, paraqitur nga SCM për miratim gjatë mbledhjeve të Asambleve të Përgjithshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve në prill 2009, në [www.csm1909.ro](http://www.csm1909.ro).

sipas drejtorisë kombëtare të antikorrupsionit. Sipas këtij kriteri, korrupsioni i nivelit të lartë përfshin çështjet që i nënshtrohen ndjekjes së veçantë penale, pavarësisht shumës së parave ose vlerës së aseteve në fjalë, përfshijnë HCCJ dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; gjyqtarët e tjerë dhe prokurorët; anëtarët e SCM; dhe oficerët e policisë. Individë të tjerë mund të jenë udhëheqësit e autoriteteve dhe institucioneve kombëtare dhe vendore por jo udhëheqësit e autoriteteve dhe institucioneve publike të qytetit dhe fshatit; avokatët; komisarët e gardës financiare; personelin e doganës; individët që kanë pozicione gjyqësore në gjykatat ndërkombëtare juridiksioni i të cilëve pranohet në Rumani, si dhe personeli administrativ në ato gjykata; likuidatorët gjyqësorë; dhe oficerët e zbatimit të gjykatës në autoritetin për vendosjen e aseteve shtetërore<sup>131</sup>. Personeli tjetër gjykohet nga prokuroritë e rregullta.

#### **b. Vlera e objektit të korrupsionit<sup>132</sup>**

*Korrupsioni i nivelit të lartë* mund të përfshijë për shembull, procedurat e prokurimit publik, përkundër korrupsionit të vogël që ndodh në dogana, pagesën e tatimeve, ose lëshimin e autorizimeve dhe lejeve.

Legjislatura rumune vendosi që aty ku shuma e parave ose e vlerës së aseteve e përfshirë në krimin e korrupsionit e kalon barasvlerën e *10.000 eurove* të RON, atëherë Drejtoria Kombëtare e Antikorrupsionit ka juridiksionin mbi çështjen (neni 13, paragrafi (a) në G.E.O. nr. 43/2002)

#### **c. Impakti i krimit të korrupsionit<sup>133</sup>**

Një krim korrupsioni mund të ketë impakt të gjerë si kontraktimin e paligjshëm të shërbimeve të ndriçimit publik. Kontraktimi i shërbimeve të ndriçimit mund të ndikojë tek të gjithë taksapaguesit në një qytet; mund të jetë edhe më individual, si korruptimi i nëpunësit publik tek recepsioni, gjë që ndikon tek mitëdhënësi dhe të tjerët që aplikojnë për licenca të ngjashme. Në këtë drejtim, krimet që kërcënojnë interesat financiare të Komunitetit Evropian futen në juridiksionin e Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsioni (neni 13, paragrafi (11) G.E.O. nr. 43/2002).

### **5.7.2 Korrupsioni sistemik kundrejt atij sporadik<sup>134</sup>**

*Korrupsioni sistemik (endemik)* është korrupsioni që formon një pjesë të rëndësishme dhe të qenësishme të sistemit ekonomik, social dhe politik. Meqenëse virtualisht të gjitha institucionet dhe aktivitetet përdoren dhe kontrollohen nga individë të korruptuar, qytetarët nuk kanë alternativë tjetër por të pranojnë dhe të përfshihen në këto shkelje.

Në lidhje me një institucion të vetëm, korrupsionit konsiderohet sistemik kur e gjithë organizata, kultura apo drejtuesit i lejojnë praktikat korruptive, e bëjnë një sy qorr para këtyre shkeljeve ose madje e inkurajojnë këtë sjellje të padrejtë<sup>135</sup>.

---

<sup>131</sup> Neni 13, paragrafi 1 (b) i Udhëzimit Emergjent i Qeverisë nr.43/04.04.2002, në NAD, botuar në O.J nr. 244, datë 11 prill 2002, dhe amenduar nga G.E.O. nr.134/2005.

<sup>132</sup> Sipas një kriteri të qendrës burimore të antikorrupsionit të Shoqatës Ndërkombëtare U4, në [www.u4.no](http://www.u4.no).

<sup>133</sup> Klasifikimi nga TI, [www.nudaspa.ro](http://www.nudaspa.ro).

<sup>134</sup> Klasifikimi nga U4, [www.u4.no/document/glossary.cfm](http://www.u4.no/document/glossary.cfm).

<sup>135</sup> Gerald Caiden, barra në shpinat tona; korrupsioni në Amerikën Latine, punim i paraqitur në të 8-in "Congreso Internacional del CLAD sobre la Reforma del Estado y de la Administracion Pública, Panamá, 2003".

*Korrupsioni sporadik (rastësor)* nuk ndodh shpesh dhe nuk ndikon aq shumë tek mekanizmi, por tek individët, etika e të cilëve përfshihet. Në këto raste, nuk mund të flasim për rrjet, as në nivel vendor.

### **5.7.3 Korrupsioni funksional kundrejt atij disfunksional**

*Korrupsioni funksional* synon të lehtësojë përfundimin e ligjshëm të veprimeve të caktuara. Ai 'grasaton' mekanizmat burokratik, siç tregohet më sipër dhe përfshin shuma të vogla parash. Ai është më tepër një çështje kulture, sepse vetë shoqëria ndonjëherë i legjitimon këto sjellje (Rusi, Koreja e Jugut, Turqi)<sup>136</sup>.

*Korrupsioni disfunksional* është korrupsioni që çon në pengimin e aktiviteteve. Përdorimet e ofruara ose të marra në këtë rast përfshijnë vlerë të lartë.

### **5.7.4 Korrupsioni në sektorin publik kundrejt sektorit privat**

*Korrupsioni në sektorin publik* përfshin:

- korrupsionin administrativ: ka lidhje me aktivitetin e administratës vendore dhe qendrore publike, autoritetet e doganës, kujdesin shëndetësor dhe asistencën sociale, kulturën dhe arsimin, mbrojtjen, rendin publik dhe institucionet e sigurisë kombëtare;
- korrupsioni gjyqësor: lidhet me autoritetet gjyqësore, prokuroritë dhe gjykatat;
- korrupsioni ekonomik: përfshin në veçanti sistemin financiar - bankar por edhe bujqësinë, pyjet, fushat e caktuara industriale dhe industrinë e hekurit, çelikut dhe të naftës;
- korrupsioni politik: kryesisht ndikon në aktivitetin parlamentar dhe partitë politike nëpërmjet heqjes së imunitetit politik<sup>137</sup>, duke ndikuar iniciativat legjislative dhe duke ndikuar financimin e partive politike dhe të fushatave elektorale.

*Korrupsioni në sektorin privat* përfshin operacionet tregtare të kryera nga shoqëritë ndërkombëtare ose shumëkombëshe. Ai ndërhyr në konkurrencën e drejtë dhe rregullat e ekonomisë të tregut të lirë, redukton cilësinë e produkteve dhe shërbimeve dhe minon investimet ekonomike. Krimet e korrupsionit shpesh përfshijnë zyrtarët (mitën private-publike) të cilët korruptohen në shkëmbim të dhënies së lehtësirave fiskale ose kontratave të caktuara shoqërive të caktuara. Kjo mund të shkojë nga kontratat e prokurimit në shkallë të vogël deri në koncesionet për prodhimin e armëve dhe koncesioneve për burimet natyrore. Po kaq i rrezikshëm është dhe korrupsioni brenda shoqërisë ose mes shoqërive (mita privat-privat)<sup>138</sup>.

### **5.7.5 Korrupsioni aktiv kundrejt korrupsionit pasiv**

---

<sup>136</sup> "Sjelljet që kanë qenë të pranueshme dhe legjitime sipas normave tradicionale bëhet të papranueshme dhe të korruptuara kur shikohen nëpërmjet lenteve të normave moderne" (Robert King Merton, *Social Theory and Social Structure*, 1968, New York: The Free Press).

<sup>137</sup> Në fakt në Jorio kundër Italisë, vendim i 3 marsit 2004, GJEDNJ vendosi që qëllimi i imunitetit parlamentar është që të sigurojë lirinë e fjalës të përfaqësuesve të popullit dhe të parandalojë ndërhyrjen në aktivitetin parlamentar me anë të ndjekjes të urdhëruar nga partia. Por deklaratat në fjalë janë bërë në një intervistë dhënë një gazetari, prandaj ato janë jashtë dhomës legjislative dhe nuk kishin të bënin me ushtrimin e detyrave parlamentare stricto sensu. Po kështu, shih Cordova kundër Italisë, vendim i datës 30 prill 2003, C.G.I.L. dhe Cofferati kundër Italisë, vendim i datës 24 shkurt 2009, në [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int).

<sup>138</sup> Korrupsioni në sektorin privat trajtohet në vendimin kuadër të Këshillit të BE-së 2003/568/JFA për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat dhe Konventa e OKB-së kundër korrupsionit.

*Korrupsioni aktiv* konsiston në ofrimin ose premtimin e përfitimeve një vendimmarrësi (dhënie mite, tregti influence).

*Korrupsioni pasiv* konsiston në pranimin e këtyre përfitimeve (marrje mite, marrje e përfitimeve të padrejta, tregtim influence).

#### **5.7.6 Korrupsioni i zi, gri dhe i bardhë<sup>139</sup>**

*Korrupsioni i zi* ka lidhje me sjelljet e censuruara si nga publiku i gjerë dhe elitat.

*Korrupsioni gri* ka lidhje me aktet e korrupsionit që dënohen vetëm nga elitat.

*Korrupsioni i bardhë* i referohet veprimeve dhe sjelljeve antisociale penaliteti i të cilave nuk dëshirohet nga asnjë kategori shoqërore dhe që konsiderohet si i tolerueshëm. Ai përfshin lobimin si dhe 'dhurata' të vogla (p.sh., lule) që i jepen një mësuesi, një doktori, etj).

---

<sup>139</sup> Alexandru Boroj, Sorin Corlateanu, Mirela Gorunescu, Ioan Molnar, Costica Voicu, e Drejta e biznesit penal, botimi i katërt, All Beck, Bukuresht, 2006, fq. 6.

### PJESA III

## STANDARDET E INTEGRITETIT GJYQËSOR

Vendet demokratike janë themeluar mbi sundimin e ligjit. Sipas nenit 16 të Kushtetutës së Rumanisë, *askush nuk është mbi ligjin*, që do të thotë se si qytetarët edhe autoritetet publike duhet t'i binden ligjit. Kjo kërkesë nuk duhet vetëm të plotësohet, por gjithashtu duhet të duket që plotësohet<sup>140</sup>, që është e vetmja mënyrë për të krijuar besimin e përdoruesit të gjykatës në sistemin gjyqësor. Për të ndërtuar këtë bindje, *dukja dhe perceptimi* luajnë një rol jetësor.

Ekziston prezumimi pak a shumë i bazuar se "*kush ka pushtet ka tendencën për të abuzuar më të*"<sup>141</sup>. Disa thonë edhe se "*pushteti tenton të korruptojë; pushteti absolut korrupton në mënyra absolute*"<sup>142</sup>. Së pari kjo është arsyeja për se sjelljet abuzive, të paanshme duhet të parandalohen nëpërmjet krijimit të standardeve dhe duke imponuar praktikën e mira. Së dyti, duhet të ekzistojnë mekanizmat për të shtypur sjelljet që shmangen nga këto standarde.

Kur përvijojmë një politikë mbarëkombëtare për të rregulluar sjelljen e agjentëve që operojnë në sistemin gjyqësor duhet të marrim parasysh kërkesat ndërkombëtare që janë relevante gjithnjë e më shumë në epokën e globalizimit. Megjithëse shumë rregulla kanë lidhje me integritetin, dhe veçanërisht pavarësia personale dhe paanshmëria (p.sh., *Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit* miratuar nga OKB në vitin 1995, *Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët* miratuar nga Këshilli i Evropës në 1998), kjo analizë do të trajtojë rregullat për etikën dhe antikorrupsionin.

### 1. Rregullimet dhe përpjekjet mbarëbotërore

Do të analizojmë më poshtë instrumentet kryesore ndërkombëtare që rregullojnë korrupsionin duke u fokusuar tek rregullimet që kanë si objekt sistemin gjyqësor. Shumë prej tyre japin praktika dhe zgjidhje të mira për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, duke e përfshirë dhe atë në sektorin gjyqësor, që është edhe arsyeja përse e analizojmë në kapitullin tjetër të punimit tone.

#### 2.1 OKB

Kombet e Bashkuara u themeluan në vitin 1945 dhe ato aktualisht bashkojnë 192 Shtete Anëtare<sup>143</sup>. Sipas Kartës së saj, OKB-ja ka katër qëllime kyçe: të ruajë paqen dhe sigurinë botërore; të ushqejë miqësinë midis kombeve; të kontribuojë në zgjidhjen e

---

<sup>140</sup> "Drejtësia jo vetëm që duhet të jepet; por duhet edhe të duket që jepet" - opinion nga Gjyqtari Hewart CJ in Rex kundër Drejtësisë së Sussex-it, me një palë të pranishme McCarthy [1924].

<sup>141</sup> Monteskie, Shpirti i Ligjeve, pjesa XI, kapitulli 4, Editura Shëtitore, Bukuresht, 1964.

<sup>142</sup> Lord Acton, historian britanik, profesor në Universitetin e Kembrixhit, 1887, në Enciklopedinë Biografike, Kembrixh, University Press, 1988, fq. 6.

<sup>143</sup> Aplikimi i Rumanisë për tu futur në OKB u miratua nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e 14 dhjetorit 1955 me rezolutën 995 (X). Qendra e OKB-së për informacionin hapi një zyrë në Rumani në vitin 1970. OKB-ja përfaqësohet në Rumani nga 11 fonde, programe dhe agjenci të specializuara. Detajet gjenden në [www.onuinfo.ro](http://www.onuinfo.ro).

problemeve ndërkombëtare dhe të promovojë respektin për të drejtat e njeriut; dhe të veprojë si një qendër për harmonizimin e veprimeve të shteteve individuale.

Çështja e korrupsionit dhe integritetit trajtohet në instrumentet e mëposhtme të OKB-së:

**a. Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit (1979)<sup>144</sup>('Kodi')**

Kodi aplikohet për të gjithë individët me fuqi policimi, veçanërisht me të drejtë arresti dhe ndalimi. Si i tillë, në Rumani, ai aplikohet për forcat policore, prokurorët, gjyqtarët dhe punonjësit e autoritetit kombëtar penitenciar. Secili nen shoqërohet me komente zyrtare. Tetë nene parashikojnë se agjenti duhet 1) të ushtrojë pushtetet në përfitim të komunitetit dhe të mbrojë individët nga aktet e paligjshme, 2) të respektojë të drejtat e njeriut, 3) të përdorë forcën vetëm kur është e domosdoshme, 4) të mos zbulojë informacionin që marrin, 5) të mos iniciojë ose të tolerojë aktet e torturës ose të mizorisë, 6) duhet të sigurojë shëndetin e individëve të ndaluar, 7) nuk duhet të kryejë aktet e korrupsionit dhe duhet të rezistojë dhe t'i kundërshtojë këto akte dhe 8) duhet t'i bindet ligjit dhe Kodit dhe të parandalojë dhe të luftojë kundër shkeljes së tyre.

Zbatimi i Kodit inkurajohet nga '*Udhëzimet për Implementimin Efektiv të Kodit të Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit*' (1989)<sup>145</sup>. Udhëzimet rekomandojnë se i duhet dhënë rëndësi më e madhe përzgjedhjes, trajnimit dhe edukimit të zyrtarëve; pagesa dhe standardet e punës duhet të jenë të përshtatshme; duhet të ekzistojë një mekanizëm disiplinor i brendshëm dhe një monitorim i jashtëm; dhe publiku duhet të informohet për mekanizmin për të depozituar ankesa kundër zyrtarëve. Për implementimin kombëtar, sugjerimet përfshijnë përkthimin e udhëzimeve dhe transpozimin në legjislacionin kombëtar, komunikimin e Kodit dhe dispozitave të lidhura me të nëpunësve civilë dhe publikut, organizimin e simpoziumeve për rolin dhe kompetencat e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e krimit.

**b. Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Zyrtarët Publikë (1996)<sup>146</sup>.**

Me këtë Kod, OKB e deklaroi korrupsionin si një problem që ndikon në stabilitetin dhe sigurinë e qytetarëve, që ndikon tek demokracia dhe morali, dhe që pengon zhvillimin ekonomik, social dhe politik. Korrupsioni bëhet një fenomen me pasoja ndërkombëtare dhe lidhet me krimin e organizuar dhe krimet ekonomike. Kodi rekomandohet për përdorim si instrument në luftën e shteteve kundër korrupsionit.

Udhëzimet së pari përkufizojnë *parimet e përgjithshme*. Në lidhje me zyrtarët publikë, ato duhet të punojnë vetëm për interesin publik; të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive, efikase dhe të paanshme; të menaxhojnë siç duhet burimet publike; dhe të jenë përgjegjës, të paanshëm dhe të drejtë në marrëdhëniet e tyre me publikun. Më tej, udhëzimet trajtojnë *konfliktin e interesave dhe papajtueshmëritë*: zyrtarët

<sup>144</sup> *Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit* miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social me Rezolutën 36/169 të 17 dhjetorit 1979. "Zyrtarë të zbatimit të ligjit" janë të individët me fuqi policimi, veçanërisht ata që kanë të drejtë arrestimi e ndalimi. Kodi gjendet në [www2.ohchr.org/english/law/codeofconduct.htm](http://www2.ohchr.org/english/law/codeofconduct.htm).

<sup>145</sup> *Udhëzimet për Implementimin Efektiv të Kodit të Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit* (1989). Miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social me Rezolutën 1989/61, gjendet në <http://tinyurl.com/ghidcondoficiali>.

<sup>146</sup> *Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Zyrtarët Publikë* u miratua me rezolutën 51/59 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB më 12 dhjetor 1996, gjendet në [www.un.org/documents/ga/res/51/a51r059.htm](http://www.un.org/documents/ga/res/51/a51r059.htm). Me 'zyrtarë publikë' Kodi do të thotë individët që mbajnë pozicionet publike.

publikë nuk mund të përdorin pozicionin e tyre në mënyrë që të marrin përfitime të padrejta në interesin e tyre personal ose financiar ose të familjeve të tyre, as edhe pasi të jenë larguar nga detyra; ata nuk mund të përfshihen në tregti, marrëdhënie financiare ose të tjera, të cilat janë të papërputhshme me pozicionin e tyre; ata duhet të deklarojnë këto interesa dhe marrëdhënie, dhe të marrin masa për të eliminuar ose reduktuar këto konflikte interesi; ata nuk mund t'i përdorin paratë publike, asetet publike apo informacionin e fituar gjatë punës së tyre për aktivitete që nuk lidhen me punën e tyre.

Pjesa e fundit rregullon *detyrimet dhe ndalimet* për zyrtarët publikë: detyrimi për të deklaruar asetet dhe borxhet e tyre; ndalimin e kërimit ose marrjes direkt ose indirekt të dhuratave ose përfitimeve të tjera që mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave të tyre, performancën ose aftësinë e tyre për të marrë vendim; detyrimin për të ruajtur informacionin konfidencial, edhe pasi largohen nga pozicioni; paralajmërimin se ushtrimi i aktiviteteve politike ose aktivitete të tjera publike nuk duhet të minojë besimin publik në ushtrimin e paanshëm të detyrave të tyre.

### **c. Programi global kundër korrupsionit (1999)<sup>147</sup>**

Programi u hartua nga qendra për parandalimin e krimit ndërkombëtar brenda UNODC<sup>148</sup> me synimin për të asistuar shtetet anëtare në përpjekjet e tyre për të frenuar korrupsionin.

Programi përbëhet nga dy pjesë: një komponent kërkimi dhe një komponent bashkëpunimi teknik. *Komponenti i Kërimit* përfshin një studim global dhe krahasues të korrupsionit dhe të llojeve të masave të antikorrupsionit. Studimi fokusohet në tre tipe të korrupsionit: 1) korrupsioni i përditshëm dhe i administratës publike, 2) korrupsioni në mjedisin e biznesit dhe 3) korrupsioni në nivelin e lartë në qendrat e pushtetit politik, administrativ dhe financiar. Studimi do të ndihmojë për të mbledhur disa tregues për tendencat e korrupsionit dhe për tendencat efikase antikorrupsion. Rezultatet e këtij studimi do të përfshihen në një bazë të dhënash ndërkombëtare, që arrihet me mjete elektronike dhe që disponohet nga shtetet anëtare dhe nga komuniteti ndërkombëtar. *Komponenti i bashkëpunimit teknik* synon të asistojë shtetet anëtare për të ndërtuar dhe forcuar kapacitetin e tyre institucional për të parandaluar, identifikuar dhe luftuar kundër korrupsionit. Janë krijuar masat për nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Në Programin Global, deri tani janë arritur sa më poshtë:

- *Grupi Ndërkombëtar për Koordinimin Antikorrupsion (IGAC)*<sup>149</sup> është organizuar me synimin për të lehtësuar koordinim dhe bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim që të shmangen aktivitetet e mbivendosura dhe për të siguruar një përdorim efikas dhe efektiv të burimeve tashmë ekzistuese në nivele kombëtare dhe rajonale. IGAC ofron një platformë për shkëmbimin e pikëpamjeve, informacionit, përvojës dhe praktikave të mira në lidhje me aktivitetet kundër korrupsionit;

- *Manuali i OKB-së për Masat Praktike Antikorrupsion për Prokurorët dhe Hetuesit* (2004)<sup>150</sup>, është përpiluar, përfshin një përshkrim të të gjithë problemeve dhe

<sup>147</sup> Gjetet në [www.unodc.org/pdf/crime/corruption\\_programme.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption_programme.pdf).

<sup>148</sup> Faqja e internetit, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin që është e specializuar në çështjet e korrupsionit, është [www.unodc.org/unodc/en/corruption/index.html](http://www.unodc.org/unodc/en/corruption/index.html).

<sup>149</sup> *Grupi Ndërkombëtar për Koordinimin Antikorrupsion (IGAC)* u krijua nga UNODC së bashku me rrjetin GPAC. Anëtarët e IGAC përfshijnë: Këshillin e Evropës, zyrën evropiane kundër mashtrimit (OLAF), Interpolin, Organizatën për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSCE), Transparency International, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankën Botërore, UNODC. Shih [www.igac.net](http://www.igac.net).

<sup>150</sup> Emri original është "The United Nations Handbook on Practical Anti-Corruption



opsioneve që hasin profesionistët e drejtësisë kriminale në çështjet e korrupsionit kombëtar dhe ndërkombëtar;

- *Mjetet Antikorrupsion të OKB-së* (2004)<sup>151</sup>, është hartuar, dhe përfshin disa parime që mund të përdoren si nga ata që përpiqen të integrojnë strategjitë kombëtare antikorrupsion në një kuadër më të gjerë strategjik edhe nga ata që duhet më pas të zhvillojnë dhe të implementojnë çdo parim. Mjetet përfshijnë gjithashtu edhe studime çështjesh që ofrojnë shembuj të masave praktike për zgjidhjet e propozuara;

- *Përmbledhje e Instrumenteve Ligjore për Korrupsionin*<sup>152</sup> (2003, ribotuar në 2005) është hartuar dhe përfshin të gjitha traktatet, konventat, marrëveshjet, rezolutat dhe instrumentet e tjera globale dhe rajonale në këtë fushë. Ajo përfshin si dokumente detyruese për shtetet edhe dokumente që përcaktojnë standarde jo të detyrueshme;

- *Manuali i OKB-së për Politikën Antikorrupsion* (2001)<sup>153</sup> është hartuar dhe shpjegon aspektet e përgjithshme në lidhje me natyrën dhe gamën e problemeve që lidhen me korrupsionin dhe përshkrimin e politikave kryesore antikorrupsion, të cilat mund të përdoren nga politikanët dhe politikëbërësit publikë.

Ia vlen të përmendim gjithashtu dhe hartimin e *Përmbledhjes së Standardeve dhe Normave në Parandalimin e Krimin dhe Drejtësinë Kriminale* (1992, ribotuar në 2006)<sup>154</sup> nga Komisioni për Parandalimin e Drejtësinë Kriminale brenda ECOSOC. Pjesa e katërt e këtij punimi përshkruan instrumentet ndërkombëtare të OKB-së në lidhje me qeverisjen e mirë, *Pavarësinë e Drejtësisë dhe Integritetin e Personelit Gjyqësor*<sup>155</sup>.

Së fund, përmendim përmbledhjen e të *Drejtave të Njeriut: Përmbledhje e Instrumenteve Ndërkombëtare, botuar nga zyra e OKB-së e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut*, Volumi 1 i të cilës përfshin Kapitullin J, me titullin "*Të Drejtat e Njeriut në Administratën e Drejtësisë: mbrojtja e personave që ju nënshtrohen ndalimit ose burgosjes*"<sup>156</sup>

---

Measures for Prosecutors and Investigators", gjendet në [www.unodc.org/pdf/crime/corruption/Handbook.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/Handbook.pdf).

<sup>151</sup> Emri origjinal është "The United Nations Anti-Corruption Toolkit", gjendet në [www.unodc.org/pdf/crime/corruption/toolkit/corruption\\_un\\_anti\\_corruption\\_toolkit\\_sep04.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/toolkit/corruption_un_anti_corruption_toolkit_sep04.pdf).

<sup>152</sup> Emri në original është "Compendium of International legal instruments on Corruption", gjendet në [www.unodc.org/pdf/corruption/publications\\_compendium\\_e.pdf](http://www.unodc.org/pdf/corruption/publications_compendium_e.pdf).

<sup>153</sup> "The United Nations Manual on Anti-Corruption Policies", në [www.unodc.org/pdf/crime/gpacpublications/manual.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/gpacpublications/manual.pdf).

<sup>154</sup> Përmbledhja përfshin 55 instrumente të OKB-së, të grupuara në katër pjesë: I. Personat në burg, sanksionet pa burg, drejtësia për të miturit, drejtësia restauruese; II. Rregullimet ligjore, institucionale dhe praktike për bashkëpunimin ndërkombëtar; III. Parandalimi i krimit dhe çështje të viktimës; IV. Qeverisja e mirë, pavarësia e gjyqësorit dhe integriteti i personelit të drejtësisë kriminale. Gjenden të plota në [www.unodc.org/unodc/en/justice-and-prison-reform/compendium.html](http://www.unodc.org/unodc/en/justice-and-prison-reform/compendium.html).

<sup>155</sup> [www.unodc.org/pdf/compendium/compendium\\_2006\\_part\\_04\\_01.pdf](http://www.unodc.org/pdf/compendium/compendium_2006_part_04_01.pdf). Specifikisht, këto janë: Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (1979), Udhëzimet për Implementimin Efektiv të Këtij Kodi (1989), Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës Dhe Armëve Të Zjarrit Nga Personeli I Zbatimit të Ligjit (1990), Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), Procedurat për Implementimin Efektiv të Këtyre Parimeve (1989), Parimet Bazë për Rolin e Avokatëve (1990), Udhëzimet për Rolin e Prokurorëve (1990), Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Zyrtarët Publikë (1996), Deklarata e OKB-së Kundër Korrupsionit dhe Mitës në Transaksione Tregtare dhe Ndërkombëtare (1996).

<sup>156</sup> Gjendet në [www.ohchr.org/Documents/Publications/Compilation1.1en.pdf](http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Compilation1.1en.pdf). Ajo përfshin 22 instrumente ndërkombëtare (fq.273-433): Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve (1955), Parimet Bazë për Trajtimin e të Burgosurve (1990), Korpusi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave nën çdo Formë Ndalimi ose Burgosjeje (1988), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria e tyre (1990), Deklaratë për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, jo Humane apo

***d. Deklarata e Vjenës për Krimin dhe Drejtësinë (2000)***<sup>157</sup>

OKB u bën thirrje shteteve që të krijojnë dhe të mbajnë një sistem drejtësie penale të drejtë, etik dhe efikas. Deklarata afirmon vullnetin e shteteve për të forcuar veprimin ndërkombëtar kundër korrupsionit duke krijuar konventa rajonale dhe forume rajonale dhe globale. Këto do të fillonin me Deklaratën e OKB-së Kundër Korrupsionit dhe Mitës në Transaksionet Tregtare Kombëtare dhe Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes për Zyrtarët Publikë. Deklarata propozon zhvillimin e një instrumenti ligjor ndërkombëtar kundër korrupsionit, i cili do të ishte i pavarur nga Konventa e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

***e. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit (2003)***<sup>158</sup>

Ky dokument gjyqësor ndërkombëtar është traktati i parë ndërkombëtar që trajton drejtpërdrejtë korrupsionin. Hartimi i aktit universal ligjërishit detyrues konfirmon faktin se ky fenomen është i përhapur dhe madje ndodh vendet e zhvilluara. Ai është edhe një provë e faktit se njerëzit po ndërgjegjësohen për nevojën e promovimit të praktikave të drejta si në administratën publike dhe në transaksionet private. Konventa trajton katër fusha: parandalimin, kriminalizimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rikuperimin e aseteve.

*Parandalimi.* Korrupsioni bazohet në sjelljen kriminale, që është dhe arsyeja për se janë parashikuar një numër masash (si për publikun dhe sektorin privat) që synojnë krijimin dhe forcimin e veprimeve parandaluese mbarëkombëtare midis vendeve. Këto përfshijnë politikat parandaluese model, të tilla si krijimi i institucioneve antikorrupsion dhe një transparencë e rritur në financimin e fushatave të zgjedhjeve dhe të partive politike. Ajo inkurajon shtetet që të sigurojnë që shërbimet publike t'i nënshtrohen masave siguruese të efikasitetit, transparencës dhe të punësimit bazuar tek meritat. Duhet të promovohen edhe transparenca dhe përgjegjshmëria në financat publike dhe drejtësi. Parandalimi i korrupsionit publik kërkon një përpjekje nga shoqëria si e tërë, prandaj

---

Degraduese (1975), Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimi dhe Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jo humane apo Degraduese (1984), Protokollit Opsional i kësaj Konventë (2002), Parimet e Etikës Mjekësore që Lidhet me Rolin e Personelit Shëndetësor në Mbrojtjen e të Burgosurve dhe të Ndaluarve Kundër Torturës dhe Ndëshkimit (1982), Parimet për Hetimin Efektiv dhe Dokumentimin e Torturës dhe Ndëshkimit (2000), Masat Mbrojtëse që Garantojnë Mbrojtjen e të Drejtave të atyre që Përballen me Dënimin me Vdekje (1984), Kodi i Sjelljes për Zyrtarët dhe Zbatimit të Ligjit (1979), Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit (1990), Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Masat pa Burgim (Rregullat e Tokios, 1990), Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë së të Miturve (rregullat e Pekinit, 1985), Udhëzime për Veprim për Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Kriminale (1997), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve (udhëzimet e Rijadit, 1990), Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Pushtetin (1985), Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), Parimet Bazë për Rolin e Avokatëve (1990), Parimet për Parandalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve Ekstraligjore, Arbitrare dhe Përmbledhëse (1989), Deklarata për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja e Zbatuar (1992).

<sup>157</sup> *Deklarata e Vjenës për Krimin dhe Drejtësinë: Përballimi i Sfidave të Shekullit Njësht e Një* u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 55/59 të 4 dhjetorit 2000 dhe gjendet së bashku me planin përkatës të veprimit në [www.unodc.org/pdf/compendium/compendium\\_2006\\_part\\_02\\_02.pdf](http://www.unodc.org/pdf/compendium/compendium_2006_part_02_02.pdf).

<sup>158</sup> Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit (njohur edhe si shkresat Merida) u miratua në Nju Jork nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën nr. 58/4 të 31 tetorit 2003. Ajo hyri në fuqi më 14 dhjetor 2005. Deri tani ajo është nënshkruar nga mbi 140 shtete. Ajo u nënshkrua nga Rumania në Merida, Meksikë, më 9 dhjetor 2003 dhe u ratifikua nga Parlamenti i Rumanisë me ligjin nr. 365/15. 09.2004, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 903 të 5 tetorit 2004.

Konventa i bën thirrje shteteve që të angazhojnë organizatat jo qeveritare dhe komponentë të tjerë të shoqërisë civile dhe të përmirësojnë ndjeshmërinë publike për korrupsionin dhe zgjidhjet që lidhen me to.

*Kriminalizimi.* Konventa i inkurajon shtetet që të përkufizojnë veprat penale të korrupsionit dhe llojet e tjera të shkeljeve brenda kësaj sfere, në sektorin publik dhe privat. Në rrethana të caktuara, shtetet janë të detyruara ligjërisht që të përkufizojnë veprat penale, ndërsa në raste të tjera përkufizimi është thjesht fakultativ. Konventa i referohet jo vetëm kriminalizimit të formave bazë të korrupsionit, të tillë si mita dhe keqpërvetësimi i fondeve publike, por edhe tregtimit në influencë, fshehjes dhe 'pastrimit' të korrupsionit. Ka edhe referenca për veprat penale që mbështetin korrupsionin, të tilla si pastrimi i parave dhe pengimi i drejtësisë.

*Bashkëpunimi ndërkombëtar.* Vendet duhet të punojnë së bashku në çdo aspekt që lidhet me luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të kriminelëve. Ata thirren që të identifikojnë format specifike të asistencës gjyqësore reciproke për mbledhjen dhe transferimin e provave midis gjykatave dhe në ekstradimin e kriminelëve. Ata duhet të ndërmarrin hapa për të monitoruar, ngrirë dhe për të marrë në posedim asetet e fituara nëpërmjet veprave penale të korrupsionit.

*Rikuperimi i aseteve.* Ky afirmohet si një parim themelor i Konventës, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në vendet në tranzicion, ku korrupsioni i nivelit të lartë është endemik dhe ku nevojiten burimet për të rindërtuar dhe rehabilituar shoqëritë. Është hera e parë që një dokument rregullon kthimin e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme ose të mbajtura jashtë shtetit, dhe kjo temë përfshihet në strategjinë UNODC për 2008 - 2011<sup>159</sup>.

Zbatimi i Konventës plotësohet nga një *Udhëzues Legjislativ për Implementimin e Konventës së OKB-së kundër korrupsionit (2006)*<sup>160</sup>, hartuar për të promovuar asistencën ndaj ligjvënësve dhe politikëbërësve në vendet që synojnë të ratifikojnë dhe implementojnë Konventën në legjislacionin e tyre.

Nënshkrimi i Konventës mbështetet nga *Shoqata Ndërkombëtare e Autoriteteve Kundër Korrupsionit (IAACA)*<sup>161</sup>, iniciuar në Merida në vitin 2003 dhe realizuar në vitin 2006 nga përfaqësuesit e autoriteteve kombëtare kundër korrupsionit dhe organizatave përkatëse ndërkombëtare. Rumania është anëtar themelues i IAACA, ku përfaqësohet nga Prokurori i saj i Përgjithshëm.

Shoqata organizoi dy konferenca ku u miratuan deklaratat. Deklarata e parë, e bërë në Pekin në vitin 2006, njohu mungesën e metodave shkencore për të matur korrupsionin, dhe të dhënat objektive se përse ndodh dhe indikimin e tij. Kjo deklaratë i shtyn shtetet anëtare të marrin praktikatat që kanë qenë të suksesshme në vendet e tjera. Deklarata e dytë, e bërë në Bali në vitin 2007, thekson nevojën për të parandaluar korrupsionin; për pavarësinë, financimin adekuat, stafin adekuat dhe kompetent të autoriteteve antikorrupsion; promovimin e pavarësisë dhe integritetit të drejtësisë; dhe shmangien e konflikteve të interesit dhe rregullimin e aksesit ndaj informacionit. Deklarata e Balit njihë përgjegjësinë në ushtrimin e detyrave publike, vlerësimin e rregullt të performancës të autoriteteve antikorrupsion dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të instrumenteve ndërkombëtare dhe praktikave të shteteve të tjera.

---

<sup>159</sup> Programi STAR (rikuperimi i aseteve të vjedhura). Strategjia e UNODC gjendet në [www.unodc.org/documents/about-unodc/strategy-brochure.pdf](http://www.unodc.org/documents/about-unodc/strategy-brochure.pdf).

<sup>160</sup> Udhëzimi gjendet në [www.igac.net/pdf/publications\\_unodc\\_legislative\\_guide\\_e.pdf](http://www.igac.net/pdf/publications_unodc_legislative_guide_e.pdf).

<sup>161</sup> Shoqata Ndërkombëtare e Autoriteteve Kundër Korrupsionit, në [www.iaaca.org](http://www.iaaca.org).

#### ***f. Dita ndërkombëtare kundër korrupsionit***<sup>162</sup>

Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit u hap për nënshkrim nga të gjithë shtetet, midis 9 dhe 11 dhjetorit 2003, në Merida (Meksikë), dhe më vonë në zyrat e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, deri më 9 dhjetor 2005. Sipas rezolutës nr. 58/4 të datës 31 tetor 2003, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vendosi gjithashtu 9 dhjetorin si ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit. Vendimi u morr në mënyrë që të rritet ndjeshmëria për korrupsionin dhe rolin që luan Konventa e OKB-së në luftën dhe parandalimin e këtij fenomeni.

#### ***g. Forcimi i integritetit gjyqësor***<sup>163</sup>: ***Parimet e Bangalorit*** (2001-2007)

OKB beson se një pengesë serioze kundër çdo strategjie antikorrupsion është korrupsioni brenda sistemit gjyqësor dhe fatkeqësisht ai është përhapur në gjykata në shumë vende. OKB ka shqyrtuar tërësisht këtë aspekt dhe ka përpiluar një program për të forcuar integritetin gjyqësor, i cili ka tre objektiva:

- Të përcaktojë konceptin e integritetit gjyqësor dhe të zhvillojë një metodologji me anë të së cilës të futet ajo, pa ndikuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit;
- Të lehtësohet një ambient i sigurt dhe produktiv mësimdhënieje në mënyrë që të reformohen mentalitetet e kryetarëve të gjykatës në të gjithë botën;
- Të rritet ndjeshmëria publike për integritetin gjyqësor dhe të zhvillohet, udhëzohet dhe të monitorohen projektet e asistencës teknike që synojnë të forcojnë integritetin dhe kapacitetin gjyqësor.

Bangalore është një lokalitet në Indi i cili në vitin 2001, me ftesë të OKB-së dhe të Transparency International, mbledhi një grup gjyqtarësh dhe prokurorësh të nivelit të lartë dhe kryetarë gjykatash nga sistemet e së drejtës zakonore (dhe më vonë u konsultuan edhe gjyqtarët e sistemit ligjor civil). Ata formuan *Grupin Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor*, që përpiloi Parimet e Bangalorit për Sjelljen Gjyqësor<sup>164</sup>, i cili është një Kod Sjelljeje që aplikohet për gjyqtarët. Parimet përkatëse u përmirësuan në vitin 2002 në një mbledhje në Hagë, Holandë. Një pikë fillimi në hartimin e Kodit ishte rishikimi i dokumenteve kryesore ndërkombëtare të fushës që ishin përpiluar nga institucionet dhe organizatat në vende të ndryshme. Kodi rregulloi gjashtë vlera: Pavarësinë, Paanshmërinë, Integritetin, Korrektesën, Barazinë, Kompetencën dhe Kujdesin. Sipas rezolutës 2003/43 të 29 prillit 2003, Komisioni i të Drejtave të Njeriut të OKB-së i miratoi këto Parime me rekomandimin që ato duhet të konsiderohen nga shtetet anëtare, organet ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare. Megjithatë, meqenëse OKB e kuptoi se Parimet nuk ishin shumë të njohura, në vitin 2007 ajo bëri bashkë disa ekspertë nga të gjitha shtetet në Vjenë për të hartuar Komentarin mbi Parimet e Bangalorit<sup>165</sup>. Komentet përshkruajnë në detaje sjelljen e dëshiruar të gjyqtarëve - nga mbledhjet private me palët apo avokatët deri tek qëndrimet dhe gjestet që gjyqtarët duhet të adoptojnë në sallën e gjyqit dhe jashtë saj.

#### **h. Fushatat antikorrupsion**

Në 2006-2007, UNODC planifikoi të implementojë një fushatë globale antikorrupsion të titulluar "*Ju mund t'i jepni fund korrupsionit*", që kishte si synim t'i bënte publicitet

<sup>162</sup> Detajet, posterat, spotet audio dhe video në [www.unodc.org/unodc/en/about-unodc/9-December.html](http://www.unodc.org/unodc/en/about-unodc/9-December.html).

<sup>163</sup> [www.unodc.org/unodc/en/corruption/judiciary.html](http://www.unodc.org/unodc/en/corruption/judiciary.html).

<sup>164</sup> Parimet gjenden në rumanisht në [www.inm-lex.ro](http://www.inm-lex.ro).

<sup>165</sup> Që gjendet në [www.unodc.org/documents/corruption/publications\\_unodc\\_commentary-e.pdf](http://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf).

Konventës së OKB-së në dhjetor 2005. Fushata solli një mesazh të qartë për sektorin gjyqësor: "Drejtësia nuk është për t'u shitur". Fushata e UNODC 2007-2008, e titulluar "JO-ja jote ka rëndësi", u planifikua për të mbështetur masat pozitive dhe proaktive për të luftuar kundër korrupsionit. Kjo theksoi nevojën për një sukses global, me promovimin e Konventës së OKB-së si një instrument kyç në luftën kundër korrupsionit<sup>166</sup>.

### **i. Progami i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD)<sup>167</sup>**

PNUD është një rrjet i 135 qendrave kombëtare që ndihmon vendet të krijojnë një mjedis të favorshëm për mbështetjen e zhvillimit njerëzor. Sipas rezolutës A/RES/51/59 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 28 janar 1997, PNUD u autorizua të asistonte vendet në zhvillim në luftën e tyre kundër korrupsionit. Kjo është mënyra se si lindi Programi për Përgjegjshmërinë dhe Transparencën ("PACT"). Në vitin 1998, u miratua një rekomandim politike i PNUD-it i titulluar 'të luftojmë korrupsionin për të përmirësuar qeverisjen'. Në vitin 2001 OKB zhvilloi CONTACT<sup>168</sup>, që ishte një udhëzues për sigurimin e integritetit të një sistemi nëpërmjet vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe të sistemeve antikorrupsion. Në vitin 2004, PNUD përpiloi një '*Notë Praktike Antikorrupsion*'<sup>169</sup> i cili analizonte shkaqet e korrupsionit, efektet e tij në zhvillimin e shoqërisë, elementet e strategjisë për të luftuar kundër tij dhe një përshkrim të programeve të PNUD-it. PNUD-i vazhdoi në vitin 2005 me hartimin e një studimi për institucionet antikorrupsion që nevojiten për të zbatuar politikën ndërkombëtare. Ky mund të përdoret si model për atë se si mund të krijohen institucionet kombëtare antikorrupsion dhe përfshin dispozitat në lidhje me Agjencinë Kombëtare Antikorrupsion, Komisionin Kombëtar Antikorrupsion, Ombudsmanin, Gjykatën e Llogarive, Agjencinë e Nëpunësve Civilë, Prokurorët, Gjykatat; pjesa e dytë i analizonte këto institucione në 14 shtete<sup>170</sup>. Pasi Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit hyri në fuqi më 14 dhjetor 2005, Nota e 2004-ës u zëvendësua nga një dokument i ri, lëshuar në dhjetor 2008 dhe i quajtur "Standardizimi i Antikorrupsionit në Zhvillim: Notë Praktike Antikorrupsion"<sup>171</sup>. PNUD e konsideron korrupsionin si pasojë e mos qeverisjes së mirë. Nota e re përmbante katër pjesë: pjesa e parë paraqet përkufizimin, shkaqet dhe pasojat e korrupsionit; pjesa e dytë përshkruan institucionet përkatëse, komitetet dhe rregullat ndërkombëtare; pjesa e tretë diskuton përfshirjen e PNUD-it në nivel rajonal dhe global; dhe pjesa e katërt përfshin shtojca në lidhje me politikën që synojnë parandalimin, frenimin ose luftën kundër korrupsionit (p.sh., duke siguruar integritetin në miratimin e ligjeve, forcimin e aspektit kriminal, cilësisë së

<sup>166</sup> Fushata përfshinte postera, flamuj, fletëpalosje, dhe reklama televizive në të cilat një oficer policie, anëtar i Komisionit të Zgjedhjeve dhe një oficer policie i doganës refuzojnë mitën që u ofrohet atyre në [www.unodc.org/yournocounts](http://www.unodc.org/yournocounts).

<sup>167</sup> Progami i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, në [www.undp.org](http://www.undp.org). Programi përfshinte 166 vende. PNUDI kishte një zyrë në Rumani që në 1971. Aktualisht implementohet programi i vendit 2005-2009 i cili fokusohet në: qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e decentralizuar; zhvillimin ekonomik dhe social; ndërtimin e një mjedisi të shëndetshëm për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.

<sup>168</sup> CONTACT është shkurtimi për Vlerësimi i Vendit për Përgjegjshmërinë dhe Transparencën. Gjetet në anglisht dhe frengjisht në [www.undp.org/governance/docs/AC\\_guides\\_contact.htm](http://www.undp.org/governance/docs/AC_guides_contact.htm).

<sup>169</sup> *Notë Praktike Antikorrupsion*, cituar më sipër.

<sup>170</sup> PNUD, 'Rregullimi institucional për të luftuar korrupsionin - Studim krahasues', në <http://tinyurl.com/comparativestudy2005>.

<sup>171</sup> Në [www.undp.org/governance/docs/Mainstreaming\\_Anti-Corruption\\_in\\_Development.pdf](http://www.undp.org/governance/docs/Mainstreaming_Anti-Corruption_in_Development.pdf).

shërbimeve publike, transparencës dhe aksesit në informacion, etj.), aktorët (p.sh., parlamentarët, qeveria, autoritetet vendore publike, sistemi i arsimit, drejtësia, agjencia antikorrupsion, masmedia, OJQ-të), promovimi i ATI<sup>172</sup>, paraqitjen e instrumenteve kombëtare dhe rajonale në luftën kundër korrupsionit në disa nivele (p.sh., OKB, në Afrikë, Amerikë, Azi, KiE, BE, OECD), burime të tjera, lidhjet, programet partnere.

Po atë vit, në 2008, u publikua "*Udhëzues Përdoruesi për të Matur Korrupsionin*". Ky u synua si udhëzues për praktikën e mirë për qeveritë, shoqërinë civile dhe zhvilluesit në lidhje me njohjen dhe matjen e korrupsionit<sup>173</sup>. Qëllimet e Kombeve të Bashkuara në lidhje me tregtinë mbështeten nga një rrjet vullnetar ndërkombëtar i quajtur The UN Global Compact<sup>174</sup>. Ky është një rrjet mjedisi biznesi që bashkon aktorët qeveritarë, shoqërinë civile, departamentet e Kombeve të Bashkuara, shoqëritë dhe punonjësit, me qëllimin e madh që të përshtaten operacionet dhe strategjitë e anëtarëve të tij me dhjetë parimet që lidhen me të drejtat e njeriut, punën, mbrojtjen e mjedisit dhe antikorrupsionit. Parimi i fundit, i lidhur me antikorrupsionin, u miratua në 2004: "*Në sektorin e biznesit, duhet të ndërmerren hapa kundër korrupsionit në të gjitha format e tij, duke përfshirë shantazhin dhe mitën*".

#### **j. Banka Botërore**<sup>175</sup>

Është një organizatë që e shikon korrupsionin si pengesën më serioze për zhvillimin social dhe ekonomik sepse ai gërryen sundimin e ligjit dhe dobëson institucionet publike, duke ndikuar mbi popullsinë më të varfër dhe shërbimet publike. Sipas politikës së Bankës Botërore, strategjia antikorrupsion duhet të bazohet në *pesë elementë*: rritjen e përgjegjshmërisë politike, forcimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, ndërtimin e sektorit privat konkurrues, kufizimet institucionale mbi pushtetin dhe përmirësimin e menaxhimit të sektorit publik.

Në lidhje me *kufizimet mbi pushtetin*, organizata deklaron se struktura e institucioneve publike është një mekanizëm i rëndësishëm në fushën e korrupsionit. Kjo nënvizon nevojën për ndarjen e pushteteve dhe përgjegjësi të gjithanshme të mbikëqyrjes, të cilat mund ta ndalojnë dhe penalizojnë abuzimin me pushtetin. Në mënyrë specifike, kjo mund të arrihet nëpërmjet gjyqësorit të pavarur dhe efektiv, legjislacionit antikorrupsion, ndjekjes penale të pavarur dhe zbatimit të ligjit, institucioneve të auditit dhe mbikëqyrjes legjislative.

Banka Botërore është e interesuar për reformën gjyqësore, si në lidhje me gjykatat edhe pushtetin gjyqësor<sup>176</sup> dhe institucione të tjera në sistemin gjyqësor<sup>177</sup>. Ajo ka zhvilluar një *strategji për reformën gjyqësore në antikorrupsion*<sup>178</sup> që shikon tre aspekte: (1) ligjet thelbësore për luftën kundër korrupsionit: ligjet antikorrupsion, aksesit

<sup>172</sup> ATI do të thotë: përgjegjshmëri (në të gjitha format e saj: financiare, administrative, politike dhe sociale), transparencë (lehtësimin e aksesit të qytetarëve ndaj informacionit dhe kuptimin e mekanizmit të vendimmarrjes nga ana e tyre) dhe integritet (përkufizuar si moskorrupsion, që është sinonim i ndershmërisë).

<sup>173</sup> Në [www.undp.org/oslocentre/flagship/users\\_guide\\_measuring\\_corruption.html](http://www.undp.org/oslocentre/flagship/users_guide_measuring_corruption.html).

<sup>174</sup> Detajet tek [www.unglobalcompact.org](http://www.unglobalcompact.org). Rrjeti bashkon shoqëri nga 100 vende. Ai nuk ka përfaqësues në Rumani.

<sup>175</sup> Faqja e Bankës Botërore në internet është [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org). Banka Botërore ka pasur një zyrë në Rumani që në 1992. vendi ynë u bë anëtar i Bankës Botërore në 1972. Seksioni që i kushtohet antikorrupsionit është [www.worldbank.org/corruption](http://www.worldbank.org/corruption).

<sup>176</sup> Materialet gjenden në <http://go.worldbank.org/3023X91SE0>.

<sup>177</sup> Materialet gjenden në <http://go.worldbank.org/HC5BA9D380>.

<sup>178</sup> Materialet gjenden në <http://go.worldbank.org/3X2A5GMIH0>.

ndaj informacionit, dhe kontrolli mbi pushtetin diskrecionar të autoriteteve administrative; (2) roli i gjykatave në luftën kundër korrupsionit; dhe (3) lufta kundër korrupsionit gjyqësor. Në aspektin e fundit, Banka Botërore përmend se besimi i qytetarëve në sistemet gjyqësore kërkon që gjyqtarët, avokatët dhe personeli i gjykatës duhet të ruajnë standardet e larta të moralit. Kjo kërkon masa të shumëllojshme, nga rregullat e përcaktuara qartë të sjelljes dhe programeve të edukimit moral, deri tek procedurat me anë të të cilave zgjidhen ankesat për shkeljet.

## **1.2 Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin**<sup>179</sup>

OECD është institucioni më i rëndësishëm ndërkombëtar që fokusohet në kërkimin ekonomik dhe social. Ajo përdor informacionin dhe statistikat për të ndihmuar shtetet të luftojnë varfërinë nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit financiar dhe promovon qeverisjen e mirë në shërbimet publike. Ajo trajton luftën kundër korrupsionit në nivel shumë disiplinor, një nga dokumentet thelbësore në *Konventë për luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë në transaksionet tregtare ndërkombëtare* (1997), që plotësohet nga një *Komentar* (1997), dhe një *Rekomandim* (1997). Instrumentet që ajo ka zhvilluar për të parandaluar mitën, pretendimet për mitë janë:

### **a. Parimet për menaxhimin e etikës në shërbimin publik** (1998)<sup>180</sup>

Parimet shpallin se standardet etike nuk duhet të jenë me dy kuptime dhe duhet të pasqyrohen në legjislacion. Veç kësaj, punonjësit duhet të kenë akses ndaj udhëzimeve dhe mekanizmave të brendshme për tu konsultuar për etikën; ata duhet të dinë detyrimet e tyre në lidhje me sjelljen e tyre. Ajo trajton gjithashtu politikanët, të cilët duhet të krijojnë kuadrin ligjor për rregullat etike dhe për ndëshkimin e shkeljeve. Ajo promovon transparencën e proceseve të vendimmarrjes dhe krijimin e rregullave të qarta në lidhje me ndërveprimin midis sektorit publik dhe privat. Parimet kërkojnë që menaxherët të demonstrojnë dhe të promovojnë sjelljen etike, të cilat duhet të mbarten tek politikat e menaxhimit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore për të krijuar një mekanizëm të përshtatshëm për rritjen e përgjegjshmërisë para eprorëve dhe publikut dhe për të realizuar procedurat dhe penalitetet për rastet e shkeljeve.

### **a. Udhëzimet për menaxhimin e konfliktit të interesit në shërbimin publik** (2003)<sup>181</sup>:

Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi është që të ndihmojë shtetet anëtare, në nivelin e qeverisjes qendrore për të vlerësuar politikat dhe praktikat e tyre aktuale në lidhje me konfliktet e interesave në marrëdhëniet me zyrtarët publikë - duke përfshirë nëpunësit civilë, punonjësit dhe titullarët e pozicioneve të ndryshme në sektorin publik - të cilët punojnë në sistemin e administratës publike kombëtare. Rekomandimet në udhëzim mund të përdoren edhe në

---

<sup>179</sup> Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin u themelua në 1960, bashkon 30 shtete anëtare dhe ka marrëdhënie me 100 shtete dhe organizata të tjera. Rumania nuk është anëtare e OECD-së, detajet në [www.oecd.org](http://www.oecd.org); sektori antikorrupsion mund të gjendet në [www.oecd.org/corruption](http://www.oecd.org/corruption). G.R. nr. 1607/2004 miraton krijimin dhe operimin e Qendrës Rumune për Informacion dhe Dokumentacion, që ndodhet në ndërtesën e Institutit të Ekonomisë Kombëtare të Akademisë Rumune dhe zyra e OECD-së për Informacion dhe Dokumentacion në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Sajti i saj në internet është ...

<sup>180</sup> Parimet për menaxhimin e etikës në shërbimin publik, u nënshkrua nga Këshilli i OECD-së në rekomandimin e 23 prillit 1998 dhe synojnë të përdoren nga udhëheqësit e institucionit kombëtar. Gjenden në [www.oecd.org/dataoecd/60/13/1899138.pdf](http://www.oecd.org/dataoecd/60/13/1899138.pdf).

<sup>181</sup> Udhëzimi gjendet në rumanisht edhe në [www.oecd.org/dataoecd/13/19/2957377.pdf](http://www.oecd.org/dataoecd/13/19/2957377.pdf).

fusha të tjera qeverisëse, të tilla si niveli nën-kombëtar dhe tek shoqëritë që operojnë me kapital publik.

*Katër parimet* që duhet të respektohen nga punonjësit për të shmangur konfliktet e interesit dhe për të ruajtur besimin publik janë: (1) shërbimi ndaj interesit publik, (2) mbështetja e transparencës dhe hetimit, (3) promovimi i përgjegjësisë individuale dhe shembullit personal, dhe (4) promovimi i kulturës së bashkëpunimit që ka tolerancë zero ndaj konflikteve të interesave.

Udhëzuesi e përcakton '*konfliktin e interesit*' si një rrethanë që përfshin një konflikt midis detyrës së nëpunësit civil para publikut dhe interesave personale. Në këto rrethana, nëpunësi civil ka interesa si individ privat që mund të kenë një impakt negativ në aftësinë e nëpunësit për të plotësuar detyrimet dhe përgjegjësitë zyrtare. I përcaktuar si i tillë, një 'konflikt interesi' ka të njëjtin kuptim si 'konflikti real i interesit'. Një konflikt interesash për këtë arsye mund të jetë aktual ose mund të ketë ekzistuar në një moment në të shkuarën. Në të kundërt, mund të thuhet se ka një konflikt të dukshëm interesi, kur interesat e nëpunësit civil duket se ndikojnë negativisht në aftësinë e nëpunësit për të përmbushur detyrat dhe detyrimet, kur në fakt ato nuk ndikojnë. Një konflikt potencial shfaqet kur një nëpunës civil ka interesa personale që kanë gjasë të gjenerojnë një konflikt interesi, në qoftë se ai nëpunës civil ka kompetenca zyrtare (konfliktuese) në atë fushë të veçantë. Aty ku interesi personal ka ndikuar *faktikisht* në performancën e përshtatshme të detyrave të një nëpunësi civil, rrethana përkatëse duhet të konsiderohet si një rast shkeljeje ose 'keqbërjeje' ose madje si një çështje korrupsioni, më tepër se sa si një 'konflikt interesi'. Me këtë përkufizim, 'interesat personale' nuk kufizohen me interesat financiare ose ekonomike, ose me ato interesa që gjenerojnë një përfitim të drejtpërdrejt personal për nëpunësin civil. Një konflikt interesi mund të lidhet me një aktivitet që përndryshe do të ishte i ligjshëm për personin privat, me lidhjet personale dhe njerëzit që shoqërohet dhe interesat e familjes, kur këto interesa në mënyrë të besueshme mund të supozohen se janë në gjendje që të kenë një impakt negativ nga mënyra se si i kryejnë detyrat nëpunësit civil.

Një rast i veçantë është zgjedhja e një detyre tjetër për një nëpunës civil. Negociata për një punë të ardhshme nga një nëpunës civil, përpara se ai/ajo të heqë dorë nga pozicioni publik, në përgjithësi shihet si një çështje e konfliktit të interesit.

OECD krijoi në 1998 *Rrjetin Antikorrupsion për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore*<sup>182</sup>, i cili përbëhet nga 20 shtete anëtare, duke përfshirë Rumaninë, si një forum rajonal për shkëmbimin e praktikave antikorrupsion, informacionit dhe teknologjisë.

### **1.3 Forumi global për luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjes së integritetit**

Në 1997, duke njohur një rritje të krimit ndërkufitar, Presidenti i SHBA-së kërkoi nga Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shtetit dhe Departamenti i Thesarit që të krijonin një strategji për luftën kundër krimit ndërkombëtar dhe reduktimin e impaktit të tij tek qytetarët amerikanë. Në 1998, u miratua *Strategjia e Parë e Kontrollit të Krimit Ndërkombëtar* nga qeveria e SHBA-së.

Një nga qëllimet e saj ishte që të forconte sundimin e ligjit, i cili kërkonte, para së gjithash, luftën kundër korrupsionit mes institucioneve të zbatimit të ligjit. U vendos që të organizohej edhe një konferencë ndërkombëtare.

Konferenca e parë u titullua "*Forum Global për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Mbrojtjen e Integritetit mes Zyrtarëve të Drejtësisë dhe Sigurisë*" dhe u mbajt më 24-26

---

<sup>182</sup> Rrjeti Antikorrupsion për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, në [www.oecd.org/corruption/acn](http://www.oecd.org/corruption/acn).



shkurt 1999 në Uashington<sup>183</sup>. Të ftuar nga 90 vende u përpoqën që të shqyrtonin shkaqet e korrupsionit dhe se cilat praktika mund të përdreshin për parandalimin dhe luftën ndaj tij. Me këtë rast, pjesëmarrësit përpiluan *Parimet Udhëzuese për Luftën kundër Korrupsionit dhe Mbrojtjen e Integritetit mes Zyrtarëve të Drejtësisë dhe Sigurisë*<sup>184</sup>.

Parimet japin një listë të praktikave për të luftuar korrupsionin dhe sjelljen e pandershme dhe joetike, bazuar në dokumentet ndërkombëtare të hartuara nga institucione të tjera dhe me përvojën e pjesëmarrësve në Forum:

1. Të krijojnë dhe mbajnë sisteme qeverisjeje që punësojnë zyrtarë të drejtësisë dhe sigurisë, të cilët të sigurojnë qenien të hapur, barazinë dhe efikasitetin dhe të promovojnë punësimin e individëve të niveleve më të larta të kompetencës dhe integritetit.
2. Të miratojnë masa të menaxhimit publik që promovojnë dhe ruajnë në mënyrë pohuese integritetin e drejtësisë dhe zyrtarëve të sigurisë.
3. Të krijojnë kode etike dhe administrative të sjelljes që dënojnë konfliktet e interesit, sigurojnë përdorimin e duhur të burimeve publike dhe promovojnë nivelet më të larta të profesionalizmit dhe integritetit.
4. Të krijojnë ligjet penale dhe sanksionet që ndalojnë efektisht mitën, keqpërdorimin e pasurisë publike dhe përdorimet e tjera të padrejta të detyrave publike për fitime private.
5. Të miratohen ligje, praktika menaxhimi dhe procedura auditimi që e bëjnë korrupsionin më të dukshëm dhe për këtë arsye promovojnë zbulimin dhe raportimin e aktivitetit korruptiv.
6. T'u jepen hetuesve dhe prokurorëve penalë kompetenca dhe burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zbuluar efektisht e për të ndjekur penalisht krimet e korrupsionit.
7. Të sigurohet që hetuesit, prokurorët dhe personeli gjyqësor të jenë të paanshëm në mënyrë të mjaftueshme për të zbatuar ligjet kundër korrupsionit në mënyrë të drejtë dhe efektive.
8. Të sigurohet që ligji penal dhe civil të parashikojë sanksionet dhe rregullimet e mjaftueshme për të penguar aktivitetin korruptiv efektisht dhe në mënyrën e duhur.
9. Të sigurohet që publiku i gjerë dhe media të kenë lirinë për të marrë dhe për të kaluar informacion mbi çështjet e korrupsionit, duke ju nënshtruar vetëm kufizimeve dhe limitimeve që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
10. Të zhvillohet në masën më të gjerë të mundshme bashkëpunimi ndërkombëtar në të gjitha fushat e luftës kundër korrupsionit.
11. Të promovohet, inkurajohet dhe mbështetet kërkimi i vazhduar dhe diskutimi publik në të gjitha aspektet e çështjes së ruajtjes së integritetit dhe parandalimit të korrupsionit mes zyrtarëve të drejtësisë dhe sigurisë dhe zyrtarëve të tjerë publikë përgjegjës të cilëve lidhen me ruajtjen e sundimit të ligjit.
12. Të inkurajohen aktivitete të organizatave rajonale dhe të organizatave të tjera shumëpalëshe në përpjekjet kundër korrupsionit.

Forumi i dytë Global u mbajt në Hagë midis 28 dhe 31 majit 2001 dhe u fokusua në *'Kapërcimin e korrupsionit nëpërmjet integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë'*<sup>185</sup>. Morën pjesë 142 shtete dhe organizata. Sipas Deklaratës Përfundimtare, qëllimi i konferencës ishte që të parandalohet dhe luftohet korrupsioni

<sup>183</sup> Dokumentet e forumit në [www.state.gov/www/global/narcotics\\_law/global\\_forum/appendix2.html](http://www.state.gov/www/global/narcotics_law/global_forum/appendix2.html). Rumania u përfaqësua nga zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Administratës dhe të Brendshme, Shërbimi Informativ i Rumanisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.

<sup>184</sup> 'Zyrtarë të drejtësisë dhe sigurisë' përfshinte të gjithë ata që luajnë një rol kyç në ruajtjen e sundimit të ligjit (p.sh., policia, policia kufitare, personeli ushtarak, prokurorët, gjyqtarët).

<sup>185</sup> Dokumentet e Forumit në [www.worldbank.org/wbi/governance/events/gf2hague.html](http://www.worldbank.org/wbi/governance/events/gf2hague.html).

duke promovuar integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë. Përfshirja e shoqërisë civile, e sektorit publik dhe masmedias në luftën kundër korrupsionit u konsiderua si i domosdoshëm.

Forumi i tretë Global për luftën kundër korrupsionit u organizua në Seul midis 28 dhe 31 maj dhe u quajt '*Sfida të Rritura, Përgjegjësi të Përbashkëta*'<sup>186</sup>. Deklarata Përfundimtare përfshinte një paraqitje të problemeve aktuale dhe të planit të veprimit që përmbante parimet e përgjithshme dhe masat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai konstatoi se korrupsioni duhet të trajtohet në një mënyrë holistike, duke përfshirë të gjithë segmentet e shoqërisë. Në nivel kombëtar, duhet të bëhen propozime për të forcuar pavarësinë dhe integritetin gjyqësor, integritetin dhe efektivitetin e aktorëve të policisë, promovimin e qeverisjes së mirë, transparencës, përgjegjshmërinë, integritetin dhe etikën në të gjitha segmentet e shoqërisë. Nga ana e tyre, këto propozime mbështetën masmedian dhe shoqërinë civile në zbulimin e korrupsionit.

Forumi i katërt Global u zhvillua në 7-10 qershor në 2005 në Brazili, Brazil dhe u titullua '*Nga Fjalët tek Veprimi*'<sup>187</sup>. Konkluzionet e Konferencës ishin rëndësia e nënshkrimit dhe implementimit të Konventës të OKB-së kundër korrupsionit, nevoja për përmirësim të vazhdueshëm dhe forcimin e mekanizmave shtesë në lidhje me Konventat ndërkombëtare ekzistuese për korrupsionin, mbështetje për qeveritë pjesëmarrëse në promovimin e bashkëpunimit në ekstradim, asistencën ndërgjyqësore në rikuperimin dhe kthimin e asetëve të vëna nëpërmjet krimit, si dhe implementimin e konkluzioneve të Forumeve të mbajtura deri në atë moment.

Forumi i pestë Global, mbajtur nga 2-5 prill 2007 në Johaneshburg, Afrika e Jugut, u quajt '*Mbajtja e Zotimeve: Veprim Efektiv kundër Korrupsionit*'<sup>188</sup>. Temat e trajtuara gjatë kësaj konference ishin si më poshtë: veprim konsolidues duke pasur parasysh implementimin e masave antikorrupsion: zbatimi i ligjit: masat operuese, praktike dhe efektive dhe legjislacioni për zbatimin e ligjit që synon luftën kundër korrupsionit; krimi i organizuar, veçanërisht pastrimi i parave; dhe veprimi parandalues nëpërmjet sistemit kombëtar të integruar.

**1.4 INTERPOL**, organizata më e madhe policore ndërkombëtare<sup>189</sup>, merret me gjashtë fusha të krimit: drogat dhe organizatat kriminale, sigurinë publike dhe terrorizmin, krimin financiar dhe të teknologjisë së lartë, trafikimin e qenieve njerëzore, të arratisurit dhe korrupsionin.

Në *Deklaratën e tij të Seulit (1999)*<sup>190</sup>, INTERPOLI paralajmëron se një oficer i korruptuar i zbatimit të ligjit minon besimin e publikut tek shteti në përgjithësi dhe në shërbimin publik dhe në zbatimin e ligjit në veçanti. Ai deklaroi se një përparësi kryesore e vendeve anëtare është të sigurojnë që zbatimi i ligjit të jetë i lirë nga korrupsioni, dhe që programi kombëtar i integritetit të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm: luftën kundër korrupsionit nëpërmjet edukimit dhe parandalimit, hetimit dhe marrëdhënieve publike; nevoja për një kod sjelljeje dhe një kod të etikës për punonjësit e policisë; një proces punësimi që do të përfshinte teste integriteti; vazhdimin e trajnimit për të gjithë punonjësit, me vëmendje të veçantë tek etika

<sup>186</sup> Dokumentet e Forumit në [www.worldbank.org/wbi/governance/pdf/gf3\\_finaldec.pdf](http://www.worldbank.org/wbi/governance/pdf/gf3_finaldec.pdf).

<sup>187</sup> Dokumentet e Forumit në [www.cgu.gov.br/ivforumglobal](http://www.cgu.gov.br/ivforumglobal).

<sup>188</sup> Dokumentet e Forumit në [www.globalforum5.gov.za](http://www.globalforum5.gov.za).

<sup>189</sup> INTERPOLI u krijua në 1923 për të lehtësuar bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Ai ka 186 vende anëtare, duke përfshirë Rumaninë. Detajet në [www.interpol.int](http://www.interpol.int).

<sup>190</sup> Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOLIT nr. 4 në sesionin e 68, 8-12 nëntor 1999, në [www.interpol.int/Public/ICPO/GeneralAssembly/AGN68/Resolutions/AGN68RES4.asp](http://www.interpol.int/Public/ICPO/GeneralAssembly/AGN68/Resolutions/AGN68RES4.asp).

dhe integriteti; përfshirja e strukturave të menaxhimit në iniciativat antikorrupsion dhe shpërblimin adekuat të zyrtarëve të zbatimit të ligjit në mënyrë që ata të mund të përballojnë një standard jetese siç duhet. Në 1998, u krijua *Grupi i Ekspertëve për Korrupsionin* i INTERPOLIT (IGEC)<sup>191</sup> dhe në vjeshtën e 2009-ës u themelua gjithashtu Zyra Antikorrupsion e INTERPOLIT (IACO) dhe Akademia Antikorrupsion e INTERPOLIT (IACA). Këto ndarje mbështetin standardin dhe politikëbërjen si dhe udhëzimin dhe asistencën nëpërmjet arsimit, kërkimit, trajnimit, hetimit dhe operacioneve për rikuperimin e aseteve. IGEC ka miratuar tre instrumente kyçe për sektorin e policisë që diskutojmë:

- ***Kodi i Sjelljes për Oficerët e Zbatimit të Ligjit*** (1999): ai përmban dhjetë parimet e mëposhtme:

- 1) Ndershmëria dhe integriteti;
- 2) Drejtësia dhe toleranca;
- 3) Përdorimi i forcës dhe abuzimi i autoritetit;
- 4) Performanca e detyrave;
- 5) Urdhrat e ligjshëm;
- 6) Mos publikimi;
- 7) Dëmtimi;
- 8) Paraqitja;
- 9) Sjellja e përgjithshme; dhe
- 10) Bashkëpunimi dhe partneritetet;

- ***Kodi i Etikës për Oficerët e Zbatimit të Ligjit*** (1999)<sup>192</sup>: është një betim që kufizon përdorimin e kompetencave të zbatimit të ligjit vetëm për përfitimin e njerëzve;

- ***Standardet globale për të luftuar korrupsionin në forcat policore*** (2002)<sup>193</sup>: përbëhet nga parimet dhe masat që synojnë ta bëjnë luftën kundër korrupsionit më efikase. Ai thekson ndershmërinë, etikën dhe kompetencat profesionale të punonjësve të policisë.

## 2. Instrumentet e Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës (KiE) është organizata më e vjetër politike në Evropë. E krijuar më 5 maj 1949, Këshilli aktualisht ka 27 shtete evropiane anëtare, përfshirë Rumaninë<sup>194</sup>. Qëllimi kryesor i KiE është të forcojë qasjen e unifikuar të shteteve anëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe sundimin e ligjit, parime të cilat mbështetin demokracitë e vërteta dhe ndikimin në jetën e të gjithë evropianëve. Organet vendimmarrëse të KiE janë Asambleja Parlamentare dhe Komiteti i Ministrave.

Nga pikëpamja e KiE, *lufta kundër korrupsionit* mbështetet në tre elemente:

1) hartimin i rregullave dhe standardeve evropiane, 2) monitorimi i implementimit të tyre, dhe 3) programet e bashkëpunimit teknik që u jepen shteteve anëtare.

Instrumentet kryesore në luftën kundër korrupsionit janë:

### 2.1 Në Asamblenë Parlamentare:

a) ***Rezoluta 1214 (2000) për Rolin e Parlamenteve në Luftën kundër Korrupsionit***<sup>195</sup>: deklaron se parlamentarët duhet të japin shembullin për pakorruptueshmërinë, duhet të sigurojnë transparencën e institucioneve, të deklarojnë interesat financiare të tyre dhe të familjeve të tyre, të mbrojnë pavarësinë e gjyqësorit

<sup>191</sup> IGEC faqja e tij në [www.interpol.int/Public/Corruption/IGEC](http://www.interpol.int/Public/Corruption/IGEC).

<sup>192</sup> Kodet gjenden në [www.interpol.int/Public/Corruption/IGEC/Codes/Default.asp.conduct](http://www.interpol.int/Public/Corruption/IGEC/Codes/Default.asp.conduct).

<sup>193</sup> Standardet gjenden në [www.interpol.int/Public/Corruption/Standard/Default.asp](http://www.interpol.int/Public/Corruption/Standard/Default.asp).

<sup>194</sup> Rumania e ratifikoi statutin e Këshillit të Evropës me ligjin nr. 64/4.10.1993, botuar në O.J. nr. 238 më 4 tetor 1993. Zyra e Informacionit të KiE në Bukuresht u krijua në vitin 2002. Detajet në [www.coe.ro](http://www.coe.ro).

<sup>195</sup> Roli i Parlamenteve në Luftën kundër Korrupsionit në <http://tinyurl.com/parlcorupt>.

dhe të medias, të miratojnë legjislacionin për mbrojtjen e denoncuesve, dhe të ndihmojnë shoqërinë që të përfshihen në luftën kundër korrupsionit. Në këtë aspekt, anëtarët e parlamentit kanë krijuar GOPAC - Organizata Globale e Parlamentarëve Kundër Korrupsionit<sup>196</sup>.

b) Rezoluta 1492 (2006) për *Varfërinë dhe Luftën kundër Korrupsionit në Shtetet Anëtare në Këshillin e Evropës*<sup>197</sup>: rekomandon thjeshtimin e procedurave burokratike, implementimin e rregullave për deklarimin e pasurisë së nëpunësve civilë, transparencën në shpenzimet publike, paga të përshtatshme, decentralizimin dhe autonominë financiare për autoritetet vendore ose rajonale, futjen e sistemeve të analizës për ankesat për korrupsion, kryerjen e skemave të trajnimit të specializuar për gjyqtarët dhe prokurorët dhe policinë, pavarësi e rritur dhe transparenca e gjyqësorit dhe masat administrative kundër punonjësve të korruptuar në sistemin publik dhe privat.

## 2.2 Në *Komitetin e Ministrave*<sup>198</sup>:

a. *Plani i Veprimit Antikorrupsion* (1996), i hartuar nga Grupi Ndërdisciplinor kundër Korrupsionit, u miratua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në përgjigje të rekomandimeve të konferencës së 19 të Ministrave të Drejtësisë të Evropës mbajtur në La Valetta në 1994.

b. *Njëzet Parimet Udhëzuese për Luftën kundër Korrupsionit* (1997), miratuar me Rezolutën (97) 24<sup>199</sup>, fton vendet anëtare që t'i përfshijnë këto parime në legjislacionin dhe praktikën e tyre kombëtare, dhe e udhëzon Grupin Ndërdisciplinor Kundër Korrupsionit që të hartojë një instrument për monitorimin e implementimit të këtyre parimeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare të miratuara.

20 parimet janë:

1. Të merren masa efektive për parandalimin e korrupsionit dhe në këtë drejtim, të rritet ndjeshmëria e publikut dhe të promovohet sjellja etike;
2. Të sigurohet kriminalizimi i koordinuar i korrupsionit kombëtar dhe ndërkombëtar;
3. Të sigurohet që ata që janë të ngarkuar për parandalimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të korrupsionit të gëzojnë pavarësinë dhe autonominë e përshtatshme për funksionet e tyre, të mos kenë ndikim të padrejtë dhe të kenë mjetet efektive për mbledhjen e provave, duke mbrojtur personat që ndihmojnë autoritetet në luftën kundër korrupsionit dhe ruajtjen e konfidencialitetit të hetimeve;
4. Të merren masat e duhura për kapjen dhe heqjen e të ardhurave nga krimet e korrupsionit;
5. Të merren masat e duhura për parandalimin e përdorimit të personave juridikë për të mbuluar veprat penale të korrupsionit;
6. Të kufizohet imuniteti nga hetimi, ndjekja penale ose gjykimi i veprave penale të korrupsionit deri në masën e nevojshme në një shoqëri demokratike;

---

<sup>196</sup> Organizata Globale e Parlamentarëve Kundër Korrupsionit (GOPAC), <http://gopacnetwork.org>.

<sup>197</sup> Varfërinë dhe Luftën kundër Korrupsionit në Shtetet Anëtare në Këshillin e Evropës <http://tinyurl.com/coecorrupt>.

<sup>198</sup> Konkluzionet e Komitetit të Ministrave mund të formulohen, nëse është e nevojshme, si rekomandime për qeveritë kombëtare. Komiteti mund të ftojë qeveritë anëtare për tu komunikuar masat e marra në përgjigje të këtij rekomandimi, (neni 15(b.2) në Statutin e Këshillit të Evropës, nënshkruar në Londër më 5 maj 1949, dhe që hyn në fuqi më 3 gusht 1949).

<sup>199</sup> Gjendet në [www.coe.int/greco](http://www.coe.int/greco).

7. Të promovohet specializimi i personave ose organeve të ngarkuar për luftën kundër korrupsionit dhe t'u jepen atyre mjetet dhe trajnimi i duhur për të kryer detyrat e tyre;
8. Të sigurohet që legjislacioni fiskal dhe autoritetet e ngarkuara për të implementuar atë të kontribuojnë për luftën kundër korrupsionit në mënyrë efektive dhe të koordinuar, veçanërisht duke mohuar zbritjen e taksave, sipas ligjit ose në praktikë, për mitë ose shpenzime të tjera të lidhura me veprat penale të korrupsionit;
9. Të sigurohet që organizata, funksionimi dhe proceset vendimmarrëse të administratave publike të marrin parasysh nevojën për të luftuar korrupsionin, në veçanti duke siguruar sa më shumë transparencë që përputhet me nevojën për ta rritur efektivitetin;
10. Të sigurohet që rregullat që lidhen me të drejtat dhe detyrat e zyrtarëve publikë të marrin parasysh kërkesat e luftës kundër korrupsionit dhe të garantojnë masat e duhura dhe efektive disiplinore; të promovohet më tej specifikimi i sjelljes së pritur nga zyrtarët publikë me anë të mjeteve të përshtatshme, të tilla si kodet e sjelljes;
11. Të sigurohet që të zbatohen procedurat e duhura të auditimit për aktivitetet e administratës publike dhe të sektorit publik;
12. Të miratohet roli që mund të luajnë procedurat e auditimit në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit jashtë administratave publike;
13. Të sigurohet që sistemi i detyrimit dhe përgjegjshmërisë publike të marrë parasysh pasojat e sjelljes korruptive të zyrtarëve publikë;
14. Të miratohen procedurat transparente siç duhet për prokurimin publik që promovon konkurrencën e ndershme dhe pengon të korruptuarit;
15. Të inkurajohet miratimi, nga përfaqësuesit e zgjedhur të kodeve të sjelljes dhe të promovohen rregullat për financimin e partive politike dhe fushatave të zgjedhjeve, të cilat pengojnë korrupsionin;
16. Të sigurohet që media të ketë lirinë për të marrë dhe për të kaluar informacion për çështjet e korrupsionit, duke ju nënshtruar vetëm kufizimeve dhe limitimeve që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike;
17. Të sigurohet që ligji civil të marrë parasysh nevojën për luftën kundër korrupsionit dhe në veçanti të parashikojë kompensimet për ata të drejtat dhe interesat e të cilëve ndikohen nga korrupsioni;
18. Të inkurajohet kërkimi për korrupsionin;
19. Të sigurohet që në çdo aspekt të luftës kundër korrupsionit të merren parasysh lidhjet e mundshme me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave;
20. Të zhvillohet sa më shumë që të jetë e mundur bashkëpunimi ndërkombëtar në të gjitha fushat e luftës kundër korrupsionit.

**c. Konventa e Ligjit Penal për Korrupsionin**<sup>200</sup> dhe **Konventa e Ligjit Civil për Korrupsionin**<sup>201</sup> u hartuan si pjesë e Planit të Veprimit Antikorrupsion, nga Grupi Ndërdisciplinor Kundër Korrupsionit.

*Konventa e Ligjit Penal për Korrupsionin* (1999) rregullon detyrimin e vende nënshkruese që të miratojnë masa të përshtatshme legjislative për kriminalizuar format e mëposhtme të korrupsionit: (1) korruptimi aktiv dhe pasiv i zyrtarëve publikë kombëtarë dhe të huaj; parlamentarëve kombëtar dhe të huaj; anëtarëve të Asambleve Parlamentare Ndërkombëtare; zyrtarët ndërkombëtarë, gjyqtarët kombëtarë, të huaj, ndërkombëtarë dhe zyrtarët e gjykatave ndërkombëtare; dhe korrupsioni në sektorin privat; (2) tregtimi i influencës; (3) të ardhurat nga pastrimi i parave prej veprave penale të korrupsionit; dhe (4) veprat penale të lidhura me korrupsionin. Konventa parashikoi nevojën e miratimit të

<sup>200</sup> Konventa e Ligjit Penal për Korrupsionin, miratuar në Strasburg më 27 janar 1999, u ratifikua nga Rumania me ligjin nr. 27/16.01.2002, botuar në O.J. nr. 65, datë 30 janar 2002.

<sup>201</sup> Konventa e Ligjit Civil për Korrupsionin, miratuar në Strasburg më 4 nëntor 1999, u ratifikua nga Rumania me ligjin nr. 147/01.04.2002, botuar në O.J. nr. 260, datë 18 prill 2002.

sanksioneve dhe masave efektive, përpjesëtimore dhe penguese, duke përfshirë masat e burgosjes që nënkupton ekstradimin. Ajo parashikoi edhe nevojën për të rregulluar përgjegjësinë penale të enteve ligjore, të cilët duhet t'i nënshtrohen sanksioneve penale ose sanksioneve të tjera. Konventa e Ligjit Civil për Korrupsionin (1999) është dokumenti i parë ndërkombëtar që parashikon rregullat civile për korrupsionin. Ajo i inkurajon shtetet që të miratojnë kompensime efektive për ata që preken nga veprat penale të korrupsionit, duke u mundësuar atyre mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, duke përfshirë mundësinë e marrjes së kompensimit për dëmet. Konventa parashikon gjithashtu detyrimin e shteteve anëtare që të përfshijnë në legjislacionin e tyre kombëtar përgjegjësinë e shtetit për veprat penale të korrupsionit të kryera nga punonjësit e tij, si dhe masat për të mbrojtur punonjësit që zbulojnë shkeljet e korrupsionit. Konventa përmban gjithashtu dispozita në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar të shteteve nënshkruese në proceset civile të lidhura me korrupsionin, veçanërisht në lidhje me njoftimin e dokumenteve, marrjen e provave jashtë shtetit, dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve të lëshuara jashtë shtetit.

**d. Rezoluta (99) 5 për GRECO-n:** Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO) monitoron implementimin e standardeve antikorrupsion të KiE dhe siguron zbatimin e Dispozitave të Konventës në lidhje me korrupsionin<sup>202</sup>. GRECO është një komitet i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare dhe është i hapur për pjesëmarrje të shteteve të tjera që kanë kontribuar në punimet e grupit ndërdisiplinor kundër korrupsionit (SHBA, Kanada, Japoni, Meksikë, Bjellorusi, Gjeorgji dhe Bosnje-Hercegovina). Grupi kryhen vlerësime vjetore mbi të cilat harton raporte konfidenciale që i mundësojnë GRECO-s që të bëjë rekomandime për shtetet anëtare me synimin për të përmirësuar legjislacionin dhe praktikën e tyre kombëtare antikorrupsion.

Konkluzionet e misionit të ekspertëve të GRECO-s në tetor 2001 në Rumani përfshijnë shqetësimet se institucionet e përfshira më seriozisht në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë *policinë* dhe *gjykatat/prokuroritë*, janë gjithashtu më të prekurat nga korrupsioni. Kjo e bën të nevojshme për vendin tonë që t'u përmbahet rekomandimeve specifike të bëra nga misioni.

Në raundin e dytë të vlerësimit, në dhjetor 2007, GRECO analizoi zbatimin nga Rumania të 15 kërkesave të mëparshme. Raporti konkludoi se Rumania kishte bërë *përparje të dukshme* për konfiskimin e aseteve të fituara nëpërmjet korrupsionit në një numër të madh rastesh, në futjen e përgjegjësisë penale të enteve ligjore, në përmirësimin e aksesit publik ndaj dokumenteve zyrtare dhe konsolidimin e shkëmbimit ndërinstitucional të informacionit për entet ligjore. Por dokumenti shënon gjithashtu se kishte një *progres të kufizuar* në lidhje me shumicën e rekomandimeve dhe *aspak progres* në lidhje me rekomandimin e futjes së rregullave të duhura për punësimin dhe karrierën e nëpunësve civilë në përgjithësi, për harmonizimin e rregullave dhe parimeve që lidhen me refuzimin e dhuratave, trajnimin e inspektorëve fiskalë për zbulimin e shkeljeve të mundshme të korrupsionit. GRECO i bën thirrje Rumanisë që të përfshihet me vendosmëri në politikat antikorrupsion që janë hartuar qartësisht për të implementuar plotësisht rekomandimet përkatëse<sup>203</sup>.

**e. Kodi model i sjelljes për zyrtarët publikë:** kodi u miratua me Rekomandimin nr. R (2000) 10 dhe shoqërohet nga një memorandum shpjegues<sup>204</sup>. Shtetet anëtare këshillohen që ta përdorin atë si model kur të hartojnë kodet e sjelljes për zyrtarët e tyre

<sup>202</sup> Në dhjetor 2007, GRECO kishte 46 shtete anëtare (duke përfshirë SHBA) dhe 6 organe ndërkombëtare si vëzhgues. Rumania është anëtar themelues i GRECO-s. Shih [www.coe.int/greco](http://www.coe.int/greco). Ja vlen gjithashtu të përmendim ekzistencën e MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, themeluar në 1997 nga Këshilli i Evropës, [www.coe.int/moneyval](http://www.coe.int/moneyval).

<sup>203</sup> Raporti u miratua më 07.12.2007 dhe gjendet në rumanisht në [www.just.ro](http://www.just.ro).

<sup>204</sup> Kodi dhe shpjegimet gjenden në [www.coe.int/greco](http://www.coe.int/greco).

publik. Kjo kategori përcaktohet se përfshin punonjësit e autoritetit publik, por jo zyrtarët e zgjedhur, anëtarët e qeverisë dhe personelin gjyqësor. Si konkluzion, këto kode zbatohen për gjyqtarët dhe prokurorët kur ata nuk ushtrojnë kompetenca gjyqësore në gjykata (p.sh., kur janë anëtarë të komisioneve të ankandëve, komisioneve të punësimit, komisioneve të vlerësimit), dhe për personelin ndihmës të specializuar në gjykata dhe në prokurori.

Qëllimi i Kodit është që të përcaktojë rregullat e integritetit dhe sjelljes për zyrtarët publikë, t'i ndihmojë ata në zbatimin e rregullave dhe të informojë publikun për sjelljen që ata kanë të drejtë të presin nga zyrtarët publikë.

Kodi përkufizon *konfliktet e interesit* si ato situata ku një zyrtar publik ka interesa private që do të ndikojnë ose do të dukeshin se ndikojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore me paanësi dhe objektivitet. Ky interes privat përfshin çdo avantazh financiar apo avantazh tjetër civil për zyrtarin publik ose familjen e tij, të afërmit e ngushtë, miqtë ose çdo person apo organizatë me të cilët zyrtari publik ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose politike.

Kodi kërkon përputhshmëri me ligjin; mirësjelljen; besnikërinë; kompetencën; paanësinë; shmangien e konflikteve reale, potenciale apo të dukshme të interesit; konfidencialitetin; raportimin e urdhrave ose sjelljeve të paligjshme, jo etike apo kriminale. Kodi i detyron zyrtarët publikë të deklarojnë interesat e tyre, të mos kryejnë aktivitete që janë të papërputhshme me pozicionin e tyre, dhe të përmbushin aktivitetet e tyre publike ose politike në mënyrë që të mos dobësohet besimi në shërbimin publik.

Sipas Kodit, zyrtarët publikë nuk duhet të pranojnë dhurata ose ftesa që mund të ndikojnë në paanësinë e tyre, duhet të refuzojnë dhe të raportojnë përfitimet e padrejta; nuk duhet t'u përgjigjen favoreve me favor; nuk duhet të abuzojnë me pozicionin e tyre në mënyrë që të sigurojnë avantazhe; duhet të sigurojnë që asetet publike të përdoren në mënyrë të dobishme, efektive dhe ekonomike. Kodi kërkon që punëdhënësit të kryejnë kontrolle integriteti në momentin e punësimit, emërimit dhe promovimit; eprorët duhet të përgjigjen për veprimet e punonjësve të tyre, në qoftë se ata nuk kanë marrë masat e duhura dhe marrin masa antikorrupsion të tilla si paralajmërimin për rëndësinë e përputhshmërisë me rregullat dhe rregulloret, duke kryer trajnimin e përshtatshëm antikorrupsion, duke ju kushtuar vëmendje vështirësive financiare dhe vështirësive të tjera që punonjësit mund të hasin, dhe duhet të jenë model i integritetit. Veç këtyre, Kodi këshillon që zyrtarët publikë nuk mund të punësohen në një punë të re në të cilën ata mund të përdorin informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të mëparshme zyrtare, ose në qoftë se ata kanë punuar më parë si zyrtarë publikë në një çështje specifike, e cila tani do t'i jepte avantazh entit që i ka punësuar ata. Përfundimisht Kodi i paralajmëron zyrtarët publikë që të mos bëjnë trajtim preferencial ose të privilegjuar zyrtarëve publikë.

**f. Konkluzionet e Konferencës së pestë Evropiane të Shërbimeve të Specializuara për Luftën Kundër Korrupsionit**, mbajtur më 15-17 nëntor, 2000 në Stamboll, Turqi, e cila u fokusua në "*Investigimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e krimeve të korrupsionit*".

Konkluzionet e Konferencës ishin si më poshtë:

- krijimi i një strategjie dhe bashkëpunimi global midis institucioneve përkatëse është i domosdoshëm; shërbimet publike duhet të operojnë në mënyrë transparente; dhe publiku ka të drejtën të kontrollojë procedurat dhe substancën e vendimeve administrative;
- masmedia duhet të përdoret në fushatat antikorrupsion; publiku duhet të jetë i vëmendshëm dhe të punojë së bashku me autoritetet; studimet për perceptimin publik dhe për perceptimet e përdoruesve të shërbimit publik mund të ndihmojnë për të kuptuar fenomenin;

- drejtësia penale duhet të përcaktojë sanksione efektive, përpjesëtimore dhe penguese për krimet e korrupsionit, të cilat duhet t'u shtohen masave administrative të tilla si pushimet nga puna; hetimi i krimeve të korrupsionit çon gjithashtu në zbulimin e krimeve të tjera, të tilla si falsifikimi ose pastrimi i parave;
- prokurorët duhet të jenë të pavarur dhe policia gjyqësore duhet të funksionojë në mënyrë të pavarur;
- imuniteti i politikanëve duhet të kufizohet tek aktivitetet që lidhen me pozicionin e tyre zyrtar; detyrimi i prokurorëve për të njoftuar autoritetet administrative përpara hetimit ose ndjekjes penale të një zyrtari publik pengon funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor;
- ruajtja e sekretit bankar nuk bie ndesh me prokurorët, natyra sekrete dhe kompleksiteti i krimeve kërkon metoda të veçanta hetimore, të cilat duhet të specifikohen në ligj dhe të përdoren nga punonjës policie shumë të trajnuar, nën mbikëqyrjen e autoritetit gjyqësor;
- personeli i zbatimit të ligjit duhet tu drejtohet shërbimeve të specializuara dhe shkëmbimit të informacionit me institucione të tjera përkatëse;
- agjentët e kamufluar nuk duhet të ngrenë gracka për të dyshuarit që ata të kryejnë krime; njihet rëndësia e informatorëve; punonjësit që kanë informacion për shkeljet e korrupsionit duhet t'i raportojnë ato, dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e gjyqësorit duhet të mbrohen;
- pandëshkueshmëria e plotë për ata që raportojnë një krim korrupsioni që ata vetë kanë kryer duhet të vihet në diskutim, veçanërisht kur raportimi ka ndodhur shumë kohë pas faktit ose me rastin e fillimit të menjëhershëm të hetimeve.

**g. OCTOPUS**<sup>205</sup> është programi kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Evropë. Ai filloi në vitin 1996.

- Pjesëmarrësit në Konferencën e vitit 2003 për "Shërbimet e specializuara antikorrupsion: praktikat më të mira evropiane" arritën konkluzionet e mëposhtme:
- shërbimet e specializuara në luftën kundër korrupsionit duhet të përgjigjen për udhëheqjen dhe koordinimin e implementimit të strategjisë kombëtare antikorrupsion;
  - kjo strategji duhet të përfshijë tre elementë: implementimin, parandalimin dhe arsimin; dhe të zbatohen si në sektorin publik edhe atë privat;
  - lufta kundër korrupsionit duhet të përfshijë të gjithë komunitetin;
  - shërbimet e specializuara duhet të jenë kompetente në hetimin e krimeve të korrupsionit por edhe në hetimin e krimeve të lidhura ose të ngjashme me korrupsionin; duhet të hetohet çdo ankesë në lidhje me krimin e korrupsionit;
  - shërbimet administrative antikorrupsion duhet të paraqesin ankesën në departamentet që përgjigjen për hetimin e krimeve dhe të njoftohen për konstatimet;
  - mbështetja dhe besimi publik janë të rrënjësura në pavarësinë dhe autonominë operuese të shërbimeve të specializuara, d.m.th. përgjegjshmëria për punën e tyre, e cila duhet të parashikohet në ligj; aktiviteti i tyre duhet të jetë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut; duhet të sigurohet financimi i duhur; çdo aktivitet duhet të jetë transparent, përjashtuar rastin kur një hetim i veçantë duhet të jetë konfidencial;
  - pajisja me staf e këtyre shërbimeve duhet të bazohet ekskluzivisht tek merita dhe të përfshijë kontrollin e integritetit; personeli duhet të zbatojë kodin e sjelljes;
  - duhet të kryhet trajnim i vazhduar dhe i specializuar me personelin; duhet të matet performanca e shërbimit, rregullisht përkundrejt treguesve cilësor dhe sasior, si dhe përkundrejt perceptimeve publike dhe qëndrimeve publike dhe vlerësimet GRECO mund të përdoren si pikë fillimi.

<sup>205</sup> Një program i bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian. Detajet gjenden në [www.coe.int/cybercrime](http://www.coe.int/cybercrime).



*Konferenca e 2006-ës mbi 'Korrupsionin dhe Demokracinë'* trajtoi katër çështje: financimin e partive politike, lobimin, konfliktin e interesit dhe *korrupsionin, drejtësinë dhe demokracinë*. Në lidhje me konfliktet e interesit, konferenca konkludoi se mund të merren parasysh Udhëzimi i OECD për menaxhimin e konflikteve të interesit në shërbimin publik dhe rekomandimet e GRECO në raundin e dytë të vlerësimit.

Në lidhje me ndikimet e padrejta mbi gjyqësorin, theksi vihet në ndarjen e pushteteve; të gjashtë parimet e sjelljes të përfshira në Parimet e Bangalorit, të cilat shikohen si kritike për udhëzimin e sjelljes së gjyqtarëve; forcimi i pavarësisë së atyre që hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë krimet e korrupsionit; dhe përgjegjshmëria e gjyqësorit para publikut. OCTOPUS njohu se ka pasur ndikime të padrejta, praktika abuzive dhe korruptuese në punësimin dhe promovimin e gjyqtarëve, kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në detyrë, pagat, aktivitetet jashtëgjyqësore, punët e reja, standardet e sjelljes dhe mekanizmi i disiplinës. Ai citoi probleme etike dhe praktika korruptive që ndodhin më shpesh në sistemin e drejtësisë penale; rregullat e sjelljes si një instrument përforcimi e integritetit gjyqësor; deklaratat financiare si instrument për monitorimin e konflikteve të interesit; përfshirjen publike si efektive në hartimin e politikave gjyqësore dhe transparenca si e dobishme në rritjen e aktivitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**h. Kodi i administrimit të mirë**, një shtojcë për Rekomandimin nr. 7 (2007) për mirë administrimin<sup>206</sup>. Rekomandimi e shikon menaxhimin e mirë si një aspekt të qeverisjes së mirë. Menaxhimi i mirë varet nga cilësia e organizatës dhe menaxhimit dhe duhet të plotësojë nevojat e shoqërisë, të ruajë dhe të mbrojë pasurinë publike dhe interesat e tjera publike dhe të përjashtojë të gjitha format e korrupsionit. Vendet anëtare inkurajohen të promovojnë parimin e menaxhimit të mirë nëpërmjet administrimit efikas, efektiv dhe me efektivitet në kosto dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike (treguesit e performancës, inspektimin e rregullt, cilësinë e shërbimeve). Ata inkurajojnë gjithashtu promovimin e të drejtës për menaxhim të mirë për interesin e përgjithshëm, duke miratuar normat e parashtruar në këtë kod.

*Kodi* detajon parimet e ligjshmërisë, barazisë, paanësisë, proporcionalitetit, sigurisë ligjore, duke vepruar brenda një afati kohor të arsyeshëm, pjesëmarrja dhe respektimi i jetës private dhe transparencës. Kodi paraqet statusin e procesit administrativ nga krijimi i tyre deri në implementimin e tyre si dhe mjetet për t'i sfiduar ato dhe kompensimet për dëmet e shkaktuara prej tyre.

**2.3 Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë**<sup>207</sup>. Organi konsultativ në Këshillin e Evropës specializohet në çështjet që lidhen me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjyqtarëve. Ai përbëhet nga një gjyqtar nga çdo shtet anëtar dhe lëshon opinione. Opinioni nr. 3 me titullin "**Parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanësinë**" i përgjigjet tre pyetjeve:

1) "*Cilat standarde sjelljeje duhet të aplikohen për gjyqtarët?*"; 2) "*Si duhet të formulohen standardet e sjelljes?*"; 3) "*Çfarë përgjegjësie penale, civile dhe disiplinore duhet të aplikohet për gjyqtarët?*".

Sipas këtij opinioni, kompetencat që u janë besuar gjyqtarëve janë të lidhura rreptësisht me vlerat e drejtësisë, të vërtetës dhe lirisë. Ai deklaron se standardet e sjelljes që

<sup>206</sup> Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 20.06.2007, <http://tinyurl.com/Rec-2007-7>.

<sup>207</sup> Faqe e internetit e CCEJ [www.coe.int/ccje](http://www.coe.int/ccje). Opinioni nr. 3 gjendet edhe në rumanisht.

aplikohen për gjyqtarët janë pasojë e këtyre vlerave dhe një parakusht për besimin publik në administratën e gjyqtarëve. Prandaj, sipas opinionit gjyqtarët do të ushtrojnë detyrat e tyre pa preferenca, paragjykime dhe parakonceptime dhe do të veprojnë në mënyrë të tillë që të shmangin konfliktet e interesit dhe abuzimit me pushtetit. Gjyqtarët të cilët gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, kryejnë shkelje që do të cilësoheshin si vepra penale në çdo rrethanë (p.sh., pranimi i mitës) nuk mund të përfitojnë nga imuniteti në ligjin e zakonshëm penal.

**2.4 Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë**<sup>208</sup>. Ky është një organ tjetër konsultativ i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Ai u krijua në vitin 2005 për të institucionalizuar takimet e mbajtura më parë në formën e Konferencave të Prokurorëve të Përgjithshëm Evropianë. Një konferencë e tillë, mbajtur në Budapest, miratoi më 31 maj 2005, një "*Udhëzues Evropian për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve*"<sup>209</sup>. Udhëzuesi u rekomandon prokurorëve që të mos kenë preferenca për ndonjë nga palët; të mos i lejojnë interesat personale, familjare apo interesat e tjera që të ndikojnë mbi vendimet e tyre; të mos përdorin informacionin e marrë gjatë detyrave zyrtare në interesin e tyre ose në interes të palëve të treta; ose të mos pranojnë dhurata, avantazhe ose mikpritje nga palë të treta, të cilat mund të ndikojnë në integritetin, paanësinë dhe drejtësinë e tyre.

### 3. Instrumentet e Bashkimit Evropian

Politikat antikorrupsion të BE-së<sup>210</sup> synojnë të krijojnë një qasje të përbashkët evropiane. Instrumentet specifike të BE-së janë:

#### **a. Konventa për mbrojtjen e interesave financiare të komunitetit evropian (1995)**<sup>211</sup>.

Konventa shoqërohet nga një raport shpjegues (1996) dhe u plotësua nga dy Protokolle (1996, 1997), të cilët janë të shoqëruar me raport shpjegues. Këshilli i Bashkimit Evropian i miratoi të gjitha ato. Protokollin i parë u fokusua në përkufizimin e koncepteve të tilla si 'zyrtarë', 'korrupsion aktiv dhe pasiv', dhe në harmonizimin dhe ndëshkimin e krimeve të korrupsionit.

#### **b. Konventa për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komunitetit Evropian apo zyrtarët e Shteteve Anëtare të BE-së**, miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian (1997)<sup>212</sup>.

---

<sup>208</sup> Shih [www.coe.int/ccpe](http://www.coe.int/ccpe).

<sup>209</sup> I njohur gjithashtu si 'Udhëzuesi i Budapestit' gjendet në [www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccpe/conferences/](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccpe/conferences/).

<sup>210</sup> Siç përshkruhen në <http://europa.eu/scadplus/leg/fr/s30004.html>.

<sup>211</sup> Konventa për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit u publikua në Gazetën Zyrtare C 316 të datës 27 nëntor 1995 të hyrë në fuqi më 17 tetor 2002. Gjendet në <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l33019.html>.

<sup>212</sup> Konventa për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komunitetit Evropian apo zyrtarët e Shteteve Anëtare të BE-së u botua në Gazetën Zyrtare nr. 195, datë 25 qershor 1997; në <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l33027.html>.

Konventa shoqërohet nga një memorandum shpjegues (1998). Ai parashikon detyrimin e shteteve anëtare të kriminalizojnë shkeljet e korrupsionit aktiv dhe pasiv, veçanërisht kur kryhen nga parlamentarët, ministrat, gjyqtarët dhe auditorët ose në lidhje me ta gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare. Ajo aplikohet edhe për shkeljet e anëtarëve të Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian, Gjykatës së Drejtësisë Evropiane ose Gjykatës Evropiane të Auditorëve ose në lidhje me ta. Shtetet duhet të ndërmarrin hapa që të ndëshkojnë efektisht krimet e korrupsionit (si dhe shtyrjen për krime korrupsioni ose pjesëmarrje në to), në mënyrë përpjesëtimore dhe me efekt pengues, duke përfshirë edhe sanksionet e burgosjes që çojnë në ekstradim.

***c. Komunikata (2003) 317 nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin Evropian dhe Komitetin Evropian social dhe ekonomik - për një politikë gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit të BE-së<sup>213</sup>.***

Parimet e komunikatës lidhen me angazhimin politik të nivelit të lartë për të luftuar kundër korrupsionit, implementimin nga çdo shtet anëtar të instrumenteve ndërkombëtare antikorrupsion, zhvillimin e instrumenteve të hetimit, caktimin e personelit të specializuar antikorrupsion dhe futjen e standardeve të integritetit. Ajo mbështet gjithashtu vendet kandidatë që të adoptojnë legjislacionin e duhur antikorrupsion, të bëjnë transparent përdorimin e fondeve publike dhe përmirësimin e mjediseve sociale dhe ekonomike. Qëllimi është të reduktohet korrupsioni në të gjitha format e tij dhe në të gjitha nivelet, në vendet dhe institucionet e BE-së si dhe jashtë tyre.

***d. Vendimi Kuadër 2003/568/JHA të datës 22.07.2003 i Këshillit të Bashkimit Evropian për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat<sup>214</sup>.***

Sipas vendimit, korrupsioni aktiv dhe pasiv i kryer nga organizata fitimprurëse ose jo fitimprurëse në sektorin privat duhet të kriminalizohet; dhe entet ligjore gjithashtu duhet të përgjigjen për këto veprime. Limiti i sipërm i sanksionit duhet të jetë të paktën 1-3 vjet burg si dhe një pezullim përkohshëm deri me afat të pacaktuar i të drejtës për të tregtuar.

***e. Zyra evropiane kundër mashtrimit (1999)<sup>215</sup> u krijua për të kryer hetime administrative për mashtrimin, korrupsionin dhe krime të tjera që ndikojnë tek interesat financiare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë shkeljet në institucionet evropiane.***

***f. Vendimi Kuadër i Këshillit 205/212/JAI i 24 shkurtit 2005 për konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, dobitë dhe pasuritë<sup>216</sup>.***

Sipas këtij vendimi, çdo shtet anëtar duhet të marrë masat e domosdoshme për të mundësuar konfiskimin e plotë ose të pjesshëm të instrumenteve dhe produkteve që janë gjeneruar nga një krim i ndëshkueshëm me dënim me burg më shumë se një vit ose asetet e vlerës së krahasueshme me produktet e përfshira.

---

<sup>213</sup> Komunikata (2003) 317 nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin Evropian dhe Komitetin Evropian social dhe ekonomik – për një politikë gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit të BE-së nuk është botuar në gazetën zyrtare; gjendet në <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l33301.html>.

<sup>214</sup> Vendimi Kuadër 2003/568/JHA të datës 22 korrik 2003 i Këshillit të Bashkimit Evropian për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, në Gazetën Zyrtare L102 datë 31 korrik 2003, fq. 54-56, në <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l33308.html>.

<sup>215</sup> OLAF me faqe interneti <http://ec.europa.eu/olaf>.

<sup>216</sup> Botuar në Gazetën Zyrtare L68 e 15 marsit 2005, fq. 49-51.

Prandaj, duhet të implementohen kompetencat *e rritura të konfiskimit*: çdo shtet anëtar do të marrë të paktën masat që nevojiten për t'i mundësuar atij konfiskimin e plotë ose të pjesshëm të pasurisë së një individi të dënuar në rastet e mëposhtme: (a) aty ku një gjykatë kombëtare e bazuar në faktet specifike është e bindur plotësisht se prona në fjalë ka rrjedhur nga aktivitete kriminale të personit të dënuar gjatë një periudhe para dënimit për krimin që u përmend në paragrafin 1, i cili konsiderohet i arsyeshëm nga gjykata në rrethanat e një çështje të veçantë, ose në mënyrë alternative, (b) aty ku gjykata kombëtare bazuar në faktet specifike është plotësisht e bindur se prona në fjalë ka rrjedhur në aktivitete të ngjashme kriminale të personit të dënuar gjatë një periudhe para dënimit për krimin që përmendet në paragrafin 1, i cili konsiderohet i arsyeshëm nga gjykata në rrethanat e një çështjeje të veçantë, ose në mënyrë alternative, (c) aty ku vendoset se vlera e pronës është në përpjesëtim të zhdrejtë me të ardhurat e ligjshme të personit të dënuar dhe një gjykatë kombëtare bazuar në fakte specifike është plotësisht e bindur që prona në fjalë ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal i personit të dënuar.

#### **4. Programet e tjera antikorrupsion dhe të integritetit publik**

##### **4.1 Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë<sup>217</sup>.**

OSBE është organizata rajonale më e madhe në botë dhe bashkon 56 anëtarë. E krijuar me Aktin Final të Helsinkit (1975), OSBE asiston shtetet pjesëmarrëse në përmirësimin e qeverisjes së mirë dhe të luftës kundër korrupsionit duke promovuar ratifikimin dhe implementimin e Konventës së OKB-së kundër korrupsionit; duke organizuar seminare në nivel kombëtar dhe rajonal, në lidhje me instrumentet ndërkombëtare ligjore dhe praktikatat e mira; asistencën, me kërkesë, në ndërtimin institucional, veçanërisht në lidhje me trajnimin e zyrtarëve publikë; dhe shpërndarjen e *Manualin e Praktikave më të Mira në Luftën kundër Korrupsionit të OSBE-së (2004)*<sup>218</sup>.

Manuali përmban studime çështjesh dhe ka si objekt ligjvënësit, zyrtarët publikë, masmedian, OJQ-të, njerëzit e biznesit, dhe shoqërinë civile në përgjithësi. Kapitujt diskutojnë transparencën e çështjeve politike, financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, konfliktet e interesave dhe deklarimin e interesave, lobimin, imunitetin politik dhe gjyqësor, etikën në administratën publike, prokurimin publik, licencat dhe koncesionet, ligjin penal dhe implementimin e legjislacionit penal (ky kapitull diskuton *policinë* dhe *prokurorët*), privatizimin dhe procedurat antikorrupsion, strategjitë kombëtare antikorrupsion, komisionet antikorrupsion, masmedian dhe shoqërinë civile dhe gjyqësorin (ky kapitull diskuton *gjyqtarët* dhe *avokatët*). Konkluzionet përsërisin se strategjitë antikorrupsion të përcaktuara qartë janë të domosdoshme, bashkë me fushatat publike efektive, kodet e sjelljes dhe kartat e qytetarëve. Ai gjithashtu thekson se procedurat burokratike duhet të modernizohen, denoncuesit duhet të inkurajohen dhe të mbrohen, duhet të kryhen kontrole integriteti rregullisht, duhet të përfshihet shoqëria civile, natyra kritike e aksesit ndaj informacionit publik dhe disponueshmëria e internetit. Veç këtyre, manuali sugjeron se rritja e pagave është një zgjidhje, por vetëm për zyrtarët e pozicioneve të ulëta. Ai promovon se duhet të zbatohen ligjet e reja, rregulloret për provat duhet të azhurnohen sipas natyrës specifike të krimeve të korrupsionit (ligjet nuk duhet të jenë një pengesë për ndjekjen penale), se si ligjet për aktivitetet e paligjshme mund të udhëheqin fushatën antikorrupsion dhe se sistemet duhet të monitorojnë perceptimin publik, impaktin e

<sup>217</sup> Faqja e internetit të OSBE-së është [www.osce.org](http://www.osce.org).

<sup>218</sup> Manuali gjendet në shtatë gjuhë në [www.osce.org/eea/item\\_11\\_13568.html](http://www.osce.org/eea/item_11_13568.html).

korupsionit mbi biznesin dhe të matin korupsionin në sektorë të ndryshëm. Metodat e menaxhimit, antikorrupsion dhe etika gjithashtu duhet të mësohen me institucionet arsimore.

Posaçërisht lidhur me *grykatat*, manuali thekson nevojën për pavarësi institucionale, promovimin e kodeve të sjelljes, udhëheqësit e plotësuar, rishikimin e grykatave dhe substancës së vendimeve gjyqësore, një mekanizëm për ankesat publike, emërimet dhe promovimet e bazuara tek merita, komitetet e përdoruesve të grykatës të takohen dhe të diskutojnë me gjyqtarët për zgjidhjet dhe operacionet e grykatës, mbikëqyrja e personelit ndihmës që merret me dosjet dhe që punojnë sipas detyrave të dhëna prej tyre, dhe për postimin e të dhënave të dosjeve të çështjeve të grykatës në faqet e internetit.

**4.2 Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI)**, që prej tetorit 2007, është emri i atij që më përpara njihet si Pakti i Stabilitetit të Evropës Juglindore (themeluar në 1999). Ajo përbëhet nga marrëveshje politike të nivelit të lartë për të asistuar Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Maqedoninë, Moldavinë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Serbinë në implementimin e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale antikorrupsion; duke promovuar qeverisjen e mirë dhe administrimin e besueshëm publik; promovimin e sundimit të ligjit, transparencës dhe integritetit; dhe promovimin e shoqërisë civile aktive.

**4.3 Partnerët Evropianë kundër korupsionit**<sup>219</sup>. EPAC është një rrjet i autoriteteve të ngarkuar me monitorimin dhe hetimin e organeve të policisë kombëtare dhe organeve antikorrupsion. Anëtarët rumunë të EPAC përfshijnë Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Mbrojtjen e Brendshme<sup>220</sup>, Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion<sup>221</sup> me Ministrinë e Administrimit dhe të Brendshme dhe Drejtorinë Kombëtare Antikorrupsion<sup>222</sup>.

Rrjeti mban mbledhje vjetore. Në *Deklaratën e Helsinkit 2007*, ai theksoi nevojën për pavarësi të organeve kombëtare që mbikëqyrin policinë dhe autoritetet kombëtare antikorrupsion. Kjo pavarësi duhet të forcohet, veçanërisht në lidhje me strukturat

---

<sup>219</sup> Partnerët evropianë kundër korupsionit, në [www.epac.at](http://www.epac.at).

<sup>220</sup> DGIPI punon për të mbledhur, përpunuar, magazinuar dhe përdorur inteligjencën për: monitorimin e grupeve kriminale të përfshira në kryerjen e krimeve të rënda me mjete veprimi unike, të cilat janë të rëndësishme për nga përmasat dhe kërkojnë hetime komplekse dhe afatgjata (kontrabanda e drogës, vrasjet, krimi dhe korupsioni, kontrabanda, migrimi i paligjshëm, trafikimi i qenieve njerëzore, falsifikimi i parave, trafikimi në kapitale, krimi financiar, krimi kibernetik); monitorimi i operacioneve që përfshin produktet dhe teknologjitë strategjike me përdorim të dyfishtë, që iu nënshtrohen kontrollit të destinacionit final; implementimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për informacionin e klasifikuar, duke përfshirë inteligjencën e NATO-s, si dhe mbrojtjen e aseteve, misioneve dhe personelit të Ministrisë së Brendshme dhe të Reformës Administrative; bashkëpunimin teknik dhe implementimin e strategjisë së departamentit të Ministrisë së Brendshme dhe të Reformës Administrative për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmin dhe aktivitete të lidhura me terrorizmin si dhe bashkëpunimin me institucionet strategjike kombëtare me kompetencat përkatëse, bashkëpunimi i brendshëm dhe ndërkombëtar në fushë me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Shih [www.dgipi.ro](http://www.dgipi.ro).

<sup>221</sup> Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion u ngrit me Ligjin Nr. 161/30.05.2005 si strukture e Ministrisë së Administratës dhe Brendshme e specializuar për parandalimin dhe luftën kundër korupsionit për personelin e Ministrisë. Shih [www.mai-dga.ro](http://www.mai-dga.ro).

<sup>222</sup> Drejtoria Kombëtare Antikorrupsion u ngrit me Urdhër Emergjent të Qeverisë Nr. 43/2002, me emrin fillestar Prokuroria Kombëtare Antikorrupsion, si prokurori e specializuar për të luftuar krimin e korupsionit. Aktualisht është ent ligjor më vete në varësi të Prokurorisë atashuar Grykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtesisë, dhe e specializuar për të luftuar krimin e lartë dhe të mesëm të korupsionit. Ka këtë faqe: [www.pna.ro](http://www.pna.ro)

hierarkike pjesë e së cilës ato janë. Ai deklaroi gjithashtu se nevojitet legjislacioni specifik, burime buxhetore adekuate dhe akses i publikut. Ai deklaroi se standardet minimale dhe praktikave të mira duhet të hartohen për të përforcuar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë. Ai miraton avancimin e të drejtave të njeriut në aktivitetet policore duke i forcuar ato, dhe të sigurohet transparenca, paañësia dhe integriteti. Përfundimisht ai rekomandon forcimin e lidhjeve midis institucioneve të ngarkuara me arsimin, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

*Deklarata e Lisbonës 2005* inkurajon futjen e vlerave të të drejtave të njeriut dhe etikës në përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit policor; për hapjen e praktikave të të drejtave të njeriut, veçanërisht të atyre që lidhen me përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit; dhe forcimin e besimit midis njerëzve, OJQ-ve dhe forcave të policisë. Së fundi, *Deklarata e Vjenës e 2004-ës* thekson rëndësinë e lirisë së shtypit si një mjet madhor dhe jetësor në luftën kundër korrupsionit në një shoqëri demokratike.

#### **4.4 Instrumentet e Transparency International<sup>223</sup>**

TI është një nga aktorët udhëheqës të antikorrupsionit në nivel global. Themeluar në 1993, ajo është organizata më e madhe joqeveritare botërore kushtuar luftës kundër korrupsionit. TI bashkon shoqërinë civile, njerëzit e biznesit dhe institucionet për të formuar një koalicion global të fuqishëm, duke gjeneruar në këtë mënyrë *një lëvizje antikorrupsionit*. Nëpërmjet sekretariatit të saj që ndodhet në Berlin dhe mbi 90 degë të pavarura në gjithë botën, ajo operon në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar kërkesën dhe ofertën e korrupsionit. Në nivel ndërkombëtar, TI organizon fushata mbi efekt dëmtuese të korrupsionit, mbështet politikën për reformat, punon për të implementuar konventat shumëpalëshe nga qeveritë, shoqëritë dhe bankat. Në nivel kombëtar, degët punojnë për të rritur përgjegjësinë dhe transparencën duke monitoruar performancën e institucioneve kryesore, duke lobuar për reformë dhe duke bashkuar entet që merren me korrupsionin në vendin e tyre.

TI është përfshirë në hartimin e instrumenteve kryesore ndërkombëtare antikorrupsionit, të tilla si Konventa e OKB-së kundër korrupsionit, Konventa Afrikane kundër korrupsionit, Konventa e OECD-së për luftën kundër mitës. TI i dha një kuptim të ri konceptit të 'mitës', për të përfshirë konfliktet e interesave dhe dhuratave në spektrin e korrupsionit.

Në luftën kundër korrupsionit, TI përdor ekspertizën që jepet nga degët kombëtare dhe Sekretariati Ndërkombëtar. Ajo zhvillon koalicionet me vendimmarrësit në të gjithë sektorët e shoqërisë - institucionet, qendrat studimore, shoqërinë civile. TI gjithashtu analizon dhe bën diagnozën e korrupsionit, duke matur gamën, frekuencën dhe format në studime, anketimet dhe tregues megjithëse ajo nuk heton çështje të veçanta korrupsionit. TI vazhdon përpjekjet e saj duke kryer fushata publike për të paralajmëruar efektet imediate dhe afatgjata të korrupsionit, për të identifikuar rolet individuale për luftën kundër korrupsionit, për të dhënë zgjidhje në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor dhe për të nxitur publikun që të kërkojë reforma.

Më poshtë paraqitet një numër specifik i instrumenteve të antikorrupsionit:

##### **a. Studimet e Sistemit Kombëtar të Integritetit**

---

<sup>223</sup> Faqja e internetit të organizatës është [www.transparency.org](http://www.transparency.org).

Promovimi i integritetit dhe parandalimi i korrupsionit kërkojnë një model holistik të institucioneve të përfshira në sektorët publikë, privatë dhe të shoqërisë civile. Sa më poshtë shihen si shtyllat e 'Sistemit Kombëtar të Integritetit': Ekzekutivi, Legjislatura, Partitë Politike, Byrotë Zgjedhore, Institucioni i Lartë i Kontrollit të Llogarive, Gjyqësori, Sektori Publik, Policia dhe Prokuroria, Prokurimet Publike, Ombudsmeni, Agjencitë Antikorrupsion, Masmmedia, Shoqëria Civile, Sektori Privat, Administrata e Qarkut dhe Vendore, Institucionet Ndërkombëtare. Kuadri jepet në punimin '*Libri Burimor Kombëtar i Integritetit*' nga Jeremy Pope (2002)<sup>224</sup>.

Duke e shfrytëzuar këtë, TI hartoi *Manualin Antikorrupsion*<sup>225</sup> (2004), një instrument që synon të japë asistencë në hartimin dhe zbatimin e masave antikorrupsion. Mund të përdoret nga praktikuesit në çdo vend, dhe përmban fjalët kyçe që përditësohen rregullisht.

**b. Indeksi i perceptimit të korrupsionit (CPI)**<sup>226</sup>, i filluar në 1995, është instrumenti më i mirënjohur i botës për matjen e korrupsionit të perceptuar tek zyrtarët publik në çdo vend. Për të matur korrupsionin në një shtet, institucioni parapëlqen përvojën dhe perceptimin e atyre që përballen me korrupsionin drejtpërdrejt në atë vend, duke pasur parasysh që matja e korrupsionit kundrejt të dhënave konkrete empirike, të tilla si numri i dënimeve ose shuma e mitës së paguar, është veçanërisht e vështirë. Në rastin e numrit të dënimeve, të dhënat nuk pasqyrojnë nivelin faktik të korrupsionit, por më tepër kapacitetin e prokurorëve, gjyqtarëve dhe medias për të zbuluar çështjet e korrupsionit. Masat e rekomanduara në nivel global, me fillimin e CPI-së në 2007, nënvizoi nevojën për të përmirësuar pavarësinë, integritetin dhe përgjegjshmërinë publike të gjyqësorit duke pasur parasysh rritjen e besueshmërisë së tij. Për funksionimin optimal të gjyqësorit, duhet të mbrohen procedurat gjyqësore nga ndikimi politik dhe gjyqtarët duhet t'i nënshtrohen rregullave disiplinore dhe kodit të sjelljes, ndërsa duhet përfituar nga imuniteti i kufizuar. Në vitin 2008, rekomandimet i referohen forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe përgjegjshmërisë. Nëse flasim për një vend të varfër apo jo, sfida e luftës kundër korrupsionit kërkon institucione funksionuese qeveritare dhe shoqërore. Në vendet e varfra, korrupsionit është evident në gjyqësor, dhe kontrolli institucional është joefikas. Në mënyrë që të reduktohet korrupsioni në këto vende, atyre u nevojiten institucione të fuqishme, sundimi i ligjit, masmedia e pavarur dhe një shoqëri civile aktive.

Në vitin 2007, Rumania renditej e 69 nga 179 vende me një rezultat prej 3.7 nga 10 (1 për më të korruptuarin, 10 për më pak të korruptuarin), dhe perceptohej si *shteti më i korruptuar në BE*, ku rezultati mesatar ishte 6.51.

Në vitin 2008, indeksi i Rumanisë u rrit në 3.8 pikë dhe u kalua nga Bullgaria si anëtari më i korruptuar i Bashkimit Evropian. Në nivel global, Rumania tani renditet e

---

<sup>224</sup> Gjendet në mbi 20 gjuhë në [www.transparency.org/publications/sourcebook](http://www.transparency.org/publications/sourcebook).

<sup>225</sup> Që gjendet në [www.transparency.org/index.php/policy\\_research/ach](http://www.transparency.org/index.php/policy_research/ach).

<sup>226</sup> Gjendet në [www.transparency.org/ro/politici\\_si\\_studii/indici/ipc/index.html](http://www.transparency.org/ro/politici_si_studii/indici/ipc/index.html). CPI është një indeks i përbërë, bazuar në të dhënat e korrupsionit të dhëna nga anketimet e specializuara të përpunuara nga disa institucione të pavarura udhëheqëse. Ai pasqyron opinionin e njerëzve të biznesit dhe analistëve në të gjithë botën, duke përfshirë ekspertët nga vendet që analizohen. Anketimet e përdorura për përpilimin e pyetjeve të CPI në lidhje me përdorimin jokorrekt të pozicioneve publike për përfitime private duke u fokusuar, për shembull tek zyrtarë dhe prokurimet publik që marrin mitë, në shpërdorimin e fondeve publike ose pyetjet që kontrollojnë fuqinë e politikave antikorrupsion, të cilat përfshijnë korrupsionin politik dhe administrativ.

70-a nga 180 vende<sup>227</sup>. TI-Ro rekomandon implementimin e një standardi të qëndrueshëm për hetimin dhe ndëshkimin e të gjithë rasteve të korrupsionit dhe largimin e të gjithë filtrave të tjerë shtesë, që mund të ndikojnë në administratën e drejtësisë, përkatësisht forcimin e juridiksionit administrativ-disiplinor në të gjitha komponentët e sektorit publik duke përfshirë prokurorët dhe gjyqtarët, nëpunësit civil, personelin e punësuar.

### Evucioni i Rumanisë midis 1997 dhe 2008.




Tabela nr. 3 : Indeksi i perceptimit të korrupsionit (TI)  
Performanca e Rumanisë në 1997-2008

c. **Indeksi i Mitëdhënësve (BPI)**<sup>228</sup> është gjendja e vendeve më të mëdha eksportuese, me udhëzimet e shoqërive të tyre për të paguar mitë jashtë kufijve kombëtarë. Deri tani kanë dalë katër botime të këtij indeksi (1999, 2002, 2006 dhe 2008). Rumania nuk është përfshirë në këtë klasifikim sepse ajo nuk është udhëheqës në eksportet rajonale apo botërore.

d. **Barometri i Korrupsionit Global (GCB)** është një anketim i botuar në vitin 2003 për të matur si perceptimin e publikut të gjerë për korrupsionin edhe përvojën e njerëzve në lidhje me këtë fenomen. Barometri mblledh opinionet e qytetarëve për elementët më të korruptuar të sektorit publik në aspektet e jetës (jeta familjare, mjedisi i biznesit ose

<sup>227</sup> Në vitin 2008, shtetet më pak të korruptuara janë Danimarka, Zelanda e Re, Suedia, Singapori, Finlanda, Zvicra, Islanda, Holanda, Australia dhe Kanadaja. Më të korruptuarit janë Kongo, Guinea Ekuatoriale, Çadi, Guinea, Sudani, Afganistani, Haiti, Iraku, Mianmar dhe Somalia.

<sup>228</sup> Gjendet në [www.transparency.org/ro/politici\\_si\\_studii/indici/ipm/index.html](http://www.transparency.org/ro/politici_si_studii/indici/ipm/index.html).



komuniteti politik) që janë më të ndikuarat nga korrupsioni, si dhe për hapat e marra nga qeveritë për të luftuar korrupsionin<sup>229</sup>.

Në vitin 2007, të dhënat tregojnë se në nivel global, publiku i gjerë vazhdonte të perceptonte parlamentet dhe partitë politike si institucionet më të korruptuara, ndërsa përvoja direkte zbulon se niveli i mitës është më i lartë në *policia* dhe në *gjyqësor*. Për pasojë, institucionet kyçe në shoqëri, veçanërisht institucionet që luajnë një rol jetësor në sigurimin e integritetit dhe të përgjegjshmërisë publike të qeverive, janë të diskredituara. Perceptimi i gjyqësorit si institucioni i dytë më i korruptuar, pas policisë, ngre pikëpyetje serioze për garanci të aksesit të barabartë tek drejtësia për qytetarët. Është detyra e institucioneve të tilla si gjyqësori dhe policia, që të ndëshkojnë sjelljet e korrupsionit. Në qoftë se këto ndikohen nga mita, siç tregohet nga Barometri i 2007-s, atëherë pengohen mekanizmat e zbatimit të ligjit, të cilat janë jetësore për efektivitetin e përpjekjeve antikorrupsion dhe minohet besimi i publikut.

Barometri 2007 tregon se të anketuarit me të ardhura të ulëta dhe të mesme ishin më të prekurit nga korrupsioni i shkallës së vogël, sepse gjasa e tyre për të paguar mitë për të siguruar shërbimet publike ishte më e lartë se e anketuarve me të ardhura më të larta. Rezultati është i vlefshëm si për vendet e pasura edhe ato të varfra. Kudo në botë, ata që fitojnë më pak duhet të paguajnë shpesh më tepër mitë.

Në vitin 2008, perceptimi i shumë institucioneve publike mbetej negativ. Publiku vazhdoi t'i identifikonte partitë politike si institucionet më të korruptuara, ndërsa përvoja direkte e të anketuarve zbulonte se *policia*, pasuar nga autoritetet e regjistrimit të tokës dhe *sistemi gjyqësor* kishin prirjen më të rëndë për mitëmarrje. Rezultati është se institucionet kyçe në shoqëri, veçanërisht institucionet që janë kritike për integritetin dhe përgjegjshmërinë e qeverisë dhe për garantimin e të drejtave të njeriut diskreditohen. Nuk ka dyshim se legjitimiteti i qeverisë minohet nga korrupsioni.

Në vitin 2007, 33% e të intervistuarve pranonin se kishin paguar mitë dhe institucionet më të korruptuara mbeteshin partitë politike dhe parlamenti me 3.9 pikë, *drejtësia* me 3.8 pikë dhe policia dhe sistemi i kujdesit shëndetësor të dyja me nga 3.7 pikë. Hetimi zbulon se gjatë 12 muajve të fundit, 10% e të anketuarve (ose njerëzit e afërt me ta) kishin pasur kontakte me *gjyqësorin*, prej të cilëve 11% iu kërkua të jepnin mitë, dhe 10% thanë se e kishin paguar atë. Shuma mesatare e mitës ishte 114.60 euro. Një 16% tjetër kishte kontakt me policinë; 9% e tyre iu kërkua mitë, dhe 11% u ofruan mitë punonjësve të policisë. Mesatarja e këtyre mitave kapte shumën 114.80 euro<sup>230</sup>.

Në vitin 2008, 14% e popullsisë pranonte se kishte paguar mitë (përkundrejt mesatares 5% në Evropë ose matje 5% në Bullgari). Institucionet më të korruptuara ishin partitë politike dhe parlamenti me 4.3 pikë secili, ndjekur nga *gjyqësori* me 4.2, mjedisi i biznesit me 3.8 dhe për herë të parë në pozicion drejtues, masmedia me 3.4 pikë. Anketimi zbulon se në 12 muajt e kaluar, 6% e të anketuarve (ose njerëzit e afërt me ta) kishin hyrë në kontakt me *gjyqësorin*, prej tyre, 8% thanë se kishin paguar mitë, gjithashtu 10% u përgjigjën se ata kishin kontakte me policinë dhe 13% e tyre u ofruan mitë punonjësve të policisë<sup>231</sup>.

<sup>229</sup> GCB pasqyron pikëpamjet e publikut për korrupsionin, ndërsa CPI bazohet në opinionet e ekspertëve. I pari pasqyron përvojat individuale të korrupsionit (korrupsioni në shkallë të vogël), i dyti pasqyron perceptimet e vëzhguesve të informuar për korrupsionin në sistemin publik dhe politik. Megjithatë të ndryshëm, rezultatet e të dy instrumenteve janë në korelacione (në 2007-ën, indeksi i korelacioneve ishte 0.66).

<sup>230</sup> Të dhënat disponohen në [www.transparency.org.ro/politici\\_si\\_studii/indici/bgc/2007/tabele.pdf](http://www.transparency.org.ro/politici_si_studii/indici/bgc/2007/tabele.pdf).

<sup>231</sup> Të dhënat disponohen në [www.transparency.org.ro/politici\\_si\\_studii/indici/bgc/2009/index.html](http://www.transparency.org.ro/politici_si_studii/indici/bgc/2009/index.html).

Rezultati është llogaritur në shkallën nga 1 (aspak i korruptuar) deri në 5 (më i korruptuari). Në fakt intensiteti i korrupsionit siç perceptohet nga publiku është direkt në përpjesëtim të drejtë me nivelin hierarkik të institucioneve kryesore publike ose të pushtetit.

	Paguesit e mitës	Partitë politike	Parlamenti	Sistemi legjislativ/gjyqësor	Mjedisi i biznesit sektori privat	Media	Shërbimet e kujdesit shëndetësor	Policia	Sistemi i arsimit	Regjistrimi/zyrat e lejeve	Të ardhurat e shtetit	OJQ-të	Shërbimet komunale	Ushtria	Organizatat fetare
2008	14%	4.3	4.3	4.2	3.8	3.4									
2007	33%	3.9	3.9	3.8	3.6	2.8	3.7	3.7	3	2.9	2.6	2.6	2.4	2.4	2.2
2006	20%	4.1	4	3.9	4	2.9	3.8	3.6	3.2	2.8	2.2	2.9	2.3	2.5	2.3
2005	22%	3.8	3.6	3.7	3.4	2.7	3.6	3.6	2.9	2.9	2.4	2.5	2.5	2.4	2.1
2004	25%	4.2	4	4.1	3.7	2.6	3.9	3.6	3.3	3.4	2.9	2.7	2.5	2.4	2.2

Tabela nr. 4: GCB-Institucionet më të prekura nga korrupsioni në Rumani në 2004-2008.

	Sistemi arsimor	Gjyqësori	Shërbimi i kujdesit shëndetësor	Policia	Lëshimi i dokumenteve	Shërbimet komunale	Të ardhurat për shtetin	Shërbimet e pasurive të paluajtshme
<b>Kontakti në 12 muajt e kaluar (i anketuari ose një njeri afërt)</b>	33%	6%	49%	10%	15%	58%	53%	12%
<b>Pagoi mitë</b>	7%	8%	22%	13%	6%	2%	3%	4%

Tabela nr. 5: GCB-Kontakti me institucionet publike dhe mitëdhënësit

*e. Raporti i Korrupsionit Global (GCR)* përpilohet çdo vit mbi një temë specifike dhe përfaqëson një analizë komplekse të situatës globale të korrupsionit. Raporti përqendron lajme dhe analiza nga ekspertë dhe mbështetës të lëvizjes antikorrupsion, që zbulon zhvillimet e fundit të korrupsionit. Çdo raport mbulon një periudhë 12-mujore, nga korriku deri në qershor të vitit pasardhës dhe shikon ndikimin e korrupsionit në një sektor specifik. Ai përfshin studimet e detajuara nga vendet e ndryshme<sup>232</sup>.

<sup>232</sup> Raporti i 2007-ës pa korrupsionin në gjyqësor. Në vitin 2009, GCR analizon korrupsionin në sektorin privat, në 2008-ën GCR analizon korrupsionin në sektorin e ujit, në 2006-ën korrupsionin në sektorin e kujdesit shëndetësor, në 2005-ën korrupsionin në ndërtim dhe në zonat e rindërtimit pas konfliktit dhe në 2004-ën korrupsionin politik.

Raporti i botuar në 24 maj 2007, trajtonte *Korrupsionin dhe Sistemet Gjyqësore*<sup>233</sup> dhe synon që të jetë udhëzues për analizimin e korrupsionit gjyqësor në nivel kombëtar dhe si burim frymëzimi për reforma në sistem. Manuali nënvizon sfidën e madhe të sigurimit të përputhjes me ligjet antikorrupsion dhe funksionimin e të gjithë sistemit gjyqësor. Një gjyqësor i pastër është qendror për luftën kundër korrupsionit dhe përdorimi i postit gjyqësor për përfitime private gjithashtu mund të implikojë tolerancë më të lartë ndaj korrupsionit në shoqëri. Konkluzioni kritik i Raportit është se drejtësia minohet nga korrupsioni në shumë vende, dhe se e drejta themelore për gjykim të paanshëm u mohohet palëve<sup>234</sup>. Në Shtojcën I të kësaj analize kemi bashkëlidhur një përmbledhje të këtij raporti.

Çdo vit, GCR shoqërohet me një **Raport Kombëtar për Korrupsionin (RNC)**<sup>235</sup>, botuar nga Transparency International Rumani, që synohet të japë një përmbledhje përzgjedhëse të shumicës të zhvillimeve më të rëndësishme legislative, institucionale dhe politike për vitin para botimit të tij.

Sipas GRC 2007, korrupsioni gjyqësor është i pranishëm kudo në botë dhe pengon aksesin e qytetarëve për një gjykim të paanshëm, të pavarur dhe të drejtë. Nga ana tjetër kjo gërryen rritjen ekonomike, sepse shton mosbesimin tek investitorët. Të varfrit janë më të prekurit, sepse atyre u duhet të paguajnë mitë që ata nuk e përballojnë dot.

Korrupsioni gjyqësor përfshin keqpërdorimin e parave dhe pushtetit. Për shembull, kur një gjyqtar punëson një anëtar të familjes në gjykatë që ai e ka në varësi, ose përdor pozicionin e tij/të saj për të manipuluar kontratat e prokurimit të ndërtimit ose pajisjeve. Korrupsioni gjyqësor mund të marrë edhe formën e ndikimit në caktimi i çështjeve për gjyqtarët ose në procese të tjera paragjyqësore, kur nëpunësit korruptohen duke 'humbur' dokumentet ose provat. Ky fenomen mund të ndikojë çdo gjyq ose zgjidhje midis palëve, si dhe zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe të dënimeve.

Mita, forma tjetër negative e korrupsionit gjyqësor mund të shfaqet në çdo etapë të procesit gjyqësor. Siç është provuar nga 32 raportet kombëtare të përfshira në GCR, gjyqtarët mund të pranojnë mitë në shkëmbim të vonesës ose përshpejtimit të gjykimit, për dhënien ose mohimin e apeleve, për ndikimin tek gjyqtarë të tjerë ose thjeshtë për lëshimin e një vendimi të veçantë mbi një çështje të veçantë. Zyrtarët në gjyqësor mund të pranojnë mitë në shkëmbim të shërbimeve që duhet të jenë falas.

Avokatët mund të kërkojnë 'pagesa' shtesë për të vonuar ose përshpejtuar çështjet, ose për t'i drejtuar klientët tek gjyqtarët të njohur si mitëmarrës. Një faktor që rrit gjasën e gjyqtarëve për të pranuar mitë, janë pagat e ulëta. Kushtet e pasigurta të punës, duke përfshirë promovimet e padrejta dhe transferimet, si dhe mungesa e trajnimit të vazhduar Profesionit, i bën gjyqtarët dhe personelin ndihmës të gjykatave të cenueshëm.

Në lidhje me Rumaninë, NCR 2007 shënon impaktin e vogël që reformat kanë pasur në marrëdhëniet midis qytetarëve dhe gjyqësorit; kapacitetin e dobët administrativ të institucioneve shtetërore; mungesën e dëshirës nga drejtuesit e gjykatës dhe prokurorisë për të implementuar reformat; mungesa e integritetit në gjykata, arkiva dhe zyrat e sekretarive; korrupsioni dhe mungesa e transparencës në administrimin e drejtësisë, veçanërisht në marrëdhëniet midis përdoruesve të gjykatës dhe personelit ndihmës; se vetë gjyqtarët dhe prokurorët flasin për presion që vjen nga media, politikanët, grupet ekonomike të interesit, dhe eprorët; vendimet e paparashikueshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërsa konfliktet e interesave janë të shpeshta; ankesat e depozituara nga përdoruesit e gjykatës marrin shumë

<sup>233</sup> GCR gjendet i plotë në [www.transparency.org/publications/gcr/download\\_gcr](http://www.transparency.org/publications/gcr/download_gcr). Aspektet më të rëndësishme të GCR mbulohe në një prezantim të postuar në TI-Ro në [www.transparency.org.ro/politici\\_si\\_studii/studii/global\\_coruptie/2007/index.html](http://www.transparency.org.ro/politici_si_studii/studii/global_coruptie/2007/index.html).

<sup>234</sup> TI, GCR 2007, fq. xix-xxi.

<sup>235</sup> Gjendet në [www.transparency.org.ro/politici\\_si\\_studii/national\\_coruptie/index.html](http://www.transparency.org.ro/politici_si_studii/studii/national_coruptie/index.html).

kohë për t'u zgjidhur; qytetarët nuk i njohin të drejtat e tyre dhe kapaciteti i reduktuar i SCM për të penguar gjyqtarët dhe prokurorët që të mos abuzojnë me pushtetin e tyre<sup>236</sup>.

GCR 2007 është plotësuar me *Mjete Avokatie*<sup>237</sup>, një instrument që jep këshilla anëtarëve të shoqërisë civile se si të luftojnë korrupsionin në vendet e tyre. Manuali përmban Strategjitë e Avokatisë dhe shembujt e planeve për vendet e tjera. Ai gjithashtu jep shpjegime për korrupsionin gjyqësor, bën rekomandime se si duhet të luftohet ai dhe sugjeron instrumentet për ta analizuar atë.

Mjetet paraqesin një numër treguesish për vlerësimin e garancive kundër korrupsionit gjyqësor, të grupuara në dy kategori: 1) kërkesat e sistemit për një gjyqësor të pastër përfshijnë garancitë për mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore; kushtet e mira të punës për gjyqtarët; emërimi i gjyqtarëve; përgjegjshmëria (përgjegjësia ligjore, procedurat e qarta administrative, justifikimi për përdorimin e burimeve publike, kodi i sjelljes, pasojat për shkeljet); transparenca dhe burimet (procedurat transparente, arsimi, materialet dhe burimet); 2) përgjegjshmëria e aktorëve të përfshirë në gjyqësor: përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe pushteti gjyqësor; përgjegjshmëria e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv; roli i shoqatave të gjyqtarëve; roli i prokurorëve; roli i avokatëve; roli i individëve dhe shoqërisë; roli i medias dhe gazetarëve; roli i shoqërisë civile dhe programet e reformës gjyqësore të donatorëve.

---

<sup>236</sup> Shih <http://tinyurl.com/coruptiejustitierom>.

<sup>237</sup> TI, lufta kundër korrupsionit në sistemet gjyqësore-mjetet mbrojtjes, <http://tinyurl.com/advtoolkit>.

## PJESA IV POLITIKAT ANTIKORRUPSION PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

*Korrupsioni është një mosfunksionim i sistemit që e ka origjinën dhe ndikon në sistemin legjislativ, sistemin institucional dhe marrëdhëniet ndërpersonale specifike për institucionet shoqërore. Si një fenomen kompleks, ai kërkon metoda speciale për t'u luftuar. Masat antikorrupsion duhet të marrin parasysh të gjitha aspektet e përshkruara në diagnozën e korrupsionit. Masat janë si ligjore edhe administrative dhe përfshijnë si autoritetet edhe publikun e gjerë.*

Deklaruam në fillimin e këtij punimi rëndësinë e krijimit dhe respektimit të tre Vlerave - Pavarësia, Paanshmëria dhe Integriteti. Ndërsa pavarësia duhet të sigurohet në mënyrë të veçantë në nivel institucional, paanshmëria edhe integriteti duhet të mbrohen në mënyra të tjera sepse ato janë virtyte morale.

Duhet përmendur megjithatë se bëhen rrallë studime dhe analiza zyrtare mbi korrupsionin në sistem<sup>238</sup>. Nuk ka anketime të rregullta as me punonjësit as me publikun në lidhje me integritetin e zyrtarëve publikë dhe nuk ka instrumente për të matur cilësinë e gjyqësorit<sup>239</sup>. Kryesisht, nuk ka ndonjë interes për të marrë informacionin e atyre që u drejtohen shërbimeve gjyqësore. Si rezultat, efikasiteti i sistemit matet duke krahasuar të dhënat statistikore por jo cilësinë e këtyre shërbimeve. Është saktësisht kjo arsyeja për se nuk janë identifikuar zyrtarisht dobësitë në sistem - personeli nuk ka interes për të dhënë informacion ndërsa publiku nuk ka mundësinë që të shprehë përvojat e veta.

Siç njoftuam në fillimin e këtij studimi, pas shpjegimit se çfarë është korrupsioni në pjesën e parë, duke treguar zonat e cenueshme në gjyqësor në pjesën e dytë, duke përdorur zgjidhjet ndërkombëtare si model të paraqitur në pjesën e tretë, në këtë pjesë përfundimtare të kërkimit do të tregojmë politikat më të përshtatshme antikorrupsion që duhet të implementohen për parandalimin, kontrollin dhe ndëshkimin e korrupsionit në gjyqësor. Këto politika janë hartuar për të krijuar bazat konkrete për masat e përgjithshme të vlefshme në çdo publik ose edhe sistemin institucional privat, dhe synohet që të forcojnë integritetin e gjyqësorit, si në nivel institucional edhe atë individual.

Pas paraqitjes të disa koncepteve teorike, do të paraqesim kuadrin ekzistues ligjor, i cili përvijon drejtimit dhe masat kryesore antikorrupsion, dhe pastaj do të zhvillojmë drejtimit dhe masat specifike për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në gjyqësor.

---

<sup>238</sup> Ministria e Drejtësisë bëri kërkime për integritetin dhe rezistencën ndaj korrupsionit të sistemit gjyqësor dhe në vitin 2003 publikoi rezultatet në lidhje me gjyqtarët, ndërsa nuk publikoi të dhënat për prokurorët. TI-Ro, kreu në 2005, 2006 dhe 2007 një anketim për perceptimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për pavarësinë e gjyqësorit. DGA kreu një anketim publik për korrupsionin e përcaktuar në Ministrinë e Administratës dhe të Brendshme në vitin 2006 dhe 2008 dhe një anketim me personelin e saj për të njëjtën çështje në vitin 2007.

<sup>239</sup> Të vetmet anketime të kryera në pak vitet e kaluara nuk përmendin gjykata specifike, por sistemin gjyqësor në tërësi. Qarku Timisoara është i vetmi që në 2006-ën ka kryer një program vjetor duke pyetur përdoruesit e shërbimit gjyqësor ndërsa një anketim i ngjashëm u krye në 2007-ën në gjykatat e Qarkut Alba; një projekt pilot që fokusohet në cilësinë e shërbimeve gjyqësore u fillua në qarkun Cluj në vitin 2009.

## 1. Komponentët e politikave antikorrupsion.

Qëllimi i politikës antikorrupsion është që të reduktojë korrupsionin dhe të rritë besimin në institucione, i cili lidhet direkt me qeverisjen e mirë. Veçanërisht, që prej vitit 2000 në Rumani janë përvijuar strategji për luftën kundër korrupsionit, janë amenduar ligje dhe janë krijuar institucione. Ajo që mungon megjithatë është arsimimi antikorrupsion, krijimi i praktikave më të mira, menaxhimi efikas dhe mjetet specifike për të shtypur dhe luftuar sjelljen që devijon nga standardet.

Një strategji antikorrupsion për gjyqësorin duhet të mbulojë dy fusha veprimi: parandalimin dhe luftën<sup>240</sup>.

*Parandalimi i korrupsionit* kërkon që të eliminojë dobësitë e paraqitura në pjesën e dytë të këtij punimi. Veprimet kundër korrupsionit duhet të aspirojnë që të kufizojnë monopolin, të largojnë pushtetet diskrecionare<sup>241</sup> dhe të garantojnë transparencën. Këto duhet t'u shtohen fushatave informative për mënyrën se si menaxhohen dhe operohen institucionet përkatëse, por edhe për instrumentet ekzistuese antikorrupsion; rritjen e përgjegjësisë të personelit, veçanërisht duke implementuar kodet e sjelljes; rezoluta për papajtueshmërinë dhe rregulloret për konfliktin e interesit.

*Lufta kundër korrupsionit* i drejtohet si aktiviteteve të inspektimit (inspektimi i përgjithshëm administrativ dhe auditit financiar) dhe ndëshkimeve (pasoja kur konstatohet një parregullsi specifike). Me këtë duam të themi mekanizmat e inspektimit të brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me etikën profesionale, kufizimin e ndërhyrjeve të faktorëve administrativë në kryerjen e detyrave gjyqësore, ndarjen e kompetencave gjyqësore nga ato jo juridiksonale; së bashku me dhënien e mbështetjes për institucionet gjyqësore dhe administrative kundër korrupsionit.

Mesa duket, implementimi i metodave antikorrupsion eventualisht do të çojë jo vetëm tek një rritje integriteti të personelit dhe vetë reformës së gjyqësorit por ndoshta tek forcimi i metodave antikorrupsion duke siguruar pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit.

## 2. Përkufizim i tipareve të politikave antikorrupsion

**a.** Në lidhje me grupet e saj objekt, një politikë e tillë së pari dhe kryesisht duhet të ketë objekt *personelin* në institucionet përkatëse, të cilëve u duhet kërkuar dhe u duhet inkurajuar sjellja e drejtë. Nga njëra anë, punonjësit duhet të këshillohen që të jenë të paanshëm dhe të përgjegjshëm, nga ana tjetër ata duhet të paralajmërohen për ndëshkimet që rrjedhin nga shkelja e ligjit ose standardeve të sjelljes.

Ajo duhet të trajtojë edhe individët *jashtë* institucioneve, d.m.th., ata që u drejtohen ose mund t'u drejtohen këtyre 'shërbimeve'. Këta individë jo vetëm që duhet të trajnohen për llojin e sjelljes që ata kanë të drejtë të presin nga personeli me të cilin do të jenë në kontakt, por duhet edhe të paralajmërohen për pasojat potenciale nëse tentojnë të korruptojnë zyrtarin.

---

<sup>240</sup> Disa flasin për një qasje me tre shtylla: arsimi (rritja e sensibilitetit për grupet e riskut dhe për publikun e gjerë), parandalimi (paraqitja e praktikave antikorrupsion tek institucionet legjislativë dhe ekzekutive), dhe frenimi (efektiviteti nëpërmjet specializimit dhe trajnimit); disa të tjerë flasin për tre shtresa të tjera: parandalimi, kontrolli dhe ndëshkimi.

<sup>241</sup> Shih edhe Rekomandimi R (80) 2 për ushtrimin e të drejtave diskrecionare nga autoritetet administrative, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 11 1980, në [www.coe.int/admin](http://www.coe.int/admin).

b. Në lidhje me gamën e saj, mund të hartohet një strategji e *përgjithshme*, e vlefshme për të gjithë institucionet, bashkë me një strategji sektoriale, për një fushë ose institucion specifik. Duke pasur parasysh rëndësinë e gjyqësorit, ne besojmë se duhet të miratohet një strategji sektoriale antikorrupsion specifike për sistemin rumun.

Duke konsideruar se Kushtetuta i deklaron gjyqtarët të pavarur, hartimi i politikave antikorrupsion që përfshin inspektimin, mbi të gjitha, nuk duhet të shkelin pavarësinë e gjyqësorit. Ajo që duhet kontrolluar janë aspektet që kanë një impakt negativ mbi gjyqësorin. Prandaj, propozojmë që të hartohet një politikë antikorrupsion pikërisht për ta mbrojtur atë.

### 3. Kuadri aktual antikorrupsion

Zhvillimi i një strategjie efektive antikorrupsion, kërkon, para së gjithash, përzgjedhjen e rregullave që përkufizojnë drejtimit kryesore për veprim, masa, përgjegjësi dhe burime. Nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura në kapitullin e mëparshëm, që përshkruajnë politikën kuadër për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, më të rëndësishmet janë Rezoluta e Këshillit të Evropës 24 e vitit 1994 për *Njëzet Parimet Udhëzuese në Luftën kundër Korrupsionit, Konventa Kriminale dhe Konventa Civile kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës*, 1999 dhe Konventa e OKB-së për luftën kundër korrupsionit e vitit 2003. Ato duhet të implementohen faktikisht dhe jo të mbeten thjesht aspirata.

Në Rumani mjetet për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin janë mbështetur tek këto instrumente ndërkombëtare. Ato në mënyrë strategjike parashikojnë rregullat e mëposhtme të miratuara nga qeveria: a) programi kombëtar për luftën kundër korrupsionit dhe plani kombëtar i veprimit kundër korrupsionit i vitit 2001<sup>242</sup>; b) Strategjia Kombëtare Antikorrupsion e viti 2004 (SNA I)<sup>243</sup> modifikuar me Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2005 (SNA II) dhe Planin i Veprimit për Implementim<sup>244</sup>; c) Strategjia e Reformës së Gjyqësorit 2003 - 2007<sup>245</sup> dhe Planin i Veprimit për Implementim<sup>246</sup>, ku kapitulli II i kushtohet një direktive që detajon *Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit në Gjyqësor*<sup>247</sup>. Përmendim se strategjia kombëtare 2008 –

<sup>242</sup> Miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 1.065/25.10.2001, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 728 , date 15.11.2001.

<sup>243</sup> Vendimi i Qeverisë nr. 1.944/10.11.2004 që miraton Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2005-2007, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 1.199 15dhjetor 2004.

<sup>244</sup> Miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 231/30.03.2005, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 272 , datë 1 prill 2005

<sup>245</sup> Shih Vendimi i Qeverisë nr. 1052/2003649 që miraton Strategjinë e reformës në Gjyqësor, 12 shtator 2003.

<sup>246</sup> Miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 232/30.03.2005, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 273 datë 1 prill 2005. Shih edhe Vendimin e Qeverisë nr. 233/30.03.2005 për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit për Koordinimin e Implementimit të Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion për 2005-2007, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 273 datë 1 prill 2005.

<sup>247</sup> Ky kapitull përfshin tre objektiva, me masa korresponduese: (1) sigurimin e transparencës në kryerjen e detyrave të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe parandalimin e korrupsionit, duke monitoruar dorëzimin e deklaratave të pasurisë dhe të interesit nga gjyqtarët dhe prokurorët, krijimin e një mekanizmi për të kontrolluar këto deklaratave dhe papajtueshmëritë e mundshme, caktimi rastësor i çështjeve, duke siguruar pavarësinë e prokurorëve, duke implementuar kodin e etikës profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët; (2) transpozimin e standardeve antikorrupsion të BE-së, OKB-së, KiE-së dhe OECD-së, duke amenduar ligjet për heqjen e imunitetit të noterëve publikë dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit në gjykatë; (3) rritjen e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit për të plotësuar standardet evropiane, duke reformuar Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen dhe Antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë.

2010-ës për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët e cenueshëm ku strategjitë në administratën publike vendore trajtojnë sektorin e kujdesit shëndetësor, sektorin financiar dhe fiskal, rendin publik dhe sigurinë, arsimin, administratën publike vendore, por jo gjyqësorin; d) plani i veprimit 2007 - 2010 kërkonte si pjesë e një Mekanizmi për bashkëpunim edhe verifikimin e progresit në vazhdim nga ana e Rumanisë, krijuar nga Komisioni Evropian<sup>248</sup>.

Në aplikimin e këtyre programeve, janë miratuar disa akte normative nga qeveria dhe parlamenti.

*Kodi penal* në kapitullin e tij për krimet që lidhen me punën, penalizon pesë vepra penale: konfliktin e interesin, mitëmarrjen, mitëdhënien, marrjen e përfitimeve të padrejta dhe tregtimin e influencës (nenet 253/1-257).

*Ligji nr. 78/2000* për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të korrupsionit, rregullon krimet e korrupsionit, krimet e krahasueshme me korrupsionin, krimet e lidhura me korrupsionin, dhe krimet kundër interesave financiare të komunitetit evropian.

*Ligji nr. 263/2002* ratifikoi Konventën evropiane për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (nënshkruar në Strasburg në 8 nëntor 1990).

Vendimi i Qeverisë nr. 43/2002 rregullon aktivitetin e Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion.

*Udhëzimi i Qeverisë nr. 161/2003* për masat për të siguruar transparencën në ushtrimin e detyrave publike, të detyrës publike dhe në mjedisin e biznesit dhe për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit ('paketa antikorrupsion') krijoi një kuadër ligjor efikas për parandalimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe sigurimin e qeverisjes së mirë.

*Vendimi i Qeverisë nr. 504/2003* miratoi programin për implementimin e ligjit nr. 161/2003. Në mënyrë që të parandalohet përdorimi i fondeve të paligjshme, ligji nr. 43/2003 u miratua dhe trajton financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

*Ligji nr. 52/2003* përcaktoi parimet e transparencës në vendimmarrje në administratën publike që janë njoftimi paraprak, konsultimi dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në vendimet administrative dhe në hartimin e projektligjeve administrative.

*Ligji nr. 7/2004* për Kodin e Sjelljes për zyrtarët publikë rregullon normat e sjelljes profesionale për zyrtarët publikë, synon rritjen e cilësisë së shërbimit publik dhe menaxhimin e promovuar të mirë për realizimin e interesit publik dhe eliminimin e burokracisë.

*Ligji nr. 251/2004* përcakton masat në lidhje me asetet e marra falas gjatë aktivitetit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave publike.

*Udhëzimi i Qeverisë nr. 24/2004* ka si objekt rritjen e transparencës në ushtrimin e funksioneve publike dhe detyrës publike si dhe forcimin e masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

*Ligji nr. 144/2007* për krijimin, organizimin dhe operimin e agjencisë kombëtare të integritetit; krijoi institucionin e ngarkuar për kontrollin e aseteve të marra gjatë detyrave publike, papajtueshmëritë dhe konfliktet e interesit.

Në sistemin gjyqësor, vetëm M.A.I. duhet të paraqesë një politikë antikorrupsion sektoriale meqenëse rendi publik dhe siguria shikohen si një sektor i cenueshëm në vetë strategjinë kombëtare antikorrupsion 2008-2010. Në lidhje me Ministrinë e Drejtësisë, vetëm në 2001-in, u miratua një *Plan Veprimi Sektorial Antikorrupsion* me një urdhër të

---

<sup>248</sup> Plani i veprimit për plotësimin e kërkesave në mekanizmin për bashkëpunim dhe verifikim për progresin në vazhdim të bërë nga Rumania në gjyqësor në luftën kundër korrupsionit, miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 1346/31.10.2007, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 765 datë 12 nëntor 2007. Mekanizmi u krijua sipas vendimit të KE 2006/928/EC të 13 dhjetorit 2006, botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian nr. 354 të 14 dhjetorit 2006.



Ministrin e Drejtësisë. Dokumenti identifikonte sektorët e mëposhtëm të cënueshëm dhe faktorët e riskut brenda Ministrisë së Drejtësisë: I) zyra për dhënien e shtetësisë; II) shërbimi i marrëdhënieve me publikun; III) drejtoria gjyqësore; IV) drejtoria e përgjithshme për shërbimin penitenciar.

Në gjykatat e drejtësisë dhe në Ministrinë Publike - I) marrëdhëniet me publikun; II) aktiviteti gjyqësor; III) zyrat e sekretarive të gjykatave; IV) caktimi i çështjeve<sup>249</sup>.

Besojmë fort se duke implementuar standardet ndërkombëtare<sup>250</sup> për të mbështetur rregulloret e brendshme, mund të hartohet një strategji antikorrupsion për gjyqësorin bazuar në disa parime. Natyrisht në mënyrë që të arrihen masat specifike të sugjeruara në këtë punim, strategjia antikorrupsion për gjyqësorin duhet të përqafohet nga të gjithë vendimmarrësit përkatës dhe duhet të shoqërohet me një plan që përcakton kurset e veprimit, masat konkrete, afatet, zyrtarët përgjegjës dhe burimet që nevojiten për implementimin. Një mekanizëm duhet të ekzistojë për monitorimin konstant të progresit në arritjen e objektivave, efekti i këtyre masave duhet të monitorohet dhe plani fillestar duhet të azhurnohet rregullisht.

Kjo strategji duhet të implementohet dhe të monitorohet nga një organ i pavarur (siç kërkohet nga neni 6 i Konventës së OKB-së kundër korrupsionit), që shpjegon bazën e statutit për Agjencinë Kombëtare të Integritetit<sup>251</sup> dhe të Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion<sup>252</sup>. Përfitimi nga kjo strategji publike e integritetit për sistemin gjyqësor është se ajo direkt përballon sfidat e ndërtimit të një sistemi të aftë për t'u përballur me pritshmëritë e qytetarëve. Kjo mund të ndodhë pavarësisht nga ngarkesa e trashëgimisë së regjimit komunist, i cili përkufizohet si mungesa e sensit të përgjegjshmërisë publike dhe të një kulture publike të aftë për të identifikuar qartësisht zyrtarët e ndershëm<sup>253</sup>.

Është domosdoshmëri absolute për politikën antikorrupsion që të ketë objekt, mes të tjerash për caktimin e treguesve të korrupsionit në gjyqësor, që mund të përdoren si

---

<sup>249</sup> Shih qeveria e Rumanisë, lufta kundër korrupsionit në Rumani. Masa për të përshpejtuar implementimin e strategjisë kombëtare, Bukuresht 2002, në <http://x.gov.ro/objective/pganticoruptie/anticoruptie-2002-2.pdf>.

<sup>250</sup> Konventa e OKB-së në nenin 11, njeh integritetin e gjyqësorit si një komponent qendror të çdo strategjie për të matur korrupsionin, veçanërisht mes gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me një organ gjyqësor të përbërë nga një grup individësh në shumë vende, promovimi i integritetit gjyqësor është një veprim i synuar me potencial të lartë. Projektet për integritetin gjyqësor dhe forcimin e kapacitetit janë implementuar tashmë dhe po zhvillohen në Indonezi, Iran, Mozambik dhe Afrikën e Jugut nëpërmjet UNODC.

<sup>251</sup> Sipas ligjit nr. 144/2007 për krijimin, organizimin dhe operimin e agjencisë kombëtare të integritetit, ky institucion është ngritur në mënyrë që të sigurojë ushtrimin e detyrës publike dhe funksioneve drejtuese me paanësi, integritet, transparencë me anë të një organizimi konsistent dhe institucional të kontrolleve në asetet e fituara gjatë detyrave zyrtare dhe kontrollet për konfliktet e interesit, si dhe njoftimin e papërputhshmërive (preambula e ligjit). Agjencia është një autoritet administrativ autonom, një ent ligjor i veçantë që operon në nivel kombëtar, si një strukturë unitare (neni 12 paragrafi 1). Sipas parimit të pavarësisë operationale, presidenti, zëvendëspresidenti dhe inspektorët e integritetit nuk do të kërkojnë apo pranojnë udhëzime në lidhje me hetimet e tyre nga asnjë autoritet tjetër publik, institucion ose person (neni 14, paragrafi 3).

<sup>252</sup> Sipas urdhrin të qeverisë nr. 43/2002 për drejtorinë kombëtare antikorrupsion, ky institucion është një ent ligjor i veçantë, brenda prokurorisë atashuar Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë (neni 1, paragrafi 1). Ajo është e pavarur nga gjykatat e drejtësisë dhe prokuroritë që u atashohen atyre, dhe nga autoritete të tjera publike dhe operon ekskluzivisht në përputhje me ligjin dhe për të siguruar përputhshmërinë me ligjin (neni 2).

<sup>253</sup> Institutul pentru o Societate Deschisa, Monitorimi i Procesit të Anëtarësimit në BE: Politikat e Korrupsionit dhe Luftës kundër Korrupsionit, Exclous SRL, Bukuresht 2002, fq. 37.

shenja dalluese të mangësive të mundshme në lidhje me korrupsionin<sup>254</sup>. Këta tregues mund të përfshijnë një numër aspektesh që lidhen me *sjelljen e përgjithshme* të profesionistëve, (p.sh., një rritje e rëndësishme e pasurisë së zyrtarit publik, standarde të larta të jetesës, kontaktet me komunitetin e biznesit dhe qarqet e krimit, dhe mjediset e blerjes së mallrave ose shërbimeve). Ja vlen të analizojmë gjithashtu *treguesit profesionalë* të tillë si shkelja e rregulloreve të brendshme, marrja përsipër në mënyrë vullnetare e detyrave ose kompetencave, kohëzgjatja e zgjidhjes së çështjeve (tepër e gjatë ose në të kundërt tepër e shkurtër), zhdukja e provave në dosje, aksesit nga njerëzit që janë të jashtëm për detyrën, kontaktet e gjera private me palët e interesuara, cilësia e diskutueshme e shpjegimeve për udhëzimet e dhëna/marra, praktikat e paqëndrueshme, një rritje në numrin e ankesave kundër një zyrtari, përpjekjet për të biseduar me kolegët për të trajtuar një çështje në mënyrë të veçantë, fshehja e parregullsive, një numër i madh deklarimesh i të pandehurve të pafajshëm ose marrja e një detyre të veçantë mbas dorëheqjes. Kjo kërkon një sistem vlerësimi të integruar që kombinon vlerësimin individual të zyrtarit publik<sup>255</sup>, vlerësimin e institucionit<sup>256</sup> dhe vlerësimin e sistemit gjyqësor<sup>257</sup>.

#### 4. Parandalimi i korrupsionit në sistemin gjyqësor

Siç kemi treguar gjatë gjithë këtij punimi, cenueshmëria nga korrupsioni shfaqet aty ku përgjegjësi të caktuara janë *monopol* i institucioneve të caktuara, ku vendimet merren *arbitrarisht* dhe ka *mungesë transparence*, ku sistemit dhe individëve iu mungon *përgjegjësia* dhe *integriteti*. Kontrolli i korrupsionit kërkon politika që i trajtojnë këto aspekte. Prandaj, ai kërkon garë, ligjshmëri, transparencë, përgjegjshmëri. Por jo të gjitha këto kërkesa mund të plotësohen në të njëjtën kohë në të gjithë sektorët e sistemit të drejtësisë. Për shembull, ndërsa liberalizimi është i mundshëm në aktivitetin

---

<sup>254</sup> Shih UNODC dhe OSBE, aksesit në drejtësi – pavarësia, paanshmëria dhe integriteti i gjyqësorit. Komploti i vlerësimit të drejtësisë kriminale, shtëpia botuese e OKB-së, Nju Jork, 2006, fq. 14.

<sup>255</sup> Vlerësimi i parë i gjyqtarëve dhe prokurorëve, që sipas ligjeve të reja kryhet çdo tre vjet, filloi në mars 2008 dhe duhet të jetë përfunduar në mars 2009. Për shkak të mungesës së akteve nënligjore, që SCM nuk arriti t'i nxjerrë në kohë, ky vlerësim nuk mbuloi të gjithë aktivitetin nga 2005 – 2007, por vetëm vitin 2007. Në këtë kohë ky punim u finalizua, dhe nuk u bënë publike rezultatet e këtij vlerësimi. Veç kësaj, duke pasur parasysh vlerësimin 2008 – 2010, një vlerësim i përkohshëm për 2008-ën duhet të jetë përfunduar por ai nuk është kryer në ndonjë gjykatë apo prokurori.

Për rregulloret përkatëse, shih vendimin e plenumit SCM nr. 676/2007 (rregullore për vlerësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve) dhe nr. 10/2008 (udhëzime për vlerësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve).

<sup>256</sup> Aktualisht është përpiluar një raport vjetor për aktivitetin e çdo gjykate dhe prokurorie. Ky konsiston kryesisht në të dhëna statistikore. Një sistem për të vlerësuar performancën e gjykatës duke matur impaktin në komunitet ose opinionin e përdoruesve të gjykatës nuk disponohet akoma. Shih Shtojcën e vendimit të SCM nr. 895/2007 që specifikon strukturat e rekomanduara të raportit vjetor.

<sup>257</sup> Aktualisht, çdo autoritet në sistemin gjyqësor bën raportin e vet, por nuk ka vlerësim të sistemit në tërësi. Në besojmë se kjo duhet të bëhet të paktën një herë në dy vjet, dhe duhet të përfshijë një analizë sasiore dhe cilësore të: buxhetit të hequr mënjatë për gjyqësorin; lehtësimin e aksesit të qytetarëve ndaj gjyqësorit; numrin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve të tjerë gjyqësor dhe pagat e tyre; numrin e padive që përfshijnë përgjegjësinë e tyre penale, disiplinore dhe financiare; mënyrat alternative për të zgjidhur çështjen; zbatimin e vendimeve të gjykatës; të dhëna për avokatët dhe noterët; reformat e implementuara në nivel kombëtar dhe lokal. Një referencë në këtë drejtim mund të jetë raporti i sistemeve gjyqësore evropiane të vitit 2004, 2006 dhe 2008 të hartuara nga CEPEJ mbi shtetet anëtare të Këshillit të Evropës - [www.coe.int/cepej](http://www.coe.int/cepej). Sugjerime të tjera, p.sh., mbi statistikat gjyqësore, u bënë nga Banka Botërore në <http://go.worldbank.org/1K40UZ6YL1>.

e avokatëve, noterëve publikë dhe përmbuesve, por ai nuk është i mundshëm për gjyqtarët të cilët sipas ligjit kanë një monopol mbi dhënien e drejtësisë. Gjyqtarët me integritet ngelen brenda kufijve të këtij monopoli pa abuzuar me pushtetin e tyre. Kjo e shpjegon për se diskrecioni i gjyqtarëve mund të eliminohet nëpërmjet detyrimit të tyre që të mbështesin të gjitha masat, aktet dhe vendimet që duhet të publikohen dhe që mund të kundërshtohen në gjykatat më të larta. Kjo shpjegon edhe arsyen për se përgjegjshmëria e gjyqtarit mund të rritet me mjete të brendshme, përkatësisht ngritjen e ndërgjegjshmërisë për integritetin (prandaj është i nevojshëm një kod etik), ndërhyrja e një institucioni të jashtëm, punësimi i duhur dhe përdorimi i një mekanizmi disiplinor, mbi të cilin e ka monopolin këshilli i lartë i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga ana tjetër, anëtarët e Këshillit duhet të ushtrojnë integritetin në përmbushje të detyrave të tyre, i cili sigurohet me mjete të ngjashme me ato të renditura më sipër. Për pasojë, duhet të merren masat për parandalimin e korrupsionit në nivele të ndryshme, nga rregulloret e aktivitetit të një institucioni deri tek menaxhimi dhe financimi, tek cilësia e burimeve njerëzore.

Prandaj, praktikat e parandalimit të korrupsionit duhet t'i trajtojnë njëloj si instrumentet gjyqësore edhe praktikat administrative. Nuk është nevoja që të krijohet formula të reja. Përkthimi dhe shpërndarja e dokumenteve ndërkombëtare, njohja e rregulloreve të brendshme dhe implementimi i praktikave të mira të marra nga institucionet e huaja ose të brendshme do të jenë të mjaftueshme.

#### **4.1 Parandalimi i korrupsionit gjyqësor tek publiku**

Metodat më të dobishme për të parandaluar korrupsionin tek sektori publik lidhen me arsimin dhe informimin<sup>258</sup> e publikut dhe përfshin:

##### ***4.1.1. Informimi dhe edukimi i publikut***

- Legjislacioni kompleks ekzistues dhe institucionet e ndryshme përkatëse ua bëjnë të vështirë qytetarëve që të njihen me mjetet e duhura administrative, civile dhe penale për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin; dhe me mjetet për të siguruar mbrojtjen e tyre në rast se ata e raportojnë korrupsionin. Në të kundërt, gabimet e gjykimit shpesh shihen nga qytetarët si pasojë e korrupsionit dhe si të tilla u njoftohen autoriteteve të ndryshme, të cilët nuk kanë juridiksion për to. Një parakusht i integritetit për përfituesit e drejtësisë është që të jenë në dijeni se çdo të thotë sjellje e drejtë. Një mënyrë për ta siguruar këtë është që të edukohet brezi i ri për antikorrupsionin, që do të kërkonte futjen e kurseve dhe moduleve të etikës<sup>259</sup> në programet shkollore. Këto kurse duhet të fillojnë me përkufizimin dhe shpërndarjen e koncepteve përkatëse të tillë si 'korrupsioni', 'integriteti moral', 'sjellja e drejtë', 'konflikti i interesi', 'papërputhshmëria', 'shërbimi publik', 'interes publik'. Këto kurse mund të kryhen veçanërisht nga përfaqësuesit e OJQ-ve që punojnë në këtë fushë;

- Riedukimi i të rriturve për shkaqet dhe pasojat e korrupsionit dhe inkurajimi i refuzimit të korrupsionit mund të arrihet veçanërisht nëpërmjet fushatave antikorrupsion

---

<sup>258</sup> Për metodat dhe shpjegimet e detajuara, shih Opinioni nr. 7 (2005) për 'drejtësia dhe shoqëria', miratuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë në Këshillin e Evropës, gjendet në [www.coe.int/ccje](http://www.coe.int/ccje).

<sup>259</sup> Në shkollat në Milano, nxënësve Italianë u mësohet për hetimet gjyqësore 'Mani pulite, ('Duart e pastra') të viteve 1990.

në sektorin gjyqësor, që kryhet si në nivelin kombëtar (nëpërmjet medias së shkruar dhe audio-vizive) dhe brenda çdo institucioni (duke përdorur postera dhe zyra informacioni, transmetimet televizive dhe radiofonike me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>260</sup>, e kështu me radhë).

Pa dyshim, paralajmërimi i publikut për pasojat negative të veprimeve të paligjshme të korrupsionit mund të veprojë si një pengesë;

- Dhënia e koncepteve bazë gjyqësore në modulet e organizimit ligjor dhe gjyqësor. Në shkollat dhe, më e rëndësishme, në shkollat e mesme, këto kurse mund të mësohen nga personeli gjyqësor, ose i emëruar formalisht nga drejtuesit e institucionit ose në mënyrë joformale t'u ngarkohet detyra nga shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve (p.sh., shoqata rumune e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shoqata rumune e gjyqtarëve), padyshim organizimi i vizitave të nxënësit dhe studentit në prokurori, gjykata ose vende të vuajtjes së dënimit, mund të ketë një impakt të madh. Vëmendje gjithashtu u duhet dhënë kurseve juridike (duke trajtuar institucionet dhe procedurat gjyqësore) dhe kurset antikorrupsion që duhet të jepen si mësim në departamentet e gazetarisë së universiteteve;

- Deklarimi dhe përhapja e informacionit mbi vendimet e dhëna në gjyqet për korrupsionin<sup>261</sup>. Para së gjithash, bërja publike e këtyre vendimeve ka gjasën që bëjë qytetarët që të mos i drejtohen korrupsionit, veçanërisht në institucionet e zbatimit të ligjit. Së dyti, ajo do forcojë besimin e qytetarëve tek drejtësia, e cila nga ana e saj mund të sjellë efekte pozitive të tilla si inkurajimin e tyre për të raportuar të gjitha këto vepra penale. Megjithëse ekziston kuadri ligjor tashmë, me miratimin e Urdhrit të Qeverisë nr. 1346/2007<sup>262</sup> dhe nenit 30 të Ligjit nr. 78/2002<sup>263</sup>, ai është aplikuar dhe publikuar në mënyrë jo të përshtatshme;

- Përmirësimi i aksesit të qytetarëve ndaj legjislacionit: aksesit ndaj drejtësisë përfshin jo vetëm nëpërmjet aksesit fizik në gjykatat e ligjit, por edhe aksesit intelektual në drejtësi, d.m.th., për burimet e informacionit në ligjet përkatëse (aksesi i lirë). Kjo

---

<sup>260</sup> Një pikë fillimi mund të jetë Protokollin i nënshtruar më 23. 10.2008 nga Këshilli i Lartë i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Korporata Rumune e Radiopërhapjes. Qëllimi kryesor i Protokollin është që të informojë publikun për aktivitetin e Këshillit dhe për operacionin e sistemit gjyqësor në Rumani. Mjetet që duhet të përdoren nga palët për të arritur këtë qëllim, përfshijnë: prodhimin e transmetimeve që synojnë edukimin e publikut për çështjet gjyqësore; shpërndarja e materialeve dhe dokumenteve të përpiluara nga Këshilli që lidhen me aktivitetin e tij; skemat e shkëmbimit të teknologjive që përfshijnë gjyqtarët dhe prokurorët dhe gazetarët, me synimin për të përmirësuar rregullat e komunikimit edhe të zhvillimit të praktikave më të mira nga palët. Deri tani nuk ka pasur raporte për implementimin e këtij Protokollin, as në nivel qendror, as në gjykata dhe prokurori.

<sup>261</sup> Postuar në faqen e Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion [www.pna.ro/hotarari.jsp](http://www.pna.ro/hotarari.jsp). janë disa vendime të formës së prerë për çështjet e ndjekura penalisht nga ky institucion, të dhëna nga gjykata që nga janari 2007. Fatkeqësisht, pak njerëz e dinë se ekziston kjo faqe interneti. Në mënyrë paradoksale, masmedia dhe publiku janë më të interesuar për fillimin e ndjekjes penale për korrupsion kundrejt individëve që kanë një pozicion të caktuar në shoqëri se sa në mënyrën se si finalizohet procesi nga gjyqtarët.

<sup>262</sup> Strategjia thotë: "edhe duke synuar informimin e publikut për të gjithë procesin penal në gjykimet e korrupsionit të nivelit të lartë, vendimet e formës së prerë të marra në gjykime që përfshijnë NAD, do të bëhen publike në çdo tre muaj, duke zbatuar gjithashtu rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale". Duke pasur parasysh këtë, plani i veprimit parashikon: "dërgimin nga gjykatat të dosjeve elektronike që përfshijnë vendimet e formës së prerë të marra në gjykimet që përfshihen në ndjekjen penale të NAD, dhe postimin e këtyre vendimeve në faqen e internetit të NAD, në përputhje të plotë me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, në çdo tre muaj, deri në mars 2008".

<sup>263</sup> "Mund të publikohet një vendim dënimi ose pafajësie në gazetë qendrore, ose në qoftë se ka, në gazetë vendore të përmendura në vendim". Deri tani, nuk dimë ndonjë vendim gjykatë që urdhëron këtë publikim.

është e vetmja rrugë që siguron përfitimin nga të drejtat në mënyrë efektive dhe të parashikueshme. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë ofron një portal legjislativ në <http://legislatie.just.ro>, por është e pamundur të përdoret pa njohur numrin dhe datën e lëshimit të një akti normativ të veçantë. Një alternativë do të jetë [www.e-monitorul.ro](http://www.e-monitorul.ro), e cila ende nuk është operuese. Aksesimi ndaj legjislativit të Bashkimit Evropian është i mundur në <http://eur-lex.europa.eu>;

- Aksesimi ndaj vendimeve të gjykatës: të gjitha vendimet për çështjet gjyqësore, duke përfshirë apelin dhe kundërshtimin e vendimeve, duhet të justifikohen dhe t'u komunikohen palëve të përfshira. Veç kësaj, vendimet duhet të bëhen publike në mënyrë që publiku të familjarizohet me ligjin përkatës të çështjes dhe t'u mundësojë njerëzve që të kenë akses të saktë për mundësitë e fitimit të padisë përpara se ta depozitojnë atë. Ministri i Drejtësisë u ka dhënë gjykatave një portal, <http://portal.just.ro>, por postohen vetëm vendime të caktuara, pasi përzgjidhen në bazë të kriterëve të panjohura. Po kështu, është duke u kryer një program kombëtar që synon publikimin e të gjithë vendimeve të gjykatës. *Jurindex*, një program i iniciuar dhe i zgjeruar deri në nivel kombëtar nga tribunali Vrancea, me burimet e tij, disponohet që prej 4 majit 2009, në [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int), gjithashtu jurisprudenca e GJEDNJ disponohet në <http://curia.europa.eu>;

- Informimi i qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre për përgjegjësitë dhe detyrimet ekzakte të institucioneve dhe stafit në lidhje me qytetarët: nëpërmjet shpërndarjes së vazhdueshme dhe postimit të udhëzimeve, përfituesit e shërbimeve publike do të njohin ekzaktesisht se cili institucion është i ngarkuar për të zgjidhur problemin e tyre dhe cilin departament të një institucioni duhet të kontaktojnë. Në këtë mënyrë kjo do të shmangte kontaktimin e institucionit të gabuar dhe do të ulte riskun e të qenit i mashtruar;

- Rritja e ndjeshmërisë publike nëpërmjet masmedias, internetit, posterave<sup>264</sup>, tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave të shtypit për mjetet ligjore dhe civile për të luftuar korrupsionin: mbulimi konstant nga media i korrupsionit është i domosdoshëm për të shpjeguar para publikut të gjerë se çfarë është korrupsioni, cilat janë shkaqet dhe efektet e tij, si ndëshkohet ai, si mund të japim informacion publik dhe të rritim transparencën e institucioneve<sup>265</sup>

#### 4.1.2 Përfshirja e publikut:

- Përfshirja e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit: parandalimi i korrupsionit nuk është detyrë vetëm e autoriteteve publike; ai ka nevojë edhe për bashkëpunimin e organizatave joqeveritare dhe të të gjithë elementëve të tjerë të shoqërisë civile. Për të krijuar një kulturë antikorrupsion, duhet një promovim konstant dhe rezultatet duhet të vlerësohen rregullisht. Pjesëmarrja aktive e individëve dhe organizatave joqeveritare në parandalimin e korrupsionit gjyqësor mund të përfshijë monitorimin e aktivitetit të gjyqtarëve<sup>266</sup> duke përfshirë cilësinë e vendimeve. Kjo mund

<sup>264</sup> Sipas urdhrorit të kryeministrit nr. 194/2007 për masat për tu përmirësuar shërbimet publike, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 465 e 11 korrikut 2007, të gjitha institucionet që kryejnë shërbimet publike duhet të afishojnë postera antikorrupsion me përmasat A3.

<sup>265</sup> Në këtë drejtim, TI-Ro ka hartuar një "udhëzues për mjetet ligjore për të luftuar krimet e korrupsionit në gjyqësor" si pjesë e fushatës "jo mitës" të implementuar në 2007-2008.

<sup>266</sup> Një nga format e pjesëmarrjes në këtë aktivitet është prania e anëtarëve të shoqërisë civile në SCM, e cila deri tani në Rumani është kapitalizuar në mënyrë të papërshtatshme. Besojmë se SCM duhet të përfshijë edhe përfaqësuesit e avokatisë dhe të universiteteve.

të forcohet duke rritur transparencën e proceseve të vendimmarrjes dhe duke promovuar pjesëmarrjen e publikut në këto procese<sup>267</sup> (p.sh., pjesëmarrja e publikut dhe komentet për kandidaturat dhe pozicionet në sistem, qoftë punësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ose promovimi në Gjykatën e Lartë<sup>268</sup>). Veç kësaj, ajo mund të rritet duke respektuar, promovuar dhe mbrojtur lirinë për të kërkuar, për të marrë, për të botuar dhe për të përhapur informacionin për korrupsionin<sup>269</sup>; dhënia e këshillimit ligjor falas në rastet kur kërkohet mitë gjatë një gjykimi;

- Bërja e aleancave: për të siguruar konsistencën, efikasitetin dhe impaktin e përpjekjeve antikorrupsion, parapëlqehen partneritete dhe platforma të përbashkëta, ose mes organizatave joqeveritare<sup>270</sup> ose mes autoriteteve publike dhe sektorit privat (baza ligjore për bashkëpunimin mund të jetë Ligji për Vullnetarizmin<sup>271</sup>);

Në vitin 2006, një *Komitete Strategjik për Mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion* u krijua si organ konsultativ i kryesuar nga Ministri i Administrimit dhe i Brendshëm. Komiteti përfshinte edhe Sekretarët e Shtetit, Sekretarin e Përgjithshëm, një këshilltar të ministrit të brendshëm dhe të administratës, shefat e drejtorive të përgjithshme në Ministrinë e Brendshme dhe të Administratës, Inspektorët e Përgjithshëm të Inspektorateve të Përgjithshme të M.A.I., Rektorin e Akademisë Policore "Alexandru Ioan Cuza" Presidentin e Trupës Policore Kombëtare, Udhëheqësin e Sindikatës Kombëtare të Policisë dhe personelin e M.A.I. dhe një përfaqësues nga çdo tetë organizata joqeveritare.

Duke pasur parasysh besimin e ulët të qytetarëve në institucionet antikorrupsion të Rumanisë dhe nevojën për të forcuar përpjekjet e institucioneve publike dhe të shoqërisë civile për të reduktuar korrupsionin në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. disa institucione kanë krijuar dhe mbështetur *Qendrën Kombëtare për Integritetin*, duke përfshirë Shoqatën për Implementimin e Demokracisë dhe Ministrinë e Brendshme dhe të Administratës, me ambasadat Britanike dhe Holandeze në Rumani si partnerët kryesorë, bashkë me disa të tjerë. Qendra kombëtare për Integritet, u krijua me Protokollin e Partneritetit nr. 406508/02.10.2006, nënshkruan nga Shoqata për Implementimin e Demokracisë (AID) dhe Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion. Më

---

<sup>267</sup> Një shembull jepet në faqen e internetit [www.alianzaprojusticia.org.pa](http://www.alianzaprojusticia.org.pa) krijuar nga Aleanca e Qytetarëve për Drejtësi në Panama, që është krijuar për të lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarin në gjetjen e zgjidhjeve për administratën e drejtësisë, për të edukuar qytetarët, për të promovuar mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për të promovuar reformën gjyqësore dhe për të monitoruar administrimin e drejtësisë në çështje të caktuara.

<sup>268</sup> Një shembull është projekti Justicia Viva i zhvilluar nga Instituti për Mbrojtjen Ligjore të Perusë, në [www.justiciaviva.org.pe](http://www.justiciaviva.org.pe) që boton mes të tjerash, jetëshkrime të aplikantëve për postet e Gjykatës së Lartë dhe monitoron zgjidhjet për çështjet kyçe të korrupsionit.

<sup>269</sup> Kjo liri mund t'iu nënshtrohet kufizimeve të caktuara, të cilat megjithatë duhet të parashikohen nga ligji dhe janë të domosdoshme: respektimi i të drejtave ose imazhit të të tjerëve, mbrojtja e sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit publik dhe moralit.

<sup>270</sup> Një shembull i mirë është Aleanca Antikorrupsion në Republikën e Moldavisë ([www.alianta.md](http://www.alianta.md)), që është një shoqatë vullnetare e organizatave joqeveritare që funksionojnë në fusha të ndryshme, veçanërisht në politikat publike, ligjin, institucionet demokratike. Aleanca aktualisht ka rreth 30 anëtarë, bashkë me masmedian, organizatat e rinisë, arsimit dhe ekspertët e shkencës, etj.

<sup>271</sup> Ligji për Vullnetarizmin nr. 195/20.04.2001, ribotuar në Gazetën Zyrtare nr. 276 të 25 prillit 2007. Të jesh vullnetar do të thotë të punosh për interesin publik me iniciativën tënde (në fusha të tilla si: asistenca dhe shërbimet sociale, të drejtat e njeriut, kujdesi shëndetësor, kultura, arti, arsimit, trajnimi, shkenca, ndihma, feja, sporti, mbrojtja mjedisore, programet sociale dhe komunitare, etj); vullnetarizmi bazohet në një kontratë jofitimprurëse të nënshkruar nga një individ vullnetar dhe një enti ligjor, apo organizate pritëse (një person juridik publik ose privat jo fitimprurës), me anë të së cilës vullnetari merr përsipër të kryejë punë për interesin publik, pa marrë shpërblim material.

vonë, AID dhe zyrtarët madhorë nënshkruan me Ministrinë e Brendshme një partneritet të ri bashkëpunimi me synimin për të siguruar vazhdimësinë e Qendrës dhe një mjedis të favorshëm, të pavarur dhe vendimtar për arritjen e qëllimeve të përbashkëta të projektit: Protokoll i Partneritetit nr. 1784/28.09.2007.

- Inkurajimi i komenteve për sjelljen dhe rezultatet e aktivitetit të agjentëve publikë. Kritikë për procedurat gjyqësore, vendimet e gjykatës dhe gjyqtarët. Pavarësisht riskut të sulmeve të pamërituara ose të manipuluar, për sa kohë që ata e dinë se janë nën shqyrtimin publik, gjyqtarët do t'i kushtojnë më tepër vëmendje shmangies së gabimeve në marrëdhëniet e tyre me publikun dhe në hartimin e opinioneve të tyre. Kjo është arsyeja për se duhet të eliminohen barrierat legjislative, të tilla si ndëshkimi për përçmimin e gjykatës<sup>272</sup>

- Anketimet e rregullta: konsultimet, pasuar nga rregullimi i gabimeve, mund të ndihmojë për të përmirësuar besimin në sektorin e drejtësisë dhe për këtë arsye të reduktojë përpjekjet për korrupsion nga publiku.

## **4.2 Parandalimi i korrupsionit tek personeli gjyqësor**

Në nivel global, sistemi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të bazohet në pavarësinë strukturore të gjyqësorit dhe nevojën për të mbrojtur gjyqtarët, prokurorët dhe policinë gjyqësore nga çështjet e mëposhtme: presioni politik dhe përzierja në punën e gjyqtarëve; udhëzimet e dhëna nga qeveria për prokurorët; manipulimi i përzgjedhjes, emërimit, promovimit ose revokimit të gjyqtarëve e prokurorëve; imuniteti i krijuar për politikanët të akuzuar për korrupsion, e kështu me radhë<sup>273</sup>.

Në nivel individual, si gjyqtarët e prokurorët dhe personeli tjetër gjyqësor duhet të edukohet me parimet antikorrupsion. Para se të hyjë në fuqi, strategjia antikorrupsion duhet të luajë gjithashtu një rol edukues.

Njohja e vetes<sup>274</sup> dhe vetëkontrolli nevojiten për të zbrapsur një ofertë tunduese nga ana financiare që shkon kundër parimeve të vetes. Fatkeqësisht, këto aspekte nuk diskutohen ndonjëherë brenda sistemit, dhe as shkollat ose fakultetet juridike nuk trajtojnë vullnetin individual dhe rezistencën ndaj këtyre tundimeve. Sistemi aktual gjyqësor fokusohet më tepër në shtypjen dhe kërcënimin e humbjes së avantazheve të caktuara (sanksioneve disiplinore ose madje penale) në rast të largimit nga parimet e vetes, më tepër se sa në parandalimin dhe promovimin e këtyre parimeve.

Për të parandaluar korrupsionin mes personelit gjyqësor dhe për të reduktuar mundësitë për korrupsion, janë të mundshme zgjidhjet e mëposhtme:

### **4.2.1 Kritere objektive dhe trajnimi profesional**

---

<sup>272</sup> "Gazetarët duhet të jenë në gjendje që të komentojnë në mënyrë të drejtë proceset ligjore dhe të raportojnë korrupsionin e dyshuar, faktik ose prirjen. Ligjet që kriminalizojnë shpifjet ose që iu japin gjyqtarëve diskrecionin për të caktuar kompensime difektoze në çështjet e shpifjeve, pengojnë median që të investigojë dhe të raportojë kriminalitetin e dyshuar dhe duhet të reformohen" (TI, Raporti i Korrupsionit Global, në [www.transparency.org](http://www.transparency.org)).

<sup>273</sup> Ndërfaqja OCTOPUS – Korrupsioni dhe Demokracia, Strasburg, 20-21, nëntor 2006, seminar për demokracinë, korrupsionin dhe drejtësinë.

<sup>274</sup> Daniel Goleman, Richard Boyatzis, Annie McKee, Inteligjencë emocionale në leadership, Curtea Veche, Bukuresht, 2005, fq. 69.

- Vlerësimi duhet të jetë i rregullt dhe duhet të synojë që të gjejë zgjidhjet për të përditësuar dhe për të përmirësuar në mënyrë konstante trajnimin profesional të personelit gjyqësor, si në mjediset formale të mësimi dhe në ato joformale;

- Ekspertët e insolvencës dhe praktikantët duhet të emërohen nga organet gjyqësore sipas kriterëve që sigurojnë konkurrencë të drejtë dhe promovimin e kompetencës;

- Trajnimi i stafit gjyqësor duhet të përfshijë gjithashtu njohuri teknike bazë për tu mundësuar atyre që të zbulojnë gabimet e (pa)qëllimshme të personelit gjyqësor ndihmës, si ekspertët. Trajnimi i specializuar në këtë drejtim dhe publikimi i manualeve të praktikës së mirë rekomandohen shumë;

- Zhvillimi i *teorisë së paanshmërisë së dukshme*: sistemi duhet të përqafojë teorinë që nënvizon rëndësinë e paanësisë së dukshme dhe konflikteve të dukshme (të mundshme) të interesit. Si rregull, agjentët publikë paraqesin formalizëm të tepërt - ata nuk rrinë pa marrë vendime edhe në rastet e konfliktit faktik të interesit kur një çështje nuk rregullohet specifikisht nga ligji. Kjo tregon një mospërfillje të parimeve të përgjithshme dhe, ç'është më e rëndësishme, teorinë e paanësisë së dukshme, që do të përjashtonte përfshirjen e tyre në çështje;

- Punësimi i personelit, përzgjedhja, promovimi dhe sistemi i rregullt i vlerësimit duhet të bazohen ekskluzivisht në vlerësimin objektiv të meritave, të performancës dhe aftësive profesionale. Kriteret, duhet të komunikohen paraprakisht, të jenë objektive dhe transparente dhe të kundërshtueshme në gjykatë.

#### **4.2.2 Promovimi i kulturës së integritetit<sup>275</sup>.**

- Arsimimi deontologjik i të gjithë punonjësve gjyqësorë: së pari, kjo mund të arrihet nëpërmjet futjes së detyrueshme të Kodit të Sjelljes të përmendur në bibliografi për konkurimet e punësimit për zyrat publike. Së dyti, skemat e trajnimit profesional duhet të synojnë që të sigurojnë që të gjitha gjykatat të perceptohen në të gjithë aktivitetet se i trajtojnë palët njëllëj (d.m.th., në mënyrë të paanshme dhe pa diskriminim të bazuar tek raca, seksi, feja, origjina etnike apo statusi social).

Gjyqtarët dhe personeli ndihmës duhet të trajnohen për të zbuluar rastet kur prirja faktike ose e dukshme mund të perceptohet dhe t'i trajtojnë këto çështje në një mënyrë që përforcon besimin e publikut dhe respektin e tij për gjykatat. Avokatët nuk duhet të anashkalojnë - ata duhet të marrin arsim të veçantë deontologjik në mënyrë që të mos kontribuojnë, me qëllim apo pa qëllim për të thelluar mosbesimin e publikut tek gjyqtarët dhe prokurorët;

- Masat e testimit të integritetit nga koha e marrjes në punë dhe në mënyrë të rregullt, duke përdorur agjentë të fshehtë mes mjeteve të tjera, duhet t'u komunikohen personelit. Procedurat e duhura nevojiten për përzgjedhjen dhe trajnimin e atyre që do të mbajnë pozicione publike të cilat konsiderohen si të cenueshme nga korrupsioni në mënyrë të veçantë. Me sa duket, këto procedura duhet të përfshijnë kontrollues të ndershëm;

- Reduktimi i kontaktit të drejtpërdrejtë me publikun për të eliminuar burimet e drejtpërdrejta të ndikimit negativ: ky kontakt kryesisht përfshin departamentet ndihmëse në gjyqësor, që mund të zvogëlohen me anë të teknologjive moderne (të tilla si e-maili, telefoni, pagesat elektronike, postimi i informacionit të çështjes përkatëse në internet ose në tryezat e informacionit); publikimi i kalendarit të trupit gjykues, të pjesëtarëve të

<sup>275</sup> Vendimi i qeverisë nr. 1346/2007 parashikon që Rumania të marrë përsipër të "përpilojë, në korrik 2008, një udhëzues antikorrupsion për të forcuar integritetin e personelit të saj dhe ta përhapë atë gjerësisht si shembull i praktikave të mira për shërbimet e tjera publike".



trupit gjykues, të listave të zëvendësuesve (për të kontrolluar se si janë formuar trupat gjykues); ose arkivimin elektronik të dosjeve të çështjes (për të reduktuar kohën që nevojitet nga punonjësit e arkivës ose të eliminohen ata tërësisht). Agjentët e vendimmarrjes gjithashtu mund të mbrohen. Arkitektura e vendit të punës nuk duhet të lejojë ndërhyrjen e publikut në punën e përditshme të agjentëve publikë.

Masat për këtë arsye mund të përfshijnë edhe rotacionin e rregullt të personelit që punon në sektorët e cenusshëm (p.sh., zyrat e marrëdhënieve me publikun, zyrat që caktojnë çështjet në mënyrë rastësore)<sup>276</sup> ose madje transferimin e tyre në zona të ndryshme gjeografike;

- Kuptimi i saktë i detyrave të tij dhe detyrave të të tjerëve;
- Fitimi i njohurive që janë të dobishme në marrëdhëniet publike (psikologji, sociologji, gramatikë, retorikë);
- Asimilimin e praktikës në çështjet disiplinore: kjo përfshin komunikimin rregullisht për punonjësit, të sanksioneve që zbatohen për ta në periudha përkatëse dhe arsyet pse organi disiplinor e bëri këtë.<sup>277</sup> Theks i veçantë duhet t'i vihet shpërndarjes dhe sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore në lidhje me kundërshtimin dhe përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi, për të cilët ende nuk ka të dhëna publike. Në fakt, mungesa e praktikës gjyqësore konsistente është një problem i madh në Rumani siç ilustron Beian kundër Rumanisë (2008). Në atë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se mungesa e precedentit bëhet burim i pasigurisë gjyqësore dhe minon besimin publik tek gjyqësori. Në të kundërt, precedenti kontradiktor i gjykatave të ndryshme dhe vendimet inkonsistente të trupave gjykues në të njëjtën gjykatë hap derën për praktika arbitrare;
- Trajnimi për etikën: rëndësia e kodit të sjelljes si një instrument kyç në parandalimin e korrupsionit do të detajohet më poshtë;
- Diskutimi i rregullt nga profesionistët e ligjit për rolin e gjyqësorit dhe përgjegjësitë e çdo profesioni ligjor. Përfaqësuesit e të gjithë profesioneve ligjore duhet të takohen rregullisht dhe të identifikojnë format e përshtatshme të bashkëpunimit. Ata duhet të dinë se sjellja e secilit është kritike për krijimin e një perceptimi pozitiv të publikut për integritetin e sistemit. Detyrimi dhe mjetet për të mos u shoqëruar me kolegët me sjelljeje të padrejtë gjithashtu duhet të marrë vëmendje të veçantë.

#### **4.2.3 Trajnimi i specializuar antikorrupsion**

- Organizimi i debateve për korrupsionin në gjyqësor;
- Vënia në dijeni për rregulloret ndërkombëtare si për detyrat funksionale dhe për korrupsionin: punonjësit duhet të jenë në dijeni që integriteti nuk mund të imponohet, por përqafohet në mënyrë individuale. Kjo kërkon shpjegimin dhe paraqitjen e përpjekjeve të bëra më përpara nga vende të tjera ose nga organizata ndërkombëtare;

---

<sup>276</sup> "Lëvizshmëria e nëpunësve civil brenda një autoriteti ose një institucioni publik do të arrihet kryesisht duke siguruar mbrojtjen e nëpunësve civilë në fushat e cenusshme nga korrupsioni, nëpërmjet caktimit të rregullt të detyrave të ndryshme ose nëpërmjet transferimit të përkohshëm në departamente të tjera të institucionit ose autoritetit publik" thotë Strategjia Kombëtare 2008-2010 për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorë të cenusshëm dhe administratën publike dhe vendore.

<sup>277</sup> Si shembull negativ, përmendim se SCM vetëm nxjerr deklarata shtypi për sanksionimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke specifikuar emrin dhe aktin ligjor që rregullon formën përkatëse të shkeljes, pa detaje për shkeljen. Institucionet e tjera gjyqësore nuk japin madje as statistikën për sanksionet që aplikojnë. Prandaj, personeli nuk mund të identifikojë llojet e sjelljeve të padëshirueshme që mund të ndëshkohen nga ligji.

- Përfshirja në trajnimin profesional të specializuar të integritetit në sektorin publik dhe të moduleve të antikorrupsionit: mund të organizohen seminare të rregullta etike ndoshta nga trajnerët e etikës dhe deontologjisë me Institutin Kombëtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ose metoda të tjera mund të përdoren për të promovuar kulturën e integritetit;

- Diagnoza pjesëmarrëse: grupet e fokusit mund të krijohen, të përbëra nga institucioni në fjalë, për të rritur dijenitë e personelit për risqet e korrupsionit në ushtrimin e detyrave të tyre, për të ndihmuar identifikimin e sektorëve të cenueshëm brenda institucionit të tyre dhe për të gjetur strategjinë më të mirë me anë të të cilës të luftohet korrupsioni. Duhet të përmblidhet një analizë e përgjithshme e risqeve të korrupsionit në çdo 2-3 muaj dhe ndërkohë sektorët e cenueshëm duhet të monitorohen nga afër. Rregulloret e brendshme duhet të përmirësohen rregullisht. Informacioni për risqet e korrupsionit gjyqësor, mundësisht duke përfshirë raporte periodike, duhet të bëhet publik<sup>278</sup>.

### **4.3 Parandalimi i korrupsionit gjyqësor në nivelin institucional**

4.3.1 Në nivel të përgjithshëm, duhet të aplikohen parimet e menaxhimit.

Deri në një farë mase, lufta kundër korrupsionit mbivendoset me përpjekjet për të eliminuar burokracinë e tepërt, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të rritur profesionalizmin e agentëve publikë. Kjo është arsyeja për se pozicionet udhëheqëse duhet të plotësohen me persona që kanë njohuri për menaxhimin dhe bazuar në një plan menaxhimi, implementimi i të cilit duhet të monitorohet nga afër<sup>279</sup>. Një nga problemet kryesore që ndikon tek gjyqësori është ngarkesa e tepërt e punës. Sipas vendimit të qeverisë nr. 1346/2007, deri në qershor 2008, SCM-së iu kërkua që të krijonte një ngarkesë pune optimale për gjyqtarët dhe prokurorët, kjo nuk ka ndodhur akoma. Shpesh, publiku i ngatërron gabimet në trajnim ose në performancën e gjyqtarëve dhe prokurorëve me mungesën e integritetit, që përforcon akuzat për korrupsion. Por e vërteta është se me gjysmën e gjyqtarëve të detyruar për të zgjidhur 100-150 çështje në muaj dhe prokurorëve 51-100 çështje<sup>280</sup>, gabimet janë të pashmangshëm.

Po kështu, roli i sekretarëve të gjykatave, të cilët janë të kufizuar me funksionet rutinë të sekretarit në Rumani - duhet të forcohet dhe t'i jepet më tepër rëndësi. Aktualisht ata duhet të bëhen asistentë për gjyqtarët dhe prokurorët, me të cilët ato duhet të përbëjnë një ekip për të menaxhuar një çështje, ose madje t'u lejohej që të zgjidhin çështje më të thjeshta vetë (fletëthirrjet për pagesat, urdhrat e kryetarëve të gjykatave, transaksionet, pagesat për fëmijët, ndërprerjen e procesit, etj)<sup>281</sup>

<sup>278</sup> Për këtë detyrim të administratës publike, shih nenin 10 i Konventës së OKB-së.

<sup>279</sup> Që prej 2005-ës, pozicionet udhëheqëse në gjykata dhe në prokurori janë caktuar sipas garave të promovimit. Megjithatë, më shpesh planet e menaxhimit të hartuar nga kandidatët as nuk bëhen publikë, as u komunikohen personelit të atyre gjykatave dhe prokurorëve. Po kështu, nuk ka mjete për monitorimin e mëvonshëm të progresit të bërë për arritjen e këtyre angazhimeve, as me vlerësimin e performancës së udhëheqësve të institucionit as gjatë inspektimit administrativ.

<sup>280</sup> Barometri i sistemit të drejtësisë, i kryer nga Instituti për Politikën Publike dhe Instituti Kombëtar i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në vitin 2008, gjendet në [www.ipp.ro](http://www.ipp.ro).

<sup>281</sup> Me sa duket, legjislacioni thelbësor dhe madje Kushtetuta duhet të amendohen përkatësisht. Për një model të roleve të nëpunësve të gjykatave në shtetet evropiane, shih statutin model për një nëpunës drejtësie evropian miratuar nga Bashkimi Evropian i nëpunësit gjyqësor në vitin 2005 dhe letra jeshile për nëpunësin gjyqësor evropian miratuar nga e njëjta organizatë në vitin 2008, që gjendet edhe në rumanisht, në [www.rechtspfleger.org](http://www.rechtspfleger.org). Në të njëjtat linja, nuk është kaq shumë numri i gjyqtarëve që kanë nevojë për t'u rritur, por numri i nëpunësve gjyqësor. Në çdo rast, krijimi i gjykatave të reja nuk është zgjidhje. Në të

Si e tillë, besojmë se futja e formularëve të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve (p.sh., arbitrazhi, rregulluar me ligjin nr. 192/2006, i cili hyri në fuqi një vit më parë por nuk është praktikuar<sup>282</sup>), procedurat për menaxhimin e çështjes për gjyqtarët, si dhe përmirësimi i menaxhimit të gjykatës, janë veçanërisht të rëndësishme. Në këtë drejtim, ¼ e gjyqtarëve besojnë se gjykatat dhe prokuroritë duhet të drejtohen nga menaxherë të trajnuar, nga jashtë gjyqësorit, të cilët mund të rrisin efikasitetin e aktivitetit të gjykatës dhe prokurorisë me anë të metodave shkencore të menaxhimit.

**4.3.2** Tërësisht në lidhje me *antikorrupsionin* në gjyqësor, siç u deklarua më sipër, nuk ka nevojë që të nxjerrim metoda të reja antikorrupsion; asimilimi i praktikës më të mirë, tashmë në përdorim në vende të tjera<sup>283</sup> ose nga institucione të tjera kombëtare është i mjaftueshëm. Masat që duhen marrë në nivel institucional janë:

- *Reduktimi i pushtetit diskrecionar*: legjislacioni duhet të modifikohet në mënyrë që të reduktojë fuqinë diskrecionare të dhënë nga ligji. Kjo përfshin faza të tilla si 'peshimi' ose 'kërcënimi specifik për rendin publik', që janë për t'u vlerësuar përpara nënshkrimit të një urdhër arresti ose 'situatë përjashtimore' të përdorura në kodet e procedurës për rregullimin e masave të caktuara. Të gjitha këto lënë hapësirë për interpretim subjektiv, të cilat mund tu lejojnë agjentëve publik që lehtësisht t'i kapërcejnë detyrat e tyre, pa ndonjë mjet sanksioni për këto vendime<sup>284</sup>. Në të njëjtat linja, deklaratat e arsytimit të vendimeve të bëra nga organet gjyqësore<sup>285</sup> dhe që u komunikohen palëve ndërgjyqëse, duhet të përmirësojnë termat e masës dhe përmbajtjes. Kështu, sipas një anketimi të Gallupit, të janarit 2008, 66% e të pyeturve që kishin pasur kontakt me gjyqësorin mbi dy vjet deklaruan se ata nuk i kishin kuptuar argumentet e dhëna nga gjykata. Vendimet e agjentëve publikë duhet të shoqërohen me deklaratat e arsytimit, në mënyrë që ato të mund të analizohen nga palët e interesuara dhe të kontrollohen për ligjshmërinë dhe plotësinë e tyre në qoftë se apelojnë. Besojmë se deklaratat që përvijojnë arsyet duhet të shoqërojnë edhe vendimet që çojnë transferimin e një çështjeje nga një agjent në tjetrën - nga një punonjës policie tek një prokuror, nga një prokuror tek një prokuror i nivelit më të lartë, ose nga një gjykatë tek një tjetër. Në qoftë se legjislacioni do të modifikohet në mënyrë që të implementojë parimin e ndjekjes penale diskrecionare, duhet të krijohen kritere objektive për vendimet diskrecionare të bëra nga prokurorët<sup>286</sup>;

- *Rritja e transparencës*: raportet e punës së gjykatave, jetëshkrimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të dhënat statistikore, ose anëtarët e trupave gjykues nuk janë publikë. Veç kësaj, shumë gjykata nuk arrijnë të përditësojnë faqet e tyre të internetit. Kjo është

---

kundërt, gjykatat e vogla të cilat janë në gjendje të sigurojnë plotësimin e stafit dhe trajnimin e personelit dhe që harxhojnë burimet financiare, duhet të çmontohen (duke racionuar gjykatat).

<sup>282</sup> Përmbledhjen e instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare të arbitrazhit, shih Cristi Danilet, Claudiu Ignat, Zeno Sustac, Medierea – standarde si proceduri, Editura Universitara, Bukuresht, 2008.

<sup>283</sup> Më të rekomanduarat janë Komisioni i Pavarur kundër Korrupsionit në Honkong ([www.icac.org.hk](http://www.icac.org.hk)) dhe Komisioni i Vigjilencës qendrore të Indisë (<http://cvc.nic.in>).

<sup>284</sup> Republika e Moldavisë madje përdor një guidë teorike dhe praktike për kryerjen e vlerësimeve antikorrupsion të projekt-akteve normative, hartuar nga qendra për luftën kundër krimin ekonomik dhe korrupsionit në vitin 2007 dhe që gjendet në [www.justice.gov.md/upload/Ghid%20CAPC.doc](http://www.justice.gov.md/upload/Ghid%20CAPC.doc).

<sup>285</sup> Shih opinionin e CCJE nr. 11 e vitit 2008 për cilësinë e vendimeve gjyqësore, në [www.coe.int/ccje](http://www.coe.int/ccje).

<sup>286</sup> Kjo është pikërisht arsyeja përse Rekomandimi (2000) 19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për rolin e ndjekjes penale në sistemin e drejtësisë penale propozon transparencën dhe masa mbrojtëse të barazisë në ndjekjen penale të çështjeve në vendet që kanë miratuar parimet e ndjekjes penale diskrecionare, pas Rekomandimit nr. (87) 18 për thjeshtimin e drejtësisë penale propozoi këtë parim pa detaje të mëtejshëm.

arsyeja për se i duhet dhënë vëmendje e veçantë kompjuterizimit, që ndihmon të reduktojë rastet e korrupsionit. Kompjuterizimi është i rëndësishëm për palët, duke filluar nga regjistrimi i çështjeve dhe gjetja e informacionit zyrtar në lidhje me gjyqtarët që gjykon një çështje të veçantë, deri tek përdorimi i internetit në mënyrë që të gjurmohet çështja dhe ligji ekzistues i çështjes. Është me dobi dhe për masmedian, të cilat mund të jenë në gjendje të përdorin informacionin për aktivitetin e përgjithshëm të një gjykate, prirjet e krimit, etj. Është me dobi për personelin gjyqësor, në caktimin rastësor të çështjeve (veçanërisht në gjykatat<sup>287</sup> dhe në agjencinë kombëtare të integritetit) dhe menaxhimi elektronik i çështjeve, me anë të të cilave mund të identifikohen në çdo moment caktimi dhe ecuria e një çështjeje si dhe numri i çështjeve të caktuara një gjyqtari ose inspektori. Nuk është vetëm informacioni i lidhur me çështjen që duhet t'i komunikohet publikut por edhe informacioni në lidhje me aktivitetet administrative dhe financiare (p.sh., ekzistenca e një sistemi rastësor të caktimit dhe funksionimit të tij, kontrollet dhe inspektimet e brendshme, sanksionet e aplikuara, anëtarësia e strukturave drejtuese, procedurat për depozitimin e ankesave ose sugjerimit për përmirësimin e punës, buxhetet e alokuara për një institucion dhe shpenzimet e tij, burimet njerëzore, etj).<sup>288</sup>

Meqenëse roli i gjyqtarëve kufizon mundësinë e tyre për të komunikuar direkt me publikun<sup>289</sup>, roli i zëdhënësve duhet forcohet në mënyrë që të ruhet një kontakt i përhershëm midis institucionit dhe medias;

- *Forcimi i përgjegjësisë*: të drejtat dhe detyrimet profesionale duhet të rregullohen sa më qartë që të jetë e mundur. Duhet t'i shpërndahen personelit kodet deontologjike të të gjithë institucioneve ligjore dhe duhet të kontrollohet implementimi i tyre. Udhëheqësit e institucionit duhet të paralajmërojnë personelin për të përmbushur, në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur, detyrimin e tyre për të dorëzuar deklaratat e pasurisë, interesave dhe fafesisit. Kjo masë duhet të shoqërohet me monitorimin nga afër të implementimit të saj dhe me sanksione për ata që nuk e zbatojnë<sup>290</sup>. Në varësi të situatave specifike me të cilat përballë personeli, kreu i një institucioni ose departamenti duhet të garantojë udhëzimin me shkrim (të legjitimojë praktikën e

---

<sup>287</sup> Caktimi rastësor i çështjeve e bën të pamundur për gjyqtarët konkretë që të zgjidhen për çështje të caktuara, që është edhe një mjet për të parandaluar korrupsionin në sistem (strategjia për reformën e gjyqësorit 2005-2007, linja e veprimtimit nr. 1.II). Që prej vitit 2005, të gjitha gjykatat në vend janë furnizuar me sistemet e teknologjisë së informacionit dhe me programe të specializuara kompjuterike për të kryer caktimin rastësor të çështjeve për trupat gjykues. Aktualisht, caktimi rastësor është një praktikë në të gjitha gjykatat e vendit. Për incidentet procedurale që nuk mund të zgjidheshin brenda sistemit t'i (për shembull papajtueshmëritë), vendimi nr. 71 i SCM i datës 9 mars 2005 është aplikuar, për të siguruar caktimin rastësor. Kjo rezolutë përfshin gjithashtu dispozitat që mbrojnë vazhdimësinë e trupit gjykues dhe të gjyqtarëve në panele.

<sup>288</sup> Faqja e internetit të pushtetit gjyqësor të Kosta Rikës është një shembull i mirë. Ajo jep informacion gjithëpërfshirës për legjisllacionin, rregulloret, ligjin e çështjes, aksesin për dosjet e çështjes, raportet e punës, ankesat on-line, etj. [www.poder-judicial.go.cr](http://www.poder-judicial.go.cr).

<sup>289</sup> Megjithatë, në Peru ka një forum komunikimi virtual për gjyqtarët dhe prokurorët, studentët e drejtësisë dhe profesorët, personat e tjerë e interesuar në çështjet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë antikorrupsionin (gjyqësor) dhe reformën e gjyqësorit, në [www.cajpe.org.pe/rij](http://www.cajpe.org.pe/rij).

<sup>290</sup> Për shembull në 25 gusht 2008, deklarata e shtypit e SCM njoftonte se disa qindra gjyqtarë dhe prokurorë nuk kishin paraqitur deklaratat e tyre të pasurisë dhe interesit për vitin 2007, ose e kishin bërë atë pasi kishte skaduar afati. Megjithëse shkeljet e këtij detyrimi përbëjnë një kundërvajtje, Agjencia Kombëtare e Integritetit nuk i gjobiti gjyqtarët dhe prokurorët; gjithashtu, megjithëse shkeljet e këtij detyrimi përbëjnë çështje të shkeljeve, SCM nuk aplikoi ndonjë sanksion disiplinor.

mirë)<sup>291</sup>. Duhet të përcaktohen standarde financiare dhe kohore për menaxhimin e çështjeve, duhet të përcaktohen rregulla të qarta për aksesin ndaj zyrave në institucion dhe duhet të ekzistojë një sistem kujtese për të paralajmëruar se ka skaduar afati përfundimtar për një detyrë specifike. Punësimi i personelit dhe komisionet e prokurimit publik, duhet të përfshijnë anëtarë të trajnuar. Rregulloret e brendshme ose kodet deontologjike duhet të detyrojnë përdorimin e aseteve publike në mënyrë ekskluzive për interesin publik;

- *Udhëheqja dhe inspektimi efektiv*: trajnimi i personelit të institucionit, duke përfshirë stafin ndihmës dhe administrativ, por që të organizohet rregullisht. Rekomandohen inspektimet e pa njoftuara. Do të jetë e dobishme që të montohen edhe kamera në zonat ku personeli dhe publiku kanë kontakt të drejtpërdrejtë. Njoftimi publik i këtyre masave, bashkë me procesverbalet e seancave dhe proceset e gjykimit, që të kontrollohet saktësia e procesverbaleve dhe të vlerësohet sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjithashtu mund të pengonin shkeljet e korrupsionit. Elemente të tjerë për t'u kontrolluar përfshijnë arsyet për shtyrjen e procesit, arsyet për ndryshimin e caktimeve fillestare të çështjes (veçanërisht zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues, më tepër se sa zëvendësimi i gjyqtarit dhe situatat për përjashtimin e tij), dhe mospërputhshmëritë apo trajtimi i aseteve të konfiskuara. Testimi i integritetit është një metodë tjetër thelbësore ku subjekti përballet me një situatë që i ngjan rasteve të jetës reale, në mënyrë që të mundësojë se si të identifikojë reagimet dhe si të adoptojë sjelljen e duhur. Analiza e këtyre konstatimeve të testeve mund të çojë në identifikimin e sektorëve të cënueshëm, të faktorëve të riskut, të përmirësimit të praktikave të mira në institucion ose ndryshimet e mundshme në detyrat apo pozicionet e punonjësve. Rekomandohet edhe përdorimi i agjentëve të fshehtë që ofrojnë mitë për personelin gjyqësor dhe aplikimi i sanksioneve administrative në raste kur mita pranohet (përkatesisht, sanksione penale nuk aplikohen sepse neni 68 i Kodit të Procedurës Penale ndalon kryerjen e veprave penale për të marrë prova). Përfundimisht, ndalimi i marrëdhënieve direkte hierarkike midis bashkëshortëve ose të afërmeve të shkallës së parë, të cilat sipas nenit 95, paragrafi 1 i ligjit nr. 161/2003 aplikohet vetëm për nëpunësit civilë, duhet të zgjerohet për të mbuluar të gjithë sistemin publik gjyqësor;

- *Implementimi i sistemeve të sigurisë*: ka të bëjë me mbrojtjen fizike të personelit (p.sh., aksesit i sigurt në ndërtesën e gjykatës, sallat e gjykatës dhe zyrat e gjyqtarëve) dhe sigurinë elektronike (parandalimi i aksesit të paautorizuar në bazat e të dhënave të brendshme, regjistrimi i kërkimeve në sistemin e brendshëm TI)<sup>292</sup>. Personeli duhet të zbatojë procedurat e sigurisë (p.sh., ndalimin e marrjes së dokumenteve elektronike ose fizike jashtë institucionit), procedurat e menaxhimit të konfidencialitetit dhe informacionit të klasifikuar (p.sh., të gjithë gjyqtarët dhe nëpunësit e gjykatës në Rumani kanë kompjuterin e tyre në gjykatën ku ata punojnë, por nuk kanë marrë udhëzimet e duhura për fjalëkalimet e tyre personale, për monitorimin e faqeve të

<sup>291</sup> Një shembull është neni 5, paragrafi 2 i ligjit nr. 303/2004, një rregullore që nuk zbatohet sa duhet në disa gjykata. Për konfliktet e interesit që ndodhin në mënyrë të përsëritur në një gjykatë, këshilli drejtues mund të nxjerrë një udhëzim që mund të zbatohet për të gjitha rastet e ardhshme të llojit.

<sup>292</sup> Në shkurt 2009 bazat e të dhënave të policisë, autoritetit kombëtar penitenciar dhe të disa gjykatave në Bukuresht dhe qytete të tjera u sulmuan nga hakerat duket përdorur Downadup (Conficker), që konsiderohet si një nga viruset më të rrezikshme kompjuterike të të gjitha kohërave në lidhje me nivelin dhe gamën e kërcënimit, me mbi 15 milionë kompjutera të infektuar në 6 muajt e fundit. Pasi instalohet, virusi e bën të paaftë sistemin e sigurisë së kompjuterëve dhe e asgjëson atë. Pastaj ai lidhet me një server dhe merr udhëzime shtesë (p.sh., mbledh informacion ose shkarkon dhe instalon programe shtesë dëmtues).

internetit që arrihen nga kompjuterët e tyre apo mjetet për të raportuar parregullsitë). Këto detyrime duhet të plotësohen edhe nga studentët e drejtësisë në programet e praktikave në institucionet gjyqësore, të cilët kanë akses ndaj këtij informacioni. Gjithashtu, duhet të identifikohen edhe kanalet nëpërmjet të cilave rrjedh informacioni për publikun, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të forcohet përhapja e autorizuar e informacionit nga zëdhënësit profesionalë;

- *Zgjerimi dhe përhapja e informacionit për luftën kundër korrupsionit*: përveç fushatave kombëtare, të centralizuara<sup>293</sup>, kjo mund të bëhet në çdo institucion duke nxjerrë rregulla strikte në lidhje me detyrimet e stafit dhe të publikut dhe duke theksuar pasojat që krimet e korrupsionit kanë mbi sistemin dhe për përgjegjësinë personale. Një tjetër pengues për korrupsionin mund të jetë që të sigurohen xhirime nga media të rasteve interesante të korrupsionit të paraqitura në gjykatë. Aktualisht, Drejtoria Kombëtare Antikorrupsion dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion e përdorin këtë politikë. Ata lëshojnë deklarata për shtyp për të njoftuar fillimin e procesit penal kundër të dyshuarve të korrupsionit si nga jashtë gjyqësorit edhe nga brenda sistemit. Megjithatë, informacioni zyrtar duhet të jepet edhe nga gjykatat që trajtojnë çështjet e korrupsionit gjyqësor në veçanti, në mënyrë që të përforcohet besimi publik për një sistem anëtarët e të cilit e shikojnë të përshtatshme që menjëherë dhe në mënyrë efektive të trajtojnë këto probleme<sup>294</sup>. Gjithashtu, tryezat e rumbullakëta ose konferencat e shtypit mund të organizohen rregullisht për të komunikuar se si trajtohen gabime të caktuara duke përfshirë edhe ato të sektorëve të cenueshëm<sup>295</sup>.

- *Bashkëpunimi midis institucioneve*, si atyre brenda gjyqësorit dhe atyre jashtë sistemit të tilla si ato të sistemit të sigurimit kombëtar (në fakt, në çështjet e korrupsionit, bashkëpunimi i organeve të ndjekjes penale me shërbimet informative është i pashmangshëm) ose ato të sistemit arsimor (punonjësit e policisë tashmë kryejnë aktivitete në shkolla, të cilat mund të kryhen edhe nga gjyqtarët dhe prokurorët). Por krijimi i kanaleve të dialogut midis gjyqësorit dhe politikëbërësve, nëpërmjet tryezave të rumbullakëta, debateve publike, koalicioneve me organizatat e shoqërisë civile, është po aq i nevojshëm;

- *Vlerësimi i transparencës, kostos dhe efikasitetit të sistemit*: megjithëse institucionet gjyqësore janë të detyruara me ligj që të nxjerrin raporte vjetore në lidhje

---

<sup>293</sup> Fushatat kryesore antikorrupsion të kryera në Rumani janë si më poshtë: "mos jep mitë, fushata e parë në shkallë kombëtare antikorrupsion, implementuar në vitin 2004 nga Fondacioni Koncept, TI-Ro, rinia Ariel dhe Teatri i fëmijëve, Shoqata për Komunikimin me Kabëll, media OOPS, Shoqata e Botuesëve të Mediave on-line, [www.nudaspage.ro](http://www.nudaspage.ro); fushata e përgjegjësisë antikorrupsion", kryer nga M.A.I. nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në, [www.mai-dga.ro](http://www.mai-dga.ro); "unë as jap as marrë mitë" – a duhet të ketë mitë? Iniciativë e Ministrisë për Integrimin Evropian në vitin 2006, [www.demascaspaga.ro](http://www.demascaspaga.ro); "gjyqësori, një shtyllë e shoqërisë", nisur në vitin 2006 nga Ministria e Drejtësisë, fushata e parë antikorrupsion në gjykata dhe prokurori; "dëno korrupsionin!", një fushatë e nisur M.A.I. nëpërmjet ADG në vitin 2007; fushata "jo mitës", iniciuar nga Ministria e Drejtësisë dhe e implementuar nga një grup OJQ-së dhe Shoqëri të Komunikimit, [www.faraspaga.ro](http://www.faraspaga.ro); "mita e parë", kryer në 2007 nga Fondacioni Koncept dhe Transparency International Rumani, [www.primaspaga.ro](http://www.primaspaga.ro); fushata "ki besim tek gjyqtarët dhe prokurorët!", implementuar në 2008 nga Shoqata e alternativave sociale, bazuar në Iasi, [www.alternativesociale.ro](http://www.alternativesociale.ro).

<sup>294</sup> Përkufizimet për komunikimin drejtësi – media gjatë procesit gjyqësor, shih Rekomandimin nr. (2003) 13 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për dhënien e informacionit nëpërmjet medias në lidhje me proceset penale dhe Deklaratën për dhënien e informacionit nëpërmjet medias në lidhje me proceset penale, miratuar nga Komiteti i Ministrave në 10 korrik 2003.

<sup>295</sup> Shih rezolutën nr. 277 të Asamblesë Plenare të SCM të 13 prillit 2006, që miratoi Guidën për praktikën e mira për bashkëpunimin midis gjykatave, prokurorive atashuar atyre dhe medias.

me Ligjin për aksesin ndaj informacionit publik ose mbi buxhetin e të ardhurave dhe shpenzimeve, jo të gjitha ato e zbatojnë këtë detyrim faktikisht. Raporti vjetor për gjendjen e gjyqësorit, hartuar nga SCM nuk shoqërohet nga debate publike që përfshijnë gjyqtarët dhe prokurorët dhe parlamentin. Veç kësaj, raportet e 2006, 2007 dhe 2008, nuk janë analizuar nga Parlamenti pavarësisht detyrimit ligjor për ta bërë këtë. Ministria e Drejtësisë nuk ka dorëzuar në asnjë vit raportin e saj tek Ministria Publike dhe Drejtoria Kombëtare Antikorrupsion në Parlament, siç e kërkon ligji. Në fillim të vitit, gjykatat dhe prokuroritë hartuan raportet për aktivitetin e tyre nga viti i kaluar, por përmbajtja nuk është diskutuar me të gjithë punonjësit (diskutimet janë kufizuar me gjyqtarët dhe prokurorët vetëm dhe asnjë kategori tjetër e personelit). Më shpesh përmbajtja e raporteve nuk bëhet publike, megjithëse çdo institucion ka faqen e vet të internetit. Për më tepër, raportet priren që të jenë analitike dhe të bazuar tek statistikat, disi të shkëputur nga situatat e përditshme me të cilat përballen gjyqtarët dhe prokurorët dhe personeli administrativ dhe ndihmës<sup>296</sup>. Më tej, një strategji menaxhuese, sipas të cilës drejtuesit e gjykatës duhet të planifikojnë aktivitetin e tyre dhe që duhet të jetë rezultat i përpjekjeve të përbashkëta nga të gjithë punonjësit, ose mungon, ose nuk i është komunikuar stafit në ndonjë institucion gjyqësor.

#### 4.4 Konfliktet e interesit

Në pak vitet e kaluara, një formë shumë efektive e parandalimit të korrupsionit është politika e konfliktit të interesit. Institucioni synon të ruajë paanësinë e agjentëve publikë në mënyrë që ata të përmbushin objektivisht detyrat e tyre duke forcuar integritetin individual. Si e tillë, që rregulloret e konfliktit të interesit imponojnë detyrimet për agjentët publikë, por ato faktikisht i ndihmojnë ata që t'i rezistojnë ndikimeve të padrejta dhe të japin një kontribut të përgjithshëm për zhvillimin e një kulture të shërbimit publik.

##### 4.4.1 Përkufizim:

a. Për **zyrtarët publikë** (punonjësit e policisë, nëpunësit e gjykatës, etj.) zbatohet përkufizimi ligjor për konfliktin e interesit që rregullohet me nenin 70 në ligjin nr. 161/2003: *ndodh konflikti i interesit kur një individ ka një interes personal të një natyre ekonomike, që mund të korruptojë përmbushjen objektive të detyrave të individit siç përcaktohet nga Kushtetuta dhe akte të tjera normative*. Ligji specifikon se konflikti i interesit ndodh kur një nëpunës civil angazhohet në ndonjë prej situatave të mëposhtme: a) thirret që t'i përgjigjet aplikimeve, të marrë vendime, të marrë pjesë në vendimmarrje në lidhje me individët dhe entet ligjore me të cilat një nëpunës civil ka marrëdhënie të një natyre ekonomike; b) është anëtar i të njëjtut komision, të krijuar sipas ligjit, me nëpunës civilë që janë të afërm të tij/të saj të shkallës së parë ose bashkëshortë; c) interesi ekonomik i këtij nëpunësi civil, bashkëshorti ose të afërmit të shkallës së parë mund të ndikojë në vendimet që zyrtari do të marrë gjatë detyrës së tij/të saj.

Disa argumentojnë se *konflikti i interesit* mund të marrë një formë 'personale', për aq kohë sa një zyrtar publik mund të ketë kompetencë ligjore që të kryejë një akt të

---

<sup>296</sup> Një raport model për aktivitetin e gjykatës përvijohet në rezolutën nr. 8895/2007 të Asamblesë Plenare të SCM. Fatkeqësisht, ajo nuk përfshin të dhënat për kohëzgjatjen e gjykimeve, numrin e gjyqeve (dhe jo të çështjeve, sepse një i njëjti gjyq mund të përfshihet në disa çështje, kur rigjykohet), të dhëna për personelin ndihmës, vlerësimin e kënaqjes së personelit ose publikut, ose monitorimin e mbulimit të medias për çështjet gjyqësore.

veçantë, por një situatë ose rrethanë personale e bën atë të pamundur që zyrtari të jetë objektiv. Në këtë rast, zyrtari duhet të publikojë konfliktin e interesit dhe duhet të largohet ose të abstenojë nga veprimi. Në fakt, legjislativi i huaj parashikon se interesi nuk kufizohet tek natyra ekonomike. "Konflikti i interesit" mund të jetë një situatë ku një agjent publik ka ose mund të ketë një interes personal të një natyre ekonomike ose të një natyre tjetër që mund të korruptojë përmbushjen objektive të detyrës së agjentit publik, siç përcaktohet nga Kushtetuta dhe aktet e tjera normative, si dhe nga interesi publik<sup>297</sup>.

Prandaj, një konflikt interesi kundërshton dy lloje interesash - personal dhe publik: një interes personal përfshin çdo përfitim financiar apo përfitim tjetër që synohet apo merret, direkt ose indirekt për vete ose për të tjerët nga agjenti publik duke keqpërdorur reputacionin, influencën, lehtësitë, marrëdhëniet dhe informacionin për të cilat ai/ajo ka akses gjatë kryerjes së detyrave publike të tij/të saj; nga ana tjetër interesi publik kërkon masat mbrojtëse dhe respektimin e të drejtave, lirive dhe interesave ligjore të qytetarëve dhe të shoqërisë nga autoritetet publike dhe institucionet siç parashtrahet nga Kushtetuta, legjislativi kombëtar dhe traktatet ndërkombëtare në të cilat Rumania është palë.

**b.** Ligji nuk jep një përkufizim të konfliktit të interesit për kategorinë e *gjqytarëve dhe prokurorëve*, por vetëm vërejtje të përgjithshme se si duhet të shmangët kjo situatë, duke detyruar gjyqtarët prokurorët të abstenojnë ose përndryshe të zëvendësohen.

*Neni 5, paragrafi 2 në ligjin nr.303/2004* parashikon se "gjyqtarët dhe prokurorët janë të detyruar të heqin dorë nga një akt ose akte që lidhen me administrimin e drejtësisë në rastet që përfshijnë konflikt midis interesave të tyre dhe interesit publik të administrimit të drejtësisë ose të mbrojtjes së interesave të përgjithshme të shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur konflikti i interesit i është njoftuar me shkrim Këshillit Drejtues të Gjykatës ose kreut të prokurorisë dhe është konstatuar se ai nuk ndikon në përmbushjen e paanshme të detyrave zyrtare". Gjithashtu, *neni 23 në Kodin Deontologjik të gjyqtarëve dhe prokurorëve* parashikon: "gjyqtarët dhe prokurorët janë të detyruar të heqin dorë, sipas ligjit, nga çdo akt që lidhet me administrimin e drejtësisë, në rastet që përfshijnë një konflikt midis interesave të tyre dhe interesit publik të administrimit të drejtësisë ose mbrojtjes së interesave të përgjithshme të shoqërisë". *Neni 27.1 në Kodin e Procedurës Civile* parashikon zëvendësimin si më poshtë: "një gjyqtar mund të zëvendësohet kur gjyqtari, bashkëshorti ose i afërmi i shkallës së parë ka një interes në gjykimin e çështjes në fjalë". Përfundimisht, *neni 48, paragrafi 1.d në Kodin e Procedurës Penale* parashikon raste papajtueshmërie si më poshtë: "një gjykatës është i papajtueshëm me dëgjimin e një çështjeje, kur çështja përkatëse përfshin rrethanat që tregojnë se gjyqtari, bashkëshorti ose të afërmit e ngushtë kanë një interes në atë gjyq".

Duke pasur parasysh instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë institucion, ne e përcaktojmë "*konfliktin e interesit*" si një situatë ose rrethanë që ka lidhje me një gjyqtar, prokuror, kur interesi personal, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i gjyqtarit ose prokurorit bie ndesh me interesin publik, në mënyrë të tillë që ndikon ose ka gjasën të ndikojë mbi pavarësinë ose paanshmërinë e vendimmarrjes ose në kryerjen e detyrave zyrtare në mënyrë objektive dhe të shpejtë.

---

<sup>297</sup> Shih Quentin Reed, ulur në gardh: konfliktet e interesit dhe si të rregullohen ato, [www.u4.no/themes/political-corruption](http://www.u4.no/themes/political-corruption).



Tërësisht në lidhje me aktivitetin gjyqësor, një gjyqtar në një situatë me konflikt interesi duhet të zgjedhë midis interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe interesit privat të sigurimit të përfitimit personal. Kjo na jep arsye të deklarojmë se rregulli i shmangies së konflikteve të interesit është një version i parimit *nemo in rem suam auctor esse potest*, d.m.th., askush nuk mund të dëgjojë çështjen e tij.

#### 4.4.2. Parandalimi i konfliktit të interesit

Politika e konfliktit të interesit kërkon rregullimin nga institucionet ku aplikohet në lidhje me përcaktimin e saj dhe hartimin e rregullave paraprake për të parandaluar konfliktet e interesit dhe sanksionet e mëvonshme për shkeljen e këtyre rregullave.

Konfliktet e interesit mund të parandalohen me tri metoda:

a) *duke imponuar papajtueshmëritë dhe kufizimet*: këto përfshijnë ndalimin e kryerjes të shërbimit në zyra të caktuara (p.sh., gjyqtarët ose prokurorët nuk mund të jenë eprorë të bashkëshortëve të tyre) ose pozicione (p.sh., një gjyqtar nuk mund të mbajë njëkohësisht një pozicion tjetër publik ose privat), ose nga kryerja e aktiviteteve që lidhen me detyrat publike në fjalë (p.sh., një gjyqtar nuk mund të jetë pjesë e të njëjtit trup gjykues me një të afërt);

b) *duke vënë detyrimin për të publikuar interesat*: kjo përfshin deklaratat e përgjithshme, zakonisht vjetore, të interesit si dhe deklaratat specifike, të depozituara përpara marrjes së një vendimi në një çështje të veçantë (siç rregullohet nga neni 5, paragrafi 2 në ligjin nr. 303/2004). Kjo kategori përfshin gjithashtu detyrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe personelit ndihmës në gjykata dhe prokurori që të publikojnë marrëdhëniet e tyre fisnore me punonjës të tjerë në sistemin gjyqësor;

c) *procedurat për mospjesmarrjen në vendimmarrje*: këto përfshijnë heqjen dorë, largimin dhe zëvendësimin e një agjenti publik.

Konfliktet e interesit nuk duhet të ngatërrohen me *korrupsionin*. Ndërsa korrupsioni përfshin veprimet, konfliktet e interesit janë rrethanat në të cilat kryerja e një veprimi të paligjshëm është thjesht potenciale. Kështu, nuk është një shembull korrupsioni kur një prokuror vepron në mënyrë të ligjshme dhe të paanshme në një vendimmarrje për një çështje në të cilën ai/ajo ka interes personal. Po kështu, një gjyqtar mund të pranojë mitë (rast në të cilin ne flasim për korrupsion), në këmbim të marrjes së një vendimi që ai/ajo do ta merrte gjithësesi, pa përfshirë kjo gjë një konflikt interesi të mëparshëm. Megjithatë, është e vërtetë se në shumicën e rasteve korrupsioni ndodh ku një interes i mëparshëm personal ka pasur një ndikim negativ në sjelljen e një agjenti publik. Kjo është arsyeja për se rekomandohet pikërisht ruajtja kundër konflikteve të interesit si element i një politike gjithëpërfshirëse për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin. Në këtë kuadër, politikat e konfliktit të interesit janë një instrument i rëndësishëm jo vetëm për ndërtimin e integritetit të sektorit publik, por edhe për promovimin dhe mbrojtjen e demokracisë.

Konflikti i interesit nuk duhet të ngatërrohet me papajtueshmëritë dhe kufizimet. Duke pasur parasysh përdorimin inkonsistent të këtyre koncepteve nga ligjvënësit rumunë, nevojiten sqarimet e mëposhtme:

Siç tregohet më sipër, *konflikt interesi* është situata që një person duhet ta shmangë, në qoftë se ai/ajo duhet të marrë një vendim të paanshëm. Implementimi i kësaj politike sigurohet nëpërmjet masave të ndryshme (publikimin e interesave, asetëve dhe marrëdhënieve fisnore, rregullimin e papërputhshmërive, vendosjen e kufizimeve), mekanizmat e kontrollit (përvetësimi i etikës profesionale nga çdo agjent publik dhe

kryerja e kontrolleve nga organet disiplinore ose agjencia kombëtare e integritetit, përkatësisht) dhe mekanizmat e sanksioneve (ose të ndërmarra në nivelin individual, të tilla si abstenimi ose largimi, ose të aplikuara në nivel institucional, nëpërmjet masave deontologjike, disiplinore, administrative ose penale, në varësi të shkallës së shkeljes dhe të institucionit kompetent).

Në këtë kontekst, *papajtueshmëritë* janë garanci për paanësinë e agjentëve publikë, që synojnë të shmangin një konflikt interesi në menaxhimin e një çështjeje të caktuar. Politikëbërësit kanë parashikuar kështu çështjet kur mund të ndodhë një konflikt interesi, të paktën në nivel të dukshëm. Për shembull, një gjyqtar ose prokuror ose agjent publik i ndalohet të dëgjojë ose të trajtojë një çështje që ka lidhje me bashkëshortin ose të afërmit e tij/të saj të ngushtë. Si e tillë, papajtueshmëria ka lidhje me kapacitetin funksional të një agjenti publik në trajtimin e një çështjeje specifike.

Sipas nenit 24 të *Kodit të Procedurës Civile* "(1) një gjyqtar që ka marrë një vendim në një çështje nuk mund të marrë pjesë në seancën e të njëjtës çështje në apel ose në etapën e rekursit ose në rigjykimin e saj pas kasacionit. (2) një individ që ka qenë dëshmitar, ekspert ose arbitruer në një çështje, nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e asaj çështjeje." Sipas nenit 27, "një gjyqtar mund të heqë dorë: 1) kur gjyqtari, bashkëshorti ose të afërmit e linjës kanë një interes në gjykimin e çështjes, ose kur gjyqtari është i lidhur nga gjinia ose krushqia brenda katër shkallëve të farefisnisë me ndonjë nga palët; 2) kur gjyqtari është i lidhur me anë të gjinisë apo krushqisë brenda shkallëve të farefisnisë, me avokatin ose të përfaqësuesin e njëres palë ose kur gjyqtari është i martuar me një nga fëmijët e një bashkëshorti ose ndonjë prej këtyre personave; 3) kur bashkëshorti i gjyqtarit (me kushtin që ai/ajo të mos jetë i vdekur ose i divorcuar) është i lidhur nga gjinia ose krushqia, me ndonjë nga palët, brenda katër shkallëve të farefisnisë, ose kur nuk kanë mbetur fëmijë, në rastin kur bashkëshorti i gjyqtarit është i vdekur ose i divorcuar; 4) kur gjyqtari, bashkëshorti ose një i afërm brenda katër shkallëve të farefisnisë janë të përfshirë në një çështje të ngjashme me atë që shqyrtohet në seancë, ose kur ata janë të përfshirë në një çështje që gjykohet në të njëjtën gjykatë ku një nga palët është gjyqtari; 5) kur ka pasur një çështje gjyqësore penale midis këtyre personave dhe njëres nga palët, pesë vite përpara kohës së heqjes dorë; 6) kur gjyqtari është kujdestar i njëres prej palëve; 7) kur gjyqtari ka shprehur një opinion për çështjen që po shqyrtohet në seancë; 8) kur gjyqtari ka marrë prej njëres palë dhurata ose premtime për dhurata ose shërbime të tjera; 9) kur ka armiqësi midis gjyqtarit, bashkëshortit ose të afërmit brenda katër shkallëve të farefisnisë nga njëra anë dhe ndonjë prej palëve, bashkëshortëve ose të afërmit brenda tri shkallëve të farefisnisë." Dhe sipas nenit 36 këto dispozita (përveç nenit 27.7) do të aplikohen edhe për prokurorët, ndihmës-gjyqtarët ose prokurorët dhe nëpunësit e gjykatës.

Po kështu, *Kodi i Procedurës Penale* parashikon papajtueshmëritë për gjyqtarët: "gjyqtarët të cilët janë bashkëshortë ose të lidhur në ndonjë mënyrë tjetër gjinie apo krushqie, brenda katër shkallëve të farefisnisë, nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit trup gjykues" (neni 46). "Një gjyqtar, i cili ka shqyrtuar një çështje nuk mund ta shqyrtojë në seancë të njëjtën çështje në një gjykatë më të lartë, ose ta shqyrtojë në apel ose të bëjë apelim ose rekurs kundër vendimit fillestar. Po kështu, një gjyqtar i cili ka shprehur më parë një opinion për një vendim që mund të merret mbi një çështje, nuk mund ta shqyrtojë atë çështje (neni 47)". "Një gjyqtar është gjithashtu i papajtueshëm me shqyrtimin e një çështjeje, kur në çështjen përkatëse: a) ai/ajo ka nisur procesin penal ose ka urdhëruar fillimin e ndjekjes penale, ose ka paraqitur çështjen në gjykatë për ndjekje penale ose ka vendosur për masë sigurimi ose shtyrje të masës së sigurimit gjatë ndjekjes penale; b) ai/ajo ka qenë përfaqësues ose mbrojtës i ndonjëres prej palëve; c) ai/ajo ka qenë një ekspert ose dëshmitar; d) ka elementë që tregojnë se gjyqtari, bashkëshorti ose ndonjë kushëri i afërt ka një interes, të çfarëdo natyre për çështjen; e) bashkëshorti i gjyqtarit ose i afërmi nga ana e gjinisë apo krushqisë

brenda katër shkallëve të farefisnisë ka kryer ndjekje penale, ka monitoruar ndjekje penale, ka vendosur për burgosje parandaluese ose ka shtyrë burgosje parandaluese, gjatë një ndjekjeje penale; f) gjyqtari është bashkëshort ose i lidhur në ndonjë mënyrë tjetër me anë të gjinisë apo krushqisë, brenda katër shkallëve të farefisnisë, me ndonjë nga palët ose një avokat ose një i autorizuar i palës; g) ka armiqësi midis gjyqtarit, bashkëshortit të tij/të saj ose të afërmve brenda shkallës katër të farefisnisë, nga njëra anë dhe ndonjë prej palëve, bashkëshortit të tyre ose të afërmve brenda shkallës së tretë të farefisnisë, nga ana tjetër; h) gjyqtari është kujdestar i ndonjërës prej palëve; i) gjyqtari ka marrë donacione ose dhurata nga njëra prej palëve, avokatit ose përfaqësuesit të tyre". (neni 47, paragrafi 1). "Edhe një gjyqtar është i papajtueshëm me gjykimin e një apeli ose rekursi kur bashkëshorti i gjyqtarit ose një i afërm tjetër, nga ana e gjakut ose martesës brenda katër shkallëve të farefisnisë është i përfshirë si gjyqtar ose prokuror në seancën e të njëjtës çështje" (neni 478, paragrafi 2).

Sipas nenit 49 të të njëjtit Kod: "(1) Dispozitat e nenit 46 do të aplikohen edhe për prokurorin dhe ndihmës gjyqtarin ose prokurorin ose kur është e aplikueshme, edhe për nëpunësin gjyqësor të çështjes, kur ka një rast të mospërputhshmërisë midis cilitdo (prej tyre dhe një anëtari të trupit gjykues). (2) Dispozitat e papajtueshmërisë në nenin 48, paragrafi 1 b) i) dhe paragrafi 2 do të aplikohen edhe për prokurorin, zyrtarin që kryhen ndjekjen penale, ndihmës gjyqtarin ose prokurorin dhe nëpunësin gjyqësor të çështjes. (3) Një prokuror që ka ndjekur çështjen në shkallën e parë nuk mund të vendosë për të njëjtën çështje në apel ose në etapën e rekursit. (4) Një zyrtar që ka kryer një ndjekje penale është i papajtueshëm me kryerjen përsëri të ndjekjes penale, kur gjykata urdhëron ribërjen e procedurave." Dhe sipas nenit 54: "Dispozitat në nenin 48 do të aplikohen dhe për ekspertët dhe për përkthyesit. Kapaciteti i ekspertit është i papajtueshëm me atë të një dëshmitari në të njëjtën çështje, dhe kapaciteti i dëshmitarit ka precedencë."

Janë përcaktuar edhe *kufizime* për t'u ruajtur kundër konfliktit të interesit, por ato prekin aktivitetin e përgjithshëm të agjentëve publikë, d.m.th., sjelljen e përgjithshme të agjentit publik ose pavarësisht nga ndonjë prej çështjeve të veçanta.

Kështu, sipas nenit 40, paragrafi 3 në *Kushtetutën e Rumanisë*, "sa më poshtë nuk mund të jenë anëtarë të partive politike: gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Ombudsmeni, gjyqtarët dhe prokurorët, anëtarët aktiv të ushtrisë dhe të trupës policore, dhe kategori të tjera të agjentëve publikë siç përcaktohen nga ligji organik". Sipas nenit 125, paragrafi 3 i Kushtetutës, "detyra e një gjyqtari është e papajtueshme me ndonjë nga detyrat e tjera publike ose private, përjashtuar pozicionin e mësimdhënies në arsimin e lartë". Gjithashtu, neni 94, paragrafi 1, në *Ligjin nr. 161/2003* parashikon: "Kapaciteti i agjentit publik është i papajtueshëm me ndonjë detyrë publike, përveçse me atë në të cilën ai/ajo është emëruar, dhe me pozicionin e drejtuesit publik". Sipas nenit 47, paragrafi 1, në *Ligjin nr. 188/199* për Statusin e zyrtarëve publikë, "Zyrtarët publikë nuk do të kërkojnë ose do të pranojnë dhurata, ose përfitime të tjera, direkt ose indirekt, për veten e tyre ose për të tjerë, për shkak të detyrës së tyre publike". Neni 48, paragrafi 2 thotë: "Zyrtarët publikë nuk do të marrin kërkesa në mënyrë të drejtpërdrejtë, të cilat ata kanë kompetencën për t'i gjykuar ose të diskutojnë direkt me kërkuesit, me përjashtim të atyre zyrtarëve të cilët janë emëruar specifikisht me këto detyra, ose të ndërhyjnë në gjykimin e këtyre kërkesave".

Sipas nenit 43 në *Ligjin nr. 360/2002*, "një punonjës policie, në asnjë rrethanë nuk do të: a) marrë, pretendojë ose të pranojë dhurata ose premtime të tjera, ose premtime për dhurata, direkt ose tërthorazi, për vete ose për të tjerët, për shkak të pozitës së tyre zyrtare; e) nuk do të marrë shuma parash nga individë ose ente ligjore; f) nuk do të përpilojë, printojë ose të shpërndajë materiale ose publikime që janë politike, imorale ose që nxisin mungesën e disiplinës; g) nuk do të ketë direkt ose nëpërmjet ndërmjetësve, interes personal në një njësi në juridiksionin e njësisë policore ku është punësuar, ku ky interes ka gjasë që të korruptojë

paanësinë dhe pavarësinë e punonjësit të policisë". Sipas nenit 45, paragrafi 1, "një punonjës policie nuk do të: g) kryejë, direkt ose nëpërmjet ndërmjetësve, operacione tregtare, ose do të marrë pjesë në administrimin ose menaxhimin e një shoqërie tregtare përveçse të ketë aksione në të; h) nuk do të kryejë aktivitete me fitim që kanë gjasë të njollosin nderin dhe dinjitetin e punonjësit të policisë ose institucionit për të cilin ai/ajo punon; i) nuk do mbajë asnjë nga detyrat e tjera publike ose private, për të cilat ai/ajo merr pagesë, përveçse pozicionit të mësimdhënies në sistemin e arsimit, kërkimit shkencor dhe të aktiviteteve letrare ose artistike".

Sipas nenit 14 në ligjin nr. 51/1995 për praktikimin e profesionit të avokatit, "praktikimi i profesionit të avokatit është i papajtuashëm me: a) punësime të shpërblyera në profesione të tjera të ndryshme nga ai i avokatit; b) punësime që dëmtojnë dinjitetin dhe pavarësinë e profesionit të avokatit ose e përfshijnë në sjellje të pahijshme; c) praktikimi në drejtpërdrejtë të aktivitetit tregtar". Sipas nenit 21, paragrafi 1 i urdhrorit qeveritar nr. 86/2006, "Një praktikues insolvence i cili ka punuar më parë si gjyqtar civil nuk mund të emërohet si administrator ose likuidator në juridiksionin e gjykatës ku ai ka punuar, të paktën dy vjet pasi është larguar nga pozicioni përkatës".

#### 4.4.3. Llojet e interesit

Interesi mund të jetë *material*, siç tregohet në çështjen *D. kundër Irlandës (Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 1986)*, ku gjyqtari kishte aksione në shoqërinë e akuzuar, të përfshirë në çështjen që gjyqtari po shqyronte në seancë. Interesi mund të jetë edhe i një natyre *morale* si në çështjen *Remli kundër Francës (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 1996)*, ku çështja e çuar në gjykatë ishte se gjyqtari ishte deklaruar si racist gjatë një gjykimi. Në çështjen *Pescador Valiero kundër Spanjës (GJEDNJ, 2003)*, çështja e paraqitur në gjykatë ishte se gjyqtari që kishte shqyrtuar çështjen kishte marrëdhënie të ngushta profesionale me universitetin që kishte pushuar paditësin. Interesi privat i një gjyqtari në një gjykim specifik të një çështjeje gjithashtu mund të lindë nga marrëdhëniet e tij ose të saj sociale, fafesisnia, miqësia, përkatësia fetare ose bashkëjetesa me një nga palët, të afërmit e tyre ose miqtë ose avokatët e tyre.

Përfituesi i një vendimi të marrë në një situatë me konflikt interesi mund të jetë ai që vendos (interesi i *drejtpërdrejtë*); vendimmarrësit, (familja e tyre, miqtë, njerëzit e afërt, me interes të *tërthortë*); ose personat, ose organizatat me të cilat ata kishin, kanë (interesa *aktuale*) ose do të kenë (interesa të *ardhshme*) biznes, marrëdhënie politike ose të tjera.

Një formë e veçantë e konfliktit të interesit ndodh nëpërmjet pantuflazh-it (Francë) ose amakudari-t (Japoni). Kjo përfshin zyrtarët publikë që largohen nga sektori publik në mënyrë që të fillojnë punë në sektorin privat. Kjo është kundër interesave të shtetit. Për shembull, kur zyrtarët publikë përfitojnë nga programe trajnimit të ndryshme të veçanta, të paguara nga fonde publike dhe pastaj e lenë detyrën publike për një punë të paguar më mirë në sektorin privat. Një konflikt i ardhshëm i interesit mund të përcaktohet kur agjentët publikë janë punësuar nga shoqëritë private si shpërblim për vendime të caktuara të marra në përfitim të asaj shoqërie gjatë kohëzgjatjes publike në detyrë. Shembuj të tjerë mund të përfshinin rastet kur një gjyqtar kontribuon në rrëzimin e një padie kundër një kontrate të dhënë për shërbime një shoqërie dhe me pas jep dorëheqjen dhe punësohet nga kompania në një pozicion drejtues; një punonjës policie licencon një shoqëri rojesh sigurie ose agjenci dedektive dhe pastaj punësohet në shoqërinë private; një ekspert zyrtar përfiton nga programet e trajnimit jashtë, pastaj jep dorëheqjen dhe certifikohet si ekspert privat.

Kjo formë e konfliktit të interesit mund të kundërshtohet në mënyra të tilla duke ndaluar punësimin në një sektor të ngjashëm në sektorin privat pasi një zyrtar publik ka lënë një post publik, duke ndaluar dhe mbajtjen e pozicioneve në një shoqëri private që ka qenë nën kontrollin e institucionit publik ku zyrtari ka punuar, duke detyruar punonjësit që të rifinancojnë shpenzimet e kryera nga shteti me trajnimet që zyrtari ka marrë gjatë detyrës publike. Gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit e policisë në departamentet e ndjekjes penale gjithashtu u nënshtrohen ndalimeve që të mos punojnë si avokat në ato gjykata ose departamente të prokurorisë për dy vite pasi ata largohen nga detyra publike (neni 39 dhe 40 në statutin e profesionit të avokatit të vitit 2004). Gjithashtu, aty ku një individ, për shkak të pozicionit të tij/të saj, për shkak të detyrës ose postit të caktuar përgjigjet për mbikëqyrjen, inspektimin ose mbylljen e një operatori të biznesit, ai individ kryen një vepër penale në qoftë se ai/ajo kryhen një sipërmarrje në emër të operatorit privat. Këto aktivitete mund të përfshijnë lehtësimin e operacioneve tregtare ose financiare për operatorin privat ose kapitalin investuar në operatorin privat, me synimin për të siguruar përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta të padrejta për atë individ. Këto aktivitete përbëjnë gjithashtu një vepër penale në qoftë se ato kryhen brenda pesë vitesh pas përfundimit të detyrës, pozicionit ose postit (neni 11 në ligjin nr. 78/2000).

Siç duket, interesi mund të jetë *faktik*, kur rrënjohet në fakte të provuara ose *në dukje* kur gjeneron vetëm dyshime në lidhje me integritetin e zyrtarit. Në këtë drejtim është arritur vendimi se njohja e një anëtari të trupit gjykues me një nga dëshmitarët që dëgjohet nuk është i mjaftueshëm për të nënkuptuar që gjyqtari do të ketë një prirje të favorshme drejt dëshmisë së dëshmitarit; megjithatë, natyra dhe afërsia e njohjes së tyre duhet të analizohet më tej<sup>298</sup>. Një vendim i ngjashëm është marrë në lidhje me anëtarësimin e një gjyqtari dhe një prej palëve në të njëjtën organizatë - p.sh., masonët e lirë<sup>299</sup>.

Aty ku aplikanti është përfshirë në një argument kundërthënës në media kundër kryetarit të gjykatës që shqyrton çështjen dhe kryetari ka shprehur publikisht opinione negative në lidhje me aktivitetin e gjykatës për çështjen e aplikantit përpara fillimit të gjykimit, Gjykata në Strasburg, vendosi që shqetësimet e aplikantit mbi paanësinë e gjykatës ishin të bazuara objektivisht<sup>300</sup>. Po kështu, në një çështje tjetër, u vendos që pjesëmarrja në procesin e të njëjtëve individë, sjellja e të cilëve u kritikua në artikullin e medias në fjal, është i mjaftueshëm për të vënë në pikëpyetje paanësinë e organit të vendimmarrjes. Kjo ndodhi sepse gjykatat nuk janë institucione pa persona, por funksionojnë nëpërmjet gjyqtarëve që i përbëjnë ato dhe për të qenë të paanshëm ata duhet të kenë largësinë e mjaftueshme nga çështja që konsiderojnë. Megjithatë, në këtë rast, ndjenjat personale të gjyqtarëve luajtën një rol kyç në vendosjen nëse ishte fyer apo jo autoriteti gjyqësor kur fyerja kishte si objekt të njëjtin gjyqtar<sup>301</sup>. Për më tepër, kur gjyqtarët që kanë dënuar aplikantin janë të njëjtit me ata që janë objekt i fyerjes, ka mjaft arsye për të ngritur dyshime legjitime, në mënyrë objektive të justifikueshme, në lidhje me paanësinë e gjykatës (*nemo iudex in sua causa*). Kur një zyrtar punon në një gjykatë, e cila varet - në lidhje me pozicionet dhe detyrat - nga njëra prej palëve në çështje, kërkuesit e drejtësisë gjithashtu mund të kenë dyshime të ligjshme në lidhje me pavarësinë e atij zyrtari<sup>302</sup>.

<sup>298</sup> GJEDNJ, Pullar kundër MB, vendim i 20 qershorit 1996, paragrafi 38.

<sup>299</sup> GJEDNJ, Kuskinen kundër Finlandës, vendimi i 01 qershorit 1999.

<sup>300</sup> GJEDNJ, Buscemi kundër Italisë, vendim i 16 shtatorit 1999, paragrafi 68.

<sup>301</sup> GJEDNJ, Kyprianou kundër Qipros, 27 janar 2004.

<sup>302</sup> GJEDNJ, Sramek kundër Austrisë, vendim i 22 tetorit 1984.

#### 4.4.4. Shembuj

Fraza "konflikte interesi" është disi jo e shpeshtë në teorinë dhe praktikën gjyqësore. Megjithatë, kemi mundur të identifikojmë një numër rastesh që futen në këtë kategori, duke filluar nga situatat e përditshme me të cilat përballen profesionistët e drejtësisë ose situatat që tashmë rregullohen nga ligji. Situatat e mëposhtme përbëjnë konflikt interesi:

- Një zyrtar i cili, në kapacitetin e tij/të saj si anëtar i Komitetit për Disiplinën të SCM-së, ka kryer një hetim disiplinor për një gjyqtar ose prokuror, voton atëherë për zbatimin e një sanksioni si anëtar i departamentit disiplinor të SCM-së (një situatë e lejuar sipas legjislacionit kombëtar në 2005-2008);
- Një anëtar jo i përhershëm i SCM-së, që mban një pozicion drejtues në gjykatë, depoziton një aplikim në lidhje me gjykatën e tij/të saj tek SCM, pastaj si anëtar i SCM merr pjesë në diskutimin dhe votimin e atij aplikimi;
- Një anëtar i bordit drejtues të HCCJ voton për raportin e kërkuar sipas ligjit në lidhje me aktivitetin e gjyqtarit që kërkon promovimin në HCCJ, atëherë, si anëtar i SCM, voton për emërimin e atij gjyqtari;
- Një anëtar i SCM, i cili është dhe anëtar i shoqatës së gjyqtarëve, gjykon aplikime të caktuara të depozituara nga ajo shoqatë në SCM;
- Një anëtar i SCM voton për promovimin e një gjyqtari në një pozicion drejtues të SCM-së ose për pjesëmarrjen e një gjyqtari në një konferencë ose seminari jashtë shtetit, ndërsa ai gjyqtar shqyrton në gjykatë një çështje që përfshin personalisht anëtarin e SCM-së;
- Një anëtar i SCM-së ose i strukturave drejtuese të institutit të gjyqtarëve dhe prokurorëve merr pjesë në një emërim si ekspert në një program të financuar nga burime të huaja të një të afërmi ose mikut të ngushtë me të cilin zyrtari në mënyrë jozyrtare pastaj ndan pagesën e ekspertit;
- Një anëtar i SCM-së ose një zëdhënës i gjykatës ose prokurorisë ka miqësi të ngushtë ose marrëdhënie bashkëjetese me një gazetar, dhe lehtëson aksesin e gazetarit për informacion mbi karrierën e gjyqtarëve ose prokurorëve ose funksionimin e gjykatave/prokurorive;
- Ministrat e Drejtësisë propozojnë emërimin e një zyrtari si Prokuror i Përgjithshëm i prokurorisë atashuar tek HCCJ dhe pastaj, si anëtar i ligjshëm i SCM-së, voton në favor të emërimit në departamentin e prokurorëve të SCM;
- Një avokat mbron në të njëjtin rast, palët që kanë interesa të kundërta ose ndërpret kontratën me palën që fillimisht e ka punësuar atë dhe pastaj punësohet nga pala kundërshtuese, për të përdorur informacionin për të cilin ai ose ajo kishin akses (në këto shembuj, ka dy interesa private që janë konfliktuese, në vend të një interesi publik dhe një interesi privat);
- Një praktikant insolvency emërohet si likuidator për një debitor dhe në të njëjtën kohë për kreditorin e saj;
- Një ish-avokat i një pale gjykon një çështje, në cilësinë e tij/të saj të re si gjyqtar;
- Një këshilltar shoqërie i ofron këshilla punonjësve që përfshihen në një çështje gjyqësore me institucionin;
- Në një ankand, kujdestarët marrin, direkt ose nëpërmjet ndërmjetësve, asetet që kanë në ruajtje ose dorëzanët marrin asetet që ishin udhëzuar të shisnin; ose zyrtarët publikë marrin asetet publike që ishin nënvizuar t'i shisnin (neni 1308 Kodi Civil);

- Një gjyqtar është një i emëruar për të drejtat e çështjeve gjyqësore në juridiksionin e gjykatës ku ai/ajo punon (neni 1309 Kodi Civil);
- Një gjyqtar është anëtar në komisionin e prokurimit publik për gjykatën ku ai/ajo punon dhe ka kushërinj të afërm që kanë aksione në shoqërinë që dorëzon ofertën;
- Një gjyqtar vendos për një çështje në të cilën avokati i një prej palëve është anëtar i këshillit të avokatëve ndërsa aplikon për hyrjen në avokati pa provim;
- Gjyqtari gjykon një çështje në të cilën akuza është hartuar nga bashkëshorti/partneri/kushëriri i afërt i gjyqtarit si prokuror ose në të cilën ndjekja penale është kryer nga bashkëshorti/partneri/kushëriri i afërt i gjyqtarit si punonjës i policisë gjyqësore;
- Një gjyqtar gjykon një çështje që lind nga situata gjyqësore drejtpërdrejt në lidhje me gjyqtarin (p.sh., një palë kërkon kthimin e një ndërtese të shtetëzuar kur gjyqtari jeton në këtë ndërtesë; ose një gjyqtar koleg ka depozituar një kërkesë për të paditur Ministrinë e Drejtësisë për pagesën me vonesë të rrogës kur gjyqtari që shqyrton çështjen ka të drejtë për pagesa të ngjashme);
- Një gjyqtar ose prokuror gjykon një çështje që përfshin një koleg të ngushtë gjyqësor, një punonjës policie ose një nëpunës gjyqësor me të cilin gjyqtari ose prokurori punon çdo ditë;
- Një vlerësues i kërkesave për financim gjithashtu aplikon për financim në të njëjtin program ose punon në të njëjtin institucion me një aplikant ose ka marrëdhënie fisnore ose marrëdhënie administrative me një aplikant, ose ka një mosmarrëveshje me një aplikant;
- Një drejtues institucioni përdor makinën e institucionit për qëllime personale, pa të drejtën që t'i jepet atij/asaj sipas rregullores ose kontratës;
- Një drejtues institucioni jep një çmim ose një titull një punonjësi që është i lidhur me të;
- Një gjyqtar ose prokuror merr pjesë në një komision për punësimin ose promovimin e gjyqtarëve ose prokurorëve/personelit ndihmës, kur një prej konkurrentëve është bashkëshorti/kushëriri i afërt i tij/i saj;
- Një kryetar gjyqësor është anëtar i komisionit të gjykatës për provimin me gojë, në lidhje me një projekt menaxhimi që analizon, mes të tjerash, performancën e kryetarit të gjykatës, si pjesë e garës për emërimin në pozicione drejtuese<sup>303</sup>;
- Një kryetar gjyqësor e mohon fletëlejën e kërkuar nga një gjyqtar, dhe pastaj merr pjesë në analizimin e kundërshtimit të dorëzuar nga ai gjyqtar tek bordi drejtues dhe voton kundër, si anëtar i bordit drejtues<sup>304</sup>.

#### 4.5 Kodet e sjelljes në gjyqësor

Të gjithë instrumentet ndërkombëtare i kushtojnë rëndësi të veçantë kodeve të sjelljes (rregullave të etikës). Kjo ndodh sepse lufta kundër korrupsionit kërkon, si

<sup>303</sup> Alexandrina Radulescu, Opinion mosmiratues për vlerësimin e rezultateve të garës për emërimin e gjyqtarëve në pozicione drejtuese, mbajtur midis 28 tetorit – 25 nëntorit 2007, gjendet në [www.alexandrina-radulescu-csm.ro/docs/opinie-plen-13-dec-2007.pdf](http://www.alexandrina-radulescu-csm.ro/docs/opinie-plen-13-dec-2007.pdf).

<sup>304</sup> Neni 158 në rregulloren e brendshme për gjykatat, miratuar nga rezoluta nr. 387/2005 e SCM, me amendimet e mëvonshme: "(1) aplikimet ose ankesat individuale nga personeli duhet t'i drejtohen kryetarit të gjykatës/të departamentit, i cili është i detyruar të japë përgjigje në kohën e duhur dhe me shkrim. (2) Personi që nuk kënaqet me përgjigjen mund ta kundërshtojë atë para bordit drejtues të asaj gjyqësore".

mekanizëm të brendshëm ndershëmërinë dhe përgjegjësinë e agjentëve publikë. Kodet e sjelljes forcojnë shpirtin e organeve profesioniste në sensin pozitiv të integritetit, përkundër korporatizmit dhe vetëmbrojtjes.

Sjellja etike ka lidhje si me sjelljen gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe jashtë këtyre detyrave. Në lidhje me vendimet e marra nga zyrtarët publikë në gjyqësor, (p.sh., vendimet e gjykatës), pakënaqësia e qytetarëve në lidhje me këto vendime mund të dallohet nga pakënaqësia në lidhje me sjelljen e tyre. Për të vepruar në një mënyrë jo dinjitoze në sallën e gjykatës me një dëshmitar, një gjyqtar mund t'i nënshtrohet masave disiplinore, ndërsa një vendim i gabuar mund të rregullohet vetëm duke përdorur procedurat e apelimit të përcaktuara nga ligji, të cilat përfshijnë rivlerësimin e vendimit fillestar nga një gjykatë tjetër.

Kodet ose normat e sjelljes duhet të përfshijnë masat dhe sistemet që janë në gjendje të lehtësojnë publikimin nga agjentët publikë të shkeljeve të korrupsionit për të cilat ata janë bërë me dije gjatë detyrave të tyre zyrtare. Ata duhet t'i detyrojnë agjentët publikë që të publikojnë tek autoritetet publike të gjitha aktivitetet e tyre të mëparshme, punësimet, investimet, asetet dhe çdo dhuratë ose përfitim substancial që mund të gjenerojë një konflikt interesi me detyrën e tyre publike. Një rol i rëndësishëm luhet nga shoqatat profesionale, të cilat duhet të mbështesin gjyqtarët në çështjet që lidhen me etikën dhe të veprojnë si standarde deontologjike.

Nën dritën e instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare, sjellja e rekomanduar e profesionistëve në gjyqësor përkufizohet në udhëzuesit e mëposhtëm:

a. *Kodi i Sjelljes për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit* (OKB, 1979) bazohet tek ideja se funksionimi siç duhet i shërbimeve të zbatimit të ligjit është jetësor jo vetëm për efektivitetin e drejtësisë penale, por edhe për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Kodi thekson se zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të respektojnë dhe të mbajnë lart dinjitetin njerëzor dhe të aplikojnë dispozitat dhe të drejtat e njeriut për të gjithë individët. Kodi në veçanti ndalon torturën dhe çdo formë të korrupsionit, parashikon se forca do të përdoret vetëm në qoftë se është rreptësisht e domosdoshme, kërkon që të respektohet konfidencialiteti i informacionit personal dhe urdhëron që shëndeti i të dënuarve të mbrohet.

b. *Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Zyrtarët Publikë* (OKB, 1996). Kodi përfshin parimet e përgjithshme për sjelljen e agjentëve publikë, si dhe parimet për parandalimin e konflikteve të interesit, publikimin e aseteve, pranimin e dhuratave, trajtimin e informacionit konfidencial dhe përfshirjen në aktivitetin politik.

c. *Parimet e Sjelljes Gjyqësore të Bangalor-it* (OKB, 2001). Kodi përcakton gjashtë parime: Pavarësia, Paanësia, Integriteti, Drejtësia, Barazia, Kompetenca dhe Kujdesi. Në lidhje me integritetin dhe drejtësinë, ato deklarohen si esenciale për performancën e të gjithë aktivitetëve të një gjyqtari:

- *Paraqitja* konsiderohet si një parim: një gjyqtar do të sigurojë që sjellja e tij/e saj është përtej qortimit në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm; qëndrimi dhe sjellja e gjyqtarit duhet të riafirmojë besimin e popullit në integritetin e gjyqësorit; me të gjithë aktivitetet e tij/të saj, duke përfshirë jetën personale, një gjyqtar do të shmangë gjërat jo korrekte dhe shfaqjen e gjërave jo korrekte;

- *rregullohet edhe konflikti i interesit*: një gjyqtar në marrëdhëniet e tij personale me anëtarët e tjerë të profesionit ligjor që praktikojnë rregullisht në gjykatën e gjyqtarit, duhet të shmangë situatat të cilat mund të çojnë në mënyrë të arsyeshme në dyshimin ose paraqitjen e favoritizmit; një gjyqtar nuk do të marrë pjesë në gjykimin e çështjeve, në të cilat një anëtar i familjes së gjyqtarit përfaqëson njërin nga palët ose lidhet në një



farë mënyre me çështjen; një gjyqtar nuk do të lejojë përdorimin e banesës së tij/të saj nga një anëtar i profesionit ligjor për të marrë klientë ose anëtarë të tjerë të profesionit ligjor; një gjyqtar do të informohet për interesat personale dhe financiare të tij/të saj dhe do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'u informuar mbi interesat financiare të anëtarëve të familjes së gjyqtarit;

- *parashikohen edhe liritë*: një gjyqtar, si çdo qytetar tjetër, ka të drejtën e lirisë së shprehjes, besimit, shoqërimit dhe grumbullimit, por do t'i ushtrojë këto të drejta në një mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin e detyrës gjyqësore dhe paanësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit; një gjyqtar mund të krijojë ose mund të bashkohet me shoqatat e gjyqtarëve ose të organizatave të tjera që i çojnë më tej interesat e gjyqtarëve;

- *përcaktohen edhe kufizimet*: një gjyqtar nuk do të përdorë prestigjin e detyrës gjyqësore për të avancuar interesat e tij/të saj private ose interesat personale të anëtarëve të familjes së tij/të saj ose të personave të tjerë dhe nuk do të krijojë përshtypjen ose të lejojë të tjerët që të krijojnë përshtypjen se çdo njeri është në gjendje të veçantë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë mbi gjyqtarin në kryerjen e detyrave të tij/të saj gjyqësore; një gjyqtar nuk do të përdorë ose të publikojë informacionin konfidencial të marrë në cilësinë e tij/të saj gjyqësore për qëllime që nuk lidhen me detyrat profesionale të gjyqtarit;

- *renditen të drejtat e mëposhtme të gjyqtarëve*: për të shkruar, për të dhënë leksione, për të dhënë mësim dhe për të marrë pjesë në aktivitetet që lidhen me ligjin, organizimin e sistemit gjyqësor, administrimin e drejtësisë dhe aktivitetet e lidhura me të; shfaqet në një seancë publike para një organi gjyqësor që ka të bëjë me çështjet që lidhen me ligjin, sistemin gjyqësor, administrimin e drejtësisë ose çështjet që lidhen me të; të shërbejë si anëtar i një organi zyrtar ose një komisioni, komiteti qeveritar ose një organi këshillimor, nëse kjo anëtarësi nuk është në mospërputhje me parimet e paanësisë dhe neutralitetit të gjyqtarit; të angazhohet në aktivitetet e tjera që nuk e ulin dinjitetin e detyrës gjyqësore dhe nuk ndërhyjnë në kryerjen e detyrave të tij/të saj zyrtare;

- si rast *mospërputhjeje*, Kodi parashikon se një gjyqtar nuk do të praktikojë ligjin kur shërben si gjyqtar;

- në lidhje me *korruptionin*, Parimet tregojnë se një gjyqtar, si dhe anëtarët e familjes së gjyqtarit, nuk do të kërkojnë dhe nuk do të pranojnë ndonjë dhuratë, donacion, kredi ose favor në lidhje me ndonjë gjë të kryer ose që do të kryhet ose që nuk do të kryhet nga gjyqtari gjatë performancës së detyrave gjyqësore; një gjyqtar me dijeni nuk do të lejojë stafin e gjykatës ose të tjerët që i nënshtrohen ndikimit të gjyqtarit, autoritetit ose drejtimit të tij, që të kërkojë ose të pranojë dhurata, donacione, kredi ose favore në lidhje me ndonjë gjë të bërë ose që do të bëhet ose që nuk do të bëhet gjatë performancës së detyrave të tij/të saj gjyqësore; deri në masën që lejohet nga ligji dhe rregulloret e transparencës, një gjyqtar mund të pranojë një dhuratë përkujtimore, çmim ose përfitim si të jetë e përshtatshme sipas rastit, me kushtin që dhurata përkujtimore, çmimi ose përfitimi të mos perceptohet sikur synon të ndikojë mbi gjyqtarin në kryerjen e detyrave të tij/të saj gjyqësore ose të çojë në shfaqjen e anësisë<sup>305</sup>; një gjyqtar nuk do të lejojë familjen e tij/të saj, ose marrëdhëniet sociale apo të llojit tjetër që të ndikojnë në mënyrë të gabuar mbi sjelljen dhe gjykimin e tij/të saj.

---

<sup>305</sup> Në këtë drejtim, duhet përmendur ligji nr. 251/16.06.2004 për masat në lidhje me asetet e marra si dhurata përkujtimore në raste zyrtare gjatë kryerjes së detyrës publike, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 561 të 24 qershorit 2004. Ligji i detyron gjyqtarët dhe prokurorët, mbajtësit e pozicioneve drejtuese, zyrtarët publikë etj, që të deklarojnë dhe të paraqesin tek drejtuesi i institucionit brenda 30 ditësh asetet e marra si

*Komentari për Parimet e Sjelljes Gjyqësore të Bangalorit* (UNODC, 2007) detajon çdo parim dhe përfshin shembuj specifikë të sjelljes që duhen adoptuar nga gjyqtarët në rrethana të ndryshme (p.sh., diskutimi i çështjeve me gjyqtarët kolegë, përdorimi i kushërinjve si nëpunës gjykate, miqësitë me punonjësit e policisë ose avokatët, anëtarësinë në shoqata sekrete dhe frekuentimi i klubeve, marrëdhëniet sociale me përdoruesit e gjykatës, marrëdhëniet jashtë martesore, lidhjet e familjes së gjyqtarit me firmat e avokatisë ose me institucionet qeveritare, përfshirja e gjyqtarit në jetën publike ose politike, deklaratat e gjyqtarëve për gabimet në sistem, shkrimi i letrave rekomande, dhënia e dëshmisë, pjesëmarrja në konferenca dhe në intervista publike, pjesëmarrja në aktivitetet qeveritare, pranimi i aseteve nga gjyqtari).

Për prokurorët, ja vlen të përmendim "*Standardet e përgjegjësisë profesionale dhe deklaratën e detyrave dhe të drejtave esenciale të prokurorëve*", një kod i miratuar në 1999 nga Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve<sup>306</sup> duke u bazuar tek *Udhëzimet për Rolin e Prokurorëve* miratuar nga Kombet e Bashkuara në 1990. Standardet merren me sjelljen profesionale, pavarësinë, paanësinë, rolin në proceset penale, bashkëpunimin dhe mbrojtjen e prokurorëve. Në lidhje me sjelljen, Udhëzimet parashikojnë që prokurorët duhet të praktikojnë profesionin e tyre me nder dhe dinjitet, në përputhje me ligjin dhe etikën, duhet të përpiqen që të jenë dhe të shihen si konsistentë, të pavarur dhe të paanshëm, gjatë gjithë kohës duhet të ushtrojnë standardet më të larta të integritetit, duhet të informohen për zhvillimet ligjore, duhet ta mbrojnë të drejtën e një personi të akuzuar për gjykim të drejtë dhe t'i shërbejnë interesit publik.

d. *Kodi model i sjelljes për agjentët publikë* (KiE, 2000) ofron sugjerime për menaxhimin e situatave të jetës reale me të cilat ndeshen zyrtarët publikë, (p.sh., pranimin e dhuratave, përdorimin e informacionit zyrtar ose burimeve publike, dhe marrëdhëniet me ish-punonjësit). Kodi nënvizon rëndësinë e forcimit të integritetit të agjentëve publikë dhe përgjegjshmërinë e organeve eprore hierarkike me anë të tri objektivave: krijimin e standardeve për integritetin dhe sjelljen që priten nga agjentët publikë; ndihma për agjentët publikë që të kuptojnë dhe të adoptojnë këto standarde; dhe informimi i publikut për sjelljen që mund të presin nga zyrtarët publikë.

e. *Opinionin nr. 3 për parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanësinë* (CCJE, 2002) parashikon se aktiviteti i gjyqtarëve duhet të udhëhiqet nga parimet e sjelljes profesionale, duke u mundësuar atyre që të kapërcejnë vështirësitë që hasin në këtë fushë; parimet duhet të hartohen nga vetë gjyqtarët dhe të jenë të pavarura nga rregullat disiplinore të aplikueshme për gjyqtarët; është e dëshirueshme që të krijohet në çdo vend një ose më shumë organe ose persona brenda gjyqësorit që të këshillojnë gjyqtarët që hasin probleme të lidhura me etikën profesionale ose papajtueshmërinë e aktiviteteve jogjyqësore me statusin e tyre.

Në lidhje me rregullat e *sjelljes për gjyqtarë të veçantë*, CCJE ka mendimin se çdo gjyqtar i veçantë do të bëjë çdo gjë për të mbajtur lart pavarësinë gjyqësore, si në nivel institucional dhe në atë individual. Gjyqtarët duhet të sillen me integritet në detyrë dhe

---

dhurata përkujtimore në rastet zyrtare, përjashtuar medaljet, dekoratat, dinstiktivat dhe pajisjet kancelarike që kanë vlerën deri në 50 euro. Ky sistem kontrolli është hartuar për të parandaluar përpjekjet për të fshehur mitën.

<sup>306</sup> Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve u krijua në 1995 dhe ka selinë në Hagë, [www.iap.nl.com](http://www.iap.nl.com). Standardet gjenden në [www.justice.gc.ca/eng/dept-min/pub/fps-sfp/fpd/standards.html](http://www.justice.gc.ca/eng/dept-min/pub/fps-sfp/fpd/standards.html).

në jetën e tyre private, gjatë gjithë kohës duhet të adoptojnë një qasje që është dhe duket e paanshme, dhe të kryejnë detyrat e tyre pa favoritizma faktikë ose të perceptuar dhe pa paragjykime ose anësi. Ata duhet të vendosin për çështjet duke marrë parasysh të gjitha konsideratat që lidhen me zbatimin e ligjit dhe të përjashtojnë të gjitha konsideratat jomateriale, ato duhet të tregojnë vlerësimin e duhur për të gjithë ata që përfshihen në procesin gjyqësor ose ndikohen prej tij dhe duhet t'i kryejnë detyrat e tyre duke respektuar siç duhet trajtimin e barabartë të palëve, duke shmangur çdo paragjykim dhe anësi, duke ruajtur një drejtpeshim midis palëve dhe duke siguruar një dëgjim të drejtë për secilën palë. Gjyqtarët duhet të anashkalojnë marrëdhëniet e tyre me median dhe të ruajnë pavarësinë e tyre dhe paanësinë duke mos shfrytëzuar personalisht ndonjë marrëdhënie me median dhe të bëjnë komente të pajustificuara për çështjet që ata shqyrtojnë. Ata duhet të sigurojnë gjithashtu që të kenë një shkallë të lartë të kompetencës profesionale, të kenë një shkallë të lartë të ndjeshmërisë profesionale dhe të tregojnë kujdes për të përmbushur kërkesat e dhënies së gjykimeve në kohë të arsyeshme. Ata duhet t'ua kushtojnë shumicën e kohës së punës detyrave të tyre gjyqësore, duke përfshirë aktivitetet që lidhen me to ose të angazhohen në aktivitete politike që mund të kompromentonin pavarësinë e tyre dhe të shkaktonin dëm për imazhin e tyre të aftësisë.

f. Në Rumani ka një *Kod Profesional të Etikës për Gjyqtarët dhe Prokurorët*<sup>307</sup>, hartuar nga SCM. Kodi ka gabime, së pari sepse ai aplikohet njëllë si për gjyqtarët dhe prokurorët, gjë që thëllon keqkuptimin në lidhje me dy kategoritë e mësipërme. Meqenëse ata ushtrojnë dy detyra gjyqësore të dallueshme, nuk mund të ketë një kod sjelljeje të përbashkët. Së dyti, ky nuk është një kod sjelljeje i duhur. Rregullat e tij janë tepër të përgjithshme, jo të kufizuara në përcaktimin e sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme për gjyqtarët dhe prokurorët. Në vend të kësaj, shumica e dispozitave përsëritin, pa ndonjë detaj, përcaktimet në Ligjin për organizimin e gjyqësorit dhe në Statutin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kodi gjithashtu nuk arrin të identifikojë organin për udhëzimet etike apo sanksionet për mospërmbushjen e dispozitave.

Për më tepër, deri në vitin 2005 shkeljet e Kodit të Etikës nënkuptonin masa disiplinore kundrejt prokurorëve dhe gjyqtarëve, një gabim tjetër i rëndë, duke pasur parasysh se shkeljet e rregullave të sjelljes nuk mund të shkaktojnë sanksione disiplinore<sup>308</sup>. Përgjegjësia disiplinore imponohet vetëm për shkeljen e ligjit dhe jo të rregullave të etikës. Siç tregohet më sipër, vetë Parimet Bangalorit specifikojnë se çështjet e sjelljes së keqe duhet të vendosen nga një organ i veçantë nga ai që përgjigjet për aplikimin e sanksioneve disiplinore. Ky mund të jetë senati i një shoqate profesionale (p.sh., Senati i Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve në Rumani ose Këshilli i Etikës Profesionale të Shoqatës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve) ose një autoritet tjetër i brendshëm rregullator i profesionit. Shkeljet duhet të shkaktojnë vetëm sanksione që lidhen me profesionin të tilla si qortimet nga shoqata ose përjashtimet nga shoqata. Në këtë drejtim, krijimi i departamenteve të SCM (kryesisht një organ disiplinor) për shkeljet e sjelljes etike dhe përfshirjen e tyre në të dhënat profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për t'ua marrë parasysh me vlerësimin profesional të këtyre gjyqtarëve ose

<sup>307</sup> Miratuar me vendimin nr. 328/2005 të Asamblesë Plenare të SCM botuar në Gazetën Zyrtare nr. 815 të datës 8 shtator 2005.

<sup>308</sup> Ngatërrimi i rregullave disiplinore për rregullat e etikës (profesionale) shpesh konstatohet në kodet e sjelljes për profesione të ndryshme: zyrtarët e zbatimit të ligjit në gjykatë, agjentët publikë, etj.

prokurorëve, jo vetëm që u mungon justifikimi ligjor, por shkel rëndë pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>309</sup>.

g. Në vitin 2006, u finalizua *Kodi i Etikës për Gjyqtarët në Rumani*. Ai është kodi i parë që ekskluzivisht aplikohet për gjyqtarët dhe u përpilua nga Organizata PRO Etica së bashku me SCM<sup>310</sup>. Ky kod, pret përqaftimin nga gjyqtarët, me më shumë gjasë nëpërmjet organizimit të tyre profesional. Vlerat që promovohen nga kodi bazohen në idenë se janë gjyqtarët që duhet të përqafojnë etikën dhe jo t'ua imponojë shteti.

h. Një kod tjetër i etikës u propozua nga gjyqtarët dhe prokurorët e shoqatës rumune në nëntor 2007<sup>311</sup>. Me shtatë nene të shoqëruar nga Udhëzimet për implementim, duke ndjekur modelin e Komentarit të Parimeve të Bangalorit, *Kodi i Etikës për Gjyqtarët dhe Prokurorët* u synua për adoptimin nga të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët jo vetëm nga ata që ishin anëtarë të shoqatës. Deri tani nuk ka pasur debate mes gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë drejtim.

i. Së fundi, kode të tjerë të aplikueshëm për gjyqtarët publikë në gjyqësor disponohen për:

- personelin ndihmës të specializuar në gjykata dhe prokurori<sup>312</sup>,
- zyrtarët publikë, duke përfshirë inspektorët e NIA<sup>313</sup>,
- personeli me kontrata punësimi<sup>314</sup>,
- audituesit e brendshëm<sup>315</sup>,
- trupat e policisë dhe të xhandarmërisë<sup>316</sup>,

---

<sup>309</sup> Këto detyra u morën përsipër nga SCM, kundrejt vullnetit të legjislaturës së vitit 2005, me anë të modifikimit të vetë rregullave të organizimit dhe funksionimit të Këshillit, me vendimin nr. 564/2008, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 515 të 9 korrikut 2007. Ky vendim u anulua nga Gjykata e Apelit të Bukureshtit, dhoma VII të departamentit administrativ dhe fiskal, më 1 prill 2009 (çështja nr. 8920/2/2008).

<sup>310</sup> Kodi është një rezultat i projektit të titulluar "Koordinatat e profilit etik të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Kërkesat e reja të vlerësimit moral të gjyqtarëve" inicuar nga "PRO Etica – Etika në profesione" seminar i departamentit të filozofisë të Universitetit Babes – Bolyai në Cluj – Napoca, të cilit iu bashkua në etapën përfundimtare të projektit edhe Qendra për Etikën e Aplikuar në departamentin e filozofisë së universitetit të Bukureshtit. Financimi për projektin u miratua nga SCM në mbledhjen plenare të 14 dhjetorit 2006, dhe përmbajtja e raportit të ndërmjetëm u miratua nga SCM në mbledhjen plenare të 13 korrikut 2006. Projekti ende nuk është finalizuar.

<sup>311</sup> Shoqata rumune e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kodi i etikës për gjyqtarët dhe prokurorët - udhëzime për implementim Hamanghiu, Bukuresh, 2007.

<sup>312</sup> Kodi i Etikës për personelin ndihmës të specializuar në gjykata dhe prokurori, atashuar gjykatave, miratuar me vendimin e SCM nr. 145 të vitit 2005, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 382 të 6 majit 2005. Ne kemi rezerva për ligjshmërinë e miratimit të këtij kodi nga SCM, një organ i cili ka juridiksion vetëm mbi karrierat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

<sup>313</sup> Ligji nr. 7/23.02.2004 për kodin e sjelljes për zyrtarët publikë ribotuar në Gazetën Zyrtare nr. 525 të 2 gushtit 2007.

<sup>314</sup> Ligji nr. 477/08.11.2004 për kodin e sjelljes të personelit të punësuar me kontrata në autoritetet dhe institucionet publike, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 1105 të 26 nëntorit 2004.

<sup>315</sup> Kodi i sjelljes së etikës për audituesit e brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 252 të vitit 2004 nxjerrë nga Ministri i Financave Publike, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 128 të 12 shkurtit 2004.

<sup>316</sup> Kodi i etikës profesionale për punonjës të policisë miratuar me urdhrin e qeverisë nr. 991/25.08.2005, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 813 të 7 shtatorit 2005. Sipas nenit 25 të Kodit, dispozitat e tij aplikohen edhe për trupat e xhandarmërisë rumune. Udhëzimet janë miratuar për implementimin e kodit (udhëzimet përfshijnë rregullat e sjelljes dhe rekomandojnë qasjen për situatat e korrupsionit që hasen nga punonjësit e policisë), gjendet në [ww.mai.gov.ro/Documente/Cariera/GHIDUL\\_etica\\_deontologie.pdf](http://ww.mai.gov.ro/Documente/Cariera/GHIDUL_etica_deontologie.pdf). Urdhri nr. 6582/2005 miraton kodin e etikës për zyrtarët publikë në autoritetin e doganës; ai përfshin parimet në lidhje me dhurata përkujtimore dhe publikimin e çështjeve të korrupsionit. Në nivel evropian, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin nr. (2001) 10 mbi kodin e etikës së policisë.

- noterët publikë<sup>317</sup>,
- përmbauesit<sup>318</sup>,
- avokatët<sup>319</sup>,
- mediatorët<sup>320</sup>,
- këshilltarët ligjorë<sup>321</sup>,
- personeli penitenciar<sup>322</sup>,
- praktikuesit e insolvencës<sup>323</sup>.

Patologët kriminalistë dhe kontabilistët e miratuar u nënshtrohen rregullave të etikës që aplikohen në përgjithësi për profesionet e tyre.

## 5. Lufta kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë

Përgjegjësia fillon aty ku përfundon përgjegjshmëria. Një fushatë e suksesshme për parandalimin e korrupsionit do të çojë në sanksione më të pakta. Por praktika ka treguar se numri i punonjësve gjyqësorë që ndëshkohen për krimet e korrupsionit është duke u rritur nga viti në vit. Politikat për luftën kundër korrupsionit përfshijnë tre drejtime: rregullimi i shkeljeve, hetimi i krimeve dhe frenimi i tyre. Politikat për të luftuar korrupsionin gjyqësor mbivendosen me politikat e përgjithshme kundër korrupsionit, duke u bërë gjyqësori subjekti i vetes.

### 5.1 Rregullimi i shkeljeve

Nuk ka dyshim se të gjithë mjetet penale dhe jashtë penale për të luftuar korrupsionin duhet të bazohen tek vullneti i fortë politik. Anëtarët e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv duhet të pranojnë dhe të promovojnë një kuadër ligjor që të jetë në gjendje të ndihmojë reduktimin e korrupsionit në përgjithësi. Të paktën në një nivel deklarativ, ky vullnet është shprehur në pak vitet e kaluara, veçanërisht gjatë periudhës

<sup>317</sup> Kodi i etikës për noterët publikë në Rumani, miratuar në Kongresin e tretë të Unionit Kombëtar të Noterëve Publikë në Rumani, 2001. Konferenca e noterëve të Bashkimit Evropian miratoi në 1995 një kod etik evropian për profesionin e noterëve.

<sup>318</sup> Kodi etikës për oficerët e zbatimit të ligjit të gjykatave përbën Shtojcën nr. 2 të statutit të Unionit Kombëtar të Oficerëve të Zbatimit të Ligjit të Gjykatës dhe profesionin e oficerit të zbatimit (përmbauesit) të gjykatës dhe u miratua me vendimin nr. 21/2007 të Unionit Kombëtar të Përmbauesve të Gjykatës, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 430 të 28 qershorit 2007.

<sup>319</sup> Kodi i sjelljes për avokatët ÇBE në komunitetin evropian u miratua në mbledhjen plenare të ÇBE të 28 tetorit 1998 dhe u amendua në sesionet plenare të 28 nëntorit 1998 dhe 6 dhjetor 2002. Ky kod është aplikuar drejtpërdrejt në Rumani që prej 1 janarit 2007, pas vendimit të UNBR nr. 1486/2007.

<sup>320</sup> Kodi i etikës profesionale dhe sjelljes për mediatorët (ndërmjetësit), miratuar nga Këshilli i Ndërmjetësve. Në nivel të BE-së, ka një kod të sjelljes evropian për ndërmjetësit, të miratuar nën kujdesin e Bashkimit Evropian në një konferencë të mbajtur në Bruksel në 2 korrik 2004.

<sup>321</sup> Ka disa shoqata të këshilltarëve të bashkuar. Ia vlen të përmendim kodin profesional të etikës për këshilltarët e bashkuar nga Kongresi i Bashkimit të Këshilltarëve të Shoqërive në Rumani në 27 korrik 2004 dhe kodi i sjelljes profesionale për shoqëritë e këshilltarëve miratuar nga shoqata e-F. CONC më 1 tetor 2004.

<sup>322</sup> Urdhri i Ministrisë të Drejtësisë nr. 2794/C i 8 tetorit 2004 që miraton kodin e etikës për personelin në sistemin penitenciar, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 1098 të 25 nëntorit 2004.

<sup>323</sup> Kodi i etikës dhe disiplinës profesionale të Unionit Kombëtar të praktikuesëve të insolvencës në Rumani, miratuar nga kongresi i Unionit me vendimin nr. 3/2007, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 838 cit. të 7 dhjetorit 2007.

së para aderimit të Rumanisë në BE, nëpërmjet frazave të tilla si "*zero tolerancë ndaj korrupsionit*"<sup>324</sup>.

#### **a. Kriminalizimi i krimeve të korrupsionit**

Aktualisht shkeljet e korrupsionit janë kriminalizuar në Kodin Penal (ato futen në kategorinë e veprave penale në detyrë ose të lidhura me detyrën) dhe në ligjin nr. 78/2000.

Por legjislacioni ynë duhet të kriminalizojë dhe veprën penale të pasurimit të paligjshëm siç kërkohet sipas nenit 20 në Konventën e OKB-së kundër korrupsionit: "Duke ju nënshtruar kushtetutës së tij dhe parimeve themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë do të konsiderojë miratimin e këtyre masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të domosdoshme për të përcaktuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim, pasurimin e paligjshëm, domethënë, një rritje e madhe me asetet e një zyrtari publik që ai ose ajo nuk mund t'i shpjegojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme". Në pamjen e parë, struktura e veprës penale duket se e vështirë të pajtohet me interpretimet tradicionale të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës të individit për t'u mbrojtur nga vetë inkriminimi. Në terma të përgjithshme, parakushti i përlligjjes së burimit të pasurisë së pajustificuar ndonjëherë konsiderohet ose si një transferim i barrës së provës tek i pandehuri, ose si një detyrim i të pandehurit për të inkriminuar veten, ose të dyja. Në lidhje me prezumimin në "përfitimin e paligjshëm të pasurisë" gjykatat rumune kanë qenë krejt eksplicite, duke theksuar se ky prezumim "pushon së vepruari" kur ka "*prova të qarta*" ("*prova të mjaftueshme*") për të përdorur frazën e GJEDNJ se asetet janë përvetësuar në mënyrë të paligjshme.

Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e Drejtësisë ka deklaruar në mënyrë eksplicite se "ndryshimi i barrës së provës"<sup>325</sup> është kusht për prova të mjaftueshme.

Edhe legjislacioni duhet të përcaktojë sanksione efektive, përpjesëtimore dhe penguese dhe masa për kryerjen e veprës penale të korrupsionit - të kryera nga individët, këto vepra penale duhet të çojnë në dënime me burgim<sup>326</sup>. Por ia vlen të shënohet aspekti i mëposhtëm: korrupsioni mund të reduktohet me sanksione shtrënguese kundër atyre që është provuar se janë përfshirë në këto akte. Prandaj sanksionet shtrënguese mund të ulin numrin e veprave penale të korrupsionit, por kjo mund të ketë edhe një efekt tjetër, përkatësisht atë të rritjes së vlerës së aseteve (shumave të parave, vlerën e shërbimeve) të përfshira në shkeljet e korrupsionit që kryhen akoma. Kryesisht, lind një paradoks - në mënyrë që të zhduket mita forcohen sanksionet, gjë që çon në një rritje të shumës së mitës për shkak të riskut të rritur se

---

<sup>324</sup> "Komisioneri Evropian për Zgjerimin, Günther Verheugen deklaroi: BE i çmon përpjekjet legjislative dhe inkurajon Bukureshtin që të provojë angazhimin e tij për një politikë me tolerancë zero ndaj korrupsionit në çdo nivel" (rekomandimet për Rumaninë nga Gunter Ferheugen, gjatë vizitës së tij në Rumani, ...23 qershor 2004. "Qeveria e Rumanisë deklaroi tolerancë zero ndaj korrupsionit" (kapitulli katër). III në programin e qeverisë 2005 të vitit 2008 "ne duhet të sigurojmë zhvillimin e burimeve njerëzore, mobilitetin institucional të zyrtarëve dhe një sistem matjeje për performancën e zyrtarëve publikë. Ne gjithashtu duhet të rishikojmë sistemin e pagave për të siguruar konsistencë më të lartë mes institucioneve. Këto procese gjithashtu duhet të shoqërohen me tolerancë zero për korrupsionin e zyrtarëve publikë". (fjalë e Presidentit të Rumanisë, Trajan Basescu, para Dhomave të Bashkuara të Parlamentit, mbi integrimin e Rumanisë në Bashkimin Evropian, Pallati i Parlamentit, 19 qershor 2006).

<sup>325</sup> Për një arsyetim gjithëpërfshirës, shih Guillermo Jorge, kuadri legjislativ në Rumani në lidhje me pasurimin e paligjshëm, ABA/CEELI, 2007 gjendet në faqen e internetit të SCM [www.csm1909.ro/csm/linkuri/28\\_01\\_2008\\_\\_13799\\_ro.pdf](http://www.csm1909.ro/csm/linkuri/28_01_2008__13799_ro.pdf).

<sup>326</sup> Neni 19 në Konventën e Këshillit Evropian për ligjin penal kundër korrupsionit.

dikush mund të kapet. Kjo është arsyeja për se konfiskimi i aseteve të korrupsionit dhe ndalimi i të drejtave të caktuara duhet të shoqërohet edhe me penalitete tradicionale.

Penalitetet tradicionale duhet të shoqërohen me sanksione plotësuese specifike për veprën penale të korrupsionit. Kështu, ligji duhet të *parashikojë ndëshkimin për të përfshirë ndalimin e ushtrimit të të drejtës për të mbajtur detyrën publike ose profesionin ose aktivitetin në ushtrimin e të cilit është kryer vepra penale.*

Jo vetëm individët por edhe entet ligjore duhet të përgjigjen për këtë.

Konventa e OKB-së kundër korrupsionit parashikon, sipas nenit 18, se entet ligjore duhet të përgjigjen për kryerjen e veprave aktive të korrupsionit, tregtimit të influencës dhe pastrimit të kapitalit, në qoftë se këto kryhen për llogari të tyre nga një individ që vepron ose individualisht ose si anëtar i një organi brenda entit ligjor në të cilin individ mban pozitat drejtuese. Kjo mund të lidhet me cilësinë përfaqësuese brenda entit ligjor; ose autoritetin që merr vendime në emër të entit ligjor; ose autoritetin që kryhen një inspektim të entit ligjor, si dhe pjesëmarrjen nga ai individ, si një bashkëpunëtor në krim ose shtytës për kryerjen e veprave penale të sipërpërmendura. Duhet të merren edhe masat për të siguruar që një ent ligjor mund të përgjigjet në qoftë se kërkesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga ana e një individ të përmendur më sipër ka lejuar kryerjen e veprave penale të sipërpërmendura, për llogari të atij enti ligjor nga një individ që i nënshtrohet autoritetit të tij/të saj.

#### **b. Rregullimi i konfliktit të interesit**

Aktualisht, rregullat që rregullojnë konfliktet e interesit dhe papajtueshmëritë përcaktohen në ligjin nr. 161/2003 dhe në ligjet që përcaktojnë statusin e profesioneve ligjore.

Në qoftë se *konflikti i interesit* nuk shmanget nga një agjent publik i cili megjithatë kryhen një akt korrupsioni, kjo mund të përbëjë një krim të rregulluar nga neni 2531 në Kodin Penal. Vepra penale e konfliktit të interesit sundon situatën në të cilën një zyrtar publik i cili gjatë kryerjes së detyrave zyrtare të tij/saj kryhen një akt ose merr pjesë në marrjen e një vendimi që siguron direkt ose indirekt ndonjë përfitim material për atë zyrtar, bashkëshortin e tij/saj, për këdo që lidhet nga gjaku ose martesë me zyrtarin, brenda dy shkallëve të martesës ose për ndonjë individ me të cilin zyrtari ka marrëdhënie profesionale ose zyrtare gjatë pesë viteve të fundit ose prej të cilit zyrtari ka marrë ose merr shërbime ose përfitime të çfarëdo lloji. Po qe se nuk plotësohen të gjithë elementët e kësaj vepre penale (p.sh., nuk ka pasur përfitime materiale, ose ka pasur përfitime materiale për një person të lidhur nga gjaku ose martesë brenda shkallëve të farefnisës), akti futet në kategorinë penale të keqbjërjes ose thjesht të sjelljes se keqe.

Duhet të miratohen edhe rregullat që parandalojnë konfliktet e interesit që lidhen me transferimet në *sektorin privat*. Duhet të ketë kufizime për një kohë të arsyeshme në lidhje me praktikën e aktiviteteve profesionale nga agjentët publikë të mëparshëm ose për punësimin privat të agjentëve publikë pasi ata japin dorëheqjen ose dalin në pension, kur aktivitetet përkatëse dhe punësimi përkatës janë direkt të lidhura me detyrat që këta ish-agjentë publikë mbanin ose mbikëqyrnin kur shërbenin në sektorin publik<sup>327</sup>. Për shembull, legjislacioni rumun e ndalon një gjyqtar, prokuror apo punonjës policie që është bërë avokat që të praktikojë në gjykatë ose në organin e ndjekjes penale ku ata

---

<sup>327</sup> Neni 12. e në Konventën e OKB-së kundër korrupsionit. Një rregullore e përkohshme e këtij aspekti është përfshirë në legjislacionin kombëtar në nenin 11 të ligjit nr. 78/2000, përmendur më sipër.

shërbenin më parë<sup>328</sup>. Por kjo gjë nuk është e vërtetë për nëpunësit e gjykatës që bëhen avokatë. Megjithëse i njëjti arsyetim duhet të aplikohet, ata që bëhen avokatë ruajnë, të paktën për pak kohë, marrëdhënie të ngushta me ish-kolegët, të cilët mund të ndikojnë në objektivitetin e tyre. Gjithashtu, për ekspertin publik kriminalistik që e ndërpret këtë cilësi në shkëmbim të punës private, si ekspert i certifikuar, nuk i vendosen kufizime për praktikimin e këtij profesioni. Veç kësaj, legjislacioni aktual nuk arrin të parashikojë papajtueshmëritë midis të shërbyerit si ekspert zyrtar dhe një eksperti të autorizuar. Kjo lejon, për shembull, që një ekspert i punësuar në institutin kombëtar kriminalistik në Ministrinë e Drejtësisë, të propozohet si ekspert nga njëra prej palëve dhe të pranohet nga organi gjyqësor për të dëshmuar në të njëjtën çështje në të cilën një koleg ekspert instituti është ekspert zyrtar. E njëjta gjë është e vërtetë dhe për patologët kriminalistikë.

Për profesionet e lira, aktet normative të dallueshme që rregullojnë statutin e këtyre profesioneve përfshijnë rregullat në lidhje me konfliktet e interesit dhe parashikojnë që mos përputhja të çojë në masa disiplinore.

### **c. Rregullimi i përgjegjësisë civile për korrupsionin**

Duhet të vendoset përgjegjësia për veprat penale të korrupsionit edhe në nivelin civil. Duhet të krijohen masat e përshtatshme që do të lejonin personat që kanë kryer dëme si rezultat i një vepre penale të korrupsionit të kryer nga një zyrtar publik, gjatë detyrës së tij/saj zyrtare, të pretendojë kompensime nga qeveria ose aty ku qeveria nuk është palë, nga organet kompetente të asaj pale<sup>329</sup>.

Në rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kjo kërkesë është në përputhje me formën aktuale të përgjegjësisë materiale të gabimeve gjyqësore. Sipas nenit 52 të Kushtetutës të Rumanisë, "Qeveria përgjigjet për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga gabimet gjyqësore. Përgjegjësia e qeverisë vendoset sipas ligjit dhe nuk përjashton përgjegjësinë e gjyqtarëve ose prokurorëve të cilët i kanë kryer detyrat e tyre në keqbesim ose me neglizhencë të rëndë". Aktet normative që renditen pas kushtetutës rregullojnë përgjegjësinë e anëtarëve të tjerë të gjyqësorit.

Për gabimet gjyqësore, neni 96 i ligjit nr. 303/2004 dhe neni 504 - 507 në Kodin e Procedurës Penale, parashikon sistemin e mëposhtëm të përgjegjësisë:

1) *në ligjin penal*, ka dy situata:

- një person që është dënuar gabimisht me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimeve në qoftë se, sipas një vendimi të dhënë gjatë rigjykimit të çështjes së tij (pas rishikimit, d.m.th., një gjyq i ri i bazuar në prova të reja në të njëjtën çështje), ai person deklarohet i pafajshëm,

- një person që është arrestuar/ ndaluar ose që nuk i lejohet të largohet nga vendi/ lokaliteti, ka të drejtën e kompensimeve në kushtin që natyra e paligjshme e masës është vendosur nga një prokuror ose një gjyqtarë. Personi në fjalë ose përfituesit e tij/saj kanë të drejtën të ngrënë padi kundër qeverisë, nëpërmjet Ministrisë së Financave brenda 18 muajsh. Qeveria do të paguajë të gjithë shumën ose pagesat për çdo vit, pastaj do të lëvizë për të marrë paratë nga gjyqtari ose prokurori ose ndonjë person tjetër që ka gjeneruar

<sup>328</sup> Neni 106 I ligjit nr. 161/2003: (1) një gjyqtar që bëhet avokat nuk do të paraqesë çështjen në gjykatën ku ai/ajo shërbente si gjyqtar, për dy vite pas ndërprerjes së punësimit publik. (2) një prokuror që bëhet avokat nuk do të japë asistencë gjyqësore në organet e ndjekjes penale në lokalitetin ku ai/ajo shërbeu, për dy vite pas ndërprerjes së punësimit publik". Neni 19, paragrafi 4 në ligjin nr. 51/1995: "avokatët që kanë qenë gjyqtarë nuk do të paraqesin çështje në gjykatat ku ata shërbyen dhe ish-prokurorët dhe punonjësit e policisë nuk do të japin asistencë në njësinë e ndjekjes penale ku ata kanë shërbyer, për dy vite pas ndërprerjes së punësimit të tyre publik përkatës".

<sup>329</sup> Neni 5 në Konventën për ligjin civil të KiE kundër korrupsionit.



situatën, e cila ka çuar tek dëmet (p.sh., punonjësi i policisë i cili ka përdorur mjete të paligjshme për të marrë dëshminë e dëshmitarit kyç, sekretarja e gjykatës që ka hequr nga dosja e çështjes një provë të rëndësishme, e cila do të çonte në një vendim të ndryshëm) në qoftë se ky person ka vepruar në keqbesim ose me neglizhencë të rëndë.

2) *në ligjin civil*: në qoftë se një vendim është shpallur se mbetet i formës së prerë, por që në fakt, është një gabim gjyqësor, pala e dëmtuar së pari duhet të kërkojë një vendim kundër gjyqtarit, i cili ka kryer një vepër penale, ose një vendim të SCM në lidhje me masat disiplinore kundër gjyqtarit ose prokurorit, për aktin që gjeneroi gabimin (p.sh., keqpërvetësimi i dokumenteve nga dosja e çështjes, mos arritja për të konsideruar prova themelore të tilla si testet NAD). Vetëm atëherë pala e prekur nga gabimi gjyqësor ka të drejtën që të ngrejë padi kundër shtetit rumun, përfaqësuar nga Ministria e Financave. Në qoftë se, qeveria humbet çështjen dhe paguan kompensimet, qeveria mund të kërkojë kthimin e shumave nga gjyqtari ose prokurori që duke vepruar në keqbesim ose me neglizhencë të rëndë, ka bërë që gabimi gjyqësor të shkaktojë dëmin. Besimi i keq ose neglizhencia e rëndë do të provohet gjatë procesit përkatës. Por të gjitha këto masa duhet të merren brenda një viti. Natyrisht, kur është i përfshirë një agjent publik në një shkelje korrupsioni, *keqbesimi* i tij/i saj gjithmonë do të regjistrohet.

#### **d. Rregullimi i masave disiplinore**

Aktet që përbëjnë shkelje përcaktohen në rregullat që përcaktojnë statusin e çdo kategorie të personelit në gjyqësor. Shkeljet që iu nënshtrohen veprimeve disiplinore përfshijnë ato që lidhen me keqbërjen ose korrupsionin të tilla si ndërhyrja e paligjshme në punën e kolegut, ndërhyrja me synimin për të ndikuar në gjykimin e aplikimeve për të plotësuar interesat e ndonjë personi, pranimin e dhuratave, shkeljen e rregullave të papajtushmërisë ose konfidencialitetit, mos publikimi i aseteve ose interesave. Besojmë se kjo kategori duhet të përfshijë gjithashtu mospublikimin e atyre shkeljeve të kryera nga kolegët, veçanërisht kur ato kanë ardhur në dijeni të zyrtarëve të menaxhimit ose të atyre që kanë funksione mbikëqyrëse.

Në këtë drejtim ligji nr. 293/2004 mbi statusin e nëpunësit publik me një status të veçantë në listat NPA "qëndrimi i butë i eprorëve në lidhje me shkeljet e vartësve të tyre" si shembull i shkeljes.

Tërësisht në lidhje me korrupsionin, ligji për statusin e punonjësit të policisë është i vetmi që detyron punonjësit e policisë të informojnë eprorët e tyre dhe autoritetet e tjera kompetente për krimet e korrupsionit të kryera nga punonjës të tjerë policie gjatë kryerjes së detyrës së tyre (neni 41 g), përndryshe rrezikojnë që të marrin masa disiplinore vetë (neni 57 lit. k). Por për të siguruar që personeli i policisë të angazhohet në një luftë efektive kundër korrupsionit, duhet të hartohen dispozita të ngjashme edhe për profesione të tjera.

Që të funksionojë sistemi i përgjegjësisë disiplinore, njohuritë për procedurën në tërësi duhet të njihen nga grupi objekt i tij. Në këtë drejtim, disa çështje janë raportuar për sanksione të aplikuara për punonjësit e policisë sipas një urdhri të papublikuar si urdhri nr. 400 i vitit 2004 mbi rregullat disiplinore për personelin e M.A.I.<sup>330</sup>. Në tre vitet e para të zbatimit, rreth 5000 nga 75.000 punonjës policie në Rumani, iu nënshtuan penalteteve disiplinore. Ndryshe nga ky urdhër, për personelin e shërbimit të provës Ministria e Drejtësisë miratoi me urdhrin nr. 2017/2007 rregulloren për

---

<sup>330</sup> Më 29 tetor 2004, Ministri i Administratës dhe i Brendshëm, lëshoi urdhrin nr. 400/2004 mbi veprimin disiplinor për personelin e MAI. Dokumenti nuk u botua në Gazetën Zyrtare siç u kërkuar sipas nenit 10 dhe nenit 11 në ligjin nr. 24/2000 mbi rregullat e procedurës legislative duke pasur parasysh hyrjen në fuqi.

funksionimin e komitetit disiplinor që heton shkeljet e personelit të shëbimit të provës që u botua në Gazetën Zyrtare nr. 570 të 20 gushtit 2007.

Ligji gjithashtu duhet të parashikojë në mënyrë eksplicite dhe jo në mënyrë të paqartë, se cilat tipe sjelljeje cilësohen si shkelje. Frazat tepër të përgjithshme e bëjnë ligjin të paparashikueshëm dhe lejojnë organet disiplinore që të marrin masa abuzive. Shembujt përkatës përfshijnë një dispozitë të aplikueshme për avokatët, në nenin 252, paragrafi 2 i statutit të profesionit të avokatit<sup>331</sup>, i cili thotë, "*një veprim i kryer nga një avokat, i cili është kundër ligjit, statutit të profesionit, vendimeve detyruese të organeve profesionale, këshillit të avokatëve në të cilin avokati është anëtar ose ku avokati ka detyrën e tij/të saj të dytë, dhe që ka gjasë të paragjykojë nderin ose reputacionin e profesionit ose të trupës së avokatëve, përbën shkelje*". Ka një rregull të ngjashëm që aplikohet për nëpunësit e gjykatës në nenin 84 (g) i Ligjit nr. 567/2004 mbi statutin e personelit të specializuar ndihmës në gjykata dhe prokuroritë atashuar gjykatave, sipas të cilave "*sjellja që paragjykon dinjitetin ose cilësinë profesionale*" përbën shkelje. Një shembull i shkeljes shfaqen edhe në nenin 65 (d) i statutit UKNP<sup>332</sup>, i cili njih, "*sjelljen që e paragjykon nderin ose reputacionin e profesionit*". Megjithatë, një ilustrim tjetër vjen nga neni 44 (c) në ligjin nr. 188/2000 për oficerët e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, ku "*kryerja e akteve që paragjykojnë nderin ose reputacionin e profesionit është jo korrekte*".

Brenda procedurës disiplinore, duhet të zbatohet *parimi i gjykimit të drejtë*<sup>333</sup>, i cili kërkon kontrollimin e mbrojtjes të atyre që akuzohen për shkelje. Si rregull, procedura disiplinore për personelin e sipërpërmendur parashikojnë detyrimin për të dëgjuar personin e akuzuar dhe për të verifikuar provat që ai/ajo paraqet si mbrojtje. Përfundimisht, sanksionet e rregulluara duhet të jenë graduale, të kalojnë nga vërejtja ose paralajmërimi tek ndalimi i praktikimit të profesionit, por ato duhet të lidhin gravitetin e keqsjelljes me natyrën e penaltetit. Në këtë drejtim, në rastin e disa profesioneve, ligji parashikon kriteret të ndryshme për të përcaktuar ndëshkimin<sup>334</sup>, ndërsa rregulloret e profesioneve të tjera i referohen vetëm gravitetit të çështjes së keqsjelljes<sup>335</sup>. Kjo dispozitë e fundit i lejon organit sanksionues që të aplikojë penaltete

<sup>331</sup> Miratuar në mbledhjen e këshillit UNBR të datës 25 shtator 2004 dhe botuar në Gazetën Zyrtare nr. 45 të 13 janarit 2005.

<sup>332</sup> Statuti i Unionit Kombëtar të Noterëve Publikë në Rumani botuar në Gazetën Zyrtare nr. 59 të 11 shkurtit 1999.

<sup>333</sup> Rregullat e gjykimit të drejtë aplikohen edhe në veprimin disiplinor, siç parashikohet nga çështjet e GJEDNJ Oluic kundër Kroacisë, gjykim i datës 05 shkurt 2009 (mbi anëtarët e këshillit gjyqësor që bëjnë deklaratat publike për çështjen gjatë procedurës disiplinore në lidhje me një gjyqtar për të cilin ata po merrnin vendim) dhe Engel kundër Hollandës, gjykim në parim i datës 08 qershor 1976.

<sup>334</sup> Neni 59, paragrafi 8 në ligjin nr. 360/2002 mbi statusin e punonjësve të policisë: "*për përcaktimin e penaltetit, vëmendje i duhet kushtuar aktivitetit të mëparshëm, rrethanave në të cilën ka ndodhur çështja e keqsjelljes, shkaqet, graviteti dhe pasojat e çështjes së keqsjelljes, shkalla e fajit të punonjësit të policisë dhe shqetësimin për largimin e pasojave të keqsjelljes*". Neni 74, paragrafi 3 i ligjit nr. 123/2006 mbi statusin e personelin në shërbimin e provës, caktimin e sanksionit disiplinor, vëmendje i duhet kushtuar shkaqeve dhe gravitetit të çështjes së keqsjelljes, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ajo ka ndodhur, shkallën e fajit të personit dhe pasojat e çështjes së keqsjelljes, sjelljen e përgjithshme profesionale dhe në qoftë se sanksionet e mëparshme disiplinore të aplikuar në të kaluarën për personin në fjalë". Neni 63, paragrafi 1 në ligjin nr. 293 me status të veçantë nga NPA: "*në përcaktimin e sanksionit disiplinor për atë që aplikohen, vëmendje i duhet kushtuar shkaqeve dhe gravitetit të çështjes së keqsjelljes, rrethanave në të cilat ajo ndodhi, shkallës së fajit dhe pasojave të çështjes së keqsjelljes, sjelljes së përgjithshme profesionale të shkelësit dhe ekzistencës së sanksioneve të mëparshme disiplinore*".

<sup>335</sup> Neni 85, paragrafi 1 në ligjin nr. 567/2004 mbi sekretaret e gjykatave, neni 100, në ligjin nr. 303/2004 mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 46 në ligjin nr. 188/2000 mbi oficerët e zbatimit të

abuzive të pajustificuara ose madje penaltete të veçanta për të njëjtin akt të kryer nga dy punonjës, gjë që është e papranueshme. Kjo është arsyeja përse legjislacioni duhet të parashikojë kritere objektive për përcaktimin e penalteteve, duke përjashtuar kompetencat diskrecionare të organeve disiplinore.

### **c. Rregullimi i sjelljes**

Sjellja e personelit gjyqësor duhet të rregullohet me një kod të sjelljes etike. Në lidhje me gjyqtarët duhet të shpjegohen konceptet 'gjyqtar', 'pavarësi' dhe 'paanësi' dhe duhet të ruhet një kulturë e rëndësisë që kanë këto vlera. Por pavarësia, paanësia dhe integriteti janë para së gjithash detyrime që rrjedhin nga detyrat e punës - një punë që synon t'i shërbejë detyrës juridiksionale me profesionalizmin më të lartë. Prandaj, një kod i tillë duhet të theksojë rëndësinë e integritetit dhe formave të tij, nga detyrimi për të parandaluar korrupsionin dhe punën për ta luftuar atë, deri tek shmangia e nepotizmit dhe konflikteve të interesit, duke shpjeguar sjelljen që gjyqtarët dhe prokurorët duhet të adoptojnë gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare dhe kufizimet që aplikohen jashtë institucionit. Këto kode gjithashtu duhet të theksojnë idenë e autoritetit të gjyqtarëve, kryesisht autoritetin moral, i cili do t'i bënte ata më të besueshëm dhe në të cilin mbështetet besimi i përgjithshëm tek gjyqësori. Dhe së fundi, këto kode duhet të mbrojnë idenë e pavarësisë së gjyqësorit, i cila është një garanci e jashtme e paanësisë së gjyqtarëve (që mund të shikohet si një formë e integritetit) dhe e cila duhet të promovohet para së gjithash nga gjyqtarët nëpërmjet praktikës<sup>336</sup> dhe nëpërmjet forcimit të lirisë së fjalës<sup>337</sup> dhe lirisë së shoqërimit.

Një dokument i tillë nevojitet për të udhëzuar sjelljen gjyqësore. Kjo mund të rregullojë punën me mediat dhe politikanët; kufizimet për miqësitë midis gjyqtarëve dhe prokurorëve ose avokatëve; përgjegjësinë e gjyqtarëve në lidhje me personelin ndihmës në gjykata; rëndësinë e precizonit, durimit dhe transparencës; menaxhimin e duhur të seancës; rëndësinë e vetëpërgatitjes, paragjykimin, ruajtjes së një drejtpeshimi midis të drejtave të palëve; trajtimin e palëve me dinjitet dhe shmangien e diskriminimit; lirinë e shoqërimit dhe lirinë e fjalës, duke përfshirë daljen në media, pranimin e dhuratave, frekuentimin e klubeve, bareve, aktivitetet e lojërave të fatit ose shoqërive sekrete; ose praktika e aktiviteteve të tjera gjyqësore ose administrative. Kodi duhet të trajtojë jo vetëm profesionistët. Ai duhet të planifikohet edhe si një instrument për të ndihmuar

---

gjykatës vetëm parashikojnë se masat disiplinore duhet të jenë përpjesëtimore me gravitetin e çështjes së keqsjelljes.

<sup>336</sup> Një gjyqtar ka jo vetëm lirinë, por dhe detyrimin që të reagojë ndaj padrejtësive në sistem, ndaj akteve jo profesionale të kryera nga kolegët, ndaj gabimeve të drejtimit që ndikojnë në administrimin e drejtësisë. Rëndësia e pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në debatet publike për organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit u nënvizua faktikisht nga GJEDNJ në rastin e Kudeshkina kundër Ruisë (2009), në të cilën shteti rus u dënua për revokimin nga detyra të një gjyqtari që publikoi parregullsitë në lidhje me gjykimin e çështjeve madhore penale nga Gjykata e Lartë. Për lirinë e gjyqtarëve për të shprehur ideologjitë e tyre, shih gjykimin mbi Albayrak Aktas kundër Turqisë (2008).

<sup>337</sup> Në Egjipt gjyqtarët dhe prokurorët që janë të angazhuar me shoqatat profesionale kombëtare kundërshtuan vlefshmërinë e zgjedhjeve të padrejta. Megjithëse qeveria reagoi me forcë, ajo mundi vetëm të ndezë një fushatë në favor të pavarësisë së gjyqësorit, e cila kulmoi në prill – qershor 2006 kur protestat u organizuan si nga shoqëria civile edhe nga partitë e opozitës, dhe gazetarët dhe organizatat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Megjithëse, qeveria egjiptiane fillimisht i arrestoi protestuesit, më pas ajo u tërhoq pasi akuzat kundër dy gjyqtarëve u anuluan si të pa baza nga këshilli disiplinor dhe një protestë e heshtur u mbajt nga 300 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë në Kairo (Pericalt, eficaenca e ligjit në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimit të tij, në revistën e SCM 'Justicia in actualitate' nr. 3/2008, fq. 46).

politikanët (në kuptimin e rëndësisë së pavarësisë së gjyqësorit që ata duhet ta mbrojnë), avokatët (për të kuptuar nevojën për të ruajtur marrëdhënie të duhura dhe të ndershme brenda sistemit) dhe publikut të përgjithshëm (për të kuptuar se si duhet të shfaqet një gjyqtar në mënyrë që ndershmëria e tij/e saj dhe aftësitë të jenë të besueshme, rrethanat në të cilat mund të kritikohen gjyqtarët dhe gjykimet e tyre, etj). Një kod etike ose sjelljeje duhet të kontribuojë në veçanti për zhvillimin e një sensi dhe një praktike të përgjegjësive në lidhje me kryerjen e performancës dhe detyrave publike.

Theksojmë se rrallë bëhet një dallim midis kodit të etikës dhe kodit deontologjik. Dallimi bëhet vetëm me rregulloret në lidhje me punonjësit e policisë dhe ndërmjetësit<sup>338</sup>. Për profesione të tjera, ka një konfuzion shumë të madh<sup>339</sup>.

Është hartuar një kod deontologjik (për sjelljen profesionale) nga autoritetet në mënyrë që të rregullohen parimet e përgjithshme dhe rregullat që sundojnë në profesion (d.m.th., standardet minimale të nevojshme dhe të detyrueshme për praktikën antikorrupsion). Rregullat e sjelljes profesionale janë të kufizuara në plotësimin e detyrimeve ligjore që lidhen me kryerjen e detyrave përkatëse, siç parashikohen në ligjin për organizimin e institucioneve gjyqësore dhe në ligjin që rregullon statusin profesional. Prandaj, dallimi midis ligjit dhe moralit është ngatërruar dukshëm. Një shkelje e rregullave deontologjike mund të jetë dhe duhet të jetë subjekt i penalteteve disiplinore, zakonisht të aplikuara nga të njëjtat autoritete. Kjo është arsyeja, sipas parimit kushtetues të ndarjes të pushteteve, kodi deontologjik i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të imponohet nga dy pushtetet e tjera. Për ta përmbledhur, një kod i sjelljes profesionale është një mjet i korrigjimit që imponohet nga 'poshtë lart', i cili 'dënon' sjelljen e papranueshme dhe rezulton në sanksione negative, disiplinore.

*Kodi i etikës (kodi etik)* nga ana tjetër i jep grupit, rregullat për sjelljen që duhen adoptuar në situata specifike. Këto rregulla synojnë që të ndihmojnë grupin objekt të kryejë detyrat e tij në institucion si dhe jashtë detyrës, në mënyrë që të kontribuojë për ruajtjen e besimit të publikut në sistem. Këto rregulla i shtohen detyrimeve ligjore të profesionistëve dhe janë hartuar për të rritur përgjegjësinë e tyre në kryerjen e detyrave. Rregullat e etikës profesionale synojnë që të përkufizojnë detyrimet morale si standardet profesionale, jashtë gamës të drejtpërdrejtë të dispozitave ligjore. Ato janë një mjet vetëreflektimi, d.m.th, për rritjen e ndërgjegjshmërisë dhe asimilimit të parimeve të caktuara dhe kërkesave morale me synim përmirësimin e performancave individuale dhe të imazhit të sistemit. Parapëlqehet që këto kode të hartohen nga vetë trupat profesionale (zakonisht nëpërmjet shoqatave profesionale) të cilat janë edhe grupi objekt, sepse këto rregulla më tepër përqafohen se sa imponohen<sup>340</sup>. Prandaj, një kod i

<sup>338</sup> Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për punonjësit e policisë, miratuar me vendim të qeverisë nr. 991/25.08.2005; Kodi etikës dhe sjelljes profesionale për ndërmjetësit, miratuar më 17 shkurt 2007 nga Këshilli Kombëtar i Ndërmjetësve.

<sup>339</sup> Për shembull, vendimi nr. 145/2005 i mbledhjes plenare të SCM miratoi kodin e sjelljes profesionale për personelin ndihmës të specializuar në gjykata e drejtësisë dhe prokurorisë që u atashohen atyre. Sipas nenit 1, kodi synon të rregullojë "sjelljen etike të personelit ndihmës". Në mënyrë mjaft paradoksale, motoja e këtij kodi thotë: "çdo kod deontologjik trajton, në radhë të parë, njeriun dhe ndërgjegjen e njeriut dhe ai duhet të përqafohet me vullnetin e lirë të personit". Kjo është "paradoksale" sepse Kodi miratohet nga një organ që nuk ka kompetencë në lidhje me sekretaret e gjykatës; ai një është një Kod që imponohet nga ky organ mbi këtë kategori personeli dhe shkelja e të cilit shikohet si një rast keqsjelljeje (d.m.th., krejt e kundërta e fjalive fillestare në tekstin e kodit).

<sup>340</sup> Në këtë drejtim, është për të ardhur keq që një kod i sjelljes profesionale për personelin ndihmës të specializuar në gjykata dhe prokurori është miratuar nga SCM-ja, në vend të organeve të personelit; se ishte parlamenti që miratoi një ligj për kodin e sjelljes së zyrtarëve publikë; se ishte qeveria që miratoi një kod të etikës dhe sjelljes për punonjësit e policisë; dhe se ishte Ministri i Drejtësisë i cili miratoi një kod

sjelljes etike pranohet nga profesionistët që kanë rënë dakord të rregullojnë sjelljen e tyre me standarde strikte ose të buta dhe të cilët i përqafojnë këto rregulla 'nga poshtë, lart'. Një kod i etikës përshkruan sjelljen e dëshirueshme.

Duke pasur parasysh se një kod i etikës synon të inkurajojë sjelljen e dëshiruara nga trupat profesionale dhe planifikohet si një mekanizëm vetërregullator brenda profesionit, 'sanksionet' për arritjen ose tejkalimin e qëllimeve duhet të jenë pozitive (stimuj të tillë si çmime, shpërblime, dekorime, promovime). Të vetmet sanksione të vërteta duhet të jenë mosbesimi, dobësimi i reputacionit të dikujt brenda trupës profesionale dhe mundësisht përjashtimi nga shoqata profesionale. Sidoqoftë, në varësi të gravitetit të shkeljes, përsëritjes së tyre dhe efektit të tyre tek institucioni ose sistemi, shkelja e këtyre rregullave mund të sjellë masa disiplinore<sup>341</sup>. Me fjalë të tjera, shkeljet më të rënda të kodit të etikës mund të shikohen nga vetë ligjvënësit si raste të shkeljeve dhe mund të ndëshkohen si të tilla<sup>342</sup>.

Për shembull, neni 11, paragrafi 3 në kodin e sjelljes profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët parashikon: "gjyqtarët dhe prokurorët nuk do të ndërhyjnë për vendosjen mbi një çështje apo të kërkojnë ose të pranojnë plotësimin e interesave të tyre personale ose interesave të pjesëtarëve të familjes së tyre ose të tjerëve, në ndonjë mënyrë që është jashtë kuadrit ligjor. Ndërhyrja në punën e gjyqtarëve ose prokurorëve të tjerë është e ndaluar". Neni 99 (b) i ligjit nr. 303/2004 mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rendit mes rasteve të shkeljeve "ndërhyrjen për vendosjen mbi një çështje, kërkesën ose pranimin e plotësimin të interesave personale të dikujt, ose të interesave të pjesëtarëve të familjes së dikujt ose të të tjerëve, në çfarë do mënyrë që është jashtë kuadrit ligjor të përcaktuar për të gjithë qytetarët si dhe ndërhyrja në punën e gjyqtarëve ose prokurorëve të tjerë".

Neni 13 i kodit thotë: "gjyqtarët dhe prokurorët kanë detyrimin që të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme në mënyrë që të përmbushin të gjitha detyrat që u janë caktuar atyre brenda afateve ligjore dhe aty ku ligji i përcakton këto afate, me afate kohore të arsyeshme". Neni 99 (e) parashikon sanksione disiplinore për "gjyqtarët dhe prokurorët që nuk arrijnë në mënyrë të përsëritshme dhe të pandëshkueshme që të zbatojnë dispozitat ligjore në lidhje me gjykimin e përshpejtuar të çështjeve".

Neni 14 i kodit parashikon që "gjyqtarët dhe prokurorët duhet të imponojnë rregull dhe solemnitet gjatë dëgjimit të çështjeve dhe të adoptojnë një qëndrim dinjitoz dhe të qytetëruar ndaj palëve, avokatëve, dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve ose të tjerëve dhe të kërkojnë prej tyre që edhe ata të adoptojnë një sjellje të përshtatshme. Neni 99 (k) në ligj rendit si rast shkeljeje "qëndrimin jo dinjitoz gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në lidhje me kolegët, avokatët, ekspertët, dëshmitarët ose përdoruesit e gjykatës".

Në këtë drejtim, deklarojmë se ka rregullore që parashikojnë masa disiplinore kundër shkeljes së të gjithë kodit deontologjik (ose më mirë kodit të synuar për sjelljen etike), e cila është e papranueshme. Kështu, sipas nenit 84 (1) në ligjin nr. 567/2004, "kur personeli ndihmës i specializuar në gjykatat e drejtësisë dhe prokuroritë që u atashohen atyre nuk arrijnë që të zbatojnë dispozitat e Kodit Deontologjik, kjo përbën një rast shkeljeje". Por kodi përfshin detyrimet e vogla, të tilla si në lidhje me kodin e veshjes siç duhet dhe detyrimet madhore, të tilla si ato në lidhje me konfidencialitetin e

---

të sjelljes për personelin në sistemin penitenciar. Profesione gjyqësore të lira ishin të vetmet që hartuan kodet e tyre.

<sup>341</sup> Në këtë drejtim, shih pika 18-20 në Komentarin mbi Parimet Bangalore të Sjelljes Gjyqësore, në [www.unodc.org/documents/corruption/publications\\_unodc\\_commentary-e.pdf](http://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf).

<sup>342</sup> Neni 8, pika 6 në Konventën e OKB-së kundër korrupsionit: "(...) masa disiplinore ose të tjera kundër zyrtarëve publikë që shkelin kodet ose standardet e caktuara në përputhje me këtë nen".

informacionit të marrë për shkak të detyrës që mban. Detyrimi i parë ka lidhje me kodin e veshjes jashtë sallës së gjyqit, i cili do të ketë pak lidhje me nëpunësit e gjykatës e gjykatës, të cilat nuk kanë kontakt me publikun dhe shkelja e të cilit nuk do të shkaktoje as masa disiplinore të buta. Po kështu, sipas nenit 68 (e) në urdhrin e kryeministrit nr. 86/2006, penalitetet disiplinore parashikohen për "shkeljen nga praktikuesit e insolvencës të parimeve themelore të etikës profesionale siç përcaktohet nga kodi i etikës profesionale. Neni 23, paragrafi 1 në ligjin nr. 7/2004 mbi kodin e sjelljes për zyrtarët publikë parashikon që: "shkelja e dispozitave të këtij kodi të sjelljes shkakton veprim disiplinor kundër gjyqtarëve publik në përputhje me ligjin". Kjo është arsyeja për se ne e përsëritim se nuk arrihet në mënyrë të papranueshme që të dallohet deontologjia profesionale dhe sjellja etike.

Implementimi i këtij kodi etike duhet të sigurohet nga *komitetet e konsultimit të etikës*, nga të cilët një person merr këshilla në lidhje me sjelljen që duhet adoptuar në një situatë të paqartë dhe të parregulluar. Krijimi i një konsulence të tillë të brendshme dhe organi vetërregullues faktikisht parashikohet në rastin e zyrtarëve publikë. Ai është një institucion i konsulentëve etikë që është krijuar për të siguruar aplikimin efikas të dispozitave në kodin e sjelljes.

*Konsulentët e etikës* janë zyrtarë publikë zakonisht që punojnë në burimet njerëzore të cilët përzgjidhen nga një drejtues institucioni për të dhënë këshilla etike dhe për të monitoruar përputhshmërinë me rregullat e sjelljes. Ata kanë detyrat e mëposhtme: a) këshillojnë dhe asistojnë zyrtarët publikë me autoritet nga institucionet publike në përputhje me rregullat e sjelljes; b) monitorojnë implementimin e dispozitave nga kodi i sjelljes brenda autoritetit publik ose institucionit; dhe c) hartojnë raporte tre mujore për përputhshmërinë me rregullat të sjelljes srë zyrtarëve publikë në autoritetin dhe institucionin publik<sup>343</sup>.

Për gjykatat dhe prokuroritë, është përcaktuar një mekanizëm i ngjashëm në nenin 5 të ligjit nr. 303/2004, i cili jep kompetenca në lidhje me bordin drejtues të gjykatës ose prokurorisë. Por bordi ka vetëm kompetenca në lidhje me dhënien e këshillave për konfliktet e interesit që përfshijnë gjyqtarët ose prokurorët gjatë gjykimit të një çështjeje, pa mbuluar aktivitetet e tjera të gjyqtarëve ose prokurorëve apo sjelljen e kategorive të tjera të personelit që punon në institucion. Kohët e fundit u përfshi një profesion i ri në regjistrin rumun të klasifikimeve, me numrin 241942 - ai i *ekspertit për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit*<sup>344</sup>

Sipas *standardit profesional*, korrupsioni, konflikti i interesit, papajtueshmëritë, mashtrimi kundër interesave kombëtare dhe/ose interesave financiare të BE-së dhe korrupsioni që lidhet me prokurimin publik janë aspekte që trajtohen më shpesh nga një ekspert i tillë. Aktiviteti i ekspertëve synon përmirësimin e kuptimit të mekanizmave të mashtrimit dhe korrupsionit dhe inkurajimin për praktika të drejta, të cilat janë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm. Një komponent esencial i aktivitetit të ekspertëve qëndron në informimin e personelit të shoqërive tregtare për detyrimet ligjore të institucioneve dhe për metodat për të luftuar kundër korrupsionit, duke përdorur mjetet ligjore dhe civile në dispozicion të të gjithë qytetarëve. 'Ekspertët për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit' mbështetin dhe këshillojnë personelin teknik, ekonomik dhe administrativ për marrjen e vendimeve për zbatimin e duhur të legjislacionit përkatës për shkeljet faktike dhe potenciale të korrupsionit. Ekspertët duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të identifikuar

<sup>343</sup> Institucioni i këshilltarëve të etikës u fut në ligjin nr. 50 të vitit 2007, i cili modifikoi dhe plotësoi ligjin nr. 7/2004 mbi kodin e sjelljes për zyrtarët publikë.

<sup>344</sup> Urdhër nr. 170 i datës 10 mars 2008 i Ministrit të Punës, Familjes dhe Shanseve të Barabarta dhe urdhri nr. 179 i datës 13 mars 2008 i Presidentit të Institutit Kombëtar të Statistikave që amendon regjistrin rumun të profesioneve, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 219 datë 21 mars 2008.

burimet potenciale të korrupsionit, për të mbikëqyruar sjelljen e personelit për të cilin është bërë njoftimi dhe për të njoftuar drejtuesit e institucionit për shkeljet e mundshme të rregullave në lidhje me konfliktin e interesit apo papajtueshmëritë.

Për pasojë, në qoftë se vendimmarrësit në institucionet gjyqësore duhet të forcojnë disiplinën mes profesionistëve, së pari ata duhet të krijojnë mekanizmat për të penguar sjelljet jo të duhura dhe për të përvijuar sjelljen që pritet nga këta profesionistë. Në këtë drejtim, është krejt e habitshme që as SCM, as Ministria e Drejtësisë, as shoqatat profesionale nuk janë interesuar për të aplikuar Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe më e rëndësishmja, komentarin mbi këto parime, megjithëse ata janë miratuar nga Kombet e Bashkuara, anëtare e së cilave është Rumania. Modeli që parashikojnë këto rregullore, si në lidhje me kodin e etikës që u imponohet gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe për procedurën e këshillimit të etikës, do të ishte modeli ideal për të forcuar parimet e integritetit dhe për të rritur besimin e qytetarëve tek gjyqësori.

Natyrisht, në mënyrë që të shmanget korporatizmi, një përpjekje e tillë kërkon gjithashtu një pamje nga jashtë (përfshirja e shoqërisë civile duhet të inkurajohet) dhe një pamje asnjëansore (arsyeja për se kërkuesit e etikës duhet të përfshihen gjithashtu). Siç u theksua dhe më lart, Kodi i Etikës duhet të përfshijë edhe procedurat e etikës.

## 5.2 Zbulimi i keqsjelljes

Në mënyrë që të sanksionohet sjellja e paligjshme e profesionistëve, duhet t'u komunikohen organeve kompetente aktet e tyre të paligjshme. Në qoftë se ka raste të keqsjelljes, duhet të njoftohet organi i brendshëm profesional; në rastin e krimeve duhet të informohen organet gjyqësore.

### a. Mekanizmat e publikimit

a.1. Ata që duhet të depozitohen ankesa kundër personelit gjyqësor janë në radhë të parë *përfituesit* e shërbimeve gjyqësore. Nevoja për të njoftuar organet gjyqësore penale, për aktet që përbëjnë krime është e mirënjohur. Por rastet e keqsjelljes që rregullojnë mekanizmat me ligj janë më pak të njohura. Për shembull, një ankesë kundër ndonjë gjyqtari ose prokurori mund të depozitohet tek Këshilli i Lartë i Magjistraturës (Komisioni i Disiplinës së Departamentit për Gjyqtarët dhe Departamentit për Prokurorët). Në praktikë, ankesat depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë ose autoritete të tjera (Parlamenti i Rumanisë, Kryeministri, Presidenti i Rumanisë, ose madje edhe organet evropiane) më tepër se sa tek eprori administrativ. Më pak i njohur është organi kompetent për keqsjellje të kryer nga avokatët (Komiteti i Disiplinës organizuar në çdo dhomë avokatie), nga personeli i policisë (Këshilli Disiplinor) ose nga nëpunësit e gjykatës (njoftimi nxirret nga drejtuesi i gjykatës ose i prokurorisë, ndërsa sanksionet e tjera disiplinore aplikohen nga Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm i prokurorisë që i bashkëngjitet Gjykatës së Apelit).

Për përfituesit e shërbimeve gjyqësore ose personave të tjerë që mësojnë se këto akte janë kryer, përveç sistemit aktual të publikimit (ankesë ose raport, dorëzuar me shkrim ose komunikuar verbalisht organit kompetent) duhet të ketë edhe një *mjet tjetër, më të shpejtë* ose një mjet që të jetë në gjendje të parandalojë identifikimin e tyre në

qoftë se ata dëshirojnë të ruajnë *anonimitetin* e tyre<sup>345</sup>. Por sipas legjislacionit aktual, të gjithë njoftimet anonime penale ose disiplinore janë mbyllur pa hetim. Kjo është arsyeja, në veçanti për krimet e korrupsionit të kryera nga personeli gjyqësor, që rekomandohet të kenë mekanizma të publikimit si kuti ankesash, telefon (për shembull, linjë pa pagesë)<sup>346</sup> e-mail<sup>347</sup> ose formularë për ankesa on-line<sup>348</sup>.

Publiku duhet të inkurajohet që të bëjë padi kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, publiku duhet të informohet për institucionet e përfshira në luftën kundër korrupsionit dhe për mjetet për të publikuar dhe për t'u ankuar ndaj akteve abuzive në çdo institucion dhe në çdo sektor. Fushatat e informacionit mund të jenë ose kombëtare ose më e rëndësishmja brenda institucionit (nëpërmjet udhëzimeve, fletëpalosjeve, posterave).

Media gjithashtu mund të inkurajohet që të njoftojë organet gjyqësore. Kështu, roli i gazetareve investigativë është i rëndësishëm në identifikimin dhe publikimin e parregullsive të kryera në institucionet publike. Megjithatë, publikimi nga media i informacionit në lidhje me kryerjen e krimeve të caktuara mund të pengojë ose madje të blloktojë ndjekjen penale. Për këtë arsye, në disa rrethana, zyrat editoriale mund të inkurajohen të njoftojnë organet kompetente përpara se të publikohet ose transmetohet lajmi për krimet e korrupsionit, në mënyrë që verifikimet e para zyrtare të mund të plotësohen deri në datën e publikimit.

**a. 2.** Brenda institucionit, është trupa e inspektimit ose shefi i departamentit që përgjigjet për zbulimin e parregullsive. Duke pasur parasysh krijimin e një kulture të integritetit, detyrimin për të publikuar krimet e korrupsionit të gjyqësorin i përket *vetë agjentëve publikë*<sup>349</sup>.

Për punonjësit e policisë, neni 41 (g) në ligjin për statusin e punonjësit të policisë, parashikon detyrën e "Informimit të eprorit dhe të autoriteteve të tjera kompetente në lidhje me shkeljet e korrupsionit të kryera nga pjesëtarë të tjerë të policisë, që kanë ardhur në dijeni të atij punonjësi policie". Neni 57 (k) në ligj parashikon se "Shkelja e dispozitave në lidhje me detyrat" përbën një rast shkeljeje.

Për gjyqtarët dhe prokurorët, ky detyrim nuk parashikohet në mënyrë të shprehur. Megjithatë, ai mund të nxirret nga neni 107 në ligjin nr. 161/2003: "Gjyqtarët dhe prokurorët kanë detyrimin që t'i komunikojnë menjëherë kryetarit të gjykatës ose, ku është e aplikueshme, prokurorit të përgjithshëm nga i cili varen, çdo ndërhyrje, qoftë politike apo ekonomike në administrimin e drejtësisë, që vjen nga një person fizik, person ligjor ose një grup personash". Frazja 'ndërhyrje ekonomike' duhet të kuptohet se përfshin mes të tjerash,

<sup>345</sup> Aksesi ndaj organeve antikorrupsion do të parashikohet për raportimin, duke përfshirë atë anonim, të ndonjë incidenti që mund të konsiderohej se përbën një krim në përputhje me këtë konventë (neni 13 në konventën e OKB-së kundër korrupsionit).

<sup>346</sup> Krimet e korrupsionit të kryera nga personeli i M.A.I mund të njoftohen DGIPI, me telefonin nr. 021. 311. 13. 53 ose ADG telefoni nr. 0800.806.806 (linjë pa pagesë); kjo e fundit mund të përdoret edhe nga punonjësit e M.A.I të cilët publikojnë shkeljet e korrupsionit të kryera kundër tyre nga qytetarët. Njoftimi për NAD mund të dorëzohet me telefon në numrin. 021. 3127399 (linjë e rregullt).

<sup>347</sup> A.D.G. mund të njoftohet në [anticorruptie\\_petitii@mira.gov.ro](mailto:anticorruptie_petitii@mira.gov.ro).

<sup>348</sup> Ky mjet publikimi disponohet në NAD – formulari on-line për komunikimin e të dhënave mbi korrupsionin, Të dy formularët megjithatë kërkojnë të dhëna identifikuese të personit që dorëzon njoftimin. Gjenden në [www.pna.ro/sesizari.jsp](http://www.pna.ro/sesizari.jsp); A.D.G. – the e-petitie at [www.mai-dga.ro/index.php?l=ro&t=139](http://www.mai-dga.ro/index.php?l=ro&t=139).

<sup>349</sup> Në Republikën e Moldavisë, [www.justice.gov.md/index.php?cid=215&lid=55](http://www.justice.gov.md/index.php?cid=215&lid=55), Ministria e Drejtësisë ka postuar mesazhet e mëposhtme kyçe për korrupsionin: "Korrupsioni është shqetësim për të gjithë ne", "Askush nuk është mbi ligjin", "Transparenca parandalon korrupsionin", "Ti je përgjegjës në qoftë se e dije por nuk bërë asgjë për të parandaluar përfshirjen e kolegut tënd në krimet e korrupsionit".



aktet që janë specifike për korrupsionin. Shkeljet e këtij detyrimi përbëjnë rastet e shkeljes sipas nenit 108 në ligj dhe janë të dënueshme në varësi të gravitetit të shkeljes, me pezullim nga kryerja e detyrës për maksimumi gjashtë muaj ose largim nga profesioni. Një gjyqtar ose prokuror që largohet nga profesioni i gjyqtarit ose prokurorit nuk mund të mbajë çfarë do detyre gjyqësore për 3 vjet.

Në praktikë megjithatë, mungesa e kulturës së integritetit ka çuar në zgjerimin e demagogjisë: kush flet për parregullsi shikohet si i fajshëm në vend të atij që i kryhen ato. Kjo shpjegon për shembull mungesën e raportimit nga gjyqtarët ose prokurorët të akteve të korrupsionit të kryera në profesion (vetëm një numër shumë i vogël i raporteve u referohet çështjeve të gjyqtarëve ose prokurorëve që i japin mitë dhe që nuk e marrin atë). Është mjaft për t'u vënë re se mes punonjësve të policisë ka pasur raste kur ata kanë raportuar kolegët e tyre<sup>350</sup>.

Konventa e OKB-së kundër korrupsionit detyron shtetet që të marrin masa dhe të adoptojnë sisteme që të jenë në gjendje të lehtësojnë raportimin nga agjentët publikë tek autoritetet kompetente, të akteve të korrupsionit për të cilat janë vënë në dijeni gjatë detyrave të tyre zyrtare (neni 8, pika 4). Në këtë drejtim, legjislacioni rumun detyron zyrtarin publik që konstaton kryerjen e krimit që lidhet me detyrën që të njoftojë prokurorin menjëherë. Mos njoftimi përbën krimin e neglizhimit për të njoftuar organet gjyqësore penale (neni 227, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale), (neni 263, paragrafi 1 i Kodit Penal). Në mënyrë krejt të pashpjegueshme megjithëse i njëjti detyrim qëndron edhe për zyrtarët e tjerë<sup>351</sup> (neni 227, paragrafi 2 Kodi i Procedurës Penale), shkelja e tij nuk shkakton të njëjtat sanksione siç bën për zyrtarët publikë, megjithëse kjo përgjegjësi në veçanti ka lidhje me krimet e korrupsionit. I njëjti detyrim është i vlefshëm për mbajtësit e pozicionit të mbikëqyrjes ose të inspektimit, por këtë herë në lidhje me ndonjë krim të kryer në institucionin e tij/të saj, që i nënshtrohet penaliteteve të sipërpërmendura (neni 227, paragrafi 1 Kodi i Procedurës Penale, neni 263, paragrafi 2 Kodi Penal). Ligji i referohet në mënyrë të veçantë detyrimit të zyrtarëve me kompetencë inspektimi që të njoftojnë organet përkatëse për ndonjë të dhënë apo informacion në lidhje me një akt *korupsionit*<sup>352</sup>. Në qoftë se zyrtari në mënyrë të qëllimshme nuk arrin të përmbushë këtë detyrim, ai/ajo përballlet me penalitete penale sipas nenit që kriminalizon mospublikimin e krimeve të caktuara (neni 25, paragrafi 4 i ligjit nr. 78/2000, përforcuar me nenin 262 Kodi Penal). Në praktikë, nuk janë raportuar raste të padive kundër atyre që nuk kanë përmbushur këtë detyrim.

Personat me kompetenca drejtuese ose inspektuese janë të detyruar të marrin masat e nevojshme për të ruajtur provat ose gjurmët e krimit, *corpora delicti* ose ndonjë provë tjetër.

---

<sup>350</sup> Në vitin 2007 pati 82 raste të punonjësve në M.A.I që raportuan situatë në të cilat kolegët e tyre ishin të përfshirë në shkeljet e korrupsionit. Në vitin 2008 pati 104 raste të tilla.

<sup>351</sup> Sipas ligjit penal, 'zyrtar' do të thotë çdo punonjës që përmbush një detyrë në shërbimin e personave juridikë, që nuk janë autoritete publike, institucione publike, shërbime ose ente të tjera që kanë lidhje me publikun (neni 147, paragrafi 2, bashkë me nenin 145 të Kodit Penal). Kjo kategori mund të përfshijë, për shembull, personat e punësuar në një firmë ligjore ose në një firmë ndërmjetësimi.

<sup>352</sup> Neni 14, paragrafi 1 i urdhrit të kryeministrit nr. 43/2002 për NAD: "Personat me kompetencë inspektimi do të njoftojnë drejtorinë kombëtare antikorrupsion për ndonjë të dhënë ose informacion që tregon se ndonjë prej krimeve që është caktuar nga urdhri emergjent aktual në juridiksionin e drejtorisë kombëtare antikorrupsion është kryer apo jo". Neni 23, paragrafi 1 i ligjit nr. 78/2000: "Personat me kompetencë inspektimi do të njoftojnë organin kompetent të ndjekjes penale ose atje ku është e aplikueshme, organin kompetent për të hetuar krimet, për ndonjë të dhënë që tregon se është kryer ndonjë operacion ose ndonjë akt i paligjshëm, i cili mund të shkaktojë përgjegjësi penale sipas këtij ligji".

Rastet e shkeljeve të raportuara në një institucion mund të jenë edhe të natyrës disiplinore, që kërkojnë një procedurë për njoftimin e organeve disiplinore. Ka raste, megjithatë të cilat nuk janë rregulluar nga ligji pozitiv. Për shembull, një gjyqtar ose prokuror është i detyruar të përjashtojë veten nga përcaktimi i një çështjeje, në qoftë se plotësohen arsyet e parashikuara sipas ligjit ose të konfirmuara nga precedenti i GJEDNJ-së. Po qe se gjyqtari ose prokurori nuk e përjashton veten, pala e interesuar mund të kërkojë largimin e tij/ të saj. Një koleg i atij gjyqtari/prokurori vendos për aplikimin për largimin e tij, i cili në qoftë se qëndron çon në zëvendësimin e atij gjyqtari/prokurori, duke bërë që për këtë arsye çështja të gjykohet nga një gjyqtar/prokuror tjetër. Problemi këtu është se në këtë situatë, megjithëse ka tregues të shkeljes që përbëhen nga moszbatimi i rregullave të mospërputhshmërisë, nuk ka asnjë procedurë që të lejojë që drejtuesit e gjykatës apo të prokurorisë ta raportojnë atë tek SCM.

### **b. Inkurajimi dhe mbrojtja e informatorëve**

b.1. Për të inkurajuar publikimin e akteve të korrupsionit nga vetë personat e përfshirë, ka një sistem të *pandëshkueshmërisë* ose të *reduktimit të ndëshkimit* për individin që publikon shkeljen dhe një sistem për *kthimin e asetëve* të përdorura në aktet e korrupsionit. Megjithatë, dhënia e mosndëshkimit të plotë një individ që publikon një akt korrupsioni që ai/ajo ka kryer është kundërthënës, veçanërisht në qoftë se publikimi bëhet shumë kohë pasi akti ose koha e një hetimi që pritet të bëhet.

Në sistemin rumun të drejtësisë, paguesit e mitës dhe blerësit e influencës nuk ndëshkohen në qoftë se ata ua raportojnë shkeljen e tyre autoriteteve para se organi i ndjekjes penale të jetë njoftuar për këtë shkelje dhe paratë ose asetet e tjera u kthehen atyre (neni 255, paragrafi 3 Kodi Penal, neni 61, paragrafi 2 në ligjin nr. 78/2000<sup>353</sup>). Gjithashtu, çdo individ i përfshirë në kryerjen e një krimi mbrohet nga ndëshkimi, në qoftë se ai/ajo ka pushuar përfshirjen ose bëri të mos ndodhte rezultati para se krimi të ekspozohet (neni 22 i Kodit Penal) dhe përfundimisht një person që ka kryer ndonjë nga krimet që futen në juridiksionin e NAD sipas GEO nr. 43/2002 dhe që gjatë ndjekjes penale raporton dhe lehtëson ndjekjen penale të personave të tjerë të përfshirë në kryerjen e këtyre krimeve, përfitojnë nga dënimi i tyre duke u hequr gjysmën e dënimit siç parashikohet nga ligji.

Për të inkurajuar raportin e shkeljeve të korrupsionit të cilat vijnë në vëmendje të agjentëve publikë (qoftë kur kryhen nga kolegët e tyre ose nga individë jashtë institucionit), duhet të ekzistojë *mbrojtja e duhur*. Kjo mbrojtje do të paraqiste një sanksion të pajustificuar për punonjësit, të cilët kanë shkaqe të arsyeshme të dyshojnë për korrupsion dhe që raportojnë në mirëbesim dyshimin e tyre personave ose autoriteteve që përgjigjen (neni 9 në Konventën e Ligjit civil të KiE për korrupsionin). Sistemi i mbrojtjes do të siguronte që agjentët publikë të mos përgjigjeshin për krimet e tilla si raportimi me keqdashje. Ligji rumun parashikon një mbrojtje të tillë nga përgjegjësia e mundshme penale për zyrtarët me kompetencë inspektimi të cilët kanë njoftuar organet kompetente mbi dyshimet e korrupsionit<sup>354</sup>. Denoncuesit mbrohen edhe nga penaltetet disiplinore ose administrative<sup>355</sup>.

<sup>353</sup> Për aplikimin e klauzolës se pandëshkueshmërisë, shih Gjykimi nr. 59/2007i bërë nga HCCJ pas apelimit në një pike të ligjit depozituar nga Prokurori i Përgjithshëm i Rumanisë.

<sup>354</sup> Neni 25 në ligjin 78/2000: "(1) Plotësimi në mirëbesim i detyrimeve të parashikuara në nenin 23 (...) dhe 24 nuk përbën një shkelje të sekretit profesional (...) dhe nuk shkakton përgjegjësi penale, civile ose

Për të inkurajuar *palët e treta* që të raportojnë aktet e korrupsionit që vijnë në dijeni të tyre, duhet të hartohet një sistem shpërblymshëm për denoncimet.

**b.2** Dy institucione përgjigjen për mbrojtjen kundër reperkusioneve të ndodhura nga ata që raportojnë akte të paligjshme ose jo etike; *mbrojtja e dëshmitarëve* dhe *mbrojtja e denoncuesve*. Të dy janë të rregulluar nga ligji rumun ka ende vend për përmirësimin e implementimit të tyre.

Personat që duhet të përfitojnë nga mbrojtja efektive dhe e duhur janë ata që japin informacion për krime të caktuara të cilat organet gjyqësore zakonisht kanë vështirësi t'i zbulojnë ose të identifikojnë autorët; ata që në një mënyrë tjetër bashkëpunojnë me autoritetet që përgjigjen për hetimet dhe ndjekjen penale dhe dëshmitarët që dëshmojnë në lidhje me këto krime. Ligji nr. 682/2002<sup>356</sup> rregullon *mbrojtjen dhe asistencën e dëshmitarëve* të cilëve u rrezikohet jeta, siguria ose liria si pasojë e mbajtjes prej tyre të informacionit ose të dhënave për kryerjen e krimeve të rënda, dhe për dhënien ose rënien dakord për dhënien e këtij informacioni organeve gjyqësore. Kjo luan një rol për identifikimin e kriminelëve dhe përcaktimin e çështjes. Krimet e korrupsionit kualifikohen si krime të rënda<sup>357</sup>.

*Denoncuesit* janë punonjës aktualë ose ish-punonjës të një institucioni ose anëtarë të organizatave të ndryshme që raportojnë shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve, mashtrimet, aktet e korrupsionit që ata kanë dëshmuar ose zbuluar. Ata u raportojnë atyre që janë kompetentë ose kanë dëshirën të ndërmarrin veprime rregulluese të duhura ose brenda sistemit (eporëve, bashkëpunëtorëve) ose jashtë tij (media, organizatat gardiane, anëtarët e profesionit ligjor). Rumania miratoi ligjin nr. 571/2004 për denoncuesit<sup>358</sup>. Sipas ligjit rumun një denoncues duhet të jetë i punësuar nga autoritetet publike në administratën qendrore publike; administratën publike vendore; parlament; administratën presidenciale; qeverinë; autoritetet administrative; korporatën publike; institucionet publike në sektorin e kulturës, të arsimit, të kujdesit shëndetësor dhe të asistencës sociale; shoqëritë kombëtare dhe korporatat kombëtare ose vendore shtetërore. Ligji gjithashtu aplikohet për personat e emëruar në këshillat shkencorë dhe

---

disiplinore. (2) Dispozitat në paragrafin 1 aplikohen edhe kur hetimi ose gjykimi i akteve të njoftuara ka çuar në një udhëzim për të mos filluar ndjekjen, për të ndërprerë ndjekjen ose për të shpallur pafajësinë".

<sup>355</sup> Neni 9 në ligjin nr. 571/2004: "(1) Në mosmarrëveshjet që lidhen me punën ose detyrën, gjykata mund të urdhërojë anulimin e penaltetit disiplinor ose administrativ të aplikuar për një denoncues, në qoftë se penalteti është aplikuar pas një raporti të depozituar me mirëbesim dhe në interes të publikut. (2) Gjykata do të verifikojë përpjestueshmërinë e penaltetit të aplikuar për denoncuesin për një çështje të paligjshme duke e kontrastuar atë me praktikën përkatëse ose me çështjet e ngjashme në të njëjtin autoritet publik, institucion publik ose njësi buxhetore, në mënyrë që të parandalohen penaltitetet e ardhshme dhe indirekte për denoncuesin, siç mbrohet në përputhje me këtë ligj".

<sup>356</sup> Ligji nr. 62/19.12.2002 për Mbrojtjen e dëshmitarëve botuar në fletoren zyrtare nr. 964 të datës 28 dhjetor 2002; G.R. nr. 760/14.05.2004 mbi rregullat për miratimin e ligjit nr. 62/2002 për mbrojtjen e dëshmitarëve, botuar në fletoren zyrtare nr. 475 të datës 27 maj 2004.

<sup>357</sup> Sipas nenit 2 (h) në ligj, një krim i rëndë është një krim që futet në ndonjë prej kategorive të mëposhtme: krimet kundër paqes dhe njerëzimit, krime kundër sigurisë publike dhe sigurisë institucioneve publike, terrorizmi, vrasje (shkalla e parë, e dytë e tretë), krime që përfshijnë trafikun e drogave dhe trafikun e qenieve njerëzore, pastrimin e parave, falsifikimin e monedhave ose kartëmonedhave ose instrumenteve të tjerë, krime që përfshijnë shkeljen e rregullave për armët, krime që përfshijnë materiale nukleare ose materiale të tjera radioaktive, krime të korrupsionit, krime kundër pasurisë me pasoja të rënda si dhe çdo krim tjetër për të cilin ligji parashikon dënim me burg duke filluar nga dhjetë vjet ose më shumë.

<sup>358</sup> Ligji nr. 571/2004 për mbrojtjen e personelit në autoritetet publike, në institucionet publike dhe njësitë e tjera që raportojnë shkelje të ligjit, botuar në fletoren zyrtare nr. 1214 të datës 17 dhjetor 2004.

këshillimorë, komitetet e specialistëve dhe organet e tjera kolegjiale brenda strukturës ose të atashuar pranë autoriteteve ose institucioneve publike<sup>359</sup>. Ligji rregullon një numër masash për të mbrojtur njerëzit që raportojnë shkelje të tilla si korrupsioni ose krime të ngjashme ose ata që janë të lidhur direkt me krimet e korrupsionit; krimet e falsifikimit; krimet në detyrë publike; krime që lidhen me punën; krime kundër interesave financiare të komunitetit evropian; shkelje të dispozitave për mospërputhshmëritë dhe konfliktet e interesave dhe të tjera (neni 5). Raporti mund të depozitohet tek një ose të gjithë sa më poshtë: tek eprori i personit që shkeli dispozitat ligjore, drejtuesi i entit përkatës, komisioni disiplinor, organet gjyqësore, masmedia ose organizatat jo qeveritare (neni 6). Denoncuesit përfitojnë nga prezumimi i besimit të mirë; prania e medias, sindikatat ose shoqatat profesionale; dhe në raste të caktuara nga mbrojtja e identitetit të tyre (neni 7).

Prandaj, për profesionistët e diskutuar në këtë punim, ligji për denoncuesit duket se në mënyrë të pashpjegueshme lë jashtë mbrojtjen e njerëzve që pikërisht punojnë në gjykata dhe prokurori dhe ky aspekt duhet të rregullohet menjëherë. Kjo ndodh, siç e deklarova më sipër, jo vetëm se këto institucione marrin vendime gjyqësore për përcaktimin e çështjeve, por ato marrin dhe vendime gjyqësore dhe administrative në lidhje me këto çështje dhe vendime administrative të pastra në lidhje me menaxhimin e përditshëm të institucionit. Secili nga këta sektorë është i cenueshëm nga korrupsioni.

Ja vlen të përmendim gjithashtu se identiteti i denoncuesve mbrohet nga e drejta e detyrës kur raportojnë denoncuesit, në mirëbesim, krimet e korrupsionit, krimet e falsifikimit, krimet në detyrën publike dhe krimet kundër interesave financiare të komunitetit evropian (neni 8 i ligjit). Për krimet e tjera, denoncuesit mbrohen nga e drejta e detyrës vetëm kur personi për të cilin raporton denoncuesi është eprori i tij/ i saj i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ose ka kompetenca inspektimi, vlerësimi ose kontrolli mbi denoncuesin (neni 7, paragrafi 2).

Mbrojtja e denoncuesve kërkon masat e duhura administrative aty ku mbrojtja e dëshmitarëve kryhet brenda ose në lidhje me një gjyq penal që duhet të miratohet nga organi gjyqësor dhe të zbatohet nga zyra kombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve në MAI<sup>360</sup>. Besimi i denoncuesve publikë është thelbësor për luftën kundër korrupsionit në sektorin ku punon denoncuesi dhe implementimi i sistemit të mbrojtjes për ta kërkon mekanizmat e duhura, të cilat duhet të parashikohen në rregulloret e brendshme të institucioneve<sup>361</sup>. Asnjë prej institucioneve që punëson personelin gjyqësor nuk i përdor këto dispozita të cilat mund të tregojnë se si raportohen parregullsitë në lidhje me një epror; një personi jashtë hierarkisë ose për disponueshmërinë e kutive të ankesave,

<sup>359</sup> Shih TI- Ro, "Udhëzime për mbrojtjen e denoncuesve", 2005, në [www.transparency.org.ro/files/File/Ghid\\_avertizori.pdf](http://www.transparency.org.ro/files/File/Ghid_avertizori.pdf); fushata "Heshtja juaj na kushton" si pjesë e projektit "Stop korrupsionit", Shoqata Klub-Club Timisoara, në <http://integritate.resurse-pentru-democratie.org>; dhe informacioni në [www.avertizori.ro](http://www.avertizori.ro).

<sup>360</sup> Sipas ligjit nr. 62/2002, masat e mbrojtjes për dëshmitarët e mbrojtur janë: a) mbrojtja e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur; b) mbrojtja e dëshmisë së tij/ të saj; c) dëgjimi i dëshmitarit të mbrojtur nga organet gjyqësore, me një identitet të ndryshëm nga ai real ose përdorimi i mjeteve speciale për shtrembërimin të zërit ose të imazhit; d) mbrojtja e dëshmitarëve të arrestuar ose të ndaluar, në bashkëpunim me drejtuesit e mjedisëve të ndalimit; e) masa sigurie të afërt tek shtëpia dhe eskortë e dëshmitarit për në zyrat gjyqësore dhe prej tyre; f) banim i ri; g) ndryshim i identitetit; h) ndryshim i pamjes fizike. Masa asistence për dëshmitarin e mbrojtur janë: a) rifutja në një mjedis tjetër shoqëror; b) ritrajnimi profesional; c) asistencë në punësim; d) sigurimi i të ardhurave deri në punësim.

<sup>361</sup> Brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, autoritetet publike, institucione publike dhe njësitë e tjera të financuara nga shteti të renditura në nenin 2 duhet të kenë sjellë rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me ligjin (neni 11 në ligjin nr. 571/2004).

adresave të e-mailit dhe faqeve të internetit<sup>362</sup> ose bloget<sup>363</sup> ku mund të depozitohet raporti duke ruajtur anonimitetin e informuesit.

Veç mbrojtjes institucionale dhe anonimitetit, dëshmitarët ose denoncuesit mund të inkurajohen të raportojnë krimet nëpërmjet shpërblimeve materialeve. Për shembull, në fund të gjyqit, dëshmitari ose informuesi mund të marrë një pjesë të shumës monetare të konfiskuar nga shteti<sup>364</sup>.

**b.3** Si personeli jashtë institucioneve edhe brenda tyre, pavarësisht nëse janë të përfshirë ose jo në aktin e korrupsionit, në çdo moment duhet të jenë në dijeni të procedurave që duhen ndjekur kur përballemi me një krim të tillë. Në këtë drejtim, një udhëzues i praktikave më të mira duhet të vihet në dispozicion, i cili duhet të përcaktojë krimet e korrupsionit dhe të tregojë sjelljen që duhet të adoptojë një agjent publik ku i ofrohet mitë. Teorikisht, kjo do të tregonte se si duhet refuzuar oferta dhe t'u shpjegonte qytetarëve pasojat potenciale ligjore të ofertës; t'u deklaronte drejtuesve të institucionit kur lihen mallra ose para nga qytetarët kur largohen nga zyra e tij/e saj; dhe t'u raportojnë organeve gjyqësore kur atij/asaj i ofrohen mitë ose i bëhet presion që të shkelë detyrat e tij/të saj. Një udhëzim i tillë duhet të detyrojë edhe agjentët publikë që të njoftojnë organet e ndjekjes penale për krimet që vijnë në dijeni të tyre gjatë kryerjes së detyrave ose krimeve të tjera. Kjo do t'i detyronte agjentët publikë të merrnin masa për të parandaluar humbjen e provave, të garantonte një mjet mbrojtës për punonjësit e ndershëm që raportojnë një krim korrupsioni dhe të specifikonte pasojat penale dhe administrative të kryerjes së aktit të korrupsionit nga agjentët publikë. Udhëzimi do të përfshijë edhe një paraqitje të juridiksionit të institucioneve që duhet të njoftohen dhe të dhënat e tyre të kontaktit dhe mundësisht një model ankese ose një formular raporti<sup>365</sup>.

### **c. Sistemet speciale të zbulimit**

Duke pasur parasysh se kryerja e krimeve të korrupsionit ka tipare specifike sepse ata mbahen larg syve të publikut dhe përfshijnë një numër të vogël personash, është krejt natyrale që të përdoren metodat specifike të zbulimit të hetimit.

Në këtë drejtim, janë të domosdoshme *njësitë e brendshme antikorrupsion*, të krijuara për të pasur kompetenca që lidhen me mbledhjen dhe hetimin parësor të të dhënave dhe informacioneve mbi kryerjen e krimeve të korrupsionit. Deri tani, një njësi e specializuar është krijuar në Ministrinë e Administratës dhe të Brendshme - *Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion (ADG)*<sup>366</sup>, që është e specializuar në parandalimin dhe

<sup>362</sup> Një shembull është <http://wikileaks.org>, që u është ofruar atyre që dëshirojnë të raportojnë rastet e korrupsionit në qeveritë e botës dhe korporatat madhore por me kushtin e anonimitetit.

<sup>363</sup> Për raportimin anonim të abuzimit në institucionet e BE-së ka një portal web-i, krijuar nga GOPAC – Evropa (Organizata Globale e Parlamentarëve Kundër Korrupsionit), në [www.meddelarfrihet.nu](http://www.meddelarfrihet.nu).

<sup>364</sup> Një pjesë e shumës së gjobës të urdhëruar nga gjykata mund t'i jepet denoncuesit ose informuesit. Për shembull, kur një gjykatë dënon një të pandehur që të paguajë RON 50.000 për dëmet për mashtrim kundër shtetit, 10% mund t'i ofrohet personit që raportoi informacionin që mundësoi ndjekjen penale dhe dënimin.

<sup>365</sup> I vetmi udhëzues i tillë i disponueshëm për publikun është udhëzuesi antikorrupsion i vitit 2008 hartuar nga ADG, që gjendet në [www.mai-dga.ro/downloads/ghid\\_anticoruptie2008.pdf](http://www.mai-dga.ro/downloads/ghid_anticoruptie2008.pdf).

<sup>366</sup> ADG u krijua sipas ligjit nr. 161/2005. Aktualisht, ajo operon sipas nenit 10, paragrafi 4 i GEO nr. 30/2007 për organizimin dhe funksionimin e MAI, botuar në gazetën zyrtare nr. 309 të datës 9 maj 2007: "Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion është strukturë e Ministrisë e specializuar në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në personelin e ministrisë". Në strukturën organizative të MAI miratuar me G.R. në R. 3/2009, ADG përmendet se varet direkt nga ministri.

luftën kundër korrupsionit në stafin e ministrisë. ADG synon të kryejë hetime të një natyre pro aktive si dhe të parashikojë dhe identifikojë dobësitë dhe faktorët e riskut. Largimi i tyre do t'i mundësonte stafit të MAI që të ofronte shërbime pa korrupsion, shërbime publike për qytetarët pa korrupsion, dhe të një cilësie të lartë. Ajo ka 15 shërbime territoriale, të shpërndara në qytete që kanë gjykata apeli dhe zyra territoriale të qyteteve qendra të qarqeve.

Deri në vitin 2009, ka pasur një njësi të tillë edhe për gjyqtarët dhe prokurorët. Ky ka qenë *Shërbimi Antikorrupsion dhe i Mbrojtjes së Pavarur* (IPAS), një strukturë ushtarake brenda autoritetit kombëtar penitenciar, krijuar në 1997 dhe në varësi të një sekretari shteti në Ministrinë e Drejtësisë<sup>367</sup>. Megjithëse kompetencat e tij kryesore kishin të bënin me informacionin në sistemin penitenciar, ai merrte dhe kompetencat në kontekstin e mbështetjes së strategjisë së parë antikorrupsion, për grumbullimin e informacioneve rastësore mbi krimet e korrupsionit, të kryera nga gjyqtarët/prokurorët, nëpunësit e gjykatave, punonjësit e policisë, avokatët, noterët<sup>368</sup>. Në praktikë, IPAS mbledhte informacion që përfshinte informacion për jetën personale të stafit gjyqësor. Në vitin 2004, IPAS u zëvendësua nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe Antikorrupsionit (PADG)<sup>369</sup>, të cilës i duheshin dhënë kompetencat e kufizuara me informacionin në sistemin penitenciar. Megjithatë, një audit i vitit 2005 konstatoi se "udhëheqja e mëparshme i kapërceu kompetencat e PADG siç përcaktohen nga ligji, dhe urdhëroi që disa oficerë në këtë institucion duhet të merrnin informacion mbi krimet e korrupsionit të kryera nga gjyqtarët/prokurorët ose zyrtarët e tjerë publikë"<sup>370</sup>. Sipas GR nr. 127 të datës 26 janar 2006, PADG u shpërbë.

Të njëjtin vit, Ministri i Drejtësisë krijoi *Drejtorinë për Parandalimin e Krimin në Sistemin Penitenciar*, një strukturë që varej nga autoriteti kombëtar penitenciar me arsye se një strukturë për mbledhje të informacionit të këtij tipi ishte e domosdoshme

---

<sup>367</sup> K.R. nr. 65/1997 për funksionimin dhe organizimin e Ministrisë së Drejtësisë, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 43 e datës 4 mars 1997, ndrequr në Gazetën Zyrtare nr. 53 të datës 31 mars 1997. Me urdhrin nr 321 të datës 19 mars 1997, Ministri i Drejtësisë miratoi rregulloren për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e IPAS, që më vonë u plotësua me urdhrin nr. 1551 të vitit 1997 të Ministrit të Drejtësisë. Asnjë nga këto urdhra nuk është botuar.

<sup>368</sup> GR. Nr. 1065/ 2001 për programin kombëtar të parandalimit të korrupsionit dhe planin e veprimit kombëtar kundër korrupsionit, përcakton publikisht për herë të parë, kategorikë e informacionit që IPAS kishte kompetencë që të grumbullonte. Kështu, "shërbimi antikorrupsion dhe mbrojtja e pavarur punon që të njihet dhe të parandalojë korrupsionin. Në këtë drejtim, kategoritë e mëposhtme të informacionit janë marrë parasysh: 1. aktet e korrupsionit që lidhen me moskryerjen e detyrës ose kryerjen e gabuar të detyrës zyrtare, që mund të çojë në elementë të tillë në sistemin penitenciar si: qytetarë rumunë ose të huaj të interesuar për të vendosur marrëdhënie (të cilat janë të cenueshme ndaj korrupsionit) me stafin e sistemit penitenciar; lidhje me personelin penitenciar me qarqe kriminale ose kriminelë të tjerë; punësim i të burgosurve për qëllime personale; kërkimi dhe pranimi i përfitimeve të padrejta në shkëmbim të lehtësimit të kushteve të ndalimit; 2. ndonjë informacion tjetër rastësor në lidhje me aktet e korrupsionit të personave në sektorë të tillë si: administrate publike, drejtësia, prokuroria, drejtorët që punojnë në institutin kombëtar të patologjisë kriminalistike, etj. Më vonë, GR. Nr. 637/2004 mbi funksionimin dhe kompetencat e ADG varur nga Ministri i Drejtësisë, redukon kategoritë e informacionit në sistemin penitenciar dhe njësitë e tjera të varura nga Ministria e Drejtësisë; por përsëri, neni 6, paragrafi 2: "informacionin rastësor në lidhje me aktivitetin e institucioneve të tjera dhe strukturave të specializuara publike, do t'u komunikohet menjëherë këtyre njësiteve dhe aty ku është e aplikueshme, përfituesve të tjerë të parashikuar sipas ligjit".

<sup>369</sup> Sipas GR nr. 637/2004 për funksionimin dhe kompetencat e PADG, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, strukturës së re iu dha statusi i entit ligjor të veçantë, me kompetenca të përcaktuara qartë, pas riorganizimit të IPAS, që me këtë rast u shpërbë.

<sup>370</sup> Përgjigje e dhënë nga Ministri i Drejtësisë, nr. 113595/II/14.12.2005 kërkesës për informacion publik për PADG depozituar nga Shoqata ...

për parandalimin e akteve të paligjshme të kryera në mjediset penitenciare<sup>371</sup>. U deklarua publikisht se ish punonjësit e IPAS-së nuk do të punonin aty<sup>372</sup>. Struktura e drejtorisë përfshinte një departament për parandalimin e krimit të organizuar dhe terrorizmin dhe një departament të veçantë për të parandaluar krimin dhe korrupsionin. Ajo ka zyra në çdo njësi penitenciare në autoritet dhe një total prej 105 zyrtarësh në borderonë e saj. Mes të tjerash, ky departament udhëzon dhe kontrollon aktivitetin në zyrat për të parandaluar krimin në njësitë penitenciare me qëllimin e parandalimit të akteve, situatave dhe rrethanave specifike për krimin dhe korrupsionin që janë identifikuar mes të burgosurve apo personelit të autoritetit kombëtar penenciar dhe njërive të tij vartëse.

Departamenti që parandalon krimin dhe korrupsionin ka kompetencat e mëposhtme specifike: a) të identifikojë dhe parandalojë aktet, situatat dhe rrethanat në të cilat stafi i autoritetit kombëtar penenciar dhe personeli i njërive vartëse nuk respekton të drejtat e të burgosurve dhe përdor torturën, trajtimin jo njerëzor dhe degradues kundër të burgosurve; të identifikojë dispozitat ligjore që mund të favorizojnë ose të gjenerojnë incidente të rënda; ose të identifikojë shkeljet e korrupsionit ose akte të tjera që bihen ndesh me ligjin; b) të identifikojë dhe monitorojë aktivitetin e atyre të burgosurve që dyshohet se përpiqen të korrumpojnë stafin e autoritetit penenciar kombëtar në shkëmbim të kushteve më të mira të ndalimit; c) të identifikojë dhe parandalojë akte specifike të krimit dhe korrupsionit; faktet dhe ngjarjet me pasoja të rrezikshme për sigurinë e ndalimit; dhe ndonjë situatë tjetër ose rrethanë që mund të gjeneronte këto kërcënime. Aty ku ndodhin ngjarje negative autoriteti kombëtar penenciar do të veprojë në mënyrë që të kontrollojë efektet e tyre; d) të identifikojë të burgosurit që planifikojnë të organizojnë akte të dhunshme kundër stafit penenciar, gjyqtarëve, prokurorëve, punonjësit e policisë ose persona të tjerë në një pozitë për të ushtruar autoritet publik ose që në raste të ndryshme e gjejnë veten në njësitë penitenciare; e) për të përmbushur detyrat e tij, të bashkëpunojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pa ndërmjetësuar, me zyrtarët në Ministrinë e Brendshme dhe reformën administrative, Ministrinë Publike, Ministrinë e Drejtësisë e kështu me radhë, në përputhje me ligjin dhe në përputhje me detyrat e tij që lindin nga instrumentet ndërkombëtare gjyqësore në të cilat Rumania është palë, deri tek institucionet e huaja që kanë detyra të ngjashme dhe organizatat e brendshme dhe ndërkombëtare të specializuara në parandalimin e krimit dhe të korrupsionit.

Sipas informacionit publik, në vitin 2007 dhe 2008 u mblodhën të dhëna aktive të cilat rezultuan nga raportet, disa prej tyre i referoheshin ekzistencës së dobësive, në disa zona ose vende të aktivitetit në njësi, që kishin gjasën të lehtësonin kryerjen e krimeve ose shkeljeve të rregulloreve në fuqi; synimet ose aktet e korrupsionit nga ana e stafit penenciar; mitëdhënie dhe mitmarrje; marrje e përfitimeve të padrejta; tregtim në influencë dhe ndonjë akt korrupsioni siç përkufizohet nga Ligji nr. 78/ 2000<sup>373</sup>. Prandaj, si në ligj edhe në praktikë, Drejtoria mbledh informacion për krimet e korrupsionit që përfshijnë punonjësit nga brenda gjyqësorit ose jashtë tij dhe e dërgon informacionin tek

---

<sup>371</sup> Shih nenin 31 - 38 me urdhrin nr.2003/2008 nga Ministri i Drejtësisë, që nënshkruan rregulloren për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar penenciar, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 603 të datës 13 gusht 2008 dhe urdhrin nr. 1540 të datës 20 qershor 2006 nga Ministri i Drejtësisë për organizimin dhe kompetencat e drejtorisë për parandalimin e krimit në sistemin penenciar, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 594 të datës 10 korrik 2006.

<sup>372</sup> Intervistë nga Doru Dobocan, drejtor i DPCPS në "Shërbimin Informativ ose sistemin penenciar", në të përditshmen Romania Libera e datës 11 tetor 2006.

<sup>373</sup> Nxirr nga raportet e aktivitetit vjetor të NPA-së të vitit 2007 dhe 2008, që gjendet në [www.anp-just.ro](http://www.anp-just.ro).

organet gjyqësore. Krahasuar me ish IPAS nuk ka ende të dhëna të mjaftueshme në lidhje me mbikëqyrjen e jetës private të gjyqtarëve/ prokurorëve, avokatëve, punonjësve të policisë dhe objekteve të tjera potenciale.

Që prej 2008-ës, kjo strukturë është njohur si *Drejtoria për Parandalimin e Krimit dhe Terrorizmit*, direkt në varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të NPA<sup>374</sup>. Është e strukturuar në dy departamente: Departamenti i Analizës, Studimeve dhe Programeve Parandaluese dhe Departamenti për Parandalimin e Krimit dhe Terrorizmit. Por kompetencat dhe detyrën e kësaj drejtorie, mbetën të pandryshuara të njëjta si ato që rregullohen nga urdhri i Ministri së Drejtësisë nr. 1540/C/20.06.2006 dhe urdhrin të Ministrin të Drejtësisë nr. 2003/ C/22.07.2008 që miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar Penitenciar.

Si konkluzion, besojmë në dobishmërinë e një njësie të tillë të brendshme antikorrupsion. Megjithatë, meqenëse ADG dhe DPCT nuk kanë juridiksion, mbetet çështja se kush mund ta mbledhë informacionin për aktet e paligjshme të kryera nga personeli i gjykatës dhe prokurorisë. Ministri i Drejtësisë ka shprehur kohët e fundit mbështetjen për rikrijimin e IPAS<sup>375</sup>. Opinioni ynë është që ky shërbim do të mbledhë informacion që ka lidhje rreptësisht me kryerjen e detyrave profesionale dhe që mbulon të gjitha kategoritë e stafit gjyqësor. Shërbimi mund të funksionojë në qoftë se krijohet me ligj dhe duhet t'i nënshtrohet autoritetit civil, i cili duhet të jetë në formën e masave që mund të miratohen nga Parlamenti (neni 65, paragrafi 2 (h) i Kushtetutës), pikërisht që të parandalohen këto raste abuzimi si ato të raportuara nga IPAS/PADG të mëparshme. Kjo është arsyeja se në vend që të krijohet një shërbim i ri, ne e konsiderojmë të parapëlqyer që të ngrihet një strukturë e tillë brenda *Shërbimit Informativ Rumun*<sup>376</sup>, i cili tashmë ka infrastrukturën, logjistikën dhe burimet e nevojshme. Kjo zgjedhje do të ngrejë rivlerësimin e mundshëm të ndalimit aktual që kanë gjyqtarët, prokurorët dhe personeli i specializuar ndihmës për të mos qenë bashkëpunëtorë ose informatorë në shërbimin informativ.

#### **d. Bashkëpunimi ndërinstytucional**

Kur autoritetet të tjera në gjyqësor vijnë në dijeni të akteve të korrupsionit, duke përfshirë shërbimet e inteligjencës, informacioni i marrë në këtë mënyrë duhet që t'u dërgohet menjëherë dhe zyrtarisht organeve kompetente. Për këtë arsye, duhet të përcaktohen limitet e marrëdhënieve të punonjësit me eprorët (veçanërisht në lidhje me prokurorët) dhe duhet të krijohen marrëdhënie të drejtpërdrejta midis prokurorit - policisë gjyqësore dhe prokurorit - shërbimeve informative.

Udhezimi nr. 43/2002 i NAD parashikon detyrën ligjore të shërbimeve informative dhe strukturat për të vënë në dispozicion të NAD të dhënat dhe informacionin e marrë në lidhje me kryerjen e krimeve të korrupsionit<sup>377</sup>. Në këtë kontekst, në përputhje me

<sup>374</sup> Urdhri nr. 3.028/C e datës 27 nëntor 2008 nga Ministri i Drejtësisë, që miraton strukturën organizative të autoritetit kombëtar penitenciar, bazuar në Gazetën Zyrtare nr 824 të datës 8 dhjetor 2008.

<sup>375</sup> Ministri i Drejtësisë thotë se ai po konsideron rikrijimin e Shërbimit Informativ në Autoritetin Penitenciar, IPAS-in e vdekur, në 09 shkurt 2009, në [www.realitatea.net](http://www.realitatea.net).

<sup>376</sup> Shërbimi Informativ Rumun (RIS) është institucioni i shtetit rumun i cili ka kompetencat në fushën e grumbullimit dhe përdorimit të informacionit përkatës për sigurinë kombëtare të Rumanisë.

<sup>377</sup> Neni 14 (1) Personat me kompetenca inspektimi janë të detyruar të njoftojnë drejtorinë kombëtare antikorrupsion për ndonjë të dhënë ose informacion që tregon kryerjen e një prej krimeve të përcaktuara nga ky urdhër emergjence në juridiksionin e drejtorisë kombëtare antikorrupsion. (2) Personat me kompetencë inspektimi gjatë inspektimeve të tyre në situatat e paragrafit (1) do të ndërmarrin veprim për



detyrat e tij zyrtare, një rol kyç luhet nga Shërbimi Informativ Rumun, si shërbimi kryesor i inteligjencës së Rumanisë, i specializuar në inteligjencën që lidhet me sigurinë kombëtare. Efikasiteti i bashkëpunimit me strukturat që luftojnë korrupsionin është e lidhur ngushtë me rezultatet e marra në dokumentimin e çështjeve të mëdha të korrupsionit. Njësitë e MAI janë gjithashtu të detyruara që të njoftojnë organet gjyqësore dhe kanë detyrë specifike në këtë drejtim.

Megjithatë, duhet të përcaktohen procedura të qarta për bashkëpunimin e NAD me të gjitha strukturat e tjera të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Për shembull, neni 912 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që *interceptimi dhe regjistrimi audio - video* janë një detyrë e prokurorisë ose në qoftë se delegohet nga prokurori, i organit penal hetues, në praktikë ato kryhen nga REIS me arsyen se organet gjyqësore nuk kanë pajisjet e nevojshme<sup>378</sup>. Veç pengesave teknike që mund të hiqen në çdo kohë, dy çështje meritojnë vlerësim në lidhje me atë se si kryhet ky interceptim.

Së pari, nuk do të lejohet përfshirja në procesin penal e organeve, përveç atyre të parashikuar specifikisht në ligj. Sipas mendimit tonë nuk ka dyshim se detyra e interceptimit, regjistrimit dhe dëgjimit të bisedave duhet t'i jepet ekskluzivisht policisë gjyqësore.

Së dyti, në Rumani autenticiteti i regjistrimeve mund të vërtetohet vetëm nga ekspertët audio-video që punojnë në institutet kriminalistike KRIS, MAI ose në Ministrinë e Drejtësisë. Por, nga ana tjetër, një ekspert privat i emëruar nga një palë faktikisht nuk mund të marrë pjesë në vlerësimin e tyre<sup>379</sup> dhe nga ana tjetër ekspertët zyrtarë që punojnë për institucionet publike nuk janë në gjendje të paraqesin garancitë e pavarësisë që kërkohen nga standardet përkatëse ndërkombëtare<sup>380</sup>.

---

të siguruar dhe ruajtur provat e krimit, Corpora Delicti ose prova të tjera që mund të përdoren nga organet e ndjekjes penale. (3) Shërbimet dhe organet që specializohen në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit do të vënë menjëherë në dispozicion të drejtorisë kombëtare antikorrupsion të dhënat dhe informacionin që ato kanë në lidhje me kryerjen e krimeve të korrupsionit. (4) Shërbimet dhe organet e specializuara për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit me kërkesën e kryeprokurorit të drejtorisë kombëtare antikorrupsion ose të një prokurori të emëruar specifikisht në këtë drejtim, do të vërë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe informacionin e përmendur në paragrafin (3) në një formë të papërpunuar. (5) Mosrespektimi i dispozitave në paragrafin (1) – (4) çon në përgjegjësi gjyqësore sipas ligjit.

<sup>378</sup> "Si NAD dhe DIICOT edhe njësitë e tjera të Ministrisë Publike nuk kanë pajisjet teknike për të interceptuar komunikimet. Aktualisht, asnjë stukturë në Ministrinë Publike nuk ka pajisjet për të interceptuar komunikimet" (Prokurori i Përgjithshëm i Rumanisë, Codruta Kovesi, Mediafax, 27.07.2007). "Si NAD dhe policia përdorin logjistikën e RIS për interceptimet e telefonatave. Ajo çka mund të bëjë NAD është mbikëqyrja e zakonshme e mjediseve natyrale" (Kryeprokurori i NAD, Daniel Morar, Mediafax, 4 shkurt 2009).

<sup>379</sup> Ekspertët e certifikuar të emëruar nga organet gjyqësore me kërkesë të palëve e shikojnë pjesëmarrjen e tyre në vlerësim të kufizuar me vëzhgimet e objektit të vlerësimit, me modifikimet ose shtesat, me kontrollin dhe plotësimin e materialit që nevojitet për vlerësim, si dhe me kundërshtimet e raportit të vlerësimit, drejtuar organeve gjyqësore (neni 7 në GO nr. 75/2000 për certifikimin e ekspertëve kriminalistë). Si të tillë, ata nuk marrin pjesë personalisht në procesin e vlerësimit; por, ky është një monopoli i ekspertit zyrtar. Por në çështjen Mirilashvili kundër Ruisë, GJEDNJ vendosi në 2008-ën se eksperti i mbrojtjes u lejua vetëm të shprehë opinionet mbi konkluzionet e ekspertëve të emëruar nga organet gjyqësore për të kryer vlerësimin, gjë që e vuri mbrojtjen në dizavantazh serioz dhe gjë që shkon kundër parimit të gjykimit të drejtë.

<sup>380</sup> Për shkak se sistemi aktual shenjtëron monopolin e shtetit për vlerësimet kriminalistike, Rumania është dënuar tashmë nga GJEDNJ, në gjykimin e saj për Dimitru Popescu kundër Rumanisë në 2007 ku GJEDNJ ka vendosur mungesën e pavarësisë të autoriteteve që supozoheshin të vërtetonin realitetin dhe besueshmërinë e provave. Gjykata konstatoi se duhet të jetë një autoritet privat, i pavarur nga ai që ka provuar provat. Gjykime të tjera në të cilat GJEDNJ vërteton nevojën për pavarësinë e ekspertëve janë ato

Megjithatë, ka institucione të ndryshme në sistemin gjyqësor që mbajnë të gjitha bazat e të dhënave mbi shkeljen e ligjit nga personeli gjyqësor dhe këto të dhëna mund të përdoren. Me këtë duam të themi ankesat e depozituara nga publiku në SCM dhe autoritete të tjera, aplikimet për transferim çështjeje në depozituara në HCCJ (të cilat pas gjykimit, ruhen në një arkiv të veçantë), ankesat drejtuar krerëve të institucioneve dhe aplikimet për largimin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Të gjitha këto përmbajnë të dhëna mbi çështjet e pretenduara të abuzimit dhe të gabimeve të gjyqtarëve/prokurorëve dhe ndonjëherë për krimet e mundshme të korrupsionit, por njoftimi i prokurorisë nga organi përkatës akoma nuk është një praktikë e mirëvendosur në Rumani.

Dhe së fundi, konstatojmë se edhe bashkëpunimi midis Zyrës Kombëtare për Parandalimin në Luftën Kundër Pastrimit të Parave, Gardës Financiare, Agjencisë Kombëtare të Integritetit dhe Gjykatës së Llogarive, është e një rëndësie shumë të madhe.

### 5.3 Ndjekja penale e krimeve

Në këtë seksion do t'i referohemi në veçanti mënyrës se si kryhen hetimet penale në çështjet e korrupsionit.

a. Një parakusht për paanësinë dhe profesionalizmin e hetimeve penale për organin që kryhen ndjekjen penale të korrupsionit është që të jetë i pavarur në kuptimin institucional, financiar dhe politik.

Hapi më i rëndësishëm në historinë e fundit të luftës kundër korrupsionit ka qenë krijimi i *Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion*, e specializuar në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet mjeteve kriminale dhe *Agjencia Kombëtare e Integritetit* për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit nëpërmjet mjeteve administrative. Një qëllim tjetër është që të forcohet aftësia e NAD (organit kompetent për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë) dhe e prokurorive (për të vendosur për çështje të tjera të korrupsionit). Duke pasur parasysh se shumë nga këto sugjerime vlejné edhe për NIA, besojmë se përforcimet e këtij kapaciteti janë të domosdoshme sa më poshtë:

- rekrutimi i prokurorëve antikorrupsion: për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në sistem, prokurorët e NAD herë pas here janë rekrutuar nga prokurorët që nuk kishin eksperiencën e duhur, interesi i vetëm i të cilëve ishte i një natyre financiare; në prokuroritë e zakonshme, prokurorët të cilëve u besohen çështjet e korrupsionit duhet të përzgjidhen me kujdes;
- trajnimi profesional: përveç specializimit në çështjet e korrupsionit, prokurorët duhet të trajnohen edhe për trajtimin e krimit ekonomik - financiar dhe madje krimit të organizuar (në se çështjet shkrihen, juridiksionin e ka NAD), ndërsa me sa duket duke mos neglizhuar trajnimin e vazhduar për procesin penal; prokurorët e specializuar në antikorrupsion brenda prokurorive të zakonshme duhet të bashkohen me rrjetin e trajnimit të prokurorëve të NAD. Përveç një zotërimi pa gabime të ligjit, duhet të ketë edhe udhëzues të praktikave më të mira për prokurorët e NAD<sup>381</sup> dhe inspektorëve të

---

të shprehura në: Bonich kundër Austrisë (1986), Kostovski kundër Hollandës(1989), P.S. kundër Gjermanisë, kundër Estonisë, Bonev kundër Bullgarisë (2006), Krasniki kundër Republikës Çeke (2006), Taal kundër Estonisë (2005), Prepelita kundër R. Moldavisë (2008), Mirilashvili kundër Ruisë (2008), A.L.kundër Finlandës(2009).

Bonich v.

<sup>381</sup> Raporti i përkohshëm i Komisionit Evropian për progresin në Rumani i shkurtit 2009 thotë: "Prokurori i Përgjithshëm miratoi disa masa për të rritur efektivitetin e prokurorive vendore në çështjet e korrupsionit. Këto masa përfshinin analizën e akuzave përkatëse të lëshuara midis vitit 2007 dhe 2008,

NIA për të mbështetur aktivitetin e tyre në çështjet specifike. Këto udhëzime duhet të përmbajnë përshkrimet e procedurave, metodave dhe kërkimeve për etapa të ndryshme të hetimit dhe heqjes së pengesave që mund të shfaqen. Këto do të përfshinin:

- vlerësim tërësor profesional të prokurorëve: ky duhet të përfshijë mes të tjerash, testet e integritetit, testet për aftësinë e trajtimit të presionit dhe testet për përpjekjen e shtuar;
- pavarësia e faktike e prokurorëve: duhet të sqarohen marrëdhëniet me eprorët (p.sh., duhet të përcaktohen kriteret për caktimin e çështjeve prokurorëve, për zëvendësimin e një prokurori gjatë hetimit, ose për rrethanat në të cilat një prokuror i nivelit të lartë mund të marrë çështje nga një prokuror më e ulët) si dhe ato me Ministrinë e Drejtësisë (Kushtetuta e Rumanisë akoma parashikon që Ministria Publike (prokuroria) funksionon nën autoritetin e ministrit, që ne besojmë duhet të jetë vetëm e një natyre administrative);
- garantimi i burimeve të mjaftueshme: NAD duhet të ketë burimet e nevojshme për blerjen e pajisjeve të saj të interceptimit, dhe financimet për t'u përdorur për të kapur kriminelët duke kryer krimin. Edhe një departament i mirë i burimeve njerëzore është esenciale, që nga punësimi i numrit të mjaftueshëm të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore deri tek personeli teknik;
- përmirësimi i sistemit të teknologjisë të informacionit të NAD nga njëra anë, aksesit në bazat e të dhënave të tjera (p.sh., regjistri tregtar, NIA) nga ana tjetër zhvillimi i bazës së të dhënave statistikore të saj (p.sh., aktualisht, asnjë institucion publik nuk mund të japë statistika mbi krimet e korrupsionit të kryera nga personeli gjyqësor dhe sanksionet përkatëse);
- paraqitja nga NAD në Parlament e një raporti vjetor mbi progresin në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, duke pasur parasysh rritjen e sensibilitetit publik dhe të autoriteteve kombëtare për gamën e korrupsionit, nevojën e luftës kundër korrupsionit dhe se si të kapërcehen pengesat e mundshme.

**b.** Analiza jonë nuk mund të anashkalojë *policinë gjyqësore*, si një organ hetimi penal. Sigurimi i pavarësisë së kësaj strukture nga Ministria e Brendshme dhe transferimi i saj tek autoriteti ekskluziv i prokurorisë është esenciale për efektivitetin e hetimeve. Aktualisht, vetëm NAD ka trupën e saj të policisë gjyqësore, të përbërë nga punonjës policie të punësuar nga NAI<sup>382</sup>. Ndërkohë prokurori të tjera punojnë me

---

një manual i praktikave më të mira të aplikueshme në hetimet e korrupsionit dhe strategjive vendore për luftën kundër korrupsionit hartuar nga të gjitha 41 prokuroritë rajonale".

<sup>382</sup> Neni 10 I GEO nr. 43/2002: "(1) Duke pasur parasysh përfundimin e shpejtë dhe tërësor të aktiviteteve që lidhen me zbulimin dhe ndjekjen penale të krimeve të korrupsionit, drejtoria kombëtare antikorrupsion punësoi oficerë policie, të cilët përbëjnë policinë gjyqësore të drejtorisë kombëtare antikorrupsion. (2) Oficerët dhe agjentët të policisë gjyqësore të përmendur në paragrafin (1) punojnë ekskluzivisht brenda drejtorisë kombëtare antikorrupsion, nën autoritetin ekskluziv të kryeprokurorit të kësaj drejtorie. (3) Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore do të kryejnë hetim penal vetëm për aktivitetet e urdhëruara nga prokurorët e drejtorisë kombëtare antikorrupsion. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore nuk do të punojnë nën drejtimin, mbikëqyrjen dhe autoritetin e drejtpërdrejtë të prokurorëve. (4) Urdhrat e lëshuara nga prokurorët e drejtorisë kombëtare antikorrupsion janë të detyrueshme për oficerët e policisë gjyqësore të përmendur në paragrafin (1). Aktet e kryera nga oficerët e policisë gjyqësore me urdhrin me shkrim të një prokurori kryhen në emër të atij prokurori. (5) Punësimi i oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në drejtorinë kombëtare antikorrupsion kryhet me emërimin e bërë nga kryeprokurori i drejtorisë kombëtare antikorrupsion, me urdhër të Ministrit të Administratës dhe të Brendshëm dhe emërimi i tyre në detyrë kryhet me urdhër të kryeprokurorit të kësaj drejtorie".

policinë gjyqësore brenda strukturës së NAI<sup>383</sup>. Gjatë kryerjes të detyrave të tyre profesionale, përveç atyre të drejtuara dhe kontrolluara nga prokurorët në përputhje me ligjin, punonjësit e policisë gjyqësore janë në varësi të oficerëve eprorë të emëruar sipas rregulloreve të kompetencave të miratuara me urdhër të Ministrit të Administratës dhe të Brendshëm.

Ia vlen të shënohet në këtë drejtim se gjyqësori italian arriti të kryejë operacionin "Mani Pulite" (Duart e Pastra) në vitin 1990 ekzaktësisht për të shkak të pavarësisë së prokurorisë, anëtarët e së cilës në Itali kanë një status të krahasueshëm me atë të gjykatës. Kjo ndodhi pjesërisht edhe falë aktivitetit të oficerëve të policisë gjyqësore të emëruar në autoritetin gjyqësor dhe që vareshin vetëm nga Prokuroria. Operacioni *Duart e Pastra* pati si objekt mbi 5.000 persona, kryetarë këshillash, ministra të shumtë, 250 anëtarë parlamenti, 100 anëtarë të policisë ekonomike, gjyqtarë dhe zyrtarë të partive politike.

c. Sipas të gjithë studimeve për antikorrupsionit, sukcesi i një fushate kundër korrupsionit matet me dënimin e 'peshkut të madh', d.m.th., një personi me një status hierarkik të caktuar. Në lidhje strikte me sistemin gjyqësor rumun, duhet të shënojmë se deri tani janë akuzuar prokurorët e prokurorisë të atashuar në Gjykatën e Lartë (HCCJ), janë dënuar gjykatësit e gjykatave të rangjeve të larta (duke përfshirë gjyqtarët me pozicione drejtuese), është dënuar edhe një ndihmës gjyqtar nga HCCJ. Fatkeqësisht, çështjet që kanë marrë gjykime të formës së prerë nuk janë publikuar në mënyrë të mjaftueshme, veçanërisht për personelin e gjykatës dhe të prokurorisë. Prandaj, stafi gjyqësor si dhe publiku i gjerë duhet të paralajmërohen se vetë sistemi është i vendosur të penalizojë të gjithë tipet e abuzimit. Përveç informimit të publikut për suksesin e përpjekjeve antikorrupsion, këto sinjale do të tregojnë se anëtarët e ndershëm të sistemit dëshirojnë t'i largojnë kolegët e pandershëm nga gjyqësori, gjë që do të forcojë besimin tek gjyqësori dhe do të inkurajojë raportimin e krimit dhe korrupsionit nga publiku, i cili në këtë mënyrë shikon rezultate të prekshme të këtyre fushatave.

*Raporti i 2007 mbi Korrupsionin Global* i Transparency International fokusohet tek korrupsioni gjyqësor. Raporti lavdëron Ana Cecilia Magallanes Cortes, një prokurore e shquar, përpjekjet e së cilës çuan në arrestimin e shumë figurave të profilit të lartë në gjyqësorin peruan, duke përfshirë ish-shëfën e saj, ish-prokurorin federal, disa gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe prokurorë e gjyqtarë në nivele të ndryshme juridiksioni. Ana Cecilia Magallanes Cortez, ka shërbyer si një frymëzim për një brez të tërë gjyqtarësh dhe prokurorësh në Amerikën Latine.

d. Në kryerjen e hetimeve penale ose jo penale, është esenciale heqja e të gjithë *filtrave proceduralë*. Deri në vitin 2004, kërkohet opinioni i Ministrit të Drejtësisë

---

<sup>383</sup> Shih ligjin nr. 364/2004 për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore botuar në Gazetën Zyrtare nr. 869 datë 23 shtator 2004. Policia gjyqësore është e organizuar dhe funksionon me struktura të specializuara të Ministrisë së Administratës dhe të Brendshme. Njësitë hetimore të policisë gjyqësore janë të organizuara dhe funksionojnë brenda strukturës së Inspektoriatit të Përgjithshëm të policisë Rumune, Inspektoriatit të Policisë Kufitare Rumune dhe njësitë e tyre territoriale. Njësitë hetimore të policisë gjyqësore operojnë nën drejtimin, mbikëqyrjen dhe autoritetin e prokurorëve dhe janë të detyruara të kryejnë dhe të zbatojnë udhëzimet e tyre. Eprorët mund të japin udhëzime dhe drejtime punonjësve të policisë gjatë zbulimit të krimeve dhe grumbullimit të të dhënave për të identifikuar dhe ndjekur kriminelët. Organet eprorë të punonjësve të policisë gjyqësore nuk mund të japin udhëzime ose drejtime në lidhje me ndjekjen penale; entet e vetme kompetente në këtë drejtim janë prokurorët. Punonjësit e policisë gjyqësore në njësitë territoriale funksionojnë nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të prokurorëve madhorë të prokurorive të atashuar gjykatave dhe tribunaleve sipas juridiksionit të tyre.

përpara fillimit të ndjekjes penale, fillimit të procesit penal ose arrestimit apo akuzimit të një gjyqtari/prokurori. Filtri administrativ diskrecionar lejoi që të bllokohehin disa ndjekje penale. Opinioni i ministrit, kërkohej edhe për hetimin e përmbauesve gjyqësorë dhe noterëve publikë.

Një filtër i tillë procedural ende mbahet aktualisht nga SCM: në dy raste: departamentet e SCM miratojnë kërkimin, ndalimin ose arrestimin parandalues të gjyqtarëve/prokurorëve (neni 42 në ligjin nr. 317/ 2004 për SCM) dhe asambleja plenare e SCM është ajo që urdhëron hetimin paraprak në lidhje me marrjen e masave disiplinore kundër një anëtari të SCM. Për të gjithë gjyqtarët/prokurorët e tjerë, këto hetime paraprake urdhërohen nga komisioni disiplinor i përbërë nga inspektorë (neni 54 dhe 46 në ligjin nr. 317/ 2004). Por as ligji as rregullorja e SCM nuk shpjegoi nevojën për këto dispozita. Në rastin e parë ai mund të pengojë ndjekjen e gjyqtarëve/prokurorëve dhe mbledhjen e provave, ndërsa në të dytin ai mund të parandalojë sanksione disiplinore të anëtarëve të SCM.

**e. Barrierat procedurale** duhet të hiqen gjithashtu. Në lidhje me kryerjen e procesit penal, përmendim se në mënyrë që të kenë akses ndaj informacionit kombëtar të klasifikuar, kur dosjet e çështjes e përmbajnë një informacion të tillë, gjyqtarët duhet të kenë një *autorizim ORNISS*<sup>384</sup>. Por, meqenëse disa çështje korrupsioni mund të përfshijnë krime të tjera, duke përfshirë disa që kanë lidhje me sigurinë kombëtare - për të cilat kërkohet ky autorizim - në qoftë se një gjyqtar nuk arrin të aplikojë për këtë ose RIS e refuzon autorizimin, atëherë pengohet hetimi i çështjes së korrupsionit nga një gjyqtar i specializuar<sup>385</sup>.

Sipas mendimit tonë kërkesa në lidhje me këtë autorizim ndikon rëndë në pavarësinë e gjyqtarëve nga njëra anë, sepse një autoritet administrativ duhet të vendosë në se një gjyqtar e ka kapacitetin për të vendosur për një lloj të caktuar çështjeje (gjë që lejon që disa gjyqtarë të 'zgjidhen' dhe të tjerëve t'u refuzohet gjykimi i këtyre çështjeve). Nga ana tjetër, kjo ndikon natyrën e drejtë të gjykimit sepse asnjëra palë, as avokatët e tyre (zakonisht) nuk i kanë këto autorizime, gjë që ndalon aksesin e tyre ndaj provave në dosjen e çështjes.

**f. Ndjekja penale dhe kryerja e procesit penal** në përgjithësi mund të ndikohet edhe nga ekzistenca e statuseve të *kufizimeve të përgjegjësisë penale* të cilat janë shumë të shkurtra. Kjo është arsyeja për se ligjvënësi duhet t'i përshtatë këto kufizime me natyrën specifike të hetimit dhe të zgjedhë ose të përcaktojë dënime maksimale më të larta për krimin (duke pasur parasysh se statutet e kufizimeve llogariten mbi bazën e ndëshkimit

---

<sup>384</sup> Zyra e regjistrimit kombëtar të informacionit shtetëror të klasifikuar, [www.orniss.ro](http://www.orniss.ro) autorizimi për akses ndaj informacionit të klasifikuar është një dokument i lëshuar me miratim të institucionit kompetent nga drejtuesi i personit ligjor që e ka këtë informacion dhe ai konfirmon se gjatë kryerjes së detyrave të tij/ të saj zyrtare, mbajtësi i autorizimit mund të shikojë informacionin e klasifikuar kombëtar me një nivel specifik konfidencialiteti, bazuar në nevojën për ta njohur (gr. Nr. 585/2002, neni 3).

<sup>385</sup> Këto barrierat procedurale hasen edhe në shtete të tjera. Gjatë viteve 1990 Franca krijoi një pol financiar në Paris, bashkë me institucione ndër rajonale të specializuara, sipas një ligji të 9 marsit 2004. Por ligji nuk u jepte policisë dhe prokurorëve autonomi të mjaftueshme për të trajtuar çështjet e korrupsionit në mënyrë efektive. Mbyllja e fregatave për udhëtimin e Tajvanit në shtator 2008, flet për këtë dobësi të ligjit. Megjithatë u arkëtuan 350 milionë euro vlerë si përçindje nga i akuzuari në këtë marrëveshje, autoritetet politike e përdorën pretekstin e sekretit kombëtar për t'u refuzuar gjyqtarëve aksesin ndaj provave (Shih Eric Alt, *Justitia penala în combaterea infractiunilor economice si financiare*, në revistën e SCM *Justitia în actualitate*, nr. 3/2008, fq. 43).

ligjor maksimal) ose të përcaktojnë statutet e veçanta të kufizimeve për krimet e korrupsionit.

Në këtë drejtim, neni 29 i Konventës së OKB-së kundër korrupsionit, parashikon nevojën për të krijuar status të gjatë të periudhave të kufizimeve për krimet e korrupsionit dhe një status më të gjatë të periudhës së kufizimeve ose pezullimin e statusit në çështjen ku krimineli i pretenduar i është shmangur administrimit të drejtësisë.

**g.** Siç u përmend më parë, krimet e korrupsionit janë të vështira për tu zbuluar; si rregull, ato kryhen pa dëshmitarë dhe mjetet e zakonshme për të mbledhur informacione dhe për të përdorur provat janë të papërshtatshme.

Për këtë arsye, nevojiten *metodat moderne të hetimit* për të lehtësuar mbledhjen e provave. Me këtë, ne nënkuptojmë metodat e tilla si interceptimi i bisedave që nga etapa të hershme të hetimit, aksesit në sistemet e teknologjisë së informacionit, monitorimi i llogarive bankare, përdorimi i hetuesve të fshehtë, informatorëve dhe bashkëpunëtorëve të policisë gjyqësore dhe përdorimi i lëvrimin të kontrolluar. Në lidhje me aspektin e fundit, theksojmë se nevoja për kontroll tërësor mbi shpenzimin e parave publike për të siguruar infiltrimin e suksesshëm të agjentëve të fshehtë ose të dërgesave me drogë në dogana ose për të parandaluar marrëveshjen e fshehtë të prokurorëve dhe agjentëve të fshehtë. Në të njëjtin kontekst theksojmë se për të parandaluar rrjedhjet e informacionit, veçanërisht kur të dyshuarit punojnë brenda të njëjtit sistem me hetuesit, rekomandohet që vendimi për ndalimin ose kërkimin të bëhet brenda një grupi sa më të vogël njerëzish që të jetë e mundur dhe, nëse është e nevojshme, të zbatohen nga agjentë prej njësisë të tjera territoriale.

Përmendim gjithashtu se, sipas praktikës së GJEDNJ, përdorimi i metodave speciale të hetimit - veçanërisht operacioneve të fshehta - nuk duhet të bjerë ndesh me parimin e gjykimit të drejtë. Megjithatë, në qoftë se një agjent i fshehtë është anëtar i forcës policore dhe provokon një gjyqtar/prokuror që të pranojë mitën kur nuk ka ndonjë tregues se krimi do të ndodhte pa ndërhyrjen e agjentit, agjenti vepron kundër nenit 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>386</sup>.

**h.** Në lidhje me provat, besojmë se *transferimi i barrës së provës* mund të jetë i mundshëm. Krimet e korrupsionit, në përgjithësi janë të ndëshkueshme nga penaltete të ashpra dhe në këtë rast detyrimi i të dyshuarit që të provojë pavarësinë e tij/të saj në lidhje me burimin ligjor të aseteve që ai/ ajo ka është i pranueshëm<sup>387</sup>.

Në Francë, Kodi Penal u amendua në mars 2007 për të konfirmuar vendimin kuadër për konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, instrumentet dhe pasurinë (2005/212/JHA). Neni 2 thotë, "Secili shtet anëtar do të marrë masat e domosdoshme për t'i mundësuar atij konfiskimin, ose tërësisht ose pjesërisht të instrumenteve dhe të ardhurave nga veprat penale të ndëshkueshme me privimin e lirisë për më tepër se një vit, ose pasurinë vlera e së cilës korrespondon me këto të ardhura". Amendimet zgjeruan opsionin e konfiskimit të të ardhurave nga një krim i ndëshkuar me burgim për më shumë se dy vjet në mënyrë që krimet e rënda (p.sh., trafikimi i drogave të paligjshme, trafikimi i qenieve

<sup>386</sup> GJEDNJ Ramanauskas kundër Lituaniës, vendim i datës 05 shkurt 2008.

<sup>387</sup> Transferimi i barrës së provës operon për shembull sipas nenit 5.7 në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave të paligjshme dhe substancave psikotrope, të 20 dhjetorit 1988, për të provuar origjinën e paligjshme të aseteve që kanë gjasë të konfiskohen të dyshuara se janë të ardhura nga trafiku i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope.

njerëzore, krimi i organizuar, pastrimi i parave), asetet mund të konfiskohen pavarësisht se nëse janë fituar ligjërisht ose nëpërmjet krimit. Ligji i ri e parashikon gjithashtu se asetet mund të konfiskohen në qoftë se origjina e tyre nuk mund të provohet, kur krimi ka gjeneruar të ardhura për kriminelin dhe kur ndëshkimi për atë krim është burgosja me më tepër se 5 vjet. Meqenëse krimet e korrupsionit të kryera nga zyrtarët publikë mund të ndëshkohen në Francë me më tepër se 10 vite burg, barra e provës është në anën tjetër. Barra transferohet nga organet e ndjekjes penale tek mbrojtja, e cila duhet të provojë burimin e ligjshëm të fitimit në këtë rast kur janë bërë fitime të drejtpërdrejta ose indirekte. Duke pasur parasysh se ky mekanizëm përfshin një përjashtim nga prezumimi i pafajësisë, duhet të ekzistojnë një garanci që ndëshkimi për shkeljen të jetë më tepër se 5 vite burg dhe që të akuzuarit t'i lejohet të prodhojë prova për të hedhur poshtë akuzën e përfitimit të paligjshëm të aseteve. I njëjti parim i transferimit të barrës së provës aplikohet gjithashtu në rastet kur një individ ka një stil jete që nuk mund të shpjegohet nga të ardhurat e deklaruara, veçanërisht kur individit ka lidhje me qarqet kriminale (tregtarët e drogave, etj). Në aplikimin e këtyre procedurave, gjykatat franceze janë të interesuara që të jenë në përputhje me rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare; trajnimi special i gjyqtarëve në këto raste inkurajohet dhe lehtësohet aksesimi ndaj informacionit përkatës (të dhënat e tatimeve, dokumentet e pasurive të paluajtshme, etj)<sup>388</sup>.

Natyrisht, në sistemin gjyqësor rumun kjo ngre çështjen e pajtueshmërisë së këtij përjashtimi me prezumimin e fajësisë që gjendet në nenin 44, paragrafi 3 të Kushtetutës së Rumanisë, sipas të cilit "*asetet e fituara ligjërisht nuk mund të konfiskohen. Asetet prezumohen që janë fituar ligjërisht*". Besojmë se interpretimi i këtij rregulli në sensin e shpjeguar më sipër materializohet nga dy rregullore në legjislacionin aktual.

Së pari, neni 10 në Kodin e Procedurës Fiskale rregullon "detyrën për të bashkëpunuar: (1) Taksapaguesit do të bashkëpunojnë me autoritetet fiskale në lidhje me përcaktimin e situatës fiskale, duke paraqitur faktet për të cilat ata kanë dijeni plotësisht dhe që janë të vërteta dhe duke treguar mjetet për të cilat kanë dijeni për të provuar këto fakte. (2) Taksapaguesit do të marrin masat për të prodhuar provat e nevojshme duke përdorur të gjithë mjetet gjyqësore dhe praktike të disponueshme për ta". Nuk ka dyshim se i përket taksapaguesit që të provojë gjendjen e tij fiskale.

Së dyti, rregullorja e fundit në NIA ligji nr. 144/2007 ndikon gjithashtu në interpretimin e këtij rregulli. Në përputhje me nenin 4, paragrafi 3, në qoftë se analiza e kryqëzuar e të dhënave në deklarata dhe në dokumentet shtesë që disponon inspektori i integritetit, zbulon një diferencë të dukshme (d.m.th., të paktën 10.000 euro) midis aseteve të fituara gjatë afatit në detyrën publike dhe të ardhurave të fituara gjatë të njëjtës periudhe, inspektori i integritetit duhet të kontrollojë nëse kjo diferencë përkatëse është e justifikuar. Aty ku inspektori i integritetit konstaton se kjo nuk është e justifikuar, ai/ajo njofton gjykatën kompetente për të vendosur bazën për pjesën e aseteve të fituara ose të aseteve të konstatuara që janë fituar nga burime të pajustificuara, për konfiskimin e të cilave ai/ajo aplikon<sup>389</sup>. Në gjykimin e çështjes, gjykata fillon duke rishikuar provat e përdorura nga inspektorët dhe mund të pranojë futjen e çështjeve të reja të provave, në qoftë se palët e kërkojnë këtë. Në qoftë se arrihet konkluzioni se përvetësimi i aseteve specifike ose një pjesë e aseteve nuk është e

<sup>388</sup> Nxjerr nga përmbledhja e bisedave në seminarin "Korrupsioni në nivelin e lartë dhe penalitetet e aplikuara nga gjykatat", Bukuresh, 2007, në ...

<sup>389</sup> Ligji nr. 144/2007 për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 359 të datës 35.05.2007 amenduar dhe modifikuar me GEO nr. 49/2007, miratuar nga ligji nr. 94/2008 dhe GEO 138/2007, miratuar me ligjin nr. 105/2008.

justifikuar, Gjykata e Apelit ose do të urdhërojë konfiskimin e aseteve të pajustificuara ose një pjese të tyre ose do të kërkojë pagimin e shumës së parave të barabartë me vlerën e asetit siç vendoset nga gjykata pas vlerësimit të ekspertit. Aty ku urdhërohet pagesa, gjykata duhet të përcaktojë gjithashtu afatin e pagesës. Kur arrihet në vendimin që burimi i aseteve është i justifikuar, gjykata urdhëron që të mbyllet çështja<sup>390</sup>.

Është pala në fjalë që duhet të provojë se asetet janë fituar në mënyrë të ligjshme duke e konsideruar publikimin e detyrueshëm të aseteve, detyrën për të dorëzuar dokumente plotësuese me kërkesën e inspektorit dhe përdorimin jo të detyruar të provave të tjera para gjykatës, një gjykim mund të merret ekskluzivisht mbi bazën e konstatimeve të inspektorit të integritetit, bazuar në të dhënat e publikuara nga personi në fjalë.

#### 5.4 Sanksionimi i korrupsionit

Sanksionimi i korrupsionit dhe krimeve të abuzimit është një çështje e rregulloreve në lidhje me përgjegjësinë administrative, disiplinore, civile dhe penale.

Pavarësisht nga procedura e adoptuar për secilën lloj të shkeljeve, *shpejtësia* e saj është një parakusht i zakonshëm. Për keqsjelljen dhe krimet e korrupsionit, shpejtësia përfshin një kërkesë të veçantë. Kjo vjen sepse zgjatja e madhe e procedurave ka dy efekte negative që duhen kundërshtuar. Nga njëra anë, një sanksion i aplikuar shumë kohë pasi është kryer akti i korrupsionit nuk përmbush më rolin pengues. Nga ana tjetër, ai minon besimin e qytetarëve, duke i bërë ata që të mos raportojnë aktet e korrupsionit me arsyen se 'asgjë nuk ndodh, sidoqoftë'. Kjo është arsyeja përse mund të specifikohet kohëzgjatja maksimale e akteve specifike procedurale.

Gjithashtu, për të siguruar sanksionet e duhura dhe objektive, meqenëse enti i besuar me kompetencën vjen nga i njëjti sistem si edhe kriminelit, nevojitet dhënia e *juridiksionit* material edhe madje territorial, i cili mund të vendosë një distancë midis kriminelit dhe organit sanksionues. Në fakt, sipas legjislacionit aktual, gjyqtarët dhe prokurorët marrin sanksione disiplinore vetëm nga SCM, një organ qendror me seli në Bukuresht. Po kështu, Gjykatat e Apelit janë organet kompetente në lidhje me krimet e kryera nga gjyqtarët/prokurorët në gjykatat dhe tribunalet, noterët, avokatët, përmbanuesit gjyqësorë. Për krimet e kryera nga gjyqtarët/ prokurorët në Gjykatat e Apelit dhe në Gjykatat e Larta - për anëtarët e SCM dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë është organi sanksionues - neni 281 dhe neni 29 i Kodit Penal i rregullon këto respektivisht. Kompetenca mbi stafin penitenciar i jepet tribunaleve, mbi oficerët e Gjykatave të Apelit dhe mbi krimet e kryera nga inspektorët e përgjithshëm të penitenciarit i jepet HCCJ (neni 60, ligji nr. 293/2004)<sup>391</sup>. Po kështu organi kompetent për të vendosur mbi konfiskimin e pasurisë ose e një asemi specifik është Gjykata e Apelit që ka juridiksionin mbi zonën ku jeton personi në fjalë, ndërsa për gjyqtarët e HCCJ, gjyqtarët e Gjykatës të Apelit dhe prokurorët në prokurori atashuar këtyre gjykatave dhe për anëtarët e SCM dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, organi kompetent është HCCJ sipas nenit 46 të ligjit nr. 144/2007.

<sup>390</sup> Neni 17-18 i ligjit nr. 115/1996 për publikimin dhe vlerësimin e aseteve të funksionarëve, gjyqtarëve/prokurorëve dhe personave që kanë kompetenca drejtuese dhe inspektuese mbi zyrtarët publikë, amenduar me ligjin nr. 161/2003, nëpërmjet EGO nr. 24/2004 miratuar nga ligji nr. 601/ 2004 dhe GEO nr. 14/20005.

<sup>391</sup> Ligji nr. 293 I 28 qershorit 2004 për statusin e zyrtarëve publikë me status të veçantë në autoritetin kombëtar penitenciar, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 581 e datës 30 prill 2004.



Në këtë drejtim, kemi identifikuar një numër dobësish ku çështjet penale, në të cilat përfshihen personeli gjyqësor, duhet të përcaktohen nga kolegët përkatës të personit. Për shembull, prokuroritë e atashuara gjykatave të apelit trajtojnë çështjet kundër oficerëve të policisë (neni 27 në ligjin nr. 218/2002)<sup>392</sup>. Megjithatë, në këto prokurori punojnë edhe prokurorët nën mbikëqyrjen e të cilëve këta punonjës policie kryejnë hetime penale rregullisht. Po kështu, krimet e kryera nga nëpunësit e gjykatës në prokurori hetohen nga vetë prokurori që punon me zyrat e të dyshuarave. Krimet e kryera nga nëpunësit e gjykatave që punojnë në gjykatat e ligjit gjykohen nga vetë gjyqtarët që punojnë në atë gjykatë. Për pasojë, për të ruajtur që gjykimi të mos influencohet nga marrëdhëniet që ndikojnë objektivitetin dhe për të ruajtur dukjen e paanësisë, këto çështje do të gjykohen nga gjykata ose prokurori të një rangu më të lartë ose nga ato të një qarku tjetër.

#### **a. Sanksionet disiplinore**

Disa akte të kryera nga punonjësit gjyqësor mund të jenë thjesht devijime nga detyrat e tyre profesionale ose shkelje të thjeshta të rregullave etike. Disa çështje të keqsjelljes mund të lidhen me korrupsionin (p.sh., mos raportimi i një akti të paligjshëm të kryer nga një koleg ose pranimit i dhuratave), ndërsa çështje të tjera mund të tregojnë dyshime për korrupsion (mos raportimi i aseteve të dikujt, shkelje e rregullave të mospërputhshmërisë, vonesat në përcaktimin e çështjeve të caktuara).

Këto sanksione, aplikohen në qoftë se, me përfundimin e veprimit disiplinor, personi në fjalë ende ruan aftësinë që ai/ajo kishte në kohën kur u krye akti. Por në vitet e fundit, është zhvilluar tendenca e mëposhtme - për t'u bërë bisht sanksioneve, personi në fjalë tenton që të largohet nga profesioni para përfundimit të vendimit disiplinor, nëpërmjet dorëheqjes ose daljes në pension.

Për shembull, sipas një deklaratë për shtyp të datës 25 shkurt 2009, SCM anuloi një veprim disiplinor kundër gjyqtarit B.V. Dalja në pension e gjyqtarit më 10 shkurt 2009 e bënte veprimin të pavlefshëm. Veprimi disiplinor ishte iniciuar për moskryerjen e pajustificuar të detyrës zyrtare dhe për një qëndrim jo dinjitoz ndaj kolegëve gjatë detyrave zyrtare. Duke dalë në pension përpara përfundimit të veprimit disiplinor, një gjyqtar mund të ruajë më pas të gjitha përfitimet që i akordohen një gjyqtari të ndershëm (p.sh., pagesën për pensionin, përfitimet e pensionit, opsionin e ripunësimit).

Kjo është arsyeja për se ne besojmë se në qoftë se ky institucion duhet të plotësojë qëllimin e tij, ligji duhet të ndryshohet për të lejuar vazhdimin e veprimeve disiplinore, edhe pasi personi në fjalë të largohet si gjyqtar ose si prokuror. Sanksionet që SCM mund të aplikojë përfshijnë: reduktimin e përfitimeve të pensionit për një periudhë të specifikuar, ndalimin për t'u ripunësuar si gjyqtar/prokuror ose në ndonjë profesion ligjor për një periudhë të specifikuar ose pa afat dhe krejt pezullimin e të drejtës për pagesë për pensione.

Në fakt, neni 145 i Kodit Penal të 1865 Kodi Penal (i anuluar aktualisht) parashikonte se kur një gjyqtar korruptohet në një çështje penale, ndëshkimi ishte burgosja maksimale dhe *ndalimi i të drejtës për t'u pranuar në profesionet e tyre respektive për gjithë jetën, si dhe ndalimi i të drejtës për përfitime për pensionin.*

---

<sup>392</sup> Ligji nr. 218/ 2002 mbi organizimin dhe funksionimin e policisë rumune botuar në Gazetën Zyrtare nr. 305 të datës 9 maj 2002, amenduar me ligjin nr. 281/2003.

Aktualisht, sugjerojmë një rregullore të veçantë në lidhje me konfliktet e interesit dhe papajtueshmëritë. Sipas nenit 47 në ligjin nr. 144/2007 për NIA, "(1) Akti i një personi që konstatohet se ka lëshuar një dokument administrativ, që ka përfunduar një dokument gjyqësor, që ka marrë një vendim ose ka marrë pjesë në bërjen e një vendimi që bie ndesh me detyrimet ligjore në lidhje me konfliktet e interesit, përbën keqsjellje dhe ndëshkohet sipas rregulloreve të aplikueshme për funksionet përkatëse publike të larta, detyrën ose aktivitetin publik, në qoftë se akti në fjalë nuk paraqet elementë përbërës të një krimi. (2) *Një person i shkarkuar ose i larguar nga detyra humbet të drejtën që ta mbajë detyrën ose funksionin publik siç parashikohet nga neni 39<sup>393</sup>, me përjashtim të pozicioneve të zgjedhura për të paktën tre vite pas largimit ose shkarkimit nga detyra ose funksioni publik.* Ndalimi urdhërohet me kërkesën e Agjencisë, nga gjykata kompetente (...), si një dënim plotësues për konfiskimin e një pjese të pasurisë së fituar ose të një aseti specifik ose në rastin e konflikteve të interesit. (3) Akti i personit që konstatohet që ka qenë në një pozicion të papërputhshëm përbën arsye për shkarkim ose aty ku është e aplikueshme, përbën një rast të keqsjelljes të ndëshkueshme sipas rregulloreve për funksionin, detyrën ose aktivitetin përkatës. (4) Në qoftë se personi që hetohet nuk e mban më detyrën ose funksionin publik që parashikohet në nenin 39 në datën kur raporti disiplinor merr formë të prerë, personi *humet të drejtën për të mbajtur detyrën publike ose detyrën e lartë publike siç parashikohet nga ligji, përjashtuar pozicionet e zgjedhura, për tre vite mbas datës kur raporti merr formë të prerë. Ndalimi urdhërohet, me kërkesën e Agjencisë, nga gjykata kompetente (...)* si një sanksion plotësues për konfiskimin e një pjese të pasurisë së fituar ose të një aseti specifik ose në rastin e konfliktit të interesit" (theksim i yni).

#### **b. Sanksionet penale**

Korrupsioni është ndëshkuar që kur s'mbahet mend. Në legjislacionin antik, korrupsioni i gjyqtarëve ndëshkohej duke konfiskuar asetet (Indi), rrahje me kamxhik (shteti hebre) ose vdekje me kryqëzim (Persi). Ligji romak parashtron detyrimin e gjyqtarëve dhe avokatëve që të kryejnë shërbimet e tyre pa pagesë dhe t'i lejojnë mitëdhënësit të iniciojnë një veprim për të rikuperuar asetet e ofruara si mitë. Më pas, u fut një ndëshkim që kishte të bënte me pagesën e dyfishit të vlerës së përfitimit të marrë dhe ndalimin e të drejtës për të mbajtur detyrën. Më vonë, u bë një dallim midis mitës që merret në çështjet civile (e ndëshkueshme me një gjobë prej 2 ose 3 herë më të lartë se sa vlera e përfitimit), dhe mitën e marrë në çështjet penale (e ndëshkueshme me konfiskimin e asetit dhe egzil)<sup>394</sup>.

Aktualisht, standardet për sanksionimin e krimeve të korrupsionit parashtrihen nga neni 30 i Konventës së OKB-së kundër korrupsionit, i cili thotë se ndëshkimi për komisionin e një krimi korrupsioni do të çojë në sanksione që marrin parasysh gravitetin

---

<sup>393</sup> Ajo përfshin ato kategori që janë të detyruara të raportojnë asetet dhe interesat e tyre duke përfshirë Ministrin e Drejtësisë, sekretarët dhe nënsekretarët e shtetit dhe personelin e punësuar në zyrat e funksioneve publike; anëtarët e këshillit të lartë të magistraturës; gjyqtarët, prokurorët, ndihmës gjyqtarët/prokurorët ose kategoritë e ngjashme si dhe asistentët gjyqësor, personelin ndihmës të specializuar në gjykata dhe prokurori, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese; anëtarët e Këshillit Kombëtar të Integritetit si dhe kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit; personat që kanë kompetenca drejtuese dhe inspektuese si dhe zyrtarët publikë, duke përfshirë ata që kanë status të veçantë, të cilët punojnë në të gjitha autoritetet vendore ose qendrore ose siç mund të jetë e aplikueshme në të gjitha institucionet publike.

<sup>394</sup> Gjerësisht në Vasile Dobrinoiu, *Coruptia în dreptul penal român*, Atlas Lex, Bukuresht, 1995, fq. 86-89.

e krimit. I njëjti kriter duhet të konsiderohet kur shqyrtohet opsioni i lirimit të hershëm ose me kusht të personave të dënuar për krimet e korrupsionit. Si sanksion plotësues, Konventa parashikon nevojën për të krijuar procedura nëpërmjet të cilave një zyrtar publik i akuzuar për një krim vendosur në përputhje me Konventën, me urdhër të gjykatës ose ndonjë mjeti tjetër të përshtatshëm, mund të përjashtohet nga mbajtja e detyrës publike ose nga mbajtja e detyrës në një sipërmarrje që është pronë tërësore ose e pjeshme e shtetit.

**b.1. Në lidhje me ndëshkimin kryesor**, legjislacioni rumun plotëson këtë kërkesë sepse krimet e korrupsionit janë të ndëshkueshme vetëm me burg dhe kohëzgjatja e tyre në përgjithësi është e madhe: 3 - 12 vjet për marrje mite, 6 muaj deri në 5 vjet për dhënie mite dhe 2 - 10 vjet për tregtim ose blerje influence.

Kur në krimet e korrupsionit përfshihen punonjësit e policisë, prokurorët ose gjyqtarët për vendosjen mbi një çështje penale, kufijtë e sipërm të penalitetit janë dy vjet më të larta (neni 7 në ligjin nr. 78/2000). Por nuk shikojmë ndonjë arsye për se gjyqtarët e ligjit civil që kryejnë krime korrupsioni të mos i nënshtrohen të njëjtës rritje në ndëshkim. I vetmi dallim që mund të ekzistojë duhet të lidhet me çështjet kur gjyqtari i korruptuar vetë specializohet në gjykimin e çështjeve të korrupsionit.

Në *Gjermani*, krimet e korrupsionit futen në kapitullin 30 të Kodit Penal - krimet në detyrën publike. Ai kriminalizon *pranimin e përfitimeve* si akt i lejimit të premtimit ose marrjes të një përfitimi për vete ose për një person të tretë në shkëmbim të kryerjes së një detyre. Pranimi i përfitimit (seksioni 331) është i ndëshkueshëm me burg jo më shumë se tre vjet ose me gjobë. Krimi mund të marrë formën e agravuar, kur subjekti aktiv i krimit është *gjyqtar* ose arbitruar, rast në të cilin ndëshkimi është burgim për pesë vjet ose gjobë.

Krijimi i mitëdhënies (seksioni 332) ka elemente përbërës të kërkesës që lejon premtimin ose pranimin faktik të një përfitimi për vete ose për një person të tretë në këmbim të kryerjes së një akti zyrtar dhe për këtë arsye shkel detyrat zyrtare. Krimi i *korrupsionit* ndëshkohet me burgim 6 muaj deri në 5 vjet. Në çështje më pak të rënda, ndëshkimi është burgim për tre vjet ose gjobë. Gjithashtu, kur një subjekt aktiv i krimit është një *gjyqtar* ose arbitruar, ndëshkimi është burgim me 1-10 vjet. Në çështje më pak serioze, ndëshkimi është burgim me 6 muaj deri në 5 vjet. *Dhënia e përfitimit* ndëshkohet me burgim deri në tre vjet ose me gjobë dhe kur përfshin një *gjyqtar* ndëshkimi është burgim deri në pesë vjet ose gjobe (seksioni 333). Në lidhje me *ofrimin* e mitës që i referohet aktit të një personi që premtton, ofron ose jep një përfitim, për atë person ose një person të tretë, në shkëmbim të kryerjes të një akti zyrtar dhe për këtë arsye shkel detyrat zyrtare (d.m.th., një akt i paligjshëm), ndëshkimi është burgim midis 3 muaj deri në 5 vjet dhe ndëshkim i agravuar (kur zyrtari vendim i të cilit ndikohet është një *gjyqtar* ose arbitruar) përfshin burgimin nga 6 muaj deri në 5 vite (seksioni 334).

Në *Finlandë*, në kapitullin 16, krimet kundër autoriteteve publike, të Kodit Penal, ndëshkimi për krimin e *mitës*, konsiston në aktin e premtimit, ofrimin ose dhënies një zyrtari publik në shkëmbim të veprimeve të tij në detyrë, të një dhurate ose përfitimi tjetër për zyrtarin ose një person tjetër që synon të ndikojë ose të çojë në ndikimin mbi veprimet në detyrë të zyrtarit publik, është gjobë ose burgim deri në 2 vjet. *Mita e agravuar* është edhe një formë më e rëndë e mitës, ku dhurata ose përfitimi synon që ta bëjë personin që të veprojë në kundërshtim me detyrat e tij/të saj me përfitim të konsiderueshëm për mitëdhënësin ose një person tjetër ose me humbje ose dëm të konsiderueshëm për një person tjetër ose kur vlera e dhuratës ose përfitimit është e konsiderueshme, dhe mita është e rënduar kur vlerësohet si e tërë. Mita e rënduar ndëshkohet me burgim për të paktën 4 muaj dhe më e shumta 4 vjet. Krimet e mitmarrjes

rregullohen në kapitullin 40 - krimet në detyrë. *Pranimi i mitës* ndëshkohet me gjobë ose burgim deri në 2 vjet. Për pranimin e rënduar të një mite, ndëshkimi është burg të paktën 4 muaj dhe më e shumta 4 vjet dhe veç kësaj largim nga detyra.

Kapitulli 17 në Kodin Penal të *Suedisë* (Krimet Kundër Aktivitetit Publik) parashikon kufi specialë të ndëshkimit dhe elemente përbërës të krimit të *mitës*: "Një person që jep, premtion ose ofron një mitë ose një shpërblim tjetër të padrejtë një punonjësi ose një personi tjetër të përcaktuar në kapitullin 20, seksioni 2, për ushtrimin e detyrave të tij zyrtare, do të dënohet për mitdhënie me gjobë ose burgim deri maksimumi 2 vjet". Sipas kapitullit 20, krimet e shpërdorimit të detyrës, nëpërmjet të cilëve një punonjës merr, pranon një premtim ose kërkon një premtim mite ose kërkon një mitë ose shpërblime të tjera të padrejta për kryerjen e detyrave të tij do të dënohet për *marrjen e mitës* me gjobë ose burgim maksimumi 2 vjet. E njëjta gjë vlen edhe për punonjësit në qoftë se punonjësi ka kryer aktin para marrjes së postit ose pas lënies së tij. Në qoftë se krimi është i madh, burgimi do të vendoset me një maksimum prej 6 vjetësh.

Kodi Penal i *Portugalisë* i kushton seksionin I, në kapitullin 4 të krimeve të korrupsionit. Sipas nenit 372 - *Korrupsioni Pasiv për Një Akt të Paligjshëm* - zyrtari që, vetë ose me anë të një ndërmjetësi që ka pëlqimin ose ratifikimin e tij/të saj, kërkon ose pranon për vete ose për një person të tretë një përfitim financiar ose jo financiar ose premtion një përfitim në shkëmbim të një akti ose moskryerjes së një akti në kundërshtim me detyrat e tij/të saj, ndëshkohet me burg prej 1 - 8 vjet. *Korrupsioni pasiv për një akt të ligjshëm* (neni 373) ndëshkohet me burg nga 2 vjet deri me gjobë deri 240 ditë. *Korrupsioni aktiv për një akt të paligjshëm* ndëshkohet me burg nga 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa *korrupsioni aktiv për një akt të ligjshëm* ndëshkohet me burg për më shumë se 6 muaj ose një gjobë prej deri në 60 ditë (neni 374).

Në Kodin Penal të *Estonisë*, seksioni për "Shkeljen e Detyrës për të Ruajtur Integritetin" e përcakton krimin e pranimit të përfitimeve në nenin 293: akti i një zyrtari i cili jep pëlqimin për një premtim pasurie ose përfitimi tjetër në shkëmbim të një akti të ligjshëm për të cilin nuk ka arsye të besohet se ai/ajo do ta kryejë, ose për një mosveprim të ligjshëm të këtij akti dhe duke bërë këtë, ai/ajo përfiton nga pozita e tij/e saj zyrtare, ndëshkohet me një gjobë ose burg deri në 3 vjet. Në qoftë se krimi kryhet të paktën dy herë ose duke kërkuar përfitime, ndëshkimi është burg deri në 5 vjet. Në qoftë se akti i pranimit kryhet në shkëmbim të një akti ose mosveprimi të paligjshëm, ai përbën mitmarrje dhe ndëshkohet me burg nga 1 - 5 vjet; forma e tij e rënduar sjell një dënim më të madh me burg nga 2 - 10 vjet. Krimi i dhënies së mitës konsiston në ofrimin ose premtimin e një mite dhe ndëshkohet me burg nga 1 - 5 vjet dhe në qoftë se kryhet të paktën një herë ndëshkohet me burg nga 2 - 10 vjet<sup>395</sup>.

Në pamje të parë vëmë re se ndëshkimet për korrupsionin në këto vende evropiane janë më të lehta se në Rumani. Megjithatë, ia vlen të shënojmë se në këto vende gama e korrupsionit është gjithashtu shumë më e vogël se sa në Rumani: në lidhje me perceptimet për korrupsionin, Gjermania renditet e 14, Finlanda e 5, Estonia e 27, Suedia e 1, Portugalia e 32, ndërsa Rumania renditet e 70 (sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit TI - 2008, i cili vëzhgoi 180 vende në botë). Renditja është nga më pak i korruptuari tek më shumë i korruptuari.

Në Rumani, megjithatë, ka probleme të rënda që shoqërojnë sanksionet në çështjet konkrete. Si shoqëria civile edhe organet ndërkombëtare e kanë kritikuar Rumaninë në mënyrë konstante për gjyqtarët që aplikojnë penaltitete shumë të buta (burg me pragun special minimal ose poshtë tij ose madje gjoba penale, dënime të kushtëzuara të pezulluara ose dënime me shërbimin e provës). Ky qëndrim nuk kufizohet me rastet që

---

<sup>395</sup> Marrë nga dokumenti pozicioni i Ministrisë së Drejtësisë dhe liritë e qytetarit mbi nenet në projektin e Kodit Penal që gjeneroi debate publike, 23 mars 2009, në [www.just.ro](http://www.just.ro).

përfshijnë anëtarët e gjyqësorit; përkundrazi shpesh nuk merr parasysh statusin e atyre që përfshihen në krimet e korrupsionit.

Në vitin 2008, u morën 63 gjykime të formës së prerë që kishin të bënin me 97 të pandehur. Nga këta, 28 vetëve iu dha dënim me burg nga 1- 5 vjet (në një rast, burgu për 9 vjet), kundrejt 42 të pandehurve që morën dënime të pezulluara midis 6 muaj dhe 3 vjet (në një rast 3 muaj, në 2 raste 2 muaj) dhe 26 të pandehur që morën dënime të pezulluara nën mbikëqyrje që ishin nga 1- 4 vjet. Në gjykimet jo të formës së prerë, 122 të pandehur u dënuan në vitin 2008 në 71 çështje, nga të cilët 38 të pandehur u dënuan me burg, krahasuar me 58 të pandehur që morën dënime të pezulluara me kusht, 20 të pandehur që morën dënime të pezulluara me mbikëqyrje dhe 6 të pandehur të cilët u dënuan me pagesë gjobash penale që shkonin nga 1000 - 15000 lei.

Me fjalë të tjera, afërsisht vetëm 29% (*d.m.th., më pak se 1/3*) e kriminelëve të dënuar do të kryejnë dënimin me burg, i cili sipas mendimit tonë, nuk ka gjasë që të ketë ndonjë efekt pengues. Prandaj, 58% të kriminelëve të dënuar që kanë marrë ndëshkime me shkallë speciale minimale të parashikuar nga ligji ose poshtë asaj shkalle, 39% që kanë marrë dënime drejt minimumit special dhe vetëm 1% dënime drejt maksimumit special, mund të konkludohet me siguri se *edhe në afatet e gjata të dënimeve të aplikuara, krimet e korrupsionit, krimet e lidhura me korrupsionin dhe krimet e ngjashme me korrupsionin sjellin ndëshkime të buta*. Është fakt se analizat e kryera deri tani zbulojnë një mospërputhje midis kërcënimit abstrakt social të akteve të korrupsionit, siç përcaktohet nga ligjvënësit që imponojnë ndëshkime të niveleve të larta dhe kërcënimit social konkret të njohur nga gjykatat, që demonstron nga aplikimi i penaliteteve të vogla.

Përqindja e lartë e gjykimeve që përmbysen në etapat e apelimit (57%), krahasuar me numrin e madh të situatave në të cilat këto përmbysje janë substanciale ose madje edhe konfliktuese, theksojnë një imazh jo konsistent të praktikës gjyqësore. Kështu, kriteret objektive në lidhje me vlerën e gjykimit të krimit të korrupsionit dhe të dëmeve të shkaktuara ose të marrëdhënieve sociale që ndikohen prej tyre nuk sundojnë ashtu siç duhet. Pikëpamja e përgjithshme se përjashtimi nga përfshirja e atyre që mbajnë detyrë publike në aplikimin e sanksioneve penale, (që gjoja shkakton një efekt pengues edhe kur ndëshkimi është poshtë minimale, ka orientuar drejt minimumit ose pezullimit), sipas mendimit tonë, nuk ka gjasë që të çojë më tej qëllimin e procesit penal për korrupsionin apo çështjet e lidhura me korrupsionin<sup>396</sup>.

Mendimi i avokatëve rumunë, i shprehur në janar 2008 në anketimin e Gallupit, është se ka një mospërputhje të përgjithshme midis ndëshkimit të imponuar nga gjyqtarët dhe gravitetit të krimeve. 62% e avokatëve të intervistuar besonin se ndëshkimet janë tepër të buta krahasuar me gravitetin e keqbërjes dhe 83% binin dakord se shpesh gjyqtarët vendosin penalitete tepër të ashpra për krime të vogla. Në të njëjtin anketim, 82% e publikut besonte se ndëshkimet e dhëna nga gjyqtarët ishin tepër të ashpra për krimet e vogla dhe 71% e publikut ishin tepër të buta për krimet e rënda.

Ky perceptim zbuloi një fakt - mungesën e parashikueshmërisë që ekziston në dhënien e ndëshkimeve, mungesën e kriterëve të qarta për përcaktimin e dënimeve.

Ky fenomen, solli kritika të justifikuar nga Komisioni Evropian në raportin e qershorit 2007 mbi Rumaninë: "Dënimet e aplikuara nga gjykatat në çështjet e korrupsionit nuk kanë

---

<sup>396</sup> Të dhëna të marra nga Raporti i Aktivitetit Vjetor të Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion, viti 2008, në [www.pna.ro/bilant.jsp](http://www.pna.ro/bilant.jsp).

një efekt pengues dhe nuk arrijnë të përmbushin funksionin e tyre parandalues<sup>397</sup>. Me një gjatësi mesatare të dënimit për krimet e korrupsionit 1- 2 vjet burg dhe shumicën e dënimeve me ekzekutimin të pezulluar me kusht, gjykatat nuk demonstrojnë se ato kuptojnë rolin e tyre esencial në përpjekjet për të luftuar korrupsionin në Rumani.

E njëjta kritikë u përsërit në raportin e tyre të korrikut 2008: "Angazhimi i Rumanisë për të çrrënjësuar korrupsionin reflektohet në fazën para gjyqimit, por nuk shkon drejt rritjes së numrit të dënimeve apo sanksioneve penguese. Është barra e autoriteteve rumune që të tregojnë se sistemi gjyqësor funksionon dhe se hetimet për korrupsionin çojnë në arrestime, ndjekje penale dhe në varësi të gjyqimit të gjykatës, në dënime me efekte penguese dhe konfiskimin e aseteve"<sup>398</sup>.

Shpjegimi për dënimet e lehta të korrupsionit nga gjyqtarët është mungesa e një kulture antikorrupsion, mungesa e kuptimit të këtij fenomeni dhe e ndjeshmërisë ndaj efekteve të tij. Disa gjyqtarë/prokurorë kanë argumentuar për pezullimin e dënimeve në çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, duke deklaruar se në krimet e korrupsionit kërcënimi social është më pak i rëndësishëm se sa është në krime të tjera (d.m.th., vjedhjet, sulmet kërcënuese). Të tjerë kanë theksuar se, pasi një çështje korrupsioni arrin në gjykatë pas procesit (të gjatë penal), dënimi me burg nuk është i justifikuar sepse kërcënimi social nuk është më i pranishëm<sup>399</sup>. Në lidhje me krimet e korrupsionit ndëshkimet e aplikuara nga gjykatat janë në përgjithësi të buta krahasuar me ato të dhëna për krime më të zakonshme të tilla si ato kundër pronës<sup>400</sup>.

Pavarësisht nga masat e përmendura më sipër, lindin dy zgjidhje, të cilat nuk e përjashtojnë njëra - tjetrën, për të inkurajuar ndëshkimin e duhur të korrupsionit.

Këto zgjidhje aplikohen veçanërisht kur përfshihen profesionet ligjore dhe nuk dëmtojnë pavarësinë e vendimmarrjes së gjyqtarëve në përzgjedhjen dhe vendosjen e sanksionit për çdo çështje të veçantë. Një nga këto zgjidhje ka natyrë *administrative* dhe përfshin hartimin e një instrumenti për përcaktimin e sanksioneve për krimet e korrupsionit, për të kufizuar diskrecionin e gjyqtarëve në përcaktimin e dënimeve në një çështje specifike. Ajo mund të vijë në formën e një përmbledhjeje të ligjit të çështjes, që paraqet sanksionet që vihen nga gjykata të ndryshme të nivelit të lartë për çështje të ngjashme, që kanë marrë dënime të formës së prerë gjatë viteve ose në formën e udhëzimeve faktike për dënimet, që disponohen në shtete të tjera, duke u sugjeruar gjyqtarëve kohëzgjatje të ndryshme dënimi për të cilët ata mund të vendosin, në varësi të rrethanave të caktuara në këto çështje<sup>401</sup>. Pas dënimit, gjyqtarët duhet të marrin

<sup>397</sup> Raporti i Komisionit Evropian në Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi progresin e Rumanisë për masat shoqëruese pas aderimit në [http://ec.europa.eu/dgs/secretariat\\_general/cvm/progress\\_reports\\_en.htm](http://ec.europa.eu/dgs/secretariat_general/cvm/progress_reports_en.htm).

<sup>398</sup> Raporti i Komisionit Evropian në Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi progresin e Rumanisë sipas mekanizmit të bashkëpunimit dhe verifikimit, gjendet në [http://ec.europa.eu/dgs/secretariat\\_general/cvm/docs/romania\\_report\\_20080723\\_ro.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/secretariat_general/cvm/docs/romania_report_20080723_ro.pdf). Në këtë raport, komisioni përmend pesë herë në gjashtë faqe nevojën e ndëshkimeve penguese në çështjet e korrupsionit.

<sup>399</sup> Përmbledhja e diskutimeve në seminarin "Për korrupsionin e nivelit të lartë dhe sanksionet e imponuara nga gjykata", Bukuresht, 19 nëntor 2007, fq. 3. Seminari u krye nga ABA/CEELI, me pjesëmarrjen e institutit kombëtar të magistraturës. Në këtë seminar morën pjesë 14 gjyqtarë nga dhoma penale e Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë. Përmbledhja gjendet në [www.csm1909.ro/csm/linkuri/28\\_01\\_2008\\_13794\\_ro.pdf](http://www.csm1909.ro/csm/linkuri/28_01_2008_13794_ro.pdf).

<sup>400</sup> Për vjedhjen e një çante me patate nga fusha, një grua u dënua përfundimisht me 1 vit burg pa pezullim - Evenimentul Zilei, 12 shkurt 2007, Justitia cu doua fete, në [www.evz.ro/article.php?artid=291833](http://www.evz.ro/article.php?artid=291833).

<sup>401</sup> Shih, për Anglinë dhe Uellsin [www.sentencing-guidelines.gov.uk](http://www.sentencing-guidelines.gov.uk), and for the USA, [www.ussc.gov/guidelin.htm](http://www.ussc.gov/guidelin.htm).

parasysh jo vetëm rrethanat specifike në të cilat u krye krimi dhe personalitetin e kriminelit, por edhe impaktin e prodhuar nga kryerja e krimit dhe rëndësia e pozicionit të kriminelit në kohën që u krye krimi. Për shembull, një kohëzgjatje dënimi e caktuar mund të vihet për një mitë prej 100 lei që i jepet një roje sigurie të spitalit në shkëmbim të hyrjes në spital jashtë orëve të vizitave, dhe një dënim krejt tjetër për një shumë të ngjashme që i jepet një gjyqtari në shkëmbim të përmbushjes (ose jo) të detyrës zyrtare. I njëjti sistem drejtpeshimi duhet të përdoret edhe për shumën e kompensimit. Rumanisë i mungojnë sot kriteret për këto vendime, si për dhënien edhe për llogaritjen e shumave, të cilat mund të kenë një efekt pengues mbi ata që dëshirojnë të raportojnë krime korrupsioni, në qoftë se krimineli ngre padi kundër tyre për dëmin e bërë për imazhin e tij/ të saj.

Nëpërmjet Vendimit të Qeverisë nr. 1346/2007, që miraton planin e veprimit për përmbushjen e standardeve në mekanizmin e bashkëpunimit dhe verifikimit për progresin e Rumanisë në reformën e gjyqësorit dhe në luftën kundër korrupsionit, botuar në Gazetën Zyrtare nr. 765 të datës 12.11.2007, autoritetet rumune morën përsipër detyrën e forcimit të kuadrit ligjor përkatës nëpërmjet vlerësimit të pavarur të mënyrës të përcaktimit të dënimeve të dhëna nga gjykatat për kategori krimesh në fushën ekonomike - financiare duke përfshirë krimet e korrupsionit. Analiza synonte të ndihmonte identifikimin e masave të nevojshme legislative dhe institucionale që duhet të merreshin nga Ministria e Drejtësisë deri në maj 2008 si afati i fundit. Pasi Komisioni Evropian paralajmëroi Rumaninë për mos përmbushjen e detyrimit, të paraqitur në raportin e 23 korrikut 2008, i cili u morr përsipër publikisht nga SCM, një grup fokusi u ngrit në këtë drejtim, i përbërë nga prokurorë e gjyqtarë, me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 2723/C i datës 21 tetor 2008. Grupit i duhet akoma që të përfundojë punën e tij.

Zgjidhja tjetër ka natyrë *legjislative* dhe përfshin rikonsiderimin e sistemit të dënimit. Duke pasur parasysh se sa më i lartë të jetë niveli maksimal i dënimeve për një krim, aq më pak kanë gjasë gjyqtarët që të priren për ta dhënë atë, dënimet e minimumit special për krimet e korrupsionit duhet të rriten në mënyrë që t'i shtyjnë gjyqtarët që të aplikojnë dënime që të janë më të ashpra se sa sot. Dënimi poshtë minimumit special (p.sh., duke përdorur rrethanat zbutëse) mund të ndalohen me ligj dhe po kështu mund të ndalohet dhënia e penaliteteve që janë alternativa të burgut. Rumania mund të ndjekë kështu shembullin e Sllovakisë, ku dënimi minimal për korrupsionin është burgu për 4 vite, me pezullimin e dënimit të ndaluar nga ligji. Kjo aplikohet pavarësisht në se mita iu ofrua një faktorinoje treni, një gjyqtari/prokurori apo një politikani.

**b. 2. Në lidhje me dënimet plotësuese,** legjislacioni rumun është më tolerant se sa diktojnë standardet ndërkombëtare, gjë që duhet rregulluar.

Kështu, pavarësisht nga dënimi standard, gjykatësit mund të japin një dënim plotësues për ndalimin e të drejtave të caktuara për një periudhë nga 1 - 10 vjet (nenin 64, Kodi Penal), specifikisht të drejtën për të mbajtur një *detyrë publike*; ose për të mbajtur një pozicion, praktik ose profesion, ose për të kryer një aktivitet *të një lloji që krimineli kryente para kryerjes së krimit*. Problemi është se për të aplikuar këto ndalime, duhet të plotësohen dy kushte:

- gjykata duhet të ketë dhënë ndëshkim me burg të paktën dy vjet. Megjithatë, siç u deklarua më sipër, gjatësia e sanksioneve specifike të aplikuar nga gjyqtarët për çështjet e korrupsionit në përgjithësi është e shkurtër, që është edhe arsyeja që një politikë e re penale duhet ta eliminojë këtë gjendje;

- ose ligji duhet të përcaktojë udhëzimet për zbatim të detyrueshëm të dënimeve komplementare ose gjyqtarët do të vlerësojnë nevojën për këto dënime në varësi të natyrës dhe gravitetit të krimit, rrethanave të çështjes dhe identitetit të kriminelit. Në lidhje me të parën, ligji parashikon ndëshkime të detyrueshme plotësuese vetëm për krimin e mitëdhënies, por ky rregullim duhet të zgjerohet për të përfshirë krime të tjera të korrupsionit. Në lidhje me hipotezën e fundit, në mënyrë që diskrecioni i gjyqtarëve duhet të eliminohet për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare sepse siç kemi parë në praktikë gjyqtarët jo vetëm që nuk japin masa plotësuese, por në 2/3 e çështjeve ata i pezullojnë dënimet me burg. Periudha e saktë për të cilën aplikohet ndalimi i të drejtave iu lihet gjithashtu gjyqtarëve plotësisht, e cila përsëri lë hapësirë për masa diskrecionare. Për këtë arsye, ligji duhet të paktën të përcaktojë kriteret për të udhëzuar gjyqtarët për përcaktimin e kohëzgjatjes së ndalimit.

Për çdo rast, për krimet e korrupsionit të kryera nga agjentët publik në gjyqësor, gjatësia e dënimit do të përcaktohet nga ligji si maksimum dhe ndalimi kundër mbajtjes së detyrave publike duhet të mbulojë çdo detyrë dhe profesion gjyqësor.

Vëmë re se për sa i përket gjyqtarëve/prokurorëve, janë përcaktuar rregulla speciale në ligjin nr. 161/2003. Sipas nenit 108 në ligjin "(1) Shkelja e dispozitave në nenin 101 - 105 dhe 107 përbën keqsjellje dhe duhet të ndëshkohet, në varësi të gravitetit të keqsjelljes me: a) pezullimin nga kryerja e detyrave publike për maksimumi 6 muaj; b) largimi nga gjykata ose prokuroria. (2) Sanksione disiplinore aplikohen nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës (...). (3) Një gjyqtar ose prokuror i larguar nga gjykata ose prokuroria *nuk do të ketë një pozicion të specializuar gjyqësor për 3 vjet*".

Në *Itali*, termi 'korrupsion', përkufizohet, në kuptimin e ngushtë, si lehtësimi ose premtimi nga një zyrtar publik i një përfitimi në shkëmbim të një favorit (të tillë si mitë), dhe në kuptimin më të gjerë, si disa veprime që çojnë në dëmtimin e buxhetit publik ose buxhetin e Bashkimit Evropian (duke përfshirë abuzimin me fondet publike, mashtrimin, etj). Për këtë lloj krimi, ekzistojnë sanksionet alternative përveç burgut, të tilla si ndalimi i aksesit për detyrat publike (ose përkohësisht, në qoftë se personi është i dënuar me burg më shumë se 3 vjet; ose përgjithmonë, në qoftë se personi është i dënuar me burg për më tepër se 5 vite); ndalimi i aksesit për pozicione drejtimi në sektorin privat; ose ndalimi i ndonjë lloji marrëdhënieje përfitimi në institucionet e administratës publike.

**b.3. Në lidhje me konfiskimin,** legjislacioni kombëtar rumun duhet të përmirësohet. Ligji aktual parashikon që paratë, mallrat me vlerë apo çdo aset tjetër që ka qenë objekt i një krimi korrupsioni duhet të konfiskohen dhe kur nuk mund të zbulohen, kriminelin i dënuar është i detyruar të paguajë vlerën e tyre ekuivalente. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, besojmë se nuk duhet konfiskuar vetëm asetit i marrë apo vlera e tij ekuivalente, por një shumë parash që përfaqëson dy ose tre herë vlerën e asetit. Ligji rumun parashikon gjithashtu se kriminelin nuk duhet të ndëshkohet për krimin e korrupsionit që ai/ajo ka kryer në qoftë se ai/ajo e raporton shkeljen tek autoritetet përpara se ata të njoftojnë organin e prokurorisë. Në këtë rast, paratë, mallrat me vlerë apo çdo aset tjetër që ka qenë objekt i krimit i kthehen pronarit fillestar.

Në praktikë, ka raste kur një kriminel e raporton shkeljen ose kur ai/ajo tashmë është ndjekur penalisht për krimet që lidhen me krimin në fjalë ose kur do të fillohet ndjekja penale. Në këto raste, në qoftë se asetet i përkasin palës denoncuese, besojmë se kriminelin nuk duhet të përfitojë nga kthimi i tyre, sipas ligjit.

Në të njëjtën drejtim, ligji rumun duhet të pasqyrojë rregullimet mbi konfiskimin e zgjeruar siç përcaktohet në vendimin kuadër të këshillit 2005/212/ JHA të 24 shkurtit



2005, mbi konfiskimin e të ardhurave, dobive dhe pronës së lidhur me krimin<sup>402</sup>. Sipas këtij dokumenti çdo shtet anëtar duhet të marrë masat e duhura për të mundësuar konfiskimin ose tërësisht ose pjesërisht, të dobive dhe të ardhurave nga veprat penale të ndëshkueshme me heqje lirie për më tepër se një vit ose pronën, vlera e të cilës korrespondon me këto të ardhura. Si të tilla, kompetencat për konfiskimin e zgjeruar duhet të implementohen. Minimumi, çdo shtet anëtar duhet të paktën të marrë masat e nevojshme që t'i mundësojë atij konfiskimin, tërësisht ose pjesërisht, të pronës që i përket një personi të dënuar për një krim në qoftë se gjykata kombëtare është plotësisht e bindur, bazuar në fakte specifike që asetet në fjalë janë të ardhura nga aktivitetet kriminale të kryera nga personi i dënuar gjatë një periudhe përpara dënimit që gjykohej e arsyeshme nga gjykata, duke konsideruar rrethanat e çështjes. Kur vendoset që vlera e pronës është e shpërpjesëtuar me të ardhurat e ligjshme të kriminelit të dënuar dhe një gjykatë kombëtare është plotësisht e bindur, bazuar në fakte specifike, se asetet në fjalë janë të ardhura nga aktivitetet kriminale të kryera nga kriminelit i dënuar atëherë kriminelit duhet ta lërë këtë pronë si gjobë.

**b.4. Në lidhje me masat e tjera.** Në mënyrë që të sigurohet një efekt pengues, ligjvënësit mund të përjashtojnë kriminelët e dënuar për korrupsion nga shërbimi i provës ose mund ta lënë atë në diskrecionin e gjyqtarit, siç e lejon sistemi ligjor anglosakson. Edhe periudha e rehabilitimit mund të jetë më e gjatë në rastin e krimeve të korrupsionit se sa për krimet e tjera.

#### **c. Sanksionet administrative**

Në lidhje me masat administrative, përgjegjshmëria e një punonjësi mund të pasqyrohet në rishikimet negative të punonjësit në lidhje me kompetencën profesionale dhe anulimin e akteve kur kjo është e mundur. Në mënyrë specifike, kur dyshimet për korrupsion janë të bazuara, agjenti publik duhet t'i hiqen çështjet mbi të cilat ai/ajo ka punuar, ose nëpërmjet zëvendësimit (p.sh., duke ndryshuar anëtarët e panelit), ose nëpërmjet caktimit të çështjes një agjenti tjetër publik. Në qoftë se punonjësi eventualisht konstatohet se është fajtor, siç u diskutua më sipër, mund të aplikohen masa të ndryshme, nga ndërprerja e punësimit pavarësisht nga krimi i kryer apo ndëshkimi i marrë deri në ndalimin e punësimit të mëtejshëm, në të njëjtën pozitë ose në një pozitë tjetër brenda të njëjtës sistem institucionesh, duke ia mbajtur si dënim pagën për pension apo përfitimet e tjera.

#### **d. Sanksionet e ligjit civil**

Në qoftë se krimet e korrupsionit të kryera nga stafi gjyqësor shkaktojnë dëme, do të përgjigjet për to jo vetëm agjenti publik individual në fjalë, por edhe punëdhënësi, për punësimin, vlerësimin dhe kontrollin e gabuar të agjentit. Përballja me një kërcënim të tillë do ta bëjë punëdhënësin që të procedojë me kujdes më të madh me kryerjen e detyrimeve të tij të drejtimit dhe inspektimit<sup>403</sup>.

<sup>402</sup> Botuar në Gazetën Zyrtare L 68/49 of 15.03.2005, pp. 58-61.

<sup>403</sup> Shih rekomandimin nr. R (84) 15 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me përgjegjësinë publike ("përgjegjësia e autoriteteve publike"), në ... rekomandimi thotë se për sa kohë që autoritetet publike i shërbejnë komunitetit, ata duhet të sigurojnë reparacionin e dëmeve të shkaktuara individëve. Mocioni për reparacionin duhet të depozitohet kundër autoritetit publik dhe jo kundër agjentit të tij; në qoftë se agjenti ka vepruar në mënyrë të paligjshme, autoriteti ka të drejtën që të ngrejë padi kundër agjentit.

## 5.5 Sanksionimi i konflikteve të interesit

Mosrespektimi i dispozitave në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit përbën shkelje. Nxjerrja e përfitimeve materiale nga rastet e shkeljeve përbëjnë një akt korrupsioni dhe duhet të njoftohen organet e ndjekjes penale.

Kur një person objekt i konfliktit të interesit megjithatë ka kryer aktet gjyqësore ose administrative, direkt ose nëpërmjet ndërmjetësve, këto akte bëhen të pavlefshme<sup>404</sup>.

Në lidhje me gjyqtarët/prokurorët, ka disa aspekte të veçanta që ia vlen t'i përmendim. Sipas nenit 60, paragrafi 3 në Ligjin nr. 144/ 2007, "Dispozitat në ligjin aktual në ligjin e verifikimin e konflikteve të interesit dhe zbulimin e papajtueshmërive, nuk aplikohen për gjyqtarët/prokurorët gjatë përcaktimit të çështjeve të pagjykuara në gjykatë dhe prokurori atashuar atyre, në lidhje me të cilët është ngritur një kundërshtim për konfliktin e interesit apo papajtueshmërinë". Dispozita u fut në ligj në mënyrë që të siguronte se procedura nuk përdoret si një mjet presioni apo ndërhyrje në aktivitetin e pavarur të gjyqtarëve gjatë përcaktimit të çështjeve specifike.

Në veçanti në lidhje vendimet e marra nga gjyqtarët të cilët kanë pasur konflikte interesi, palët mund t'i korrigjojnë/rishikojnë këto gjykime nëpërmjet procedurave të *zakonshme* të apelit, por vetëm në qoftë se ia kanë ngritur këtë kundërshtim gjyqtarit për çështjen, nëpërmjet një procedure për largimin e gjyqtarit. Kur palët kanë rënë dakord që çështja të dëgjohet nga një gjyqtar në konflikt interesi, ata nuk kanë të drejtë më vonë ta bëjnë këtë argument për të fituar një rigjykim. Gjyqtari/prokurori megjithatë, mund t'i nënshtrohen sanksionit disiplinor të aplikuar nga SCM për shkeljen e përcaktuar në nenin 99 (a) në ligjin nr. 303/2004, i cili trajton "Shkeljen e dispozitave ligjore në lidhje me raportimin e aseteve, interesave papajtueshmërive dhe ndalimeve në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët". Megjithatë, kur një gjyqtar i ka shteruar të gjitha rrugët e apelit pas dënimit për një krim që lidhet me një çështje që ai/ajo ka dhënë vendim (çështje ose civile ose penale) ose ka marrë sanksione disiplinore për të kryer detyrat e tij/të saj zyrtare në keqbesim ose me neglizhencë të rëndë (në çështjet civile) ka një opsion për të rihapur çështjen me anë të procedurës së *veçantë* të rishikimit<sup>405</sup>.

\*

Siç u theksua më sipër, nuk është e mjaftueshme thjesht ekzistenca e legjislacionit në lidhje me parandalimin dhe trajtimin e korrupsionit të personelit gjyqësor. Legjislacioni duhet të zbatohet. Dhe ndërsa kjo mund të ndodhë faktikisht në gjykatë, publiku duhet të jetë gjithashtu në gjendje që ta shikojë atë që të ndodhë.

Prandaj, përtej përpjekjeve legjislative për sigurimin e kuadrit të nevojshëm ligjor në luftën kundër korrupsionit, përtej përpjekjeve të menaxhimit gjyqësor për të miratuar masat administrative të nevojshme në parandalimin e korrupsionit dhe përtej përpjekjes së organeve gjyqësore kompetente për të luftuar korrupsionit nëpërmjet procedurave të shpejtuara dhe sanksioneve penguese, këto çështje dhe masa kanë nevojë edhe për publicitet. Përhapja e informacionit përkatës së pari duhet të ndodhë mes profesionistëve ligjorë, si një paralajmërim i pasojave të mundshme të sjelljes të padrejtë dhe për këtë arsye si një mjet parandalimi. Masa ose sanksione të caktuara

<sup>404</sup> Neni 45 në ligjin 144 të 21 majit 2007 mbi krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit.

<sup>405</sup> Neni 322, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile, neni 394, paragrafi 1 (d) Kodi i Procedurës Penale.

duhet t'i komunikohen publikut për të treguar gatishmërinë dhe rreptësinë e penalteteve që u vihen atyre që vetë janë thirrur për të sanksionuar korrupsionin në shoqëri. Efekti i menjëhershëm, padyshim do të jetë forcimi i besimit tek gjyqësori dhe një rënie në numrin e përpjekjeve për të korruptuar gjyqësorin dhe zyrtarët e tjerë.

Ligji rumun nuk duhet në asnjë mënyrë të lejojë *rishikimin* e gjyqeve<sup>406</sup> si pjesë e dënimit ose sanksioneve disiplinore të aplikuara për zyrtarët e përfshirë në marrjen e vendimit për çështjet, për aktet që lidhen me atë çështje. Aktualisht, kodi i procedurës penale parashikon një aplikim për rishikimin e gjykimit të formës së prerë lejohet kur anëtari i trupit gjykues prokurori ose punonjësi që ka kryer hetimin penal ka kryer një krim që lidhet me çështjen në të cilën aplikohet rishikimi, ose kur një dëshmitar, ekspert ose përkthyes ka kryer krimin e dëshmisë së rreme, në kushtin që këto krime të kenë çuar në një gjykim të paligjshëm ose të pabazuar (394). Në ligjin jopenal, Kodi i Procedurës Civile deklaron se rishikimi i një gjykimi që ka mbetur i formës së prerë në gjykatën e apelit ose që nuk është apeluar, si dhe një vendim i marrë nga gjykata kompetente në një apel mbi një pikë të ligjit, mund të kërkohet në qoftë se gjyqtari, dëshmitari ose eksperti që ka marrë pjesë në gjykim, është dënuar për një krim të lidhur me atë çështje ose gjyqtari/prokurori i është nënshtruar veprimit disiplinor për kryerjen e detyrave zyrtare brenda asaj çështjeje në keqbesim ose me neglizhencë të rëndë (neni 322). Vëmë re, për këtë arsye, një boshllëk rregullimi në ligjin penal, krahasuar me ligjin civil - ku një agjent publik i nënshtrohet *sanksionit disiplinor* për një krim të kryer gjatë vendosjes për një çështje specifike (p.sh., agjenti nuk e s'kualifikoi veten megjithëse ai/ajo kishte konflikt interesi ose agjenti e zbatoi ligjin në keqbesim), nuk ka mjete të disponueshme për ta rihapur një padi që ka marrë një vendim të formës së prerë. Ky aspekt do të trajtohet me mjete legjislative.

---

<sup>406</sup> Një mjet për të filluar një gjyq të ri mbi çështjen kur zbulohen prova të reja pasi është marrë vendimi i formës së prerë.

## KONKLUZIONE

Korrupsioni gjyqësor ka qenë një shqetësim që në kohët e vjetra. Në vitet e fundit, kjo temë është diskutuar gjerësisht sepse perceptohet si pengesa kryesore për vendosjen dhe respektimin e 'sundimit të ligjit', një parim që formon vetë themelin e çdo demokracie. Integriteti është një kërkesë për gjyqtarët/prokurorët që mund të përdoret si një mekanizëm për të rritur përgjegjshmërinë e tyre para publikut. Në qoftë se shteti u jep gjyqtarëve/prokurorëve pavarësi institucionale dhe kompetencat e duhura atëherë publiku natyrshëm do të presë profesionalizëm kompetencë dhe integritet nga ana e tyre.

Korrupsioni gjyqësor në vetvete është një kërcënim për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, e një gjykimi të drejtë. Ai është një sulm kundër të drejtave dhe lirive civile, kundër zhvillimit ekonomik të shteteve, kundër investimeve të huaja dhe kundër progresit të demokracisë. Korrupsioni gjyqësor është tërësisht i papërputhshëm me rolin e sistemit gjyqësor dhe e minon tërësisht atë rol - që është sigurimi i përputhshmërisë me ligjet dhe administrimin e drejtësisë në mënyrë të drejtë, efikase dhe të parashikueshme. Korrupsioni gjyqësor nuk është specifik për një shtet apo një rajon. Ai është një shqetësim global po efektet e tij janë më të thella në shtetet në zhvillim dhe tranzicion.

Në Rumani, korrupsioni nuk është një praktikë sistematike në gjyqësor. Megjithatë, çështjet konkrete të korrupsionit gjyqësor duhet të tërheqin vëmendjen e autoriteteve. Tani për tani, strategjia për luftën kundër korrupsionit gjyqësor nuk është hartuar akoma. Personeli gjyqësor nuk dëshiron jo vetëm programet antikorrupsion, por edhe diskutimet e thjeshta për këtë temë. Shumë shpesh, ata e mohojnë ekzistencën e fenomenit, madje edhe në nivelin më të përgjithshëm, në atë të shoqërisë. Nuk ka projekte private në këtë drejtim. Donatorët ndërkombëtarë nuk janë të interesuar për fushën e korrupsionit gjyqësor.

Lufta kundër korrupsionit gjyqësor nuk duhet të shikohet si një përpjekje me qëllim të ngushtë, por më tepër si një mjet për të reformuar sistemin. Një strategji kundër korrupsionit gjyqësor do të përfshijë fushata të rregullta me impakt të lartë, anketim të opinionit publik, organizimin e konferencave dhe grupeve të fokusit, mbështetje për publikimet mbi këtë temë, rregullimin e mekanizmave të përshtatshëm për të monitoruar sjelljen e personelit gjyqësor, rikonsiderimin e sistemit të punësimit të trajnimit në mënyrë që të reduktohet cenueshmëria ndaj korrupsionit, programet e trajnimit për etikën gjyqësore dhe rritja e transparencës në aktivitetin gjyqësor.

Toleranca për korrupsionin duhet të jetë zero. Reagimi kundër tij duhet të vijë fillimisht dhe kryesisht nga autoritetet shtetërore, të cilat kanë detyrën që të përcaktojnë instrumentet për parandalimin dhe luftën kundër tij si dhe nga publiku i cili duhet të kuptojë pasojat shkatërruese të këtij fshikullimi. Korrupsioni gjyqësor është i papranueshëm pavarësisht nga gama e tij. Mjetet për rritjen e ndjeshmërisë për rëndësinë e duhur që i duhet kushtuar luftës kundër korrupsionit, siç u diskutua në këtë punim, mund të ndihmojë për të vendosur respektin për ligjin dhe për qytetarët. Etika brenda shoqërisë dhe veçanërisht në botën ligjore duhet të shpërndalet, konsolidohet dhe të përditësohet në mënyrë konstante për të krijuar një infrastrukturë që sillet dhe reagon përkatësisht.

Kurset e organizimit gjyqësor aktualisht janë lëndë me zgjedhje në disa shkolla juridike. Konceptet e pavarësisë dhe paanshmërisë diskutohen shkurt në disa orë të procedurës penale dhe civile ose përfshihen në studimin teorik të mbrojtjes të të drejtave

të njeriut. Etika, sjellja dhe integriteti profesional studiohen vetëm në Institutin Kombëtar të Magjistraturës dhe vetëm si lëndë, jo si parime të jetës.

Ne besojmë fort se kufizimet e jashtme për gjyqtarët/prokurorët nuk janë të mjaftueshme që t'i bëjnë ata të adoptojnë një sjellje të përshtatshme. Qëllimi i luftës kundër korrupsionit mund të arrihet vetëm kur ai të rrënjoset tek gjyqtarët/prokurorët që kanë kuptuar rolin jetësor që ata luajnë në jetën e komunitetit - atë të vendosjes së drejtësisë dhe përputhjes me rregullat nga të gjithë qytetarët - duke iu kthyer shtyllave morale të shoqërisë demokratike.

Por kjo shkon përtej diskutimit për ligjin dhe organizimin gjyqësor. Kjo ka të bëjë me ndërgjegjshmërinë, pasionin, vokacionin - vërtet të rëndësishme për standardet e performancës. Ajo ka të bëjë me zbulimin e të vërtetës dhe pranimin e gabimeve - ka të bëjë me autenticitetin. Ka të bëjë me përqaftimin e realitetit dhe ndryshimit - e për këtë arsye me reformën e vërtetë.

Prandaj, korrupsioni duhet që t'i nënshtrohet reformës gjyqësore, e cila eventualisht duhet të çojë në forcimin e gjyqësorit dhe përmirësimin e performancave të tij.

## Shtojca I

### **Raport i Korrupsionit Global 2007<sup>407</sup>** **Përmbledhje: Çështjet kyçe të korrupsionit gjyqësor**

Korrupsioni po minon drejtësinë në shumë pjesë të botës, duke u mohuar viktimave dhe të akuzuarve të drejtën bazë njerëzore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ky është konkluzioni kritik i *Raportit për Korrupsionin Global të TI 2007*.

Është e vështirë të mbitheksohet impakti negativ i një gjyqësori të korruptuar: ai gërryen aftësinë e komunitetit ndërkombëtar që të trajtojë krimet transnacionale dhe terrorizmin; ai pakëson tregtinë, rritjen ekonomike dhe zhvillimin njerëzor; dhe ajo që është më e rëndësishme u mohon qytetarëve zgjidhjen e paanshme të mosmarrëveshjeve me fqinjët ose me autoritetet. Kur ndodh kjo e fundit, gjyqësori i korruptuar pëson frakturë dhe i ndan komunitetet duke mbajtur gjallë sensin e dëmtimit të krijuar nga trajtimi dhe ndërmjetësimi i padrejtë. Sistemet gjyqësore të poshtëruara nga korrupsioni minojnë besimin tek qeverisja duke lehtësuar korrupsionin në të gjithë sektorët e qeverisë, duke filluar nga timoni i pushtetit. Duke bërë këtë, njerëzve u dërgohet një mesazh i drejtpërdrejtë: Në këtë vend tolerohet korrupsioni.

#### **Përcaktimi i korrupsionit gjyqësor**

TI e përcakton korrupsionin si 'abuzim me pushtetin e besuar për përfitim privat'. Kjo do të thotë përfitime financiare ose përfitime materiale dhe përfitime jo materiale, si çuarja më tej e ambicieve politike ose profesionale. Korrupsioni gjyqësor përfshin çdo ndikim të padrejtë mbi paanësinë e procesit gjyqësor nga çdo aktor brenda sistemit të gjykatës.

Për shembull, një gjyqtar mund të lejojë ose përjashtojë provat me synimin e justifikimit të pushimit të çështjes për një të pandehur të fajshëm me status të lartë politik ose social. Gjyqtarët dhe stafi i gjykatës mund të manipulojnë datat e gjykimit për të favorizuar një palë ose një tjetër. Në vendet ku nuk mbahen procesverbale fjalë për fjalë, gjyqtarët mund ta përmbledhin procesin e gjykatës në mënyrë të pasaktë dhe të shtrembërojnë dëshminë e dëshmitarit përpara dhënies së vendimit që është blerë nga një palë e çështjes. Personeli i ri i gjykatës mund 'ta humbasë' një dosje - për një çmim. Pjesë të tjera të sistemit të drejtësisë mund të ndikojnë në korrupsionin gjyqësor. Çështjet penale mund të korruptohen përpara se të mbërrijnë në gjykata në qoftë se policia i manipulon provat që mbështetin akuzën penale ose prokuroria nuk zbaton kritere uniforme për provat e gjeneruara nga policia. Në vendet ku ndjekja penale ka monopolin për sjelljen e ndjekjeve penale para gjykatave, një prokuror i korruptuar mund të blloktojë efektivisht çdo rrugë për rregullim ligjor.

---

<sup>407</sup> Raport i Korrupsionit Global 2007, përmbledhje ekzekutive: probleme kyçe të korrupsionit gjyqësor. Raporti gjendet i plotë dhe i shkurtuar në [www.transparency.org/publications/gcr/gcr\\_2007](http://www.transparency.org/publications/gcr/gcr_2007).

Korrupsioni gjyqësor përfshin keqpërdorimin e fondeve të pakta publike që shumica e qeverive dëshirojnë t'ia alokojnë drejtësisë, e cila në termat politike rrallë është një prioritet i lartë. Për shembull, gjyqtarët mund të punësojnë anëtarë të familjes si staf në gjykatat ose zyrat e tyre dhe të manipulojnë kontratat për ndërtesat dhe pajisjet e gjykatës, korrupsioni gjyqësor shtrihet nga aktivitetet para gjyqit nëpërmjet procesit të gjyqit dhe zgjidhjes deri në zbatimin përfundimtar të vendimeve nga përmbaruesit e gjykatës.

Procesi i apelimit, dukshëm një rrugë e rëndësishme për të rregulluar vendimet e gabuara të çështjeve, paraqet mundësi të mëtjshme për korrupsion gjyqësor. Kur forcat dominuese politike kontrollojnë emërimin e gjyqtarëve madhorë, koncepti i apelimit tek një autoritet më pak i anshëm mund të jetë më tepër se sa një mirazh. Edhe kur emërimet janë të drejta, efektiviteti i procesit të apelit ulet në qoftë se kontrolli i kërkesave për seancat nuk është transparent ose kur përcaktimi i afateve të çështjeve do të thotë vite pritje për t'u dëgjuar. Apelimet tentojnë të favorizojnë palën me xhepat më të thellë, që do të thotë se një palë me burime të kufizuara, por me ankim legjitim, nuk mund të jetë në gjendje të ndjekë çështjen e saj përtej shkallës së parë.

### **Gama e korrupsionit gjyqësor**

Një dallim i rëndësishëm ekziston midis sistemeve gjyqësore që janë relativisht të lira, që janë relativisht pa korrupsion dhe atyre që vuajnë nga manipulimi sistemik. Treguesit e korrupsionit gjyqësor kanë një hartë me përmasa më të gjera të korrupsionit: Gjyqësori që vuan nga korrupsioni sistemik në përgjithësi gjendet në shoqëritë ku korrupsioni është pa fre kudo në sektorin publik. Ekziston dhe një korrelacion midis niveleve të korrupsionit gjyqësor dhe niveleve të rritjes ekonomike meqenëse është jetësore për investuesit pritshmëria që kontratat do të respektohen dhe mosmarrëveshjet do të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe që do të mbështetet zhvillimi i biznesit të shëndoshë dhe rritja. Një gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm ka pasoja të rëndësishme për tregtinë, investimin dhe tregjet financiare, siç kanë mësuar vende të ndryshme si Kina dhe Nigeria.

Qëllimi i sjelljes së korruptuar në sektorin gjyqësor ndryshon. Disa korrupsione shtrembërojnë procesin gjyqësor për të prodhuar një rezultat të padrejtë. Por ka shumë më tepër njerëz që korruptojnë për të naviguar ose përshpejtuar procesin gjyqësor drejt asaj që mund të jetë një rezultat i drejtë. Përfundimisht asnjëri nuk është i pranueshëm meqenëse viktimat në çdo rast është përdoruesi i gjykatës. Në mjediset më të këqija gjyqësore, megjithatë, të dy aktivitetet tolerohen dhe madje inkurajohen nga ata që punojnë përreth gjykatës. Barometri për Korrupsionin Global i TI 2006, anketoi 59,661 njerëz në 62 vende dhe konstatoi se në 1/3 e këtyre vendeve më tepër se 10% e të anketuarve që kishin ndërvepruar me sistemin gjyqësor pretendonin se ata ose një anëtar i familjes së tyre kishte paguar mitë për të marrë një rezultat 'të drejtë' në çështjen gjyqësore.

### **Llojet e korrupsionit gjyqësor**

Ka dy lloje të korrupsionit që ndikojnë më tepër gjyqësorin: ndërhyrja politike në proceset gjyqësore ose nga degët e ekzekutivit ose legjislativit të qeverisë dhe mita.

#### *A. Ndërhyrja politike në proceset gjyqësore*

Një konstatim dëshpërues i këtij volumi është se pavarësisht përpjekjeve për reformë të disa dekadave dhe instrumenteve ndërkombëtare që mbrojnë pavarësinë e gjyqësorit, gjyqtarët dhe personeli i gjykatës në të gjithë botën vazhdojnë të ndeshen me presionin për të vendosur në favor të enteve të fuqishme politike ose ekonomike, në vend të vendosjes sipas ligjit. Rrëshqitja mbrapa në standardet ndërkombëtare është e dukshme në disa vende. Pushtetet politike kanë rritur ndikimin e tyre mbi gjyqësorin, për shembull në Rusi dhe Argjentinë.

Një gjyqësor i përthyeshëm garanton mbrojtje 'ligjore' për ata që janë në pushtet për strategji të dyshimta ose të paligjshme të tilla si abuzimi me fondet, nepotizmin, privatizimet për miqtë ose vendimet politike që në të kundërt do të hasnin rezistencën në legjislaturë ose nga media. Në nëntor 2006, për shembull, një gjyqtar në Argjentinë i emëruar nga ish-presidenti Karlos Menem vendosi se shpenzimet e tepërta të fushatës nga partia në pushtet nuk kishte shkelur ligjin financiar të fushatës së 2002-it sepse partitë nuk përgjigjeshin për financimin 'për të cilin ato nuk ishin në dijeni'.

Ndërhyrja politike vjen me kërcënim, frikësim dhe korrupsion të thjeshtë të gjyqtarëve por edhe me manipulim të emërimeve gjyqësore, pagave dhe kushteve të shërbimit. Në Algjeri, gjyqtarët të cilët mendohet se janë 'tepër' të pavarur penalizohen dhe transferohen në vende të largëta. Në Kenia, gjyqtarëve iu bë presion që të jepnin dorëheqjen pa u informuar për pretendimet kundër tyre në një fushatë antikorrupsion, e cila u pa gjerësisht si një mjet i pershtatshëm politik. Gjyqtarët që perceptohen nga të fuqishmit si problematikë mund t'u ricaktohen pozicionet e ndjeshme ose mund t'u hiqet kontrolli mbi çështjet e ndjeshme dhe t'u transferohen zyrtarëve më të përthyeshëm. Kjo ishte një taktikë e përdorur në Peru nga ish presidenti Alberto Fuxhimori dhe që ndodh edhe në Sri Lanka.

Çelësi për të ndaluar këtë lloj korrupsioni janë mekanizmat kushtetues dhe ligjorë që mbrojnë gjyqtarët nga largimi ose transferimi i papritur pa përfitimin e hetimit të paanshëm. Kjo mbrojtje shkon shumë drejt sigurimit që gjykatat, gjyqtarët dhe gjykimet e tyre të jenë të pavarura nga ndikimet e jashtme.

Por mund të jetë po aq problematike në qoftë se gjyqtarëve u lejohet të mbrohen pas dispozitave të vjetruara të imunitetit, ligjeve të përçmimit drakonian ose nocioneve të kolegjalitetit, si në Turqi, Pakistan dhe Nepal respektivisht. Ajo që kërkohet është një drejtpeshim i kujdesshëm i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë dhe shumë më tepër transparencë se sa kanë pasur dëshirë të paraqesin shumica e qeverive dhe gjyqësorit.

Pavarësia e gjyqësorit i ka themelet tek besimi publik. Integriteti i perceptuar i institucionit është me rëndësi të veçantë, meqenëse ai mbështet besimin në institucion. Deri kohët e fundit, kreu i gjyqësorit britanik ishte njëkohësisht spikeri i dhomës së lartë të parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar dhe anëtar i ekzekutivit, gjë që paraqiste probleme të konfliktit të interesit. Në Shtetet e Bashkuara, zgjedhjet gjyqësore janë të dëmtuara nga shqetësimet se donacionet për fushatat e zgjedhjeve të gjyqtarëve në mënyrë të pashmangshme do të ndikojnë në marrjen e vendimeve gjyqësore.

Korrupsioni gjyqësor dhe politik përforcojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke. Aty ku sistemi i drejtësisë është i korruptuar, sanksionet mbi njerëzit që përdorin mitën dhe kërcënimet për t'i bërë politikanët të shkelin ligjin nuk kanë gjasë që të zbatohen. Degëzimet e kësaj dinamike janë të thella meqenëse ato pengojnë kandidatët më të ndershëm dhe pa pranga që të hyjnë apo të kenë sukses në politikë apo në shërbimin publik.



## **B. Mita**

Mita mund të ndodhë në çdo moment të ndërveprimit në sistemin gjyqësor: zyrtarët e gjykatës mund të nxjerrin para për punën që ata duhet të bëjnë sido që të jetë; avokatët mund të vendosin 'pagesa shtesë' për të përshpejtuar ose vonuar çështjet ose për të drejtuar klientët tek gjyqtarët që njihen se marrin mitë për të dhënë vendime të favorshme. Nga ana e tyre, gjyqtarët mund të pranojnë mitë për të vonuar ose përshpejtuar çështjet, mund të pranojnë ose të refuzojnë apelime, mund të ndikojnë gjyqtarët e tjerë ose thjesht mund të vendosin për një çështje në një mënyrë të caktuar. Studimet në këtë vëllim nga India dhe Bangladeshi detajojnë se si shtyrjet e stërzgjatura i detyrojnë njerëzit të paguajnë mitë për të përshpejtuar çështjet e tyre.

Kur të pandehurit ose palët në gjykim kanë tashmë një opinion të ulët për ndershmërinë e gjyqtarëve dhe për procesin gjyqësor ata kanë më shumë gjasë që t'i drejtohen dhënies së mitës për zyrtarët e gjykatës, avokatët dhe gjyqtarët për të arritur qëllimet e tyre.

Është e rëndësishme të mbajmë mend se gjyqësori formal trajton vetëm një pjesë të mosmarrëveshjeve në botën e zhvilluar, sistemet tradicionale ligjore apo proceset e drejtësisë administrative që kryhen nga shteti zënë rreth 90% të çështjeve jo ligjore në shumë pjesë të globit. Shumica e kërkimeve për sistemet zakonore ka theksuar rëndësinë e tyre si alternativa e vetme ndaj proceseve të zvarritura, të kushtueshme dhe të shartuara të qeverisë, por ato përmbajnë edhe elementë të korrupsionit dhe të formave të tjera të tendenciozitetit<sup>408</sup>. Për shembull në Bangladesh, ankuesve iu merren pagesa nga "sekserët" që pretendojnë se janë në gjendje të ndryshojnë vendimet e një paneli *shalish* të figurave vendore që thirren për të zgjidhur mosmarrëveshjet e komunitetit dhe për të vënë sanksione mbi ta. Veç kësaj, gratë nuk kanë gjasë që të kenë një akses të barabartë ndaj drejtësisë në kontekstin zakonor që i zvogëlon të drejtat e tyre njerëzore dhe ekonomike.

### **Trajtimi i korrupsionit gjyqësor**

Rishikimi nga ana jonë e 32 vendeve ilustron se korrupsioni gjyqësor merr forma të ndryshme dhe ndikohet nga shumë faktorë, qofshin ligjorë, socialë, kulturorë, ekonomikë apo politikë.

Poshtë këtyre kompleksiteteve në dukje ndodhen gjëra të zakonshme që tregojnë rrugën drejt reformës. Problemet e identifikuara më shpesh në studimet e vendit janë:

1. **Emërimet gjyqësore.** Mos emërimi i gjyqtarëve mbi bazën e meritave mund të çojë në përzgjedhjen e gjyqtarëve të përthyeshëm, të korruptueshëm.

2. **Termt dhe kushtet.** Rrogat e ulëta dhe kushtet e pasigurta të punës, duke përfshirë proceset e padrejta për promovimin dhe transferimit, si dhe mungesa e trajnimit të vazhduar për gjyqtarët, i çon gjyqtarët dhe personelin tjetër të gjykatës që të jenë të cenueshëm ndaj mitës.

### **3. Përgjegjshmëria dhe disiplina**

Proceset e padrejta ose joefektive për disiplinën dhe largimin e gjyqtarëve të korruptuar shpesh mund të çojë në largimin e gjyqtarëve të pavarur për arsye të interesave politike.

### **4. Transparenca**

Proceset opake të gjykatës e ndalojnë median dhe shoqërinë civile që të monitorojë aktivitetin e gjykatës dhe të ekspozojë korrupsionin gjyqësor.

---

<sup>408</sup> OECD/DAC rrjeti për konfliktin, paqen dhe bashkëpunimin për zhvillim, rritjen e dhënies së drejtësisë dhe sigurisë në shtetet e brishta, gusht 2006.

Këto pika kanë munguar në mënyrë të dukshme në shumë programe të reformës gjyqësore në dy dekadat e kaluara, të cilat janë prirë të fokusohen tek administrata e gjykatës dhe tek rritja e kapaciteteve, duke injoruar problemet që lidhen me pavarësinë dhe përgjegjshmërinë gjyqësore. Shumë para janë harxhuar duke trajnuar gjyqtarët pa trajtuar pritshmëritë dhe incentivat për gjyqtarët që ata të veprojnë me integritet. Janë shpenzuar para edhe për të automatizuar gjykatat ose përndryshe duke u përpjekur që të reduktohet ngarkesa e punës së gjykatave dhe të standardizohet menaxhimi i çështjeve të cilat, në qoftë se nuk shoqërohen me rritje të përgjegjshmërisë, kanë rrezikun që gjykatat e korruptuara t'i bëjnë më efikase në korrupsionin e tyre. Në Evropën Qendrore dhe Lindore, mos marrja parasysh plotësisht e kontekstit të shoqërisë, veçanërisht në vendet ku rjetet informale lejojnë që njerëzit t'i anashkalojnë proceset formale gjyqësore, i ka bërë virtualisht të pakuptimta disa ndryshime shumë të sofistikuara të institucioneve formale.

### **Rekomandime**

Rekomandimet e mëposhtme reflektojnë praktikën më të mirë për parandalimin e korrupsionit në sistemet gjyqësore dhe përmbledhin konkluzionet e nxjerra nga analiza e bërë gjatë gjithë këtij volumi. Ato adresojnë katër fusha problematike kyçe të identifikuara më sipër: emërimet gjyqësore, termat dhe kushtet, përgjegjshmëria dhe disiplina, transparenca<sup>409</sup>.

#### *Emërimet gjyqësore*

1. **Organi i pavarur i emërimeve të gjyqësorit.** Një proces objektiv dhe transparent për emërimin e gjyqtarëve siguron që të përzgjidhen vetëm kandidatët me cilësinë më të lartë dhe që ata të mos ndjehen të detyruar ndaj një politikani të veçantë apo një gjyqtari madhor që i ka emëruar ata. Në zemër të procesit është organi i emërimeve që vepron në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi dhe legjislatura, anëtarët e të cilit janë emëruar në një proces objektiv dhe transparent.

Përfaqësuesit nga degët ekzekutive dhe legjislative nuk duhet të formojnë shumicën në organin e emërimeve.

2. **Emërimet gjyqësore të bazuar tek merita.** Kriteret e zgjedhjes duhet të qarta dhe të publikuara mirë, që t'u lejojnë kandidatëve, përzgjedhësve dhe të tjerëve që të kuptojnë qartë se deri ku shkon steka për përzgjedhjen; kandidatëve duhet t'u kërkohet të demonstrojnë të dhënat për kompetencë dhe integritet.

3. **Pjesëmarrja e shoqërisë civile.** Grupe të shoqërisë civile, duke përfshirë shoqatat profesionale të lidhura me aktivitetet gjyqësore, duhet të konsultohen për meritat e kandidatëve.

#### *Termt dhe kushtet*

4. **Pagat gjyqësore.** Pagat duhet të jenë në përputhje me pozicionin e gjyqtarëve, përvojën, performancën dhe zhvillimin profesional të tyre për të gjithë kohën e qëndrimit në detyrë; pensione të mira duhet të jepen me daljen në pension.

---

<sup>409</sup> Rekomandimet mbështeten në një listë më të gjerë 'lista e kontrollit të t'i për Ruajtjen e Integritetit dhe Parandalimin e Korrupsionit në Sistemet Gjyqësore', që u hartua nga Kyela Leakey me kontributin e një numri të gjyqtarëve madhorë dhe ekspertëve të tjerë nga e gjithë bota. Këto disponohen nga TI.

5. **Mbrojtjet gjyqësore.** Ligjet duhet të mbrojnë pagat gjyqësore dhe kushtet e punës në mënyrë që ato të mos manipulohen nga ekzekutivi dhe legjislativi për të ndëshkuar gjyqtarët e pavarur dhe/ose për të shpërblyer ata që vendosin në favor të qeverisë.

6. **Transferimet gjyqësore.** Kriteret objektive që përcaktojnë emërimin e gjyqtarëve në gjykata të veçanta si vendndodhje sigurojnë që gjyqtarët e pavarur apo të pakorruptuar të mos ndëshkohen duke u dërguar në juridiksione të largëta. Gjyqtarët nuk duhet të emërohen në një gjykatë në një zonë ku ata kanë lidhje të afërta apo besnikëri ndaj politikanëve vendorë.

7. **Caktimet e çështjeve dhe drejtimi gjyqësor.** Caktimi i çështjes që bazohet në kriteret të qarta dhe objektive, administruar nga gjyqtarë dhe që vlerësohet rregullisht është një mbrojtje kundër caktimit të çështjeve gjyqtarëve që janë pro qeverisë apo pro biznesit.

8. **Aksesi ndaj informacionit dhe trajnimi.** Gjyqtarët duhet të kenë akses të lehtë ndaj legjislacionit, çështjeve dhe ndaj procedurave të gjykatës, dhe të marrin trajnimin fillestar përpara ose me emërimin, si dhe trajnim të vazhduar gjatë gjithë karrierës së tyre. Kjo përfshin trajnimin në analizën ligjore, shpjegimin e vendimeve, shkrimin e gjykimit dhe menaxhimin e çështjes, si dhe trajnimin etik dhe antikorrupsion.

9. **Siguria e qëndrimit në detyrë.** Siguria e qëndrimit në detyrë për gjyqtarët duhet të garantohet për rreth 10 vjet, pa iu nënshtruar rinovimit, meqenëse gjyqtarët tentojnë t'i përshtatin gjykimet dhe sjelljen e tyre nga fundi i afatit duke i paraprirë rinovimit.

#### *Përgjegjshmëria dhe disiplina*

10. **Imuniteti.** Imuniteti i kufizuar për veprimet që lidhen me detyrat gjyqësore u lejon gjyqtarëve që të marrin vendime pa pasur frikën e padisë civile; imuniteti nuk aplikohet në korrupsion apo në çështje të tjera penale.

11. **Procedurat disiplinore.** Rregullat disiplinore sigurojnë që gjyqësori të kryejë hetime fillestare rigorozë për të gjitha pretendimet. Një organ i pavarur duhet të hetojë ankesat kundër gjyqtarëve dhe të japë arsye për vendimet e tij.

12. **Procesi transparent dhe i drejtë i largimit.** Për largimin e gjyqtarit aplikohen standarde strikte dhe të përpikta. Mekanizmat e largimit të gjyqtarëve duhet të jenë të qarta, transparente dhe të drejta dhe duhet të jepen arsyet për vendime. Në qoftë se ka një konstatim korrupsioni, gjyqtari ndiqet penalisht.

13. **Proces i rregullt dhe rishikime të apelit.** Një gjyqtar ka të drejtën e një dëgjimi të drejtë, përfaqësimi ligjor dhe të një apeli të ndonjë çështje disiplinore.

14. **Kodi i sjelljes.** Një kod i sjelljes gjyqësore është një udhëzues dhe masë e sjelljes gjyqësore dhe duhet të zhvillohet dhe implementohet nga gjyqësori. Shkeljet duhet të hetohen dhe të sanksionohen nga organi gjyqësor.

15. **Politika e denoncimit.** Një procedurë konfidenciale dhe rigorozë për ankesat formale është jetësore në mënyrë që avokatët, përdoruesit e gjykatës, prokurorët, policia, media dhe shoqëria civile të mund të raportojnë shkeljet e dyshuara ose faktike të kodit të sjelljes ose korrupsionit nga gjyqtarët, administratorët e gjykatës ose avokatët.

16. **Shoqatë e fortë dhe e pavarur e gjyqtarëve.** Një shoqatë e pavarur e gjyqtarëve do të fajësojë anëtarët e saj në të gjitha ndërveprimet me shtetin dhe zyrat e saj. Ajo duhet të jetë një organ i zgjedhur; i arritshëm nga të gjithë gjyqtarët; të mbështetur gjyqtarët e veçantë për çështjet etike; dhe të shërbejë si një pikë e sigurt reference për gjyqtarët të cilët kanë frikë se ata mund të jenë kompromentuar.

## *Transparenca*

17. **Organizimi transparent.** Gjyqësori duhet të botojë raportet vjetore të aktiviteteve dhe shpenzimeve të tij dhe t'i japë publikut informacion të besueshëm për qeverisjen dhe organizimin e tij.

18. **Puna transparente.** Publikut i nevojitet akses i besueshëm ndaj informacionit që i përket ligjeve, ndryshimeve të propozuara në legjislacion, procedurave të gjykatës, gjykimeve, vendeve të punës së gjyqësorit, kritereve të punësimit, procedurave të përzgjedhjes gjyqësore dhe arsyet për emërimet gjyqësore.

19. **Shërbim transparent i ndjekjes penale.** Ndjekja penale do të kryejë procesin gjyqësor në publik (me përjashtime të kufizuara, për shembull, në lidhje me fëmijët); të publikojë arsyet për vendimet; dhe të prodhojë publikisht udhëzime të arritshme të ndjekjes penale për të drejtuar dhe asistuar vendimmarrësit gjatë kryerjes së ndjekjes penale.

20. **Raportimi i asetit gjyqësor.** Gjyqtarët duhet të bëjnë raportimin periodik të asetit veçanërisht kur zyrtarëve të tjerë publikë u kërkohet që ta bëjnë këtë gjë.

21. **Raportimi i konflikteve gjyqësore të interesit.** Gjyqtarët do të deklarojnë konfliktet e interesit sapo ata të bëhen të dukshëm dhe ta përjashtojnë veten kur janë (ose mund të duket se janë) tendenciozë ose të paragjykuar për një palë në çështje; kur më parë kanë shërbyer si avokatë ose dëshmitarë materialë në çështje; ose në qoftë se kanë një interes ekonomik në rezultatin e çështjes.

22. **Të drejta të publikuara gjerësisht për një proces të drejtë.** Mekanizmat institucional gjyqësor formal sigurojnë që palët që përdorin gjykatat të këshillohen ligjërisht mbi natyrën, shkallën dhe gamën e të drejtave dhe procedurave të tyre para, gjatë dhe pas procesit të gjykatës.

23. **Liria e shprehjes.** Gazetarët duhet të jenë në gjendje të komentojnë në mënyrë të drejtë për proceset ligjore dhe të raportojnë korrupsionin e dyshuar ose faktik ose tendencën. Ligjet që kriminalizojnë shpifjet ose që u japin gjyqtarëve diskrecionin që të caktojnë kompensime gjysmake në çështjet e shpifjeve e pengojnë median që të hetojë dhe raportojë kriminalitetin e dyshuar dhe kjo duhet reformuar.

24. **Cilësia e të komentuarit.** Gazetarët dhe botuesit duhet të trajnohen më mirë për të raportuar çfarë ndodh në gjykata dhe për paraqitjen e çështjeve ligjore para publikut të gjerë në një mënyrë të kuptueshme. Akademikët duhet të inkurajohen për të komentuar vendimet e gjykatës në revistat ligjore, në mos në media.

25. **Angazhimi i shoqërisë civile, kërkimi, monitorimi dhe raportimi.** Organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë për kuptimin e çështjeve që lidhen me korrupsionin gjyqësor duke monitoruar incidencën e korrupsionit si dhe treguesit potencial të korrupsionit, të tilla si vonesat dhe cilësia e vendimeve.

26. **Integriteti dhe transparenca e donatorit.** Programet e reformës gjyqësore duhet të trajtojnë problemin e korrupsionit gjyqësor. Donatorët duhet të njohin diagnozën, vlerësimin e proceseve të gjykatës dhe efikasitetin; dhe të angazhohen hapur me vendet partnere.

Këto rekomandime plotësojnë një numër standardesh ndërkombëtare për integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit si dhe modelet e ndryshme të monitorimit dhe raportimin që janë zhvilluar nga OJQ dhe ente qeveritare. Ato theksojnë një mungesë në kuadrin ligjor ndërkombëtar mbi mekanizmat e përgjegjshmërisë gjyqësore. TI i kushton vëmendje të veçantë Parimeve të Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore, një kod për gjyqtarët që është adoptuar nga një numër gjyqësorësh kombëtare dhe që u miratua nga Këshilli Ekonomik

dhe Social i OKB-së në vitin 2006. Parimet e Bangalorit plotësojnë në një farë mënyrë këtë mangësi, megjithëse ato mbeten vullnetare. Veç kësaj, Parimet Bazë të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit duhet të rishikohen nën dritën e shqetësimit të përhapur që është shfaqur në dekadën e fundit për nevojën e përgjegjshmërisë më të madhe të gjyqësorit.

Nuk ka ndonjë numër magjik të strukturave dhe praktikave që do të pakësonte korrupsionin në të gjitha situatat. Raportet e vendit në pjesën e dytë të këtij volumi theksojnë shumëllojshmërinë e rekomandimeve për reformën gjyqësore që janë specifike për kontekstin dhe për të këtë arsye nuk mund të aplikohen në mënyrë të përgjithshme. Situatat e ndryshme mund të krijojnë masa që nuk mund të ndihmojnë gjatë. Megjithatë, rekomandimet shërbejnë si udhëzues për të përpjekjet për reformë për të promovuar pavarësinë e gjyqësorit dhe përgjegjshmërinë dhe për të inkurajuar një zbatim më efektiv, efikas dhe të drejtë. Siç e demonstroi ky volum, reforma e shumëanshme, holistike e gjyqësorit është një hap themelor drejt rritjes së drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit që degradon sistemet ligjore dhe shkatërron jetët në të gjithë botën.

## **Aneksi II**

### **Pikëpamja e komisionerit për të drejtat e njeriut mbi korrupsionin në gjyqësor<sup>410</sup>.**

#### **"Korrupsioni shtrembëron sistemin e drejtësisë dhe dëmton njerëzit e varfër në veçanti"**

---

<sup>410</sup> "Korrupsioni shtrembëron sistemin e drejtësisë dhe dëmton njerëzit e varfër në veçanti" e 24 qershorit 2008. Kjo pikëpamje kohët e fundit është përsëritur nga komisioneri në punimin e tij "korrupsioni është një problem madhor i të drejtave të njeriut" që ai e paraqiti në konferencën e GRECO-s të 5 tetorit 2009. Iniciativa e ngritjes së këtij institucioni lindi në mbledhjen e dytë të nivelit të lartë të krerëve të shteteve dhe qeverive të Këshillit të Evropës mbajtur në Strasburg midis 10-11 tetorit 1997. Në 7 maj 1999, Komiteti i Ministrave miratoi Rezolutën (99) 50, e cila ngrinte zyrën e Komisionerit dhe krijonte atributet e tij. Në mënyrë që të veprojë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Komisioneri bën vizita, nxjerr raporte, bën ndërhyrje dhe komunikon pikëpamjet e tij. Komisioneri aktual, Thomas Hammarberg, e mori detyrën më 1 prill 2006. Selia e institucionit është [www.commissioner.coe.int](http://www.commissioner.coe.int)

[24/06/08]. Në disa vende evropiane është i përhapur besimi se gjyqësori është i korruptuar dhe se gjykatat tentojnë të favorizojnë njerëzit me para dhe kontakte. Megjithëse ky perceptim ndonjëherë mund të jetë i ekzagjeruar, ai duhet marrë seriozisht. Asnjë sistem drejtësie nuk është efektiv në qoftë se nuk besohet nga popullsia. Madje edhe më keq, ka tregues që tregojnë se dyshimet e njerëzve në disa raste janë mjaft të justifikuar.

Gjatë vizitave të mia në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, kam dëgjuar shpesh ankesa për korrupsionin që ndikon në komponentët kyç të sistemit të drejtësisë: gjyqësori, policia dhe shërbimi penitenciar.

Këto akuza mund të jenë pjesërisht propagandë e partive politike dhe në shumë raste janë të vështira për t'u verifikuar. Megjithatë, është bërë e qartë për mua se korrupsioni në sistemin gjyqësor është një problem serioz në disa vende evropiane - jo vetëm si perceptim por edhe si realitet konkret.

Në raportet nga vizitat e fundit, për këtë arsye unë e kam ngritur këtë problem dhe kam rekomanduar veprim të fortë. Një prej disa shembujsh është raporti për Shqipërinë (1) - ku qeveria i ka dhënë përparësi këtij problemi - po mua përsëri më u desh të konkludoja se "duhet të merren masa më efektive dhe efikase për të trajtuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë në mënyrë që të rivendoset besimi i publikut dhe të mundësohen gjykime të paanshme dhe procese të drejta".

Raporti për Azerbajxhanin (2) gjithashtu pranon se një numër masash ligjore dhe të tjera ishin marrë për t'i dhënë fund praktikave të korrupsionit. Megjithatë, disa aspekte të administrimit të drejtësisë ende duken se ndikohen nga interesat financiare. Konkludova se problemet e korrupsionit dhe varësia tek ekzekutivi ende pengonin drejtësinë e Azerbajxhanit "si në shumë vende në tranzicion të shpejtë nga ish-sistemi sovjetik".

Korrupsioni në sistemin e drejtësisë shpesh shkon krah për krah me ndërhyrjen politike. Ministrat dhe politikanët e tjerë udhëheqës nuk respektojnë gjithmonë pavarësinë e gjyqësorit dhe përkundrazi japin sinjale prokurorëve dhe gjyqtarëve nën dorë se çfarë priten që të vendosen. Efekti shtrembërues i këtyre praktikave është madje më i keq në vendet ku ka lidhje të ngushta midis udhëheqësve politikë dhe bizneseve të mëdha. Në këtë rast, lakmia priret t'ia hedhë drejtësisë.

Korrupsioni kërcënon të drejtat e njeriut dhe në veçanti të drejtat e të varfrit. Policët paguhen keq në disa vende dhe disa prej tyre përpiqen që ti shtojnë të ardhurat e tyre duke kërkuar mitë; rezultati është që njerëzit pa para trajtohen keq. Kam takuar të burgosur që nuk kanë pasur vizita nga familja sepse të afërmit nuk mund të paguanin pagesa jo zyrtare për të hyrë në burg.

Me trishtim, ka dhe raste të zyrtarëve të gjykatës që janë ndikuar nga paratë nën tavolinë ose nga favore të tjera më pak të dukshme, si premtime për karrierë. Ky është një shpjegim për gjyqet e stërzgatur në disa çështje dhe për procedura shumë të shkurtra nga disa të tjera.

Gjyqtarët duhet të paguhen mirë në mënyrë që të minimizojnë tundimin për këto praktika të korruptuara. Megjithatë, niveli i rrogave të larta është vetëm njëri aspekt i kësaj pamjeje dhe nuk është gjithmonë efektive (lakmia ndonjëherë synon të rritet me të ardhurat).

Ajo që nevojitet është një program gjithëpërfshirës, me prioritet të lartë për të zhdukur korrupsionin në të gjitha nivelet dhe në të gjitha institucionet publike. Nevojitet

gjithashtu që të reagohej qartë ndaj praktikave korruptive në bizneset private pasojat e të cilave tentojnë të shpërndahen në të gjithë sferën publike.

Baza për këtë duhet të jetë një legjislacion konciz që kriminalizon aktet e korrupsionit. Megjithatë, këto ligje në vetvete zor se i trajtojnë të gjitha problemet konkrete në këtë fushë. Është shumë e vështirë që të përcaktohet dimensionimi penal i disa praktikave korruptive, të tilla si nepotizmi dhe favoritizmi politik. Çështjet që lidhen me 'konfliktet e interesit' duhet të vlerësohen gjithashtu në kontekstet e tyre. Me fjalë të tjera, janë të domosdoshëm standardet më të fokusuara dhe mekanizma më efektivë për t'i ndjekur ato.

Procedura të qarta për rekrutimin, promovimin dhe karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë një domosdoshmëri dhe duhet të konfirmojnë murin mbrojtës midis partive politike dhe gjyqësorit. Siç e theksova në raportin për Ukrainën (3) procesi i emërimit të gjyqtarëve duhet të jetë transparent, i drejtë dhe i bazuar tek merita. Kërkesat në lidhje me integritetin e gjyqtarëve duhet të jenë pjesë e trajnimit të tyre dhe e procesit të rekrutimit të përcaktuar qartë dhe herët.

Kodet e sjelljes duhet të shërbejnë si mjete të dobishme për të rritur integritetin dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Standardet duhet të rregullojnë sjelljen në detyrë por edhe jashtë aktiviteteve dhe pagesën e tyre. Duhet të krijohen mekanizma të pavarur disiplinor për të trajtuar ankesat kundër zyrtarëve të gjykatës. Ata duhet të jenë në gjendje që të marrin dhe të hetojnë ankesat, të mbrojnë ankuesit nga hakmarrja dhe të parashikojnë sanksione efektive.

Përvoja është se këto procese nuk duhet të kryhen në një mjedis politik, por në vend të tij nëpërmjet një organi special dhe të pavarur brenda vetë sistemit gjyqësor - por përsëri me kërkesën që të mos lejohet asnjë ndikim i padrejtë duke përfshirë kolegët. Akuzat për korrupsion natyrisht duhet të hetohen nëpërmjet procedurave që janë të drejta në mënyrë skrupuloze.

Rekomandimet përkatëse i janë paraqitur grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO), një organ i iniciuar nga Këshilli i Evropës për të luftuar mitën, abuzimin me detyrën publike dhe praktikën korruptive të biznesit. GRECO ka zhvilluar gjithashtu një sistem për rishikimin e rregullt të masave antikorrupsion mes shteteve anëtare pjesëmarrëse; raportet e tij kanë inkurajuar reforma të rëndësishme në nivel kombëtar. (4)

Normat e detyrueshme ligjrisht për masat kundër korrupsionit përcaktohen nga disa traktate të rëndësishme ndërkombëtare të cilët duhet të përdoren si frymëzim për veprim kombëtar. Këshilli i Evropës ka miratuar Konventën e *Ligjit Penal për Korrupsionin* dhe *Konventën e Ligjit Civil për Korrupsionin*, të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2002 dhe 2003 përkatësisht (5). Është edhe *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit* e cila hyri në fuqi në 2005.

Një aspekt i theksuar në këto traktate është nevoja për të mbrojtur ata individë që raportojnë ndryshimin e tyre në mirëbesim brenda ose jashtë. Këta denoncues shpesh janë goditur nga hakmarrja - largimi nga puna ose më keq - që gjë nga ana tjetër mund të ketë bërë të tjerët që kanë pasur arsye për të raportuar që të heshtin. Edhe në qoftë se këto sanksione të hapura parandalohen, mbetet një problem se si të pengohen format më të holla të hakmarrjes, për shembull, mos promovimi ose izolimi.

Shumë skandale korrupsioni janë ekspozuar në media dhe liria e shprehjes është vërtetë kyçi në këtë luftë. Kjo është një arsye për se është e qenësishme që të promovohet liria dhe diversiteti i medias dhe të mbrohet pavarësia politike e medias së shërbimit publik. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka pranuar se shtypi është

një nga mjetet me anë të të cilit politikanët dhe opinioni publik mund të verifikojnë në se gjyqtarët i kryejnë përgjegjësitë e tyre të rënda në një mënyrë që të jetë në përputhje me detyrën që u është besuar atyre. (6)

Është e rëndësishme gjithashtu se legjislacioni i *Lirisë së Informacionit* promovon transparencën qeveritare. Publiku në parim duhet të ketë akses ndaj të gjithë informacionit që trajtohet në emër të tyre nga autoritetet. Konfidencialiteti natyrisht është i nevojshëm, për shembull, që të ruhet jeta private dhe të dhënat personale, por duhet të shihet si përjashtimor dhe duhet të përliqet. Megjithëse po bëhet progres për këtë në Evropë, transparenca ende nuk është rregulli i përgjithshëm.

Jo vetëm që qeveritë duhet të jenë transparente në mënyrë pasive, ato kanë detyrimin që të sigurojnë që publiku të ketë akses efektiv ndaj informacionit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se publiku duhet të ketë informacion për funksionimin e sistemit gjyqësor, që është një institucion i qenësishëm për çdo shoqëri demokratike. "Gjykatat, ashtu si të gjithë institucionet e tjera publike nuk kanë imunitet ndaj kritikës dhe hetimit". (7)

Kur raportova për Ukrainën, m'u desh të theksoja rëndësinë e kësaj transparence, "me përjashtim të gjykimeve të gjykatave të larta, vetëm një përqindje e vogël e vendimeve gjyqësore botohen. Të dhënat e sakta dhe të besueshme janë përjashtim".

*Parlamentarët* mund të luanin një rol veçanërisht të rëndësishëm në luftën kundër praktikave korruptive. Ata me siguri duhet të japin një shembull të mirë etik vetë dhe të deklarojnë hapur të ardhurat e tyre dhe asetet kapitale si dhe të gjithë aktivitetet përkatëse anësore, lidhjet dhe interesat. Më tej, ata mund të vepronin si gardianë të riskut të korrupsionit brenda administratës të qeverisë dhe të bëjnë pyetje që të tjerët mund ta kenë të vështirë tu përgjigjen. Ata mund të siguronin që legjislacioni dhe procedurat e mbikëqyrjes të ekzistonin dhe të funksiononin.

Disa nga *organizatat jo qeveritare* tashmë luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Në nivel kombëtar, Transparency International (TI) me seli në Berlin ka dhënë kontribute madhore dhe ka menaxhuar të inkurajojë Bankën Botërore që ta trajtojë problemin me seriozitet më të madh. TI tani ka seksione kombëtare në disa vende dhe disa grupe në nivel kombëtar të cilët ekspozojnë praktikrat e këqija dhe kërkojnë reforma kundër korrupsionit.

Ombudsmenët dhe strukturat e tjera të pavarura kombëtare për të drejtat e njeriut, në disa vende punojnë në mënyrë aktive kundër ndikimit të padrejtë dhe praktikave të tjera korruptuese. Shembuj janë mbrojtësit publikë në Gjeorgji dhe Armeni, të cilët kanë përshkruar se si njerëzit e varfër dhe të braktisur dëmtohen nga këto tendenca.

Të varfrit kanë nevojë për ndihmë ligjore, jo për presione për të paguar mitë. Ata kanë nevojë që të provohet se çdo njeri është i barabartë përpara ligjit. Ata kanë nevojë për një sistem drejtësie që të jetë i drejtë dhe i paanshëm.

Kjo është e drejta e tyre.

*Thomas Hammarberg*

Shënime

1. Raporti i komisionerit për të drejtat e njeriut për vizitën e tij në Shqipëri, 27 tetor - 2 nëntor 2007, CommDH(2008)8
2. Raporti i komisionerit për të drejtat e njeriut për vizitën e tij në Azerbajxhan, 30 - 7 shtator 2007, CommDH(2008)2



3. Raporti i komisionerit për të drejtat e njeriut për vizitën e tij në Ukrainë, 10-17 dhjetor 2006, CommDH(2008)2
4. Në maj 1998 Komiteti i Ministrave autorizoi krijimin e "Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit GRECO" në formën e një marrëveshjeje pjesore të zgjeruar dhe më 1 maj 1999, GRECO u krijua nga 17 anëtarë themelues. Tani ai ka 46 anëtarë.
5. Protokolli shtesë i Konventës së Ligjit Penal për Korrupsionin i cili hyri në fuqi më 2005, plotëson dispozitat e Konventës që synojnë të mbrojnë autoritetet gjyqësore nga korrupsioni.
6. Prager and Oberschlick, 26 prill 1995, paragrafi 34.
7. Skalka kundër Polonisë, 27 maj 2003, paragrafi 34.

### Aneksi III

#### **Gjykimet e formës së prerë të dënimeve në çështjet penale rumune për krimet e korrupsionit gjyqësor<sup>411</sup>.**

##### **Në 2005:**

Nëpërmjet gjykimit të formës së prerë, të pa apeluar nga çështja penale nr. 49 të 20 janarit 2005, tribunali i Bukureshtit, dhoma penale II, të pandehurit e dënuar V.I dhe V.R. me burgim me 5 vjet dhe 2 vjet përkatësisht, për krimin e tregtimit të influencës.

Midis korrikut dhe gushtit 2002, të pandehurit V.I. (një avokat në dhomën e avokatisë së Bukureshtit) dhe V.R. (agjent kryesor i inspektoratit të përgjithshëm të policisë rumune), në mënyrë të përsëritur pretendonin dhe merrnin nga G.I. para në shumën totale prej *31.000 USD*, duke nënkuptuar se ata mund të ndikonin tek gjyqtarët/prokuroret për të urdhëruar lirimin e të pandehurit G.R. I pandehuri V.I., duke ndjekur të njëjtën strategji kriminale, falsifikoi disa dokumente private (një kontratë asistence ligjore dhe fatura), të cilat përfshinin të dhëna false dhe nënshkrime të falsifikuara të G.I. me qëllimin e prodhimit të pasojave ligjore.

Në mars 2002, i pandehuri V.I. kërkoi dhe mori 6000 USD nga R.P. duke sugjeruar se ajo kishte ndikim mbi gjyqtarin që po kryente procesin penal kundër D.M. me synimin që të lirohej ky i fundit.

Nëpërmjet gjykimit nr. 559 të 14 korrikut 2004 nga tribunali Timis u konfirmua me vendimin nr. 2437 të 12 prillit 2005, të Gjykatës të Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, se të pandehurit I.R., L.F. u dënuan me burg 4 vjet secili, dhe N.GH. me 3 vjet dhe 6 muaj pasi gjykata konstatoi se ata kishin kërkuar dhe kishin marrë nga P.V. (administratori i shoqërisë S.C., I.C. dhe agjencia e udhëtimeve S.C., 'P' S.R.L.), rezervimin e biletave për tre pushime, për 6 vetë, në vendpushimet në Detin Adriatik dhe në Malin e Zi për gusht - shtator 2003, që kapnin shumën totale prej 1500 euro, në shkëmbim të mos aplikimit të gjobave të kundërvajtjes që shkonin nga 1 - 5 bilionë rol.

<sup>411</sup> Në hartimin e kësaj shtojce, ne u mbështetëm në referencat nga raportet e aktivitetit të NAD për vitet 2005- 2008 që gjenden në faqen e internetit të NAD [www.pna.ro/bilant.jsp](http://www.pna.ro/bilant.jsp), dhe dënimeve të formës së prerë të dhëna për çështjet e korrupsionit, të postuara në të njëjtën faqe interneti, në [www.pna.ro/hotarari.jsp](http://www.pna.ro/hotarari.jsp).

I pandehuri L.S. bashkë me nëntë të pandehur të tjerë u dënuan, nëpërmjet gjykimit në çështjen kriminale nr. 748/2003 të tribunalit Cluj, konfirmuar me vendimin nr. 1114 i 5 shkurtit 2005, i Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, me burg midis 3-4 vjet, për kryerjen e krimeve duke shkelur nenin 323, paragrafi (1) i Kodit Penal, bashkuar me nenin 17 (b) të ligjit nr. 78/2000, neni 254, paragrafi (2), bashkuar me nenin 7, paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal, neni 26, bashkuar me nenin 208, paragrafi (1), neni 209, paragrafi (1) a), g) dhe i) Kodi Penal, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) dhe nenin 13 të Kodit Penal, nenin 208, paragrafin (1) bashkë me nenin 209, paragrafi (1) a), g) dhe i) Kodi Penal, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) dhe nenin 13 të Kodit Penal.

Në vitin 1997 të pandehurit L.S., L.GH. dhe C.T., në cilësinë e tyre si punonjës të policisë, pranuan nga i pandehuri C.D. shuma të ndryshme parash, në shkëmbim të mos hartimit të raporteve të inspektimit dhe dokumenteve të ndjekjes penale kundër autorëve të vjedhjes së lëkurës në S.C. 'C' S.A. Cluj Napoca, për të siguruar mbrojtjen e zonës dhe transportimin e mallrave. Pas kryerjes së vjedhjeve, ata morën shuma të ndryshme parash.

#### **Në vitin 2006:**

Nëpërmjet gjykimit nr. 69/2005, të dhënë nga Gjykata e Apelit të Bukureshtit, Dhoma Penale I, në dosjen e çështjes nr. 4001/2004 (gjykim i lënë në fuqi me vendimin nr. 1669 të 15 marsit 2006 të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë), i pandehuri L.C.E. u dënua me burg **për 2 vjet e 6 muaj**, i pandehuri L.A. u dënua **me 1 vit e 6 muaj burg**, me pezullim të kushtëzuar të vendimit dhe i pandehuri T.P.M. u dënua me **1 vit burg** me pezullim të kushtëzuar të vendimit, për kryerjen e krimeve të parashikuara nga neni 257 i Kodit Penal bashkë me nenin 6 të ligjit nr. 78/2000, neni 264 Kodi Penal, neni 289 Kodi Penal bashkë me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) Kodi Penal dhe neni 25 bashkë me nenin 290, bashkë me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000.

U konstatua se e pandehura L.C.E., në cilësinë e saj si avokate e dhomës së avokatëve të Bukureshtit, më 27 maj 2003 i kërkoi 20.000 USD (nga të cilat ajo morri 11.000 USD) qytetarit iranian M.A. (i ndaluar dhe i akuzuar për krimin e trafikimit të paligjshëm të drogave) dhe nga bashkëshortja e tij. L.C.E. kishte pretenduar se ajo ishte në gjendje të ndikonte tek punonjësit e policisë dhe gjyqtarët në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë për të hartuar dokumente të ndjekjes penale (denoncim fiktiv i trafikantëve të tjerë të paligjshëm të drogës, etj) dhe që solli nenin 16 në ligjin nr. 143/2000, në bazë të të cilit i pandehuri do të përfitonte nga reduktimi i dënimit. I njëjti i pandehur më 3 qershor 2003, me qëllim i kërkoi M.M. që të hartonte një raport fals denoncimi (në lidhje me persona të tjerë të përfshirë në tregtinë e drogës). Më 29 tetor 2003, L.C.E. me qëllim bëri dëshmitar E.C., vuri një datë fiktive në raportin e denoncimit të përpiluar në emër të M.A. dhe detyroi M.M. të falsifikonte firmën e M.A. në atë raport. Veç kësaj, u lëshua nga prokuroria atashuar tribunalit të Bukureshtit memo nr. 5110/P/2003, që iu bashkëlidh dosjes së çështjes nr. 159/2003 të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë për të ndihmuar autorin e raportit inkriminues, M.A., që të pengonte gjyqin. E pandehura L.C.E. në cilësinë e saj si avokate në dhomën e avokatëve të Bukureshtit, në shtator 2003, kërkoi 10.000 USD nga të cilat mori 7500 USD) nga qytetari turk A.S. ( i ndaluar për trafikimin e paligjshëm të drogës), duke pretenduar se ajo kishte ndikim tek gjyqtarët në tribunalin e Bukureshtit që ta lironte A.S.

I pandehuri L.A., në cilësinë e tij si prokuror në prokurorinë pranë tribunalit të Bukureshtit në mënyrë të përsëritur dhe me të njëjtin synim penal, hartoi dëshminë e M.A., me datën 10 nëntor 2003 dhe nr. komunikimi 5110/P/2003, që vërtetonte rrethana të cilat nuk përputheshin me të vërtetën. Kjo u bë në lidhje me cilësinë e M.A. si autor i raportit inkriminues dhe me objektivin e fshehjes së krimit të tregtimit në influencë të kryer nga e pandehura L.C.E. L.C.E., me hartimin e dëshmisë dhe komunikimit, bëri deklarata që nuk ishin në përputhje me të vërtetën, me anë të të cilave ajo ndihmoi M.A.

I pandehuri T.P.M. në cilësinë e tij si oficer policie në zyrën e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës të sektorit 3 të policisë Bukuresht, kur hartoi një raport policor për krimin në flagrancë të 28 tetorit 2003, bëri deklarata false në lidhje me gjoja raportin inkriminues të M.A. kundër qytetarit turk Y.M.N. (i cili ishte raportuar se tregtonte drogë, dhe për këtë arsye e ndihmoi M.A. që të pengonte gjyqin.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 7/2005 (të marrë nga tribunali Dolj për çështjen nr. 2430/2004), që morri formë të prerë me vendimin nr. 94 të 10 janarit 2006, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, i pandehuri V.M. u dënua me 5 vjet burg për kryerjen e krimit të parashikuar nga neni 257 të Kodit Penal bashkë me nenin 6 të ligjit nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) të Kodit Penal.

E pandehura V.M. kërkoi në mënyrë të përsëritur dhe mori shumë prej 468,000,000 ROL nga T.GH., duke nënkuptuar se ajo kishte ndikim (qoftë direkt dhe nëpërmjet një avokati) tek disa gjyqtarë në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë dhe tek prokurori i përgjithshëm i prokurorisë të atashuar gjykatës. L.C.E nënkuptoi se ajo mund të siguronte që apeli nga ana ligjore do të pranohej dhe dënimi i të pandehurit T.D. (i cili ishte dënuar me 20 vjet burg) do të reduktohej dhe do të bëhej një apelim për anulimin.

\*

Nëpërmjet gjykimin në çështjen penale nr. 426/2004 të tribunalit Timis, i cili mori formë të prerë me vendimin nr. 630 të 1 shkurtit 2006, të dhomës penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë, të pandehurit J.M. dhe G.V. u dënuan **me 4 vjet burg secili**, I.S. dhe M.FD. u dënuan **me 2 vjet burg për secilin** (me pezullimin e kushtëzuar të vendimit), ndërsa C.L.C dhe B.I.M. u dënuan **me 3 vite burg secili** (me pezullimin e kushtëzuar të vendimit), për kryerjen e krimeve të parashikuara nga neni 254, paragrafi (1) i Kodit Penal, duke iu referuar nenit 6 në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal, neni 288, paragrafi (2) i Kodit Penal bashkë me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal, nenit 289, paragrafi (2) i Kodit Penal, bashkë me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) Kodi Penal, neni 26 në lidhje me nenin 254, paragrafi (1) i Kodit Penal, referuar nenit 6 në ligjin nr. 78/2000 dhe duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal, neni 288, paragrafi (2) i Kodit Penal, në lidhje me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal dhe nenin 26 bashkë me nenin 289, paragrafi (2) i Kodit Penal dhe nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal.

Në shkurt 2002, bazuar në një marrëveshje paraprake, e pandehura J.M. në cilësinë e saj **si sekretare** e shkollës juridike X dhe i pandehuri G.V. në cilësinë e tij **si këshilltar**

**i shoqërisë** për fondacionin, pranuan premtimin prej 3.500 USD secili nga të pandehurit I.S. dhe M.F. nëpërmjet të pandehurve C.C. dhe B.I. në shkëmbim të lëshimit të të dhënave akademike të falsifikuara që vërtetonin se këta të pandehur kishin mbaruar shkollën juridike. Të dhënat akademike të falsifikuara u përdorën nga të pandehurit I.S. dhe M.F. për të marrë provimin e gradës P.A. në shkollën juridike Crajova.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 37 të 15 marsit 2006 (për çështjen nr. 3629/2005 të Dhomës Penale II të Gjykatës së Apelit të Bukureshtit), i cili mori formë të prerë më tej me vendimin nr. 5366 të 19 shtatorit 2006, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, i pandehuri P.A. u dënua **me 4 vjet burg** (me provë të mbikëqyrur), për kryerjen e krimit të parashikuar në nenin 254 paragrafi (2) i Kodit Penal, bashkë me nenin 5, paragrafi (1) dhe nenin 7 paragrafi (1) i ligjit nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal.

Në cilësinë e tij si **kryekomisioner** i rajonit 17 të policisë të Bukureshtit, gjatë gjithë vitit 2005, i pandehuri P.A. kërkoi dhe morri nga F.V. shumat nga 100.000 ROL (gusht 2005) dhe 3.000.000 ROL (tetor 2005), në shkëmbim të një vendimi të favorshëm të hetimit penal me të cilin po punonte.

\*

Gjykata Ploiești e Apelit, nëpërmjet gjykimit të çështjes penale nr. 49/2005, që mori formë të prerë me vendimin nr. 1230 të 24 shkurtit 2006, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë e dënoi të pandehurin S.D. **me 3 vite burg** për 10 akuza mitëmarrjeje, në përputhje me nenin 254, paragrafi (2) i Kodit Penal bashkë me nenin 7 në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 33 a) të Kodit Penal.

I pandehuri S.D. në cilësinë e tij si **nënkomisioner i policisë** me kompetenca inspektimi, midis qershorit 2003 dhe janarit 2005, kërkoi 74,000,000 ROL nga disa individë (administratorë të shoqërive tregtare), në shkëmbim të mos hartimit të raporteve policore në lidhje me parregullsitë e zbuluara, si dhe mos kryerjes së inspektimeve në shoqëritë përkatëse.

\*

Gjykimi nr. 38/2005 i Gjykatës së Apelit Oradea, që mori formë të prerë me vendimin nr. 442 të 24 janarit 2006 të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, dënoi të pandehurit C.M. dhe D.M.S. **me 3 vite burg secili**, për kryerjen e krimeve të përcaktuara sipas nenit 254 paragrafi (1) dhe (2) i Kodit Penal, bashkë me nenin 6 dhe nenin 7.1 në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal.

Të pandehurit C.M. (**nënkomisioner**) dhe D.M.S. (**nëninspektor**) si zyrtarë publikë me kompetenca inspektimi midis 2 marsit 2004 dhe 11 marsit 2004 kërkuan më tepër se një herë shumën prej 3000 euro (që më vonë, pas 'negociatave', u ul në 700 euro) dhe morën 700 euro dhe 2,500,000 ROL (shuma e fundit përfaqësonte çmimin e vakteve në restorante të ndryshme) në shkëmbim të mos kryerjes së detyrës zyrtare gjatë një inspektimi në S.C. 'X' S.R.L., siç shënohet në raportin e policisë të datës 2 mars 2004.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 24 të 18 janarit 2005 të tribunalit Hunedoara, që mori formë të prerë me vendimin nr. 1246 të 27 shkurtit 2006, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë, i pandehuri S.V. u dënua **me 3 vite burg** (me pezullim të kushtëzuar të dënimit), për kryerjen e krimit të parashikuar në nenin 257, paragrafi (1) i Kodit Penal, bashkë me nenin 5 paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000, neni 215, paragrafi (1) i Kodit Penal dhe neni 290 i Kodit Penal.

Në cilësinë e tij si **komisioner** i Gardës Financiare, i pandehuri S.V. kërkonte dhe mori për të ushtruar ndikimin tek gjyqtari dhe tek një komisioner tjetër i gardës financiare shumë prej 99 milionë ROL nga C.M. (administratori i S.C. 'F' s.r.l.) në shkëmbim të ndihmës për C.M. që të fitonte padinë në gjykatë dhe për të bindur komisionerin tjetër që të mos inspektonte kompanitë e menaxhuara nga blerësi i influencës.

\*

Tribunali Iași, nëpërmjet gjykimit nr. 8333/2004, që mori formë të prerë me vendimin nr.5737 të 5 tetorit 2006, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë e dënoi të pandehurin S.O.C. **me burg për 2 vite e 6 muaj** (me pezullim të kushtëzuar të dënimit), për kryerjen e krimit të parashikuar në nenin 257 të Kodit Penal bashkë me nenin 6 d) në ligjin nr. 78/2000. Në korrik 2003, i pandehuri S.O.C. (**kryeinspektor** i policisë së kufirit Iasi) kërkoi dhe mori nga C.G. shumë prej 3000 euro në shkëmbim të premtimit për të rregulluar me punonjësit e Akademisë së Policisë në Bukuresht një notë mbi 8.50 në provimin B.A.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 296 të 10 tetorit 2005, i cili mori formë të prerë me vendimin nr. 49/A/2006 të Gjykatës së Apelit Oradea, i pandehuri M.C. u dënua me 4 vite burg për kryerjen e krimit të tregtimit në influencë, parashikuar në nenin 257 Kodi Penal bashkë me nenin 1 g) dhe nenin 6 në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 19 në ligjin nr. 503/2002. Gjykata shënoi gjithashtu se në vitin 2001 - 2002, M.C. kërkoi dhe mori shumë e 1 bilion ROL dhe 25.000 DM nga pala e dëmtuar C.V.R. dhe pretendoi se kishte influencë të tillë tek një gjyqtar i Gjykatës të Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë për ta bindur gjyqtarin ta marrë vendimin të favorshëm në një çështje penale në të cilën pala e dëmtuar ishte e pandehur.

\*

#### **Në vitin 2007:**

Nëpërmjet gjykimit nr. 126 të 29 marsit 2007 të tribunalit Arad (që u modifikua me gjykimin nr. 138 të datës 4 korrik 2007, të Gjykatës së Apelit Kimizoara dhe që mori formë të prerë me vendimin nr. 5850 të datës 5 dhjetor 2008 të HCCJ) i pandehuri T.S.D. u dënua me 4 vite burg për kryerjen e krimit të tregtimit në influencë siç përcaktohet në nenin 257 të Kodit Penal bashkë me nenin 5 të ligjit 78/2000.

Shënojmë se në 11 tetor 2000 i pandehuri, një avokat, pranoi 10.000 DM nga partneri i të dënuarit V.M. në shkëmbim të premtimit se me ndihmën e lidhjeve dhe

njohjeve që punojnë në Ministrinë e Drejtësisë, ai mund të rregullonte faljen e partnerit të V.M.

\*

Gjykimi nr. 483 i 21 prillit 2006, i Dhomës Penale II të tribunalit të Bukureshtit (që u modifikua nga Gjykata e Apelit Brazof, ku u transferua gjykimi sipas vendimit nr. 335 të 28 nëntorit 2006 dhe që mori formë të prerë me vendimin penal nr. 3035 të 06 qershorit 2007 të HCCJ) urdhëroi burgosjen e të pandehurit S.N. për 3 vite për kryerjen e krimit të tregtimit në influencë siç përcaktohet në nenin 257 të Kodit Penal, duke aplikuar nenin 6 në ligjin nr. 78/2000, me pezullim të kushtëzuar të dënimit nën mbikëqyrje<sup>412</sup>.

Gjykata shënoi se i pandehuri S.N. një **ish gjyqtar** që kish dalë në pension në 2003 nga Tribunali G, pranoi premtimet dhe mori nga informatori P.M.S. shumë prej 10.000 euro në 13 dhjetor 2004 në këmbim të rregullimit të anëtarëve të një trupi gjykues në tribunalin G që të merrte një gjykim të favorshëm për F.P., përfaqësuesi ligjor i të cilit ishte informuesi në çështjen e ligjit civil në lidhje me pavlefshmërinë e një titulli pronësie.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 85 të 29 majit 2006 të tribunalit Buzau (modifikuar me gjykimin nr. 369 të 18 dhjetorit 2006 nga Gjykata e apelit Ploiești dhe që mori formë të prerë me vendimin nr. 1911 të 5 prillit 2007 të Dhomës Penale të HCCJ) gjykata konstatoi se më 23 tetor 2004, bazuar në një marrëveshje paraprake midis palëve, i pandehuri B.N. i premtoi **prokurorit informues C.D.** shumë prej *10.000 euro, një ngarkesë vagoni me grurë dhe të drejtën që të përdorte një apartament pushimesh në Sinaja*, në shkëmbim të marrjes së një vendimi të favorshëm për bashkë të pandehurin D.D. në dosjen e çështjes nr. 50/P/2004 në zyrën antikorrupsion Slobozia, një vepër penale që përmban elementët përbërës të krimit të mitëdhënies siç përcaktohet në nenin 255, paragrafi (1) i Kodit Penal, duke aplikuar nenin 7, paragrafi (2) në ligjin nr. 78/2000, të kryer nga të pandehurit e sipërpërmendur, si autor dhe bashkautor përkatësisht.

Të pandehurit u dënuan **me 3 vite burg** secili, me një periudhë prove të mbikëqyrur prej gjashtë vitesh<sup>413</sup>.

Nëpërmjet gjykimit nr. 34 të datës 7 shtator 2006, të Gjykatës së Apelit Bacau (që morri formë të prerë me vendimin nr. 1420 të 14 marsit 2007, të Dhomës Penale të

<sup>412</sup> Në lidhje me zbatimin e dënimit, Gjykata e Apelit urdhëroi pezullimin me kusht të dënimit nën mbikëqyrje. Në apel, në një etapë të ligjit, HCCJ e ndryshoi këtë urdhër, me arsyet e mëposhtme: "qëllimi i dënimit nuk kërkon vuajtje të detyrueshme të kohës të burgut; megjithatë duke pasur parasysh se i pandehuri është 70 vjeç, është në pension dhe ka treguar sjellje normale qytetare, mbikëqyrja gjatë periudhës së provës nuk kërkohet dhe aplikimi i masave të mbikëqyrjes dhe detyrimit nga ana e kriminelit të dënuar nuk është më i përshtatshëm".

<sup>413</sup> Në lidhje me pozicionin e zyrtarit të korruptuar HCCJ ka shënuar: "duke konsideruar se Slobozia, prokuror i NAP nuk pretendoi për mitë që të nxirrte përfitime personale prej saj, por për të kontrolluar sjelljen e të pandehurve, atëherë siç duket, krimi i tyre përmban të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të krimit të mitëdhënies. Ndërsa është e vërtetë se mita nuk u dha sua sponte dhe iniciativa nuk i përket mitëdhënësve, kjo nuk ishte një çështje "shtytjeje" dhe nuk mund të shoqërohet me ndonjë kufizim, sepse ajo nuk e përjashton vullnetin e lirë të të pandehurve, të cilët premtuan para dhe përfitime të tjera në mënyrë që të identifikonin një zgjidhje për situatën në dizavantazh të bashkë të pandehurit D.D.".

HCCJ), i pandehuri S.M. u dënua për 4 akuza të tregtimit në influencë, siç përcaktohet në nenin 257, paragrafi (1) i Kodit Penal bashkë me nenin 6, 7, paragrafi (3) i ligjit nr. 78/2000, ribotuar, duke aplikuar nenin 74, paragrafi (2) i Kodit Penal dhe neni 76 c) i Kodit Penal, **me 1 vit e 10 muaj burg** gjithsej, me pezullim të kushtëzuar dënimi për 3 vite dhe 10 muaj.

Gjykata shënoi se S.M. në cilësinë e tij si **gjyqtar** i gjykatës së ligjit TM, i premtoi informatorit K.A. se ai do të ndërmernte veprime për t'i bindur kolegët e tij që ta lironin K.A. që priste gjyqin, dhe do të siguronte gjykime të favorshme në çështjet penale në të cilat i pandehuri i nënshtrohej procesit penal midis vitit 1988 - 2002. Në shkëmbim, ai pranoi përfitime dhe shërbime të ndryshme (pagesën e faturave për telefonin e tij celular; 3 piktura; faturat e restorantit për të pandehurin dhe miqtë e tij; shërbime për mirëmbajtjen e shtëpisë; pagesa të tatimeve dhe pagesa që i pandehuri i kishte borxh). I njëjti i pandehur S.M. si gjyqtar në tribunalin M, pranoi pagesën për vaktet e ndryshme në restorant nga informatori R.S. më tepër se një herë. Për të ndikuar kolegët gjyqtarë për të marrë një vendim të favorshëm në një padi civile për kthim prone S.C. I njëjti i pandehur në vjeshtë 2000 deri pranverë 2001, kërkoi nëpërmjet OAR shumën prej 1000 DM (nga të cilat mori vetëm 500 DM) nga informatori G, në shkëmbim të premtimit për të bindur kolegët e tij gjyqtarë që të jepnin një vendim të favorshëm në një çështje të ligjit civil nr. 2793/2001, që priste apelin në tribunalin M dhe në lidhje me kthimin e pronës së M.Z. Përfundimisht, i pandehuri S.M. morri nga informatori S.J., më 11 korrik 1997, nëpërmjet K.A., shumën prej 250 DM, në shkëmbim të premtimeve për të bindur oficerin e zbatimit të gjykatës OT për të zbatuar urdhrin e kthimit të pronës në lidhje me individët e sipërpërmendur<sup>414</sup>.

Dhoma Penale I e Gjykatës së Apelit Bukuresht, nëpërmjet gjykimit nr. 161 datë 11 tetor 2006 (që mori formë të prerë nëpërmjet vendimit nr. 1465 të datës 16 mars 2007 të Dhomës Penale të HCCJ), i dënoi të pandehurit P.F., P.V, B.R. dhe N.R. **me 7 vite, 6 vite, 5 vite dhe 4 vite burg**, përkatësisht, për kryerjen e këtyre krimeve siç parashikon neni 254, paragrafi (2) i Kodit Penal, bashkë me nenin 7 paragrafi (1) i ligjit nr. 78/2000 duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) Kodi Penal, në nenin 26 bashkë me nenin 254, paragrafi (2) i Kodit Penal dhe neni 7 paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000 duke aplikuar nenin 41 paragrafi (2) i Kodi Penal, në nenin 17 b) në ligjin nr. 78/2000 në lidhje me nenin 323 paragrafi (1) dhe (2) i Kodit Penal dhe në nenin 18 paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 33 a) të Kodit Penal.

Gjykata konstatoi se i pandehuri P.F. në cilësinë e tij si **kryeinspektor** në inspektoratin e policisë së qarkut Ilfov (shefi i departamentit të trajtimit të mashtrimit), me synimin kriminal, ndërsa kryente kontrole si pjesë e detyrave të tij zyrtare, në 4 raste kërkoi nëpërmjet të pandehurve B.R. dhe P.V. shuma që shkonin nga 6000 USD dhe 60.000 USD. Ai në 3 raste mori me bashkëfajësinë e të dy të pandehurve dhe të pandehurit N.R. shumën totale prej 18.000 USD dhe 1500 LEJ nga disa qytetarë kinezë që kishin marrë me qira magazina nga S.C. "Orient International Group" S.R.L., në

<sup>414</sup> Ja çfarë shpjegimi jep gjykata për dënimin e reduktuar: "I pandehuri S.M. është i ri, që punon aktualisht si avokat në dhomën e avokatisë M. Ai është i mirëarsimuar, ka lindur në një familje të nderuar: babai i të pandehurit, që ka vdekur, ishte gjyqtar, ndërsa nëna e të pandehurit ishte menaxhere dhe tani ka dalë në pension. I pandehuri S.M. vuan nga gjendja e zemrës. Duke marrë parasysh rrethanat dhe kushtet në të cilat janë kryer shkeljet, qëllimi i penaltetit siç përkufizohet në nenin 52 të Kodit Penal, gjykata është e mendimit se aplikimi i ndëshkimeve poshtë minimumit të parashikuar nga ligji dhe dhëni e rrethanave zbutëse, mund të ndihmojnë për parandalimin e krimeve të ardhshme dhe rehabilitimin e të pandehurit".

shkëmbim të mos vendosjes së gjobave për shkeljet në shoqëritë tregtare që ai po inspektonte. Gjatë së njëjtës periudhë, bashkë me të pandehurit B.R. dhe P.V., ai inicioi krijimin e grupit kriminal, që ai e përdorte për të kryer krimet e mitëmarrjes.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 164 të 24 tetorit 2006, Dhoma Penale II e Gjykatës së Apelit Bukuresht vendosi të dënojë të pandehurit M.F. dhe S.D.S. **me 3 vite burg** secili për kryerjen e krimit të parashikuar nga neni 254 paragrafi (1) i Kodit Penal në bashkim me nenin 6 dhe nenin 7 paragrafi (1) në ligjin 78/2000.

Të pandehurit M.F. dhe S.D.S. (komisionerë policie dhe nënkomisionerët përkatësisht, në departamentin e pastrimit të parave të drejtorisë së përgjithshme për luftën kundër krimin e organizuar në inspektoratin e përgjithshëm të policisë rumune), më 30 mars 2006, ndërsa kryenin detyrat e tyre zyrtare si **oficerë të policisë gjyqësore**, kryen inspektime në S.C. "L" S.A. dhe S.C. "A" S.R.L, bazuar në vendimin e delegimit të lëshuar nga drejtoria e hetimit të krimit të organizuar dhe krimet e terrorizmit të prokurorisë atashuar Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë. Në atë rast, ata kërkuan dhe morrën 10.000 euro secili nga informuesi P.P. (një aksioner në shoqërinë tregtare të lartpërmendur), në këmbim për të mos kryer disa procedura hetimi penale.

Dhoma Penale e Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë nëpërmjet vendimit nr. 228 të 16 janarit 2007, pranoi apelimin e depozituar nga drejtoria kombëtare antikorrupsion dhe i rriti dënimet për M.F. dhe S.D.S. **me nga 4 vite burg** secili.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 60 të 19 dhjetorit 2006, Gjykata e Apelit Brazov, urdhëroi pushimin e çështjes së të pandehurit M.F. për krimin e parashikuar në nenin 254 paragrafi (1) duke aplikuar nenin 13 të Kodit Penale.

Në fakt, i pandehuri M.F. atëherë **gjyqtar** dhe shefi i dhomës penale të tribunalit B., në këmbim të dhënies së një gjykimi të favorshëm në një çështje që përfshinte P.V. (që ishte dhe priste gjykimin për shantazh dhe shoqërim për qëllime kriminale) në korrik 1998 kërkoi dhe mori nga bashkëshortja e P.V. shumën totale prej 150.000 DM në tre këste, nëpërmjet M.C. Ai premtoi se do urdhëronte lirimin e P.V. dhe më vonë, në shkallën e apelit, do të pezullonte ekzekutimin e dënimit të tij<sup>415</sup>.

Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe të Drejtësisë nëpërmjet vendimit penal nr. 5134 të datës 31 tetor 2007 pranoi apelin në një pikë të ligjit të depozituar nga drejtoria

416

kombëtare antikorrupsion dhe e dënoi të pandehurin M.V. **me 4 vite burg** .

<sup>415</sup> Gjyqi filloi në 1998 dhe u mbyll në 2007.

<sup>416</sup> Në lidhje me dënimin, HCCJ shënoi: "Në lidhje me gjatësinë e dënimit dhe zbatimin e tij, gjykata e lartë do të marrë parasysh kriteret e përgjithshme për përcaktimin e dënimit siç parashikon neni 72 i Kodit Penal, përkatësisht kufijtë e dënimit të parashikuar nga ligji (nga 3-12 vjet), kërcënimin e rëndë shoqëror që paraqet vepra penale (d.m.th., minimi i kredibilitetit të gjyqësorit dhe dëmtimi i imazhit të tij të mirë), rrethanat specifike në të cilat është kryer vepra penale, siç përshkruhet më sipas dhe jo më pak, se cili është kriminelit (një ish gjyqtar 53 vjeç, i cili dha dorëheqjen si gjyqtar pas akuzave penale të inkurajimit e kriminelit, që trajtohen në një tjetër çështje penale dhe pa të dhëna penale të mëparshme. Duke i konsideruar këto kritere, Gjykata e Lartë do të vendosë një dënim me burg të orientuar jo aq shumë mbi minimumin special të parashikuar nga ligji, që do të kryhet në vendin e vuajtjes së dënimit, me arsyen se ky është i vemi mjet që do të mundësojë sigurimin e arritjes së qëllimit të përcaktuar në nenin



\*

Tribunali Prahova, nëpërmjet gjykimit nr. 473 të datës 31 tetor 2006, i dënoi të pandehurit A.M. me 5 vite burg, sipas nenit 257 të Kodit Penal, bashkuar me nenin 6 të ligjit nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 37 a) të Kodit Penal dhe A.A.S. me 3 vite burg, duke aplikuar nenin 861 të Kodit Penal, sipas nenit 257 të Kodit Penal në bashkim me nenin 6 të ligjit nr. 78/2000. Gjykata konstatoi se në janar 2006, të pandehurit A.M. dhe A.A.S pranuan premtimin e parave (për veten e tyre dhe persona të tjerë) nga G.N. në shkëmbim të bindjes së gjyqtarëve që ta pushonin çështjen e informuesit, në një çështje që priste para gjykatës së ligjit të Ploiești. Ata u kapën në 2 shkurt 2006 ndërsa pranonin 15.000 euro.

Gjykata e Apelit Ploiești, nëpërmjet vendimit të çështjes penale nr. 370 të 28 dhjetorit 2006, pranoi apelin e depozituar nga të pandehurit A.M. dhe A.A.S. dhe reduktoi dënimet për të pandehurit A.M. (nga 5 në 4 vite burg) dhe A.A.S. (nga 3 në 2 vite burg) dhe vendosi që ata të kryenin provë të mbikëqyrur. Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e drejtësisë nëpërmjet vendimit nr. 2343 të 2 majit 2007, e hodhi poshtë apelin e bërë nga dy të pandehurit.

\*

I pandehuri T.V.C. u dënua nga tribunali Satu Mare me vendimin nr. 575 të 17 tetorit 2006, **me 2 vite e 8 muaj burg**, për kryerjen e krimit të parashikuar në nenin 257 të Kodit Penal në bashkim me nenin 1 g) dhe nenin 6 të ligjit nr. 78/2000 dhe **me 3 vite burg** për kryerjen e krimit të parashikuar në nenin 23 c) në ligjin nr. 656/2002 në bashkim me nenin 17 e) dhe nenin 18 paragrafi (2) në ligjin nr. 78/2000; dhe në përputhje me nenin 33 a) dhe nenin 34 b) të Kodit Penal, gjykata urdhëroi që të kryente një dënim të bashkuar me 3 vite burg.

Nëpërmjet vendimit nr. 25/A/2007 të 13 shkurtit 2007, Gjykata e Apelit Oradea pranoi apelin e paraqitur nga drejtoria kombëtare antikorrupsion dhe i pandehuri T.V.C. dhe duke aplikuar nenin 19 të ligjit nr. 682/2002, dënimet e aplikuara për të pandehurin u reduktuan deri **në 2 vite burg** secili, duke e urdhëruar të pandehurin që të kryente vetëm këtë dënim. Në dëgjimin e apelit në pikat e ligjit të depozituar nga të pandehurit T.V.C, vepra penale e Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë nëpërmjet vendimit nr. 3615 të 5 korrikut 2007, i anuloi vendimet e përmendura, e ndau vendimin e bashkuar në dy komponentët e tij dhe vendosi që i pandehuri duhet të lirohej nga akuza sipas nenit 11 pika 2 a) në bashkim me nenin 10 d) i Kodit të Procedurës Penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 23 c) në ligjin nr. 656/2002, por gjithashtu i uli dënimin për tregtinë në influencë **me 2 vite burg** (dënim me burgosje pa pezullim).

Gjykata konstatoi se në dhjetor 2004, i pandehuri T.V.C. kërkoi 50.000 euro (nga të cilat mori 40.000 euro) nga informatori C.G., të cilin e bënë që të besonte se i pandehuri kishte një influencë të tillë tek prokurorët dhe zyrtarët e Gjykatës Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Financat Publike të Satu Mare, sa që do t'i bindte ata që të përfundonin hetimet kriminale dhe fiskale në mënyrë të favorshme për informatorin.

\*

---

*52 të Kodit Penal, përkatësisht riedukimin e të pandehurit, parandalimin e kryerjes së veprave të reja penale, si dhe kufizimet e duhura për shkeljen e ligjit penal".*

Nëpërmjet gjykimit nr. 90 të 14 nëntorit 2006 të lëshuar nga Gjykata e Apelit Galati, në çështjen penale nr. 1525/44/2006 (e cila mori formë të prerë me vendimin nr. 1812 të 2 prillit 2007, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë), të pandehurit A.D. dhe P.I. u dënua **me 4 vite burg** secili, me provë të mbikëqyrur, për kryerjen e krimeve të mitëmarrjes, siç përcaktohet në nenin 254, paragrafi (1) i Kodit Penal duke ju referuar nenit 6 dhe nenit 7 paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000 duke aplikuar nenin 41, paragrafi (2) i Kodit Penal.

Në gusht 2003 - prill 2004, të pandehurit A. D. dhe P.I. në mënyrë të përsëritur dhe me synimin e përbashkët penal, në cilësinë e tyre si **oficer policie** në byronë penale të hetimeve të departamentit të policisë të qytetit Vraila, kërkuan 3000 LEJ dhe morën 1.986 LEJ nga informatori P.J. në shkëmbim të vendimit të favorshëm në një hetim penal (pjesë e detyrave zyrtare të të pandehurve) në të cilin djali i informatorit P.J. ju nënshtroa hetimeve penale.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 88 të 4 dhjetorit 2006, të dhënë nga Gjykata e Apelit Ploiești në çështjen penale nr. 7470/200 (që mori formë të prerë me vendimin nr. 3487 të datës 27 qershor 2007 të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë), i pandehuri C.C.C. u dënua **me 3 vite burg**, me pezullim të kushtëzuar të dënimit, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 254, paragrafi (1), Kodi Penal, në bashkim me nenin 7, paragrafi (1) në ligjin nr. 78/2000.

Gjykata konstatoi se i pandehuri C.C.C., një gjyqtar i Gjykatës së ligjit PN, më 15 tetor 2004, kërkoi 700 euro nga informatori B.C.V., në këmbim të një gjykimi të favorshëm në çështjen penale që po zhvillohej për C.C.C. I pandehuri mori nga informatori shumën prej 500 euro më 8 tetor 2004, kohë në të cilën u kap duke marrë mitën.

#### **Në vitin 2008:**

Nëpërmjet gjykimit të çështjes penale nr. 972 të 29 qershorit 2007, të tribunalit të Bukureshtit, Dhoma Penale II, që mori formë të prerë me vendimit nr. 75 të 11 janarit 2008, të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, i pandehuri **E.L.** u dënua **me 9 vite burg për kryerjen e veprës penale përcaktuar në nenin 25 bashkuar me nenin 257 të Kodit Penal, duke iu referuar nenit në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 37 b) të Kodit Penal**, me një shtesë prej 3 vitesh dhe urdhëroi të kryente 12 vite burg.

Gjykata shënoi se në vitin 2001, ndërsa kryente dënimin me burg në burgun Jilava, i pandehuri E.L. kërkoi nga dëshmitari B.D. shumën prej 40.000 USD, nga të cilat mori 10.000 USD dhe e shtyu avokatin T.R. (që tregohet në një çështje më vete) kërkonte shumën të ndryshme parash nga B.D., dhe nga persona të tjerë. Ai la të kuptohej se kishte ndikim mbi gjyqtarët në tribunalin e Bukureshtit, gjë që do të siguronte gjykime të favorshme për kriminelë të ndryshëm të dënuar.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 52 të 28 marsit 2008, të Gjykatës së Apelit Dacau, që mori formë të prerë me vendimin nr. 2391 të 1 korrikut 2008 të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë, i pandehuri **B.A.** u dënua **me 4 vite burg (dënim për tu vuajtur në burg pa pezullim)**, sipas nenit 254 paragrafi (1) dhe (2) i Kodit Penal, në

bashkim me nenin 7 të ligjit nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 41 paragrafi (2) i Kodit Penal dhe i pandehuri **B.S.** u dënua **me 3 vite burg, me pezullim të kushtëzuar** të dënimit, sipas nenit 26 në bashkim me nenin 254 paragrafi (1) dhe (2) i Kodit Penal duke ju referuar nenit 7 në ligjin 78/2000, duke aplikuar nenin 41 paragrafi (2) i Kodit Penal.

Gjykata konstatoi se, midis korrikut 2003 dhe prillit 2006, e pandehura B.A. në cilësinë e saj si **prokurore madhore** në prokurorinë atashuar gjykatës, pranoi nga 8 persona nëpërmjet të pandehurit B.S. shumën prej *3900 euro* dhe *350 sterlina* në këmbim të udhëzimeve për të mos filluar ndjekjen penale në lidhje individë të caktuar.

Gjykata e Apelit të Bukureshtit, Dhoma Penale I, nëpërmjet gjykimit nr. 11 të 7 shkurtit 2008, që mori formë të prerë me vendimin nr. 3008 të 26 shtatorit 2008 të Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, dënoi të pandehurin **L.C.E. me 2 vite burg** sipas nenit 257 të Kodit Penal në bashkim me nenin 6 në ligjin nr. 78/2000. Duke marrë parasysh se vepra penale ishte kryer së bashku me veprat penale për të cilat i njëjti i pandehur kishte marrë një dënim me 2 vite e 6 muaj burg, gjykata urdhëroi që L.C.E të vuante vetëm **dënimin më të gjatë: 2 vite e 6 muaj.**

Gjykata shënoi faktin se i pandehuri L.C.E. në cilësinë e saj si **avokate**, midis majit dhe korrikut 2001 kërkoi dhe mori 12.000 USD nga 3 persona, duke ju thënë se ajo mund të rregullonte me gjyqtarët e gjykatës që të lironte një të pandehur të arrestuar.

\*

Gjykata e Apelit të Bukureshtit, Dhoma Penale I, nëpërmjet gjykimit nr. 195 të 8 tetorit 2007 (që mori formë të prerë me vendimin nr. 102 të 15 janarit 2008 nga HCCJ), e dënoi të pandehurin D.A., një **avokat** në dhomën e avokatëve të **Bukureshtit me 1 vit burg** për kryerjen e krimit të vazhdueshëm të tregtimit në influencë, të ndëshkueshëm sipas nenit 257 paragrafi (1) Kodi Penal, në bashkim me nenin 6 në ligjin nr. 78/2000 dhe nenin 19 në Udhëzimin e Qeverisë nr. 43/2002.

U konstatua se midis prillit 2006 dhe majit 2007 në cilësinë e tij si mbrojtës i informatorit E.H., D.A. në mënyrë të përsëritur kërkoi dhe mori 97,800 euro nga ky i fundit në këmbim të një vendimi të favorshëm në çështjen nr. 147/D/P/2006 të prokurorisë atashuar Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe të Drejtësisë - DIICOT, në të cilin dëshmitari informues ishte i pandehur. D.A. premtoi që ai mund të influenconte oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorin e çështjes; se ai mund të rregullonte që të lirohej informatori, dhe më pas t'i hiqej ndalimi për t'u larguar nga vendi; dhe që eventualisht ai mund të siguronte një gjykim të favorshëm të çështjes.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 200 të 1 tetorit 2007 të Gjykatës të Apelit të Bukureshtit (që mori formë të prerë me vendimin nr. 390 të datës 31 janar 2008 nga HCCJ), i pandehuri B.R. mori dënimin e bashkuar **me 3 vite burg** me provë të mbikëqyrur (në vend të burgut), për 4 akuza të mitëmarrjes në formën e parashikuar nga nenin 254 paragrafi (1), 2 Kodi Penal në bashkim me nenin 6 dhe 7 paragrafi (1) i ligjit nr. 78/2000, modifikuar dhe amenduar (palët e dëmtuara I.C.L., P.M., D.P., T.GH., B. V.); njëra nga akuzat e marrjes së përfitimeve të padrejta siç parashikohet nga neni 256 i Kodit Penal në bashkim me nenin 6 dhe 7 paragrafi (1) dhe (3) në ligjin nr. 78/2000 nga pala e dëmtuar L.I.; një akuzë për falsifikim, parashikuar në nenin 289 të Kodit Penal në bashkim me

nenin 17 c) në ligjin nr 78/2000, për palën e dëmtuar T.P.; dhe një akuzë për përdorimin e falsifikimeve siç përcakton neni 291 i Kodit Penal në bashkim me nenin 17 c) në ligjin nr. 78/2000, modifikuar dhe amenduar.

U deklarua se e pandehura B.R. në cilësinë e saj si prokurore madhore në prokurorinë e atashuar gjykatës PT, në mënyrë të përsëritur kërkonte dhe merrte nga persona të ndryshëm që u nënshtroheshin hetimeve për kryerjen e krimeve, para (500 euro, hua), shërbime (ridekorimin e shtëpisë të të pandehurës nga informatori), mallra (uiski, kafe, shampanjë, çokollata, produkte të tjera ushqimore), në këmbim të vendimeve të favorshme për ata persona. Në një situatë tjetër, pas marrjes së vendimit për çështjen, B.R. mori mallra të ndryshme nga personi për të cilin ishte nisur ndjekja penale, si shenjë vlerësimi. Në një situatë tjetër, B.R. pranoi zëvendësimin e fletës së të dhënave penale me një fletë të falsifikuar, me synimin që ndërprerja e ndjekjes penale kundër personit përkatës të dukej legjitime.

Në aktivitetet e saj kriminale, e pandehura vepronte ose vetë ose bashkë me të pandehurin B.B.I., bashkëshorti i saj, i cili ishte punonjës policie në zyrën policore PT. Ky i fundit u dënua gjithashtu me të njëjtin gjykim me **3 vite burg**, të pezulluar, por të mbetur nën mbikëqyrje.

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 377 të 16 tetorit 2006 të dhëna nga tribunali Suceava (modifikuar me vendimin nr. 62 të 30 majit 2007 të Dhomës Penale të Gjykatës së Apelit Suceava dhe që mori formë të prerë me vendimin nr. 500 të 11 shkurtit 2008 të HCCJ), të pandehurit S.M.L. dhe C.I.A. u dënuan **me 1 vit e 10 muaj burg** secili, për 2 akuza të tregtimit në influencë (S.M.L.) dhe një akuzë tjetër (C.I.A.), siç parashikohet në nenin 257 të Kodit Penal në bashkim me nenin 1 a) dhe nenin 6 në ligjin nr. 78/2000, duke aplikuar nenin 74 a), nenin 76 d) të Kodit Penal.

U konstatua se më 30 tetor 2003 e pandehura S.M.L. në cilësinë e saj si **avokate** në dhomën e avokatisë B, kërkoi dhe mori nga F.V. 1000 euro në këmbim për atë që ajo pretendonte se mund të ndikonte tek gjyqtari i gjykatës së apelit B për të siguruar një gjykim të nevojshëm për F.V. Më pas, përpara seancës së datës 05 shkurt 2004, S.M.L. rregulloi që F.V. të kontaktonte avokatin C.I.A. dhe i tha F.V. se ai duhet të paguante një shumë të caktuar parash për C.I.A., më anë të së cilës një gjyqtar tjetër në tribunalin B do të bindej që të jepte një gjykim të favorshëm. Për këtë, e pandehura S.M.L. u shpërblye nga C.I.A. me 200 euro. Nga ana e saj, e pandehura C.I.A. në cilësinë e saj si **avokate** në dhomën e avokatisë B, gjatë seancave të 5 shkurtit 2004 dhe 19 shkurtit 2004 kërkoi dhe mori 1500 euro për secilën, në total 3000 euro, nga F.V. që përmendet më sipër, që e bëri C.I.A. të besonte se gjyqtari i Tribunalit Bacau do të kontaktohej dhe bindej për të dhënë një gjykim të favorshëm<sup>417</sup>.

---

<sup>417</sup> Tribunali i kishte dënuar të pandehurit me 1 vit e 6 muaj burg secilin me arsyen se "Në dhënien e dënimit, iju kushtua vëmendje natyrës dhe nivelit të kërcënimit shoqëror të krimeve, pasojave që kishin lindur, përkatësisht shtrembërimi i marrëdhënieve shoqërore në lidhje me aktivitetet e gjykatave të ligjit, funksionimi i duhur i të cilave nuk përputhet me dyshimin se gjyqtarët mund të ndikohen në kryerjen e detyrave të tyre nga persona që kanë një influencë faktike ose të pretenduar mbi ta; rrethanat dhe mjetet e kryerjes së krimit, shumën e parave të mara nga informatorët, por edhe karakterin e të pandehurve, të cilët nuk kishin të dhëna kriminale të mëparshme, kishin sjelljen e duhur në të kaluarën, por nuk kishin pranuar se kishin kryer vepra penale". Në etapën e apelit, Gjykata e shtoi vendimin me 1 vit e 10 muaj: "Në lidhje me përcaktimin e dënimeve, Gjykata beson se ato duhen shtrënguar, duke pasur parasysh gravitetin e veprave penale, i rritur nga efekti i tyre dhe rezonanca e tyre sociale, por argumenton se

\*

Nëpërmjet gjykimit nr. 563 të 29 qershorit 2007 nga gjykata e ligjit Slatina (që mori formë të prerë me vendimin nr. 420 të 5 qershorit 2008 nga Gjykata e Apelit Crajova) i pandehuri J.S.A. u dënua **me 2 vite burg** me pezullim të kushtëzuar të dënimit sipas nenit 11 paragrafi (1) dhe (2) i ligjit nr. 78/2000.

Është shënuar se i pandehuri u emërua nga gjyqtari civil si likuidator dhe iu besua shitja kryesore e asetëve të S.C. A S.A. Corabia, me synimin e rikuperimit të parave që u kishte borxh kreditorëve. Pasi u krye procedura e ankandit, i pandehuri hartoi kontratën e shitjeve por përfshiu në listën e asetëve të shoqërisë një parcelë toke që nuk i përkiste shoqërisë.

\*

Me gjykimin nr. 522 të 24 tetorit 2006, dhënë nga Tribunali Dolj, modifikuar në etapën e apelit dhe më vonë në apel në pikën e ligjit me vendimin nr. 723/2008 të HÇJ, i pandehuri T.M. u dënua **me 1 vit burg**, të vuajtur si provë e mbikëqyrur, sipas nenit 257 të Kodit Penal, në bashkim me nenin 6 të ligjit nr. 78/2000.

Gjykata e shkallës së parë konstatoi se i pandehuri T.M. një **avokat** i dhomës së avokatisë Y, kërkonte dhe morri 100,000,000 ROL nga dëshmitari F.M. në shkëmbim të bindjes së dekanit të dhomës së avokatisë Y, që të lehtësonte pranimin e dëshmitarit si avokat në këtë dhomë. Rregullimi kuadër, në lidhje me organizimin e provimit të pranimit për profesionin e avokatit dhe të provimit për licencën për të praktikuar profesionin, lëshuar nga Këshilli i Shoqatës Kombëtare të Avokatëve në Rumani, deklaroi se dekani i dhomës së avokatisë është kryetari i komisionit të provimit të lartpërmendur dhe ka shumë kompetenca në lidhje me provimin për pranimin në profesionin e avokatit.

Nëpërmjet gjykimit nr. 61 të datës 6 mars 2007, të dhënë nga tribunali Gorj, modifikuar me vendimin nr. 123/2007 nga Gjykata e Apelit Crajova, dhoma penale, i pandehuri B.N. u dënua **me 3 vite burg** me pezullim të kushtëzuar të dënimit, për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 255 paragrafi (1) i Kodit Penal.

Në thelb, gjykata shënoi se i pandehuri akuzohej për mitëdhënie: më 8 janar 2006, ai i ofroi 1,000,000 ROL agjentit të policisë S.M. në shkëmbim të zgjidhjes së favorshme të një çështjeje penale dhe për anulimin e raportit të shkeljes. Në fakt, në ditën e mëparshme agjenti i policisë kishte konstatuar se i pandehuri pinte alkool në një bar në lokalitetin F. ndërsa ishte me detyrë në Guroren A në Seksionin e Rotorit , në

---

*rrethanat zbutëse, siç parashikon neni 74 a) i Kodit Penal mund të ruhen, duke marrë parasysh se të pandehurit janë të rinj, me perspektiva të padiskutueshme rehabilitimi dhe me sjellje të lavdërueshme para kryerjes së krimeve. Ata kanë pasur një performancë profesionale të shquar, një jetë familjare të shëndoshë dhe dënimi me burg, në vetvete, është një paralajmërim mjaft i fuqishëm që të sigurojë përputhshmërinë e tyre me sundimin e ligjit në të ardhmen".*

Kompleksin Energjetik. I pandehuri ju nënshtrua gjithashtu penaliteteve për shkeljen sipas ligjit nr. 61/1991 për shkak të sjelljes së tij të parregullt në atë rast<sup>418</sup>.

## Bibliografi

### *Monografi*

ABRAHAM, Pavel, Coruptia, Detectiv, Bukuresht, 2005

APOSTOL TOFAN, Dana, Puterea discretionara si excesul de putere al autoritatilor publice, All Beck, Bukuresht, 1999

BANCIU, Dan, Sociologie juridica, Lumina Lex, Bukuresht, 2007

BANCIU, Dan, DORINICA, Ioan, RADULESCU, Sorin M., Coruptia in România. Realitate si perceptie sociala, Lumina Lex, Bukuresht, 2005

CAMPOS, J. Edgardo, PRADHAN, Sanjay, Fytyrat e Shumta të Korrupsionit: në gjurmë të cenueshmërive në nivel sektori, Banka Botërore, 2007

CASUNEANU, Costel, DOBRINOIU, Vasile, HOTCA, Mihai-Adrian, MUREA, Marius, NEAGU, Norel, Legea nr. 78/2000 pentru prevenirea, descoperirea si sanctionarea faptelor de coruptie, Wolters Kluwer, Bukuresht, 2009

CHERCIU, Elena, Coruptia. Caracteristici si particularitati în România, Lumina Lex, Bukuresht, 2004

CIUNCAN, Dorin, Prevenirea, descoperirea si sanctionarea faptelor de coruptie. Legea nr. 78/2000 comentata si adnotata, Edicion suplementar, "Buletin documentar", Bukuresht, 2004

COCHINESCU, Nicolae, Introducere în deontologia juridica, magazine Dreptul nr. 4/1995, fq .3-11

COMAN, Ramona, Media, Drejtësia dhe Politika ose si u bë Pavarësia e Gjyqësorit çështje e axhendës politike rumune, në Reformat Gjyqësore dhe Vendet e Evropës Juglindore, Vanden Broele Publishers, Brugge, 2007, fq. 157-198

COPOERU, Ion, Coordonate ale profilului moral al magistratului. Studiu de caz cu privire la implementarea Codului deontologic al judecatorilor si procurorilor din România, in COPOERU, Ion, SZABO, Nicoleta (eds.), "Dileme morale si autonomie în

---

<sup>418</sup> "Të dhënat e vendimeve – të veprave penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin ekonomik – financiar", postuar në 13 mars 2009 në [www.csm1909.ro/csm/linkuri/13\\_03\\_2009\\_\\_21723\\_ro.pdf](http://www.csm1909.ro/csm/linkuri/13_03_2009__21723_ro.pdf).

contextul democratizării și al integrării europene”, Casa Cartii de Stiinta, Cluj-Napoca, 2007, fq. 215-243

COSTINIU, Florin (ed.), Codul deontologic al magistratilor. Ghid de aplicare, Hamangiu, Bukuresht, 2007.

DAKOLIS, Maria, THACHUS, Kim, Sulmi ndaj Korrupsionit në Gjyqësor: Një Proces Kritik në Reformën e Gjyqësorit, Wisconsin International Law Journal, 18, 2000, fq.353-405

DANILET, Cristi, Mecanisme de coruptie și politici anticoruptie în sistemua juridic, in Ion Copoeru, Nicoleta Szabo (eds.), “Etica și cultura profesionale”, Casa Cartii de Stiinta, Cluj-Napoca, 2008, fq. 218-255.

DIACONESCU, Horia, Infractionile de coruptie și cele asimilate sau în legatura cu coruptia, All Beck, Bukuresht, 2004

DOBRINOIU, Vasile, Coruptia în dreptul penal român, Atlas Lex, Bukuresht, 1995

HAMMERGREN, Linn, Bankat Shumëpalëshe të Zhvillimit dhe Korrupsioni Gjyqësor, <http://siteresources.worldbank.org>

KLITGAARD, Robert, MACLEAN-ABAROA, Ronald, PARRIS, H. Lindsey, Orase corupte. Ghid practic de tratament și prevenire, Humanitas, Bukuresht, 2006

KRASTEV, Ivan, Ndryshimi i Obsesioneve: Tri Ese për Politikën e Antikorrupsionit, Central European University Press, Budapest, 2004

LUCA, Catalin (ed.), PIVNICERU, Mona, Deontologia profesiei de magistrat. Repere contemporane, Hamangiu, Bukuresht, 2008

MANIKAS, Peter M., Background Note: Lufta kundër Korrupsionit në Sistemin Gjyqësor në Qarkun Cook, Illinois, 1999, në <http://siteresources.worldbank.org>

MOGÂLDEA, Ion, Coruptia în România, Majadahonda, Bukuresht, 1998

PEPYS, Mary Noel, Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor, USAID, 2003, [www.ssronline.org](http://www.ssronline.org)

POPE, Jeremy, Sisteme de integritate publice, 1997, përkthim i TI-RO, 2002, në [www.transparency.org.ro](http://www.transparency.org.ro)

REED, Quentin, Ulur Mbi Gardh: Konfliktet e interesit dhe si rregullohen ato, 2008, në [www.u4.no](http://www.u4.no)

SHARMAN, Jeffrey M., Etika Gjyqësore: Pavarësia, Paanshmëria, dhe Integriteti, Inter-American Development Bank, maj 19-22, 1996

VEDINAS, Verginia, Deontologia vietii publice, Universul Juridic, Bukuresht, 2007

WALLACE, Judge J. Clifford, Zgjidhja e Korrupsionit Gjyqësor Duke Ruajtur Pavarësinë e Gjyqësorit: Perspektiva Krahasuese, California Western International Law Journal, 28 (2), 1998, fq.341-350

### *Studime, artikuj*

Shoqata Amerikane e Avokatëve Iniciativa Ligjore e Azisë, Lufta kundër Korrupsionit në Sistemin e Drejtësisë Penale, në [www.abanet.org](http://www.abanet.org)

Centrul de Resurse Juridice, Coruptia în Justitie, 2004, në [www.crj.ro](http://www.crj.ro)

Centrul de Resurse Juridice, Ghid anticoruptie – monitorizarea conflictelor de interese si a incompatibilitatilor, Bukuresht, 2005, në [www.crj.ro](http://www.crj.ro)

Centrul de Resurse Juridice, Instrumente de monitorizare a institutiilor anticoruptie, 2006, në [www.crj.ro](http://www.crj.ro).

Procesi i Duhur i Themelimit të Ligjit, Udhëzim për Vlerësimin e Shpejtë dhe Politikëbërjen për Kontrollin e Korrupsionit në Sistemet e Drejtësisë së Amerikës Latine, 2007, në [www.dplf.org](http://www.dplf.org)

Institutul de Politici Publike, Ghid privind procedurile de sesizare a neregulilor în procesul de achizitii publike si sesizarea conflictelor de interese, a incompatibilitatilor, faptelor de coruptie si ãmbogatirii ilicite, 2006, në [www.ipp.ro](http://www.ipp.ro)

Institutul pentru o Societate Deschisa, Monitorizarea procesului de aderare la Uniunea Europeana: Coruptia si politicile de combatere a coruptiei, Exclus SRL publishers, Bukuresht, 2002.

SIGMA, Politici si practici privind conflictul de interese în noua state membre UE: o analiza comparativa, 2006, në [www.sigmaweb.org](http://www.sigmaweb.org)

Transparency International, Raporti i Korrupsionit Global 2007: Korrupsioni në Sistemet Gjyqësore, 2007, në [www.transparency.org](http://www.transparency.org)

Transparency International - Rumani, Etika Profesionale dhe Transparenca në Administratën Publike, 2006, në [www.transparency.org.ro](http://www.transparency.org.ro)

Transparency International - Rumani, Integriteti në gjyqësor. Punim për Strategjinë, 2006, në [www.transparency.org.ro](http://www.transparency.org.ro)

PNUD, Marrëveshjet Ndërkombëtare për Luftën kundër Korrupsionit. Studim Krahasues, 2005, në <http://regionalcentrebangkok.undp.or.th>

UNODC, Korrupsioni Gjyqësor në Vendet në Zhvillim: Shkaqet e tij dhe Pasojat Ekonomike, 2001, në [www.unodc.org](http://www.unodc.org)



UNODC, Forcimi i Integritetit Gjyqësor Kundër Korrupsionit, 2000, në [www.unodc.org](http://www.unodc.org)

***Burime në Internet***

Banka Botërore (faqja antikorrupsion), [www1.worldbank.org/publicsector/anticorrupt](http://www1.worldbank.org/publicsector/anticorrupt)  
World Bank (manuale dhe artikuj antikorrupsion), [www.worldbank.org/wbi/governance/library.html](http://www.worldbank.org/wbi/governance/library.html)

Regjistri i Biznesit për Mitën dhe Zhvatjen Ndërkombëtare, [www.bribeline.org](http://www.bribeline.org)

Komisioni i Pavarur kundër Korrupsionit në Hong Kong, [www.icac.org.hk](http://www.icac.org.hk)

Komisioni i Pavarur kundër Korrupsionit në New South Wales, Australi,  
[www.icac.nsw.gov.au](http://www.icac.nsw.gov.au)

Centrul de resurse anticoruptie al organizatiilor reunite în U4, [www.u4.no](http://www.u4.no)

GRECO, CoE, [www.coe.int/t/dg1/greco/webresources/organisations\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg1/greco/webresources/organisations_en.asp)

Initiativa Regionala Anticoruptie (ish -SPAI), [www.rai-see.org](http://www.rai-see.org)

Qendër Interneti për Kërkime Korrupsioni, [www.icgg.org](http://www.icgg.org)

Instituti për Etikën Globale, [www.globalethics.org](http://www.globalethics.org)

Qendra e Etikës Online, SUA, [www.onlineethics.org](http://www.onlineethics.org)

Transparency International (organizata dhe dokumente antikorrupsion),  
[www.transparency.org/index.php/misc/link\\_list](http://www.transparency.org/index.php/misc/link_list)

UNICORN, [www.againstcorruption.org](http://www.againstcorruption.org)